

# FJALA

Fjala t'urren – zhgënjën  
T'mallkon – qorton  
Ajo të shkel – përkëdhel  
Të zhduk – të shpik  
Fjala është ujë që freskon  
Zjarr që shkrumon  
O, ajo është kamxhik  
Që stuhitë i ndërsen i mund!

Fjala është e thellë sa toka  
E lartë – sa qielli mbi koka  
E hidhët – sa mëkati  
Që në vete ndryn  
Fjala të zhvesh të ngjesh  
Të fryn e shfryn –  
E bukur është kur sjell lulzim në tokë.

*Abdylazis Islami*



## *Fjalë dbe shprehje*

zhgënjën – dëshpëron  
mëkat – gjynah, shkelje e rregullave fetare



## *Bisedë rreth vjershës*

Ç'mendon ju, për çfarë fjale mendon e flet poeti?  
Çfarë fuqie ka fjala?  
Me çka krahason poeti fuqinë e fjalës?  
Pse thotë poeti “fjala është ujë që freskon”?



Abdylazis Islami

**Abdylazis Islami** i lindur në f. Gajre të Tetovës, (1930 - 2005) është njëri prej shkrimtarëve më të njohur bashkëkohorë shqiptarë, i cili krijoi në gjuhën shqipe në R Maqedonisë. Me shkrime letrare filloi të merret herët (më 1954) dhe ka botuar më shumë përmbledhje me poezi dhe prozë. Shkroi për fëmijë dhe për të rritur.

Për fëmijë ka botuar këto vepra: “Mëngjesi në fshat”, “Korrieri Artan Arta”, “Kujtime dhe ëndërrime” etj.

## MËSUESI IM I PARË

---

E kujtoj shumë herë mësuesin tim të parë. E kujtoj dhe mallëngjehem. Ne e donim dhe e respektonim shumë.

Ai ishte një burrë me trup mesatar, i hequr në fytyrë. Nuk ish plak, po flokët i qenë zbardhur. Mbante një palë syze me xham të trashë. Ishte i ngadalshëm në të ecur dhe shumë i kujdesshëm në çdo punë. Veç ta shihnit me sa durim e rregull i ndreqte detyrat! Kurrë nuk thërriste, fliste shtruar e të bënte ta dëgjoje me gojë hapur.

Vetëm atë mësues kish fshati dhe ai punonte me të pesë klasat. Dhoma e mësimit ishte e vogël e s’na merrte të gjithëve. Dy klasa mblidheshin për mësim pasdite, të tjerët paradite.

Kështu atij i duhej të punonte shumë. Ne e shihnim që lodhej. Shpeshherë ulej në karrigë, mbështeste bërrylat në tavolinë e mblidhte vetullat me mundim. Nganjëherë ishte i verdhë në fytyrë e kollitej, po mësimin s’e linte kurrë.

Ai jetonte filli vetëm. Në qytet shkonte vetëm në kohën e pushimeve... Ne ishim mësuar aq shumë me të sa që nuk e merrnim dot me mend që një ditë mund të ndaheshim.

Por e sollí rasti të ndahemi fare papritur.

Ishte vjeshhtë. Koha ishte e vrenjtur. Rrallë hapej qielli, vetëm disa çaste. Retë dendësoheshin prapë dhe dukej sikur ishte mbrëmje.

Kishim bërë 3 orë mësimi. Orën e fundit kishim këngë.

Nuk kishim për të mësuar ndonjë të re. Përsëritëm ato që dinim dhe pastaj mësuesi tha:

- Kush di ndonjë tjetër?

- Di unë, zoti mësues – u hodh e tha Maqua i Ristos, që kish një zë të bukur e që i mësonte këngët me një të dëgjuar.

- Pa hë, ta dëgjojmë njëherë.

Maqua u ngrit më këmbë, u koll një herë, e pastaj ia mori:

*“Bashkoku shok’ me ne në çetë,  
malit të lartë të shkojm’ përpjet...”*

- Këtë e dimë dhe ne! – thanë ca të tjerë.

Mësuesi nuk foli, po bëri që të fillonim të gjithë dhe vetë mbajti vesh:

*“...Se atje, o shokë kemi foletë  
ne shqipo, shqiponjat partizan...”*

Klasa buçiste. Mësuesi qeshte e vetëm lozte dorën.

Kur mbaruam këtë këngë, si e pa se mësuesit iu bë qejfi, u ngrit edhe Tirka:

- Edhe unë di një këngë. A ta këndoj?

Dhe filloi:

*“Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë  
ndizet lufta për liri dhe derdbet gjak...”*

Veç të ishit atje e të dëgjonit se sa me qejf këndonim! Sidomos për vargun: “Janë trimat partizanë që luftojnë...” ishim gati të shkullnim mushkëritë.

Mësuesi ynë nuk ndenji më duke dëgjuar, po erdhi pranë nesh dhe ia mori edhe ai.

Atëherë ne s’mbaheshim fare!...

Po akoma nuk kishim mbaruar këngën, kur dera e shkollës u shty me forcë dhe brenda hynë me rrëmbim tre burra trupmëdhenj. Të tre ishin të armatosur.

Burrat që hynë mbanin rroba shajaku. Njëri prej tyre kish varur në sup një automatik të ri, ndërsa të tjerët mbanin pushkë të gjata: në brez kishin ngjeshur nga një gjerdan plot me fishekë e nga një revole të madhe. Në kapelat pa strehë u dallohej që atje tej zhgaba e madhe dykrerëshe. Fytyrat i kishin të vrenjtura e vështrimin të egër.

Kur hodhëm sytë nga dritaret, pamë se oborri dhe rrugët po mbusheshin me

njerëz të tillë të armatosur.

E ndaluam përnjëherësh këngën dhe të trembur, shikuam mësuesin. Ai mbeti një copë herë si i ngrirë, pastaj u tha atyre:

- Zotërinj, ju lutem, pse hyni kështu pa trokitur? Unë nuk lejoj... nuk lejoj, jam në mësim.

Të tillë mësim bën ti, edepsëz?

Kjo këngë që këndon ju, është për lirinë e komunistëve. Ne nuk e duam një liri të tillë!

Ndryshe, pra, qenka liria juaj?

Neperkë! Bën sikur nuk kupton... Dhe ma paska atë gjuhë brisk. Lidhëni! – urdhëroi burri hijerëndë, i cili, siç na thanë më vonë, ishte komandant për atë zonë.

Dy të tjerët ia lidhën mësuesit duart prapa dhe zunë ta shtynin për nga dera. Zotërinj... përse kjo? Dua ta di shkakun...

E dimë ne!

Të paktën më lini sa të përshëndetem me nxënësit e mi.

Nuk e lanë të mbaronte fjalën. Njëri e shtyri me kondak dhe mësuesi desh u rrëzua. Para se të kalonte pragun e derës, ktheu kokën nga ne e tha duke buzëqeshur:

Lamtumirë, nxënësit e mi të dashur. Ju mësoni e këndon këngë të tilla... Ato janë të vërteta! Më kuptoni? Të vërteta!

Ai doli i shtyrë. Ne zumë të qanim...

*Sipas Petraq Zoto*



### *Fjalë dhe shprehje*

arrestim – burgosje

krekosje – mburrje, krenim

mistreca – emër për buzës për fëmijët e vegjël dhe të prapambetur



### *Bisedë rreth tekstit*

Pse e arrestuan mësuesin?

Çfarë këngësh u mësonte mësuesi nxënësve të tij?

Në çfarë kohe ka ndodhur kjo?

Nën sundimin e kujt ishte atëherë populli shqiptar?

Në të dalë nga dera ç'u tha mësuesi nxënësve?

Po nxënësit ç'bënë?



### *Detyrë*

Komentoni tekstin bashkë me arsimtarin.

# MALLI I ATDHEUT

Kur vete njeriu i lirë e i vetëm, larg atdheut, viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsira e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo ta harrosh Shqipërinë, po të mos vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S'di ç'të mungon, s'di ç'të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën e, pikë së pari, herë-herë, pastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtim i prindërve, i miqve dhe i shokëve, kujtim i dheut ku lindëm e u rritëm, ku qan foshnja e ku lozin djemtë, kujtim i atyre maleve, larg të cilave nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtim i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e më tepër kujtimi, dëshira e etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërrmojnë me të vërtetë zemrën. Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjti mall e dashuri e shenjta, kush është ai shqiptar që s'e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jesh jashtë Shqipërisë e të jesh larg, për ta kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri!

Ajo më e zbrazura, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parrëfyeshëm, se na sjell një copë të atdheut.

*Faik Konica*



## *Fjalë dhe shprehje*

ta përgëzojnë zemrën – të gëzojnë shumë shpirtërisht  
ta dërrmojnë zemrën – të tronditin shumë  
i parrëfyeshëm – i patregueshëm, i paparashikueshëm  
ca të liga ka – ka ca gjëra të këqia



## *Bisedë rreth tekstit*

Çfarë veçorish ka rrëfimi i autorit në këtë prozë të shkurtër artistike?  
Si e shpjegoni që ka ngjyrat e një krijimi poetik?  
Si e jep autori mallin dhe dashurinë për atdheun?  
Ç'figura letrare gjeni në këtë pjesë?  
Shpjegoni se si i ka ndërtuar autori ato dhe ku qëndron bukuria e tyre.



## Detyrë

Në qoftë se keni njerëz të afërt, që kanë qenë për pak ose shumë kohë larg atdheut, bisedoni me ta dhe sillni në klasë mbresat e përshtypjet që kanë ata për mallin ndaj atdheut.



Faik Konica

*Faik Konica* (1875- 1942) është një nga mjeshtrit e fjalës së bukur shqipe dhe “krijues i prozës moderne shqiptare”, siç e ka përcaktuar Fan Noli. Proza e tij artistike shquhet jo vetëm nga dashuria për gjuhën shqipe, por edhe nga ndjeshmëria e lartë artistike. Krijimtaria artistike dhe publicistika e F.Konicës tingëllon e fuqishme. Ajo është e qartë, e bukur dhe e natyrshme.

Faik Konica shkroi: “Gjuha jonë”, “Helena e Trojës”, “Anës liqenit” etj.

Vepra më e njohur e Faik Konicës është “Doktor gjilpëra...”



## ARBNESHËS ZARË

---

Ah, pse fjalët s'm'i kupton të nxehta si zjarr,  
Moj arbneshe e bukur, si zan' e malit?  
Nji gjakut na jemi, shpirtna mitarë,  
Nji votre atnore nji zemre shkambit.  
Po ndi se ndër sy të digjet nji flakë,  
Si dritë e pishtarit heret n'agime,  
Çmallen syt e etshëm molisë dhe mpakë  
N'valët e detit, moj Arbnesha ime.  
Oh, fol me at gjuhë t'ambël dhe të lehtë,  
Si zogut i beharit kur shfryhet në degë,  
Rrëfema sot shpirtin të gjanë sa nji det.  
Se bashkë kemi lindë në nji truall që na përgdhel.  
Dy kallij t'nji trupi-motër dhe vëlla  
Dot s'kuptohen, memeca kanë mbetë,  
Tretën të dy shpesh për t'u pa,  
Se zemra prej zemrës s'ndahet përjetë.  
Sot mos më thuej: "ciau", Bjondin e bukur,  
Se deti do të mbushet prej lotëve të mij.  
N'dhena e huej do të tretesh si flutur,  
Ku syni s'do të shofi, veshi s'do të ndinjë.  
Rri këtu së bashku fatin me e nda  
Dy fjalë të hieshme t'i them arbnisht.  
Se pllajat taliane kanë me na nda,  
Si dritën prej synit, si ashtin me misht.  
Fol dhe nji herë skalitmi në zemër  
Do fjalë të zemrës: "Janë t' gjakut tanë!"  
Se s'dij, moj Arbneshe, a do të ve ma themër  
N'zallin e Zarës, t'lume kët anë.  
Atje përtej dielli s'ngroh e hana s'ndrit,  
Në mes buzëve, si akulli, fjala të ngrinë;  
Nëpët pllajat taliane, Arbneshe, ke m'u venitë,  
Tokën braktise, të gjorë e le shtëpinë.

*Murat Isaku*



## *Fjalë dhe shprehje*

mitare – e re me moshë  
 molisë – lodhje  
 mpakur – i mbetur pa frymë  
 braktisë – e lë, e lëshon



## *Bisedë rreth vjershës*

Përse bëhet fjalë në vjershë?  
 Cila është vajza që i drejtohet poeti?  
 Ç'lidhje ka kjo vajzë me “Nitën” e Josip Relës?  
 Pse thotë poeti bashkë kemi lindur në një truall?  
 Veçoni një emër të dalluar nga krijuesit më në zë arbëresh?



## *Detyrë*

Bëni një bisedë me arsimtarin për arbëreshët e Zarës, duke mos e harruar Josip Relën dhe dramën e tij “Nita”.



Murat Isaku

*Murat Isaku* (1928 - 2007) lindi në Gajre të Tetovës. Shkollën fillore e kreu në Tetovë, ndërsa normalen në Gjakovë. Vazhdoi studimet në Beograd dhe u diplomua në grupin e gjuhës dhe letërsisë më 1953.

Me shkrime është marrë qysh në bankat e shkollës së mesme. Botoi shumë vepra si: “Zana e malit”, “Buzëqeshjet e mesditës”, “Dielli e din rrugën e vet” etj.





# FSHATI IM

---

Sokol,

Letrën ta vonova, se të prisnim, por ti s'pasje mundësi që të na vish. Kjo na dëshpëroi, jo vetëm mua me nënën e me babagjyshin, por edhe shokët. Ne të prisnim me padrurim. Tani dashke të të tregoj ndonjë gjë për fshatin. Po të shkruaj, por me zemër të thyer, pse s'na erdhe.

Fshati ynë? A e di: merre me mend një liqen të bukur rrethuar me male të larta, - të bleruara dimër e verë – me dëllinja dhe me pisha të egra. Merre me mend edhe vargmalin si është Mali i Thatë yni e prej tij një fushë që shtrihet tatëpjetë e vjen e puthet me ujërat e liqenit. Merre me mend se nga kjo fushë shkëputet një siujdhesë në formë tumbë, që futet edhe më thellë në liqen. Mbi këtë tumbë mendo një fshat me ca shtëpi përdhese, me disa të tjera të reja, - aty këtu të zë syri edhe gërmadha – dhe pranë çdo shtëpie do të shohësh lëmenjtë. Ja ky është fshati ynë. Me të vërtetë natyrën e kemi shumë të bukur edhe të gjithë miqtë, Kallamasai ynë, që na vinë, mbeten gojëhapur.

Dhe është për t'u habitur me këtë bukuri: ujërat e liqenit na rrethojnë nga të trija anët e ne jemi bërë-si të themi-shokë që në foshnjëri me këto ujra. Gjatë verës, që kur ishim të vegjël, mundoheshim të bënim not këmbëzbathur e me rrobat arna-arna; not me gjithë rroba! Kushedi sa herë i kam vajtur nënës në shtëpi laçkë nga trupi si pul'e lagur. Ajo e shkreta më rrëmbente, e në vend që të më jepte ndonjë dackë, më shtrëngonte në gji e shpejt e shpejt m'i ndronte rrobat. Një marrëzi të tillë e bëra edhe vjet, kur isha në klasën e gjashtë: Pirros i kishte sjellë i ati një top llastiku; se gjithë me topa prej lecke luajmë. E që thua ti, më thërret Pirrua i gëzuar e vemi të luajmë te lëndina e Kosornikut. Ama është një lëndinë e bukur atje, që ka edhe dy mana degëgjera për hije, - ke edhe flladin e liqenit, - e luaj tërë ditën në mes të zhegut, dhe të mos djersitesh fare. E ne aty të vajtëm. Na erdhi edhe Vasoja, edhe Gjergji, edhe Todri. Filluam lodrën. Por do ti sa i rrash njëherë – e t'i jap një shkelmë të fortë e ferr... topi mu në mes të liqenit! Po tani? Mua sa s'më ra pika! S'mu durua: mbylla sytë e u futa mu në ujë, edhe e di si? Me gjithë rroba! Topin e shpëtova, por unë u bëra gazi i botës!

Ja kështu na gënjen liqeni, të tilla ngatërresa kemi me të. Por këto janë ngatërresa që na pëlqejnë. Le verës, por edhe dimrit me liqenin jemi miq; sidomos sivjet që bën një dimër i fortë, liqenit nuk i jemi ndarë. Më pëlqen shumë edhe kur është i zemëruar, me ato dallgët e shkumbëzuara e të tërbuara. E di ç'bëjmë ne? Vemë në zallishtet dhe përpiqemi t'i gënjejmë dallgët? E si do të thuash? Ja kështu: kur

tërhiqet dallga nga bregu - ne ashtu si jemi mbathur me opingat e ndjekim valën në thellësi; kur fryhet ajo si e zemëruar, ne rendim të largohemi. Por shpesh herë ajo na mund: se si na gënjen e sakaqë me pllas – pllus na mbushen opingat me ujë. Ne shkulemi së qeshuri! Ka edhe më keq: duke dashur që t'i largohemi sa më shpejt dallgës, pengohemi dhe bëllduf më brenda në liqen. Dallga e shkumzuar duket sikur zbardh dhëmbët me ne na kalon mbi trup dhe më betër! Sivjet mua më qëlloi dy herë një gjë e tillë. Le Pirrua: është e pamundur që të mos shtrihet sa gjatë e gjerë nja dy herë në çdo lojë.

Por fshati ynë ka bukurira të ndryshme; për këto do të shkruaj herë pas here sipas rastit. Mos harro edhe ti: dua të më shkruash më gjatë. Na përshkruaj edhe vendin e përmendores së partizanit.

Mirupafshim

Ylli

*Sterjo Spasse*



### *Fjalë dhe shprehje*

siujdhesë – gadishull

tumbë – kodër

gërmadha – grumbull, por edhe rrënimë

u bëra gazi i botës – u bëra të qeshë bota me mua

ma shkeli syrin – ma bëri me shenjë



### *Bisedë rreth tekstit*

Në këtë tregim të shkurtër, personazhi, Ylli ka bërë një përshkrim të fshatit të tij. Këtë tregim shkrimtari e ka shkruar në formë letre. Pra edhe ky është tregim.

- A mund ta pasqyroni pozitën e këtij fshati?

- Përshkruani parafytyrimin tuaj!

- Bëni përshkrimin e fshatit apo të qytetit tuaj!

- Çfarë figure ka në frazën “Liqeni më pëlqen shumë edhe kur është i zemëruar”?



Sterjo Spasse

*Sterjo Spasse* (1914 – 1980) lindi në fshatin Gollomboç pranë liqenit të Prespës rrethi i Korçës. Ka shkruar mbi 10 romane dhe shumë vëllime me tregime. Romani i tij i parë është “Pse”. U bë i njohur me “Afërditën”, roman i njohur me vite si lexim shkollor. Pastaj me romanet :”Afërdita përsëri në fshat”, “Ata nuk ishin vetëm” etj.

# TANUSHËN VETË E KAM PA ...

---

Atëherë djali ka nisë me folë:  
Kah kam vlla e kah kam motër,  
vdeksha para n'u afrosha  
se gjithë gratë e krahinës, ku janë,  
se gjithë vashat e Jutbinës, ku janë,  
bash si motra që po m'duken.  
Dheu m'ka mblue e fat s'i qita vedit,  
po s'e mora Tanushën e Kralit!  
E unë Tanushën vet 'e kam pa:  
gja ma t'mirë s'sheh njeri në këtë diell!  
Vetulla e saj si fiskaja;  
shtegu i ballit, si shtegu i malit,  
kur merr hana me prendue;  
syni i saj si kokrra e qershisë;  
e ka qerpikun si krahu i dallëndyshes;  
fytyra e saj si kuqet molla n'degë;  
hunda e drejt – o si kalemi i Tushës;  
goja e vogël si lulja që shpërthen;  
dhambët e bardhë si gurëzit e lumit,  
fill mbas shiut, kur po shndërit dielli;  
qafa e saj si qafa e pëllumbit;  
shtati i saj porsi shtat çetine  
mishi i dorës, porsi rremi i shemshirit...  
kurrkund një shteg që nuk më latë  
për me dalë deri në Krali!  
Sa mirë nama bjeshkët m'i paska ndigjue!  
Sa shpejt deti ka ndigjue!  
Por n'qafë m'paçi, mori bjeshkët e Nalta,  
E e ka çue një frymë të fortë,  
e e ka çue një frymë të nxehtë,

e e ka lshue krejt renë e zezë.  
Bijnë orteqet nëpër gropa,  
ushtojnë malet si prej motit!  
Por tri ditë e ma s'ka zgjat,  
a shkri bora e ka ra n'lumë;  
por tri javë e ma ska zgjatë,  
Ç'ka e ka ba lumi atë të bardhë?  
T'bardhët e bjeshkëve krejt e ka mbytë n'det...  
ç'po këndojnë bylbylat n'mal  
ç'po lodrojnë fëmija n'fushë;  
Shpejt me dalë te thani;  
se ka shpërthyer ahi!  
Atëherë djali i Mujit i ka thënë;  
Qe tash gjokun, Mujë ti me ma dhanë...  
Gjokun e vet Muji ia ka dhanë...  
Atëherë djali i ka kcyë gjokut n'shpinë;  
T'mirë u pafshim! Mujit i ka thanë.

*Këngë kreshnike*

### *Shënim*

Të pjesa “Tanushën vetë e kam pa” autori popullor përmes fjalëve të Halilit (vëllai i Mujit) jep me forcë të rrallë artistike portretin e Tanushës si dhe peizazhin pranveror të bjeshkëve shqiptare. Ky fragment popullor i takon grupit të këngëve kreshnike (legjendare). Në letërsinë popullore shqiptare është i njohur cikli i këngëve të Mujit dhe Halilit, prej ku është nxjerrë edhe kjo këngë.

*Në këngët legjendare kreshnike dominojnë elementet fantastike si p. sh. “kur pi ujë Muji, shterroj në gurrat” ose “kur merr frymë Muji duke fjetur, lëvizin nga vendi dushqet e malit” etj. Të këngët legjendare shpesh përdoret edhe hiperbola.*



### *Fjalë dhe shprehje*

krahinë-a – këtu: vendi i kreshnikëve  
fiskajë-a – thupër e hollë  
me prendue – të perëndojë

rrem-i – këtu: dega  
shemshir-i – lloj druri  
thani – stan në bjeshkë



### *Bisedë rreth këngës kreshnike*

Si e përfytyroni portretin e Tanushës që jepet në 25 vargjet e para?  
Ç'figura letrare janë përdorur për përshkrimin e portretit të saj?  
Si paraqitet peizazhi pranveror në vargjet e tjera? Ç'figura letrare janë  
përdorur për këtë?  
Si e jep poeti popullor kalimin nga natyra dimërore në atë pranverore.  
Lexoni vargje ku jepet ky kalim.  
Si i kupton vargjet:  
Ç'ka e ka ba lumi atë të bardhë?  
... ka shpërthye ahi...



### *Detyrë*

Gjeni hiperbolën në këtë këngë dhe bëni analizën e saj, duke e plotësuar me shembuj të tjerë që dini ju.

*Në epikën popullore kemi edhe shumë këngë me përmbajtje tregimtare për persona dhe ngjarje të rëndësishme nga e kaluara e laudishme e popullit tonë. Do të dallojmë këtu: Këngët legjendare dhe Këngët historike.*

*Këngët legjendare përfshijnë ciklin e njohur të këngëve të Mujit, Halilit etj. Në këngët e këtij lloji vjen në shprehje të plotë imagjinata dhe elementet fantastike.*

*Në ciklin e këngëve epike historike përfshihen këngët për ngjarje të njohura historike ashtu si i ka përjetuar dhe kënduar artisti popullor. Shumë këngë të këtij lloji ndërliken me kryetrimin tonë historik dhe legjendar, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun.*

*Edhe në këngët për trimat legjendarë hiperbolla është figura të cilën e basim më shpesh.*

# KËNGA IME MË E BUKUR

---

Po udhëtojnë turistët skaj më skaj vendit. Po kalojnë me mjete të ndryshme. Kush me trena kush me autobusë. Shumica më e madhe me vetura. E fëmijët të pahalle, as që mendojnë se kush është prej tyre spiun dhe hileqar e kush turist i vërtetë e shtegtar.

Diku afër pjacës së qytetit, u ndal një veturë. Veturë e madhe, e bukur. Menjëherë e rrethuan fëmijët kureshtarë.

Po e kundrojnë tanimë automobilin, po i kënaqin sytë me të. Po e përkëdhelin prej së largu, po e llastojnë.

Preke! – i tha njëri shoqit.

Preke ti! – iu përgjegj ky.

Hajde ti më parë.

Jo, jo, preke ti e mandej unë.

Po shtyhen nga pak fëmijët, po ngucen në mahi. Çdo gjë është ngacmim për ta, çdo gjë lojë e ngazëllim.

Hajde preke, hajde!

Jo, jo, preke ti njëherë, preke.

Po bredhin të huajtë andej-këndeje. Po e gjezdisin vendin skaj më skaj, po shikojnë, po fotografojnë.

- Stu-de-bac-ker , - stu-de-bac-ker .... po përshpërisin buzët e fëmijëve me sy të ngulur në markën e vizëllueshme të automobilit.

- Stu-de-bac-ker ...

- Eh, sa qesharakë janë ca prej këtyre turistëve të huaj. Jo për rrobet e tyre, jo as për hundët. Për diçka tjetër janë qesharakë ata.

Ballkani është xhungëll, mendon ende shumica prej tyre. E njerëzit e tij pa vlefte e dituri. Të lindur vetëm për argatni, për kaçakë e hajdutni.

Qe përse janë qesharakë njerëz të këtyllë. Jo për pantallonat pra, jo as për të folmen. Për botkuptimet e tyre janë qesharakë ata.

Stu-de-bac-ker, Stu-de-bac-ker ... prapë i vargojnë rrokjet fëmijët kureshtarë.

Një mashkull dhe një femër zbritën prej automobilit të tyre. U futën në popull, u përzien me të. Ishte ditë pazari, ditë tollovie. Botë, pra, e larme për kah rrobat, për kah kapuçat. E larme në të pamit, në të folunit. Një qytet ynë i zakonshëm dhe njerëz të zakonshëm. Të varfër ngapak për nga pasuria, por jo edhe nga burrëria.

Po shtyhen njerëzit në treg. Po shtyhen, po shesin e po blejnë. Aty-këtu dikush

gon diçka, mban ... Aty-këtu bërtet dikush, pyet me zë.

Në pikë të vapës në treg.

Aty afër një muri janë ulur nja tre burra. Në tokë, kuptohet. Para tyre është marhamja e shtruar, mbi të buka, pranë bukës-specat, domatet, kripa.

Po drekojnë burrat e varfër. Po ngjyejnë në kripë me perime.

Pak më tej – është një djalosh në këmbë. Po i këput copat e somunes. Një kafshatë për vete, një për qenin e tij. Një me një pra, pa gabuar asnjëherë.

Njerëz të varfër me të vërtetë. Të varfër, por jo në çdo gjë. Së paku jo në burrëri e fisnikëri, në ndjenja njerëzore.

Po vëzhgojnë turistët e huaj, po fotografojnë. Po i fusin hundët andej-këndeje, po çmojnë. Mashkulli e femra u kthyen tanimë. U vendosën në veturën e tyre, në makinën e vizëllueshme.

- Stu-de-bac-ker ... edhe njëherë i vargoi rrokjet njëri prej çunave. I buzëqeshi zonja kur e vërejti. I buzëqeshi pranë timonit. Mandej i gugati diçka ëmbël. E më në fund? Më në fund ia zgjati çunit kutinë plot me biskota.

- Aj, aj, aj! ... Çka ndodhi, burra, pa pritë e pa kujtuar!

Vocrraku u tërhoq sikur ishte përvëlur. U tërhoq befas me fytyrë të vrenjtur. E gruaja pra ishte fytyrë ëmbël, e bukur sa s'bën më. Po edhe biskotat i ofronte. Plot një kuti e jo mahi. Nja dhjetë palë sy u ngulën në faqet e femrës, në buzët e saj në gaz. Jo, më se njëzet palë sy u drejtuan atje tanimë. Atje kah zonja dhe kutia në dorën e saj.

Të gjithë sytë u bën tanimë si një palë sy të vetëm. Sy tejet të mëdhej.

“A thua do t'i marrë biskotat?” – po pyesin vetveten kureshtarët.

“Po sigurisht do ta marrë!” – Do ta marrë kutinë e ofruar, do ta marrë pa ngurrim – pëshpërisin disa.

“Jo, nuk do ta marrë!” – mendon shumica gati me zë.

“Do ta marrë, do ta marrë! Kutia është lara-lara dhe plot me biskota”

“Jo, jo! ... Nuk do të përulet çuni. Di ai për krenari”.

“Megjithatë do ta marrë! Të ëmbla janë biskotat, të ëmbla dhe shumë ndjellacake”.

Zotëroi më në fund njëfarë qetësie. Luhatje e mundimshme. Të gjithëve iu ngrehën damarët si telat e qitelisë. Me çuna e vashëza, me burra e burreca. Të gjithë pritnin me padurim, me kureshtje.

Jo! – i refuzoi vocrraku biskotat dhe i fshehu duart pas shpine.

Haaa! – bënë të gjithë gati njëzërit.

Pirolla të qoftë, o çun krenar! bërtiti dikush tejet i gazmuar.

Vocrraku bëri nja dy hapa dhe u ndal. Dora e zonjës mbeti në hava. Me të edhe biskotat, vocrraku këmbëzbathur refuzoi t'i marrë, pra.

Kutia e zonjës tani u drejtua kah fëmijët e tjerë. Mirëpo as duart e tyre nuk u zgjatën t'i merrnin. Duke tundur kryet në shenjë mospranimi të gjithë u tërhoqën

prapa.

E huaja u habit sa s'bën më. U hutua gati krejt. Buzëqeshja e saj e ëmbël u shndërrua tani në çudi e zemërim. Si në pezëm, mbylli derën me rraptimë. I dha mandej gaz automobilin dhe u zhduk fluturimthi.

- Udhë e mbarë, o jabanxhikë e pasur! – bërtiti pas saj një fshatar që mbante njëfarë thesi nën sqetull. Udhë e mbarë dhe mbajti në mend këta çuna krenarë.

Fëmijët e shikuan me sy të vizëllueshëm. Me miqësi, me buzëqeshje.

- Rrofshi dhe qofshi, o fëmijë sokola! – ua bëri gëzueshëm dhe ia mori njërit faqen ndër shuplaka. Paj, ju jeni vetë mrekullia dhe hiç më pak, ta dini. Kënga ime më e bukura, a po më dëgjoni. Të këtillë ju dua, bre çuna. Të këtillë kur jeni të zotët ta zotëroni vetveten. Lakmia e shkretë gjithmonë e ka koritur njeriun, ju sikur e ditki këtë. Djelmosha të vyer do të bëhi, po shihet kjo më. Dhe burra të fortë, trima, pa pikë dyshimi ...

Shumë u gëzua Tafil Gaca për këtë qëndrim krenar të fëmijëve. Shumë u gëzua dhe po buzëqesh pa ndarë. E me të edhe të tjerët, plot kapuçbardhë, por edhe kaçketa.

Aty pranë, në treg. Në pisk të vapës, në Prishtinë.

*Hivzi Sulejmani*



### *Bisedë rreth tekstit*

Pse i quan shkrimtari “qesharakë” disa nga turistët që e vizitojnë vendin tonë?

A pajtoheni me të?

Arsyetoni qëndrimin tuaj.

Çka zgjoi interesimin e fëmijëve?

A ishte e arsyeshme frika (dyshimi) i të rriturve?

Në fund çka ngadhëjeu: lakmia apo krenaria?

Pse i quan shkrimtari vogëlushët “Kënga ime më e bukur”?

Pra, tregoni më në fund cila është tema dhe ideja e shkrimtarit?

*Hivzi Sulejmani* (1912 - 1975) është njëri ndër shkrimtarët më të frytshëm të letërsisë sonë të pasluftës. Mori pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare, prandaj edhe veprat e tij, kryesisht, janë me tematikë nga lufta për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë. Gati tërë jetën pas çlirimit e kaloi në Prishtinë.



Hivzi Sulejmani

Ka shkruar poezi, prozë dhe vepra dramatike, për fëmijë dhe të rritur si: “Fëmijët e lumit tim”, “Njerëzit”, “Era dhe kolona” etj.



# KOPSHTI I DASHURISË

---

O Pëllump' i shkruar,  
do t' të marr në duar  
dhe duke kënduar  
gjetkë do t' të shpie;

në një vënt t' uruar  
dhe të lulëzuar,  
në uj' të kulluar  
edhe nënë hie;

afër tek një lumë  
ku ka lule shumë  
të biem në gjumë,  
hëna të na ndrijë;

yjtë të shukojnë,  
zoqtë të këndojnë  
edhe të na zgjojnë  
dita kur të vijë.

Pa ngrën' e pa pirë  
s' mbetemi, moj Mirë,  
se u' ndaj të gdhirë  
dërgoj e na sjellin:

qumësht të dhirë  
dhe djathë të mirë  
pa uj' e pa hirë,  
dhe rrush kur të vjelin;

ngjalë nga Janina,  
mjaltë nga Kanina,  
verë nga Voshtina,  
ujë nga Sopoti;

mollë nga Horia,  
mish nga dhënt'e mia,  
desh nga Labëria, -  
na e faltë Zoti!

*Andon Z. Çajupi*

### *Ditirambi*

*Ditiramb quhet një lloj kënge lirike, e gëzueshme, në të cilën vjersbëtari plot shend këndon lumturinë dhe gëzimin e jetës.*

*Pothuaj se të gjithë rilindësit kanë shkruar kësi lloj vjersbash: Naimi, Kristo Floqi, Çajupi etj.*

*Si shembull për ditirambin zgjodhëm vjershën “Kopshti i dashurisë” të Andon Z. Çajupit.*



Andon Zako Çajupi

Andon Zako Çajupi (1866 - 1930) është poet, atdhetar e demokrat i shquar. Lindi në fshatin Sheper të Zagorisë. Studimet e larta i kreu jashtë atdheut dhe jetoi në Egjipt ku edhe vdiq. Poezitë e tij i ka botuar në vëllimin “Baba Tomori”. Ka shkruar edhe pjesë teatrore si “Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr”, “Pas vdekjes”, dhe “Burri i dheut”. Ka përkthyer bukur fabulat e La Fontenit.

Poezia e Çajupit të tërheq me gjallërinë dhe frymën e saj popullore shpeshherë plot humor.

# PËRTEJ VALËVE TË KOHËS

---

Të vërtetën e së vërtetës, as unë s'e di t'ju them sa breza kanë shkuar që kur u prish e u shkretua Katjeli i Mokrës.

Mbaj mend vetëm se kam dëgjuar nga pleqtë e lashtë, e këta nga pleqtë e tyre, se ky Katjeli i Mokrës paska qenë dikur ndoshta pesë a gjashtë breza përpara nesh – një fshat i madh, i begatshëm fort. Vendësit e tij paskëshin qenë trima të njohur e paskëshin luftuar me të vërtetë si burra në ballin e burrave për të mbrojtur vendin e nderin nga osmanllinjtë.

Nga ky shkak osmanllinjtë kur e morën, e paskan shkatërruar që nga themeli.

Sot, në gjithë grykën ku pat qenë njëherë katundi, janë përhapur pyje gështenjash, driza e dëllinja. Viset, sheshe të pllajave, janë bërë livadhe e ara, ku thekra na rritet dy bojë njeri. Në vise-vise duken edhe sot themelet e mureve të vjetra. Në vjeshtë a në pranverë, kur hapen brazdat e dheut, që dërmohen, andej-këndej, dalin copa pllakash të gdhendura me dorë e tulla të kuqe mu si flaka e zjarrit. Në dimër zbresin gjer këtu poshtë bishat e malit.

Vetëm kjo kodra e Shën Deljës, ku pat qenë dikur kisha e fshatit, ka mbetur edhe sot e pacenuar prej dorës së njeriut. Vendi i saj as lavrohet, as mbillet, as korrret. Këtu njihen edhe sot murishtat e vjetra të kishës e rrasat e rënda të themelit të pabluara prej kohës. Rreth e rrotull, nëpër plisa e fier, duken gurë varresh me çipe të mbuluar me myshk. Në mes të kishës së Shën Deljës, që i përngjan një anije të fundosur ndër ujëra, dheu është pak si i batisur dhe çapet e njeriut godasin me bosh.

Një pëlhurë fshehtësie, që të bën të biesh në mendime, mbulon të gjitha këto vise gërmadhash të lashta. Fshatarët që ngjiten të korrin thekrat e të mbledhin gështenjat edhe barinjtë e bagëtive rrëfejnë se shumë herë, e më fort në netët me hënë, dalin e shëtisin nëpër murishta e ledina njerëz të mëdhenj, të veshur me mëgore e fustane të bardha, edhe tretën pastaj, rishtas, me të thyerit e hënës.

Vraga, që nis nga ana e djathtë e Shën Deljës, zbret në fshat buzë liqenit, kurse ajo që nis nga ana e mëngjër, shkon kah pylli i dendur i gështenjave duke u ngjitur e duke zbritur kurrizit e çukave e del mbi gurin e Kolë Branës, një rrasë e lartë dy-tri hostene që qëndron mbi greminat e bregut.

Rrëfejnë gojë pas goje pleqtë e lashtë se këtu pat qenë në kohët e vjetra një qytezë e vogël, qyteza e Zotit Kolë Branë Katjelit.

Edhe thonë se këtij Kolë Branës i paskan humbur në luftërat e përgjakshme të asaj kohe, kur hyri turku në Shqipëri, të pesë djemtë e gjithë nipëria. Edhe si u sosën këta të gjithë edhe turqit iu afruan Katjelit, Kolë Brana ngjiti shkallët e gurta të qytezës, mbylli dyert dhe priti të afrohet rrebeshi. E atëherë, kur erdhi armiku, as dora, as këmba nuk iu drodh nga pleqëria. Shumë kohë gryka buçiti si buçet kur luftojnë trimat e ballit, luftonte Zoti Kolë Brana vetë...

Më vonë, kur kështjella ra, nuk u gjend brenda veç se një plak i thinjur me gjoksin e mbushur plot plagë. Zoti Kolë Brana i Katjelit të Mokrës nuk ishte më në jetë.

Që asaj kohe muret e kështjellës u gremisën e mbretëria e dëllinjave ia mori vendin. Vetëm guri i Kolë Branës, si thuhet edhe sot, ka mbetur i patundur prej valëve të kohës e prej valëve të osmanllinjve...

*Mitrush Kuteli*

## *Shënim*

“Përtej valëve të kohës”, është një fragment i një novele më të gjatë të Mitrush Kutelit. Lexoni me kujdes dhe vëreni pasojat e sulmit të osmanëve dhe të robërisë së gjatë mbi popullin shqiptar. Përqëndrohuni posaçërisht në qëndresën e Kolë Branë Katjelit, i cili jo vetëm se dha pesë djem e shumë nipër për ta mbrojtur atdheun, por edhe vetë tregoi shembull të rrallë qëndrese dhe heroizmi.



### *Fjalë dhe shprehje*

**drizë-a** – farrëkuqe, merrqinjë, akacie, bagrem i egër

**plis-i** – copë dheu që ngre parmenda, copë e dheut me bar, bos

**rrebesh-i** – shi i rreptë e i shkurtër, por edhe sulm i ushtrisë me furi, si furtuna



### *Bisedë rreth tekstit*

Tregoni nga e merr motivin shkrimtari dhe në çka e mbështet këtë rrëfim për shkretimin e Katjelit të Mokrës!

Çfarë përshtypjesh u bën ky rrëfim dhe çfarë ndjenjash nxit tek ju!

Ç’deshi shkrimtari kur e thuri një tregim të këtillë letrar?

Çka mund të mësojmë prej tij?

A i harron populli ata që luftojnë për ta mbrojtur atdheun?



## Detyrë

Përqëndrohuni në përfundimin e kësaj cope, sepse këtu edhe shkrimtari ka dashur të thotë diçka të madhe, të cilën ju duhet ta zbuloni!



Mitrush Kuteli  
(1907 - 1966)

*Mitrush Kuteli* (Dhimitër Pasko, 1907 – 1966) lindi në Pogradec. Mësimet e mesme i kreu në Selanik, ndërsa studimet e larta në Bukuresht. Njihet si prozator i shquar i letërsisë sonë.

Veprat e tij letrare më të njohura janë: “Netë shqiptare”, “Ago Jakupi”, “Këngë e britmë nga qyteti i djegur”, “Tregime të moçme shqiptare” etj.



## TË DUA - KOSOVË

Të dua për duart e çara duke lidhur  
Shekujt sukave të zgjuara,  
Për duart mbi tanksa të Hitlerit e Musolinit,  
Për pishtarët e lirisë.  
Të dua për këngët e babait  
Mbrëmjeve pa dritë,  
Për fishekët e tij nëpër xhepa,  
Për lutjet e nënave vetëtimave,  
Për pranverat që nxjerrë nga gjoksi,  
Për yjet, diejt tokës së plleshme.  
Të dua për duart që ngrejne ura,  
Që lidhin mesveti popujt,  
Për ato që ndërtojnë shkolla në fshat.

Kosovë shqiptonjë vallëtare shkëmbinjsh  
Dhe fushash të bleruara!  
Të dua për një kështjellë eshtrash,  
Për një shpatë,  
Për një emër,  
Për gjithçka që shihet e preket,  
Për gjithçka në ëndërr e zbgjëndërr,  
Të dua kur qeshi, kur qaj,  
Kur ngritem, kur zbres,  
Kur eçtohem, kur kam uri,  
Kur dashuroj, kur çmendem

Kosovë zog i Diellit...

*Din Mehmeti*



### *Bisedë rreth vjershës*

Këtë poezi të bukur lirike nëse e lexoni me kujdesin e duhur dhe kërkoni ndihmën e arsimtarit tuaj, do ta kuptoni më lehtë. Ku e ka gjetur poeti burimin e frymëzimit në këtë vjershë? Si mund të formulohet ideja kryesore e kësaj vjershe? Kujt i drejtohet ai? A dini ndonjë vjershë tjetër ku i këndohet Kosovës?

### *Poezia refleksive*

*Poezi refleksive ose mendimtare e quajmë atë poezi lirike ku poeti shfaq marrëdhëniet e veta emocionale ndaj një të vërtete, që ka të bëjë me njeriun dhe jetën, si p.sh. te kjo poezi e Din Mehmetit.*

# DUHANMBLEDHËSIT

---

Natë, natë gushti, me ngrohtësi të jugut. Qielli i hapët ishte plot yje. Kudo qetësi. Errësira e tejpashme si rrjeta e marimangës. Poshtë në fushë shtohen shushurimat e ujërave të lodhura të Vardarit, sikur lajnë lodhjen e qytetit që fle. Ajri është i pasur dhe i ngopur me erën e mëngjesit të freskët. Mushkëritë e thithin me etje. Kjo është pjesa më e ëmbël e gjumit, pushimi më i ëmbël për punëtorët e lodhur. Menjëherë këndesat dallojnë agimin nga lindja e largët dhe me zërin e tyre përhëndesin. Jo, patjetër duhet ngritur, pa tjetër të ndërpritet gjumi: duhani mund të mblidhet vetëm para se të lindë dielli. Porsa ta ledhatojnë rrezet e para të diellit ai myket dhe kalbet. Zgjuhuni, o duhanmbledhës të lodhur! Ndërpreni pjesën më të ëmbël të gjumit tuaj e lëshohuni nëpër fushat e gjata të Vardarit. Koha më e ëmbël duhet të kalohet në arat me duhan: vetëm kështu ai do të fitojë erën e tij të mirë.

Hapa të ngadalshëm.

Shtim thirrjesh, pëshpëritje.

- Lenkë!

- Naskë!

- Mari!

Zgjohen mbledhësit e lodhur. Ranë të flenë në orën nëntë tani në orën një të mesnatës duhet përsëri të ngrihen. Sytë e përgjumur i lajnë me pak ujë. Sytë u mbyllën prapë. Por jo: patjetër duhet të ngrihen.

Më parë marrin disa sende: ushqim. Hanë kur mbarojnë së mbledhuri duhanin. Të gjitha këto i fusin nëpër kosha, të cilat i ngarkojnë në gomarin që kotet. Ush bre!

Dhe grupet e vogla, duhanmbledhësit, pa u diktuar largohen nga qyteti dhe shpërndahen nëpër arat e gjera. Nëpërmjet të errësirës së tejpashme dallohen të qarta arat e mbjella me duhan. Ato janë copa të vogla katrore. Duhani mbillet në rreshta të drejtë.

Bima e njomë dhe e bukur është rritur një metër. Lart në majat ka lulëzuar. Prej lules e gjer në rrënjë plot me gjethe të gjelbëra – të errëta, ngjitëse dhe maja e gjethit ka formën e gjuhës së kthyer pak poshtë.

Më parë mblidhen gjethet e poshtme. Ato piqen më herët. Mirëpo duhani i tyre është më i dobët. Më i mirë është ai i gjetheve poshtë lules. Është e sigurtë se prej atij duhani mbledhësit nuk do të mundën të pinë asnjëherë. Munden vetëm fshehurazi.

Duhani është bimë që mbillet vonë. Bimë tropikale, që qëndron vetëm disa muaj, prej qershorit gjer në mes të shtatorit. Mblidhet nga fillimi i gushtit dhe ndehet që të thahet.

Kjo punë është e rëndë: gjethi mblidhet një nga një, radhitja e gjethit bëhet një nga një, e pastaj nxirren nga vargjet dhe palohen e ndërrohen disa herë.

*Koço Racin*



### *Fjalë dbe shprehje*

tejpamshme – tejdukshme

myket – prishet

ndehet – shtrohet, varet për të tharë



### *Bisedë rreth tekstit*

Punëtorët që e mbillnin duhanin, pse kishin të drejta të kufizuara mbi duhanin e tyre?

Tregoni sa rëndë është mbjellja e duhanit sipas përshkrimit në tregim?

Pse thotë shkrimtari se duhanmbledhësit nuk do të pinë asnjëherë nga duhani i tyre më i mirë?

Çdo të thotë se do ta pinë vetëm fshehurazi?



### *Detyrë*

Përshkruani mëngjesin e duhanmbledhësve.



Koço Racini

*Koço Racini* lindi në Veles më 1909 dhe u vra si partizan në vitin 1943. Është njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj maqedonas. Vepra e tij trajton tema **shoqërore, sociale**, është plot vuajta dhe revoltë kundër shfrytëzuesve të njerëzve punues.



# GJENIU I ANIJES

---

Vështroni si shklet sipër valash  
e tundet anije më nge  
Me krisma e me prush stërkalash,  
mbi të shkrepiti një rrufe...

Ti, det, brohori fshehtësire!  
Kuptim i potershëm, ti, det  
po heshtje: ndaj valës së nxirë  
Gjeniu i anijes po flet:

Prej zallit që sot po largohem,  
fillova mërgimin e ri  
hepohem...anohem...humbohem...  
po sulmin s'e ndal kurrsesi.

Përpara, kur shoh gjeratore  
dh'ato më gremisin në fund,  
mbi kulmin e valës malore  
unë heq të shpëtoj, sa me mund.

E mortit fatkeq në më çiku,  
n'u desh tmerrësisht të fundas,  
aspak nuk më thyen rreziku,  
po nis e përmbysëm me gaz.

Se prapa la vazhdën e ndritur,  
që hapa me shpirtin fatos,  
fistonin gazmör, ku pat shkitur  
valim' i anijes q'u sos.

Valim i anijes së lehtë  
qetohet, ndalohet, mbaron:  
gjeniu i anijes përjetë  
hepohet...anohet...valon.

*Lazgush Poradeci*

## *Sbënim*

Vjersha “Gjeniu i anijes” e Lasgush Poradeci është një ndër *lirikat* më të bukura të tij, që i kushtohet lundërtarit trim e guximtar, i cili nuk e përfill rrezikun. Ai kundrejt “tallazit armik” dhe vështirësive të mëdha, shkon me guxim, i bën ballë vdekjes me burrëri, duke qenë i sigurt se të tjerët do ta ndjekin udhën e tij dhe do të fitojnë.



### *Fjalë dhe shprehje*

gjeni-u – këtu lundërtari, dejtuesi i anijes

stërkalë-a – pikë uji që shpërndalet me vrull

hepohem - përkulem, epem

gjeratore - vorbull

valim - valëvitje (valon flamuri, kënga, gëzimi)

fistonin gazmor – fustanellën për çaste gëzimi (solemne)



### *Bisedë rreth vjershës*

Si i kuptoni fjalët e lundërtarit: “ Po sulmin s’ e ndal kurrsesi”?

Si del figura e tij në çastet plot tallaze e pengesa?

Çfarë e frymëzon atë të mos u trembet rrebesheve të jetës?

Ç’figura letrare gjejmë në këtë vjershë? Shpjegoni si janë ndërruar ato.

Si e përfytyroni lundërtarin (gjenium e anijes) që lufton me dallgët e fuqishme të detit?

Bëni portretizimin (tipizimin) fizik dhe psikik të tij (të lundërtarit)!



Lasgush Poradeci

*Lasgush Poradeci* (1899 - 1987) – emri i vërtetë Lazër Gusho, i lindur në Pogradec, është poet me ndjesi e shije të hollë artistike. Filloi të shkruajë vjersha që në rininë e hershme. Vjershat e tij janë kryesisht lirike. Këto i botoi më parë nëpër revista e fletore e më vonë në përmbledhjet “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”.

Poezia e Lasgushit shquhet për gjuhën e pasur shqipe me formë të përkryer artistike.

## I BIRI I GJAHTARIT PŁAK

---

Kishi ishte një djalë i fortë, kështu fliste populli, i fortë dhe i shëndoshë. E kishin ngrohë trembëdhjetë diellëra, siç e llogarisnin kohën bashkëfshatarët e tij.

I ati i Kishit qe gjahtar trim. Në një vjet thatësie e humbi jetën duke i shpëtuar jetën popullit. Ai u nxeh, shumë iu afrua arushës, e cila ia theu brinjët.

Po arusha kishte shumë mish, e populli shpëtoi. Kishi ishte djali i vetëm i tij. Pas vdekjes së t'et ai mbeti vetëm me nënën e tij. Mbas Kishi ishte ende i vogël dhe e ëma pa mbështetje, gati të gjithë i harruan, ata rronin pothuajse më keq se të gjithë në fshat. Por një mbrëmje, në një mbledhje, Kishi u bë njeri i qëndrueshëm, si njeri i madh, priti sa pushuan të gjithë dhe tha:

- Po vërtet: neve na japin mish, po ç'mish se? Të vjetër dhe vetëm brinjë. E di im atë, Boku, ishte gjahtar i madh, ndryshe nuk do të thoja një fjalë të këtillë. Thonë se ai binte më shumë se dy gjuetarë të zgjuar, vetëm shikonte dhe kujdesej që të gjithë të jenë të ngopur: plaku dhe plaka të fundit.

- Shih, shih! thirrën të gjithë, përzëreni atë djalë! Vëreni të flejë! Ai është ende i vogël të flasë ashtu me të rriturit e pleqtë. Pleqtë u hidhëruan. Disa e përzunë Kishin të flejë. Të tjerët kërkuan të mos i japin më mish, të tretët iu kërcënuan se do ta rrahin me shkop për fjalët e ashpra. Sytë e Kishit ndritën, fytyra iu vrenjt dhe iu skuq. Në zhurmën më të madhe rreth tij, ai u ngrit në këmbë.

- Dëgjoni, - u thirri ai. Qysh sot ju nuk do të dëgjoni asnjë fjalë prej meje derisa të vini vetë të më thoni: "Kish hajde dhe fol. Gjithë populli e do atë". Këtë e kam fjalën e fundit. Ndjesë pastë babai im, Boku, qe gjahtar i dëgjuar. Unë, biri i tij, do të shkoj në gjueti dhe do të gjej mish. Dhe ta dini se mishi do të ndahet me të drejtë, asnjë e vejë dhe asnjë i dobët nuk do të qajë natën, duke u lutur për mish, kur të fortit do të rënkojnë nga dhembja në bark prej grykësisë. Unë Kishi u them. U qeshën dhe u tallën në llogari të tij, por Kishi i shtrëngoi dhëmbët e doli dhe nuk u kthye më.

Ditën e dytë shkoi në breg të detit. Kaluan një, dy ditë, të tretën ditë fryu një erë e madhe dhe Kishi s'ishte askund.

Ditë e katërt herët në mëngjes, Kishi erdhi në fshat. U kthye si fitimtar: në kurriz mbante copëza të arushës së vvarë. Në ecjen e tij dukej kryelartësia, në fjalë

ashpërsia. Merrini shpejt qentë, merrini sajat dhe ejani pas meje, sepse udha është e largët – thirri Kishi. – Andej nga akulli ka shumë mish, është një arushë e madhe me ca arusha të vogla.

- Më jepni të ha, Ajkida, se jam i lodhur dhe më flihet. Ai erdhi në vete dhe hëngri shumë. Pas kësaj fjeti dymbëdhjetë orë. Kishte shumë mendime dhe shumë mosmarrëveshje ndërmjet njerëzve. Arusha e veriut është shumë e rrezikshme, por më e rrezikshme është atëherë kur është me të vegjlit e vet. Gjahtarët nuk besuan në fjalët e Kishit. Fëmijët nuk mund të bëjnë çudira të këtilla. “Kishi nëse me të vërtetë e ka vrarë arushën, nëse e ka vrarë vetë, sigurisht nuk mund ta pastrojë mishin”. (Në vendet e veriut menjëherë duhet të pritej mishi i arushës së vrarë, sepse mishi ngrin dhe forcohet aq shumë sa që nuk mund ta presë as thika më e mprehtë, por është fare e pamundur të hiqet zvarrë në akullin e mprehtë, mishi i arushës 300 funtash i rëndë).

Por kur erdhën në vendin e caktuar i gjetën arushat e vrara e mishi i tyre ishte i prerë si duhet. Pjesët e brendshme ishin të nxjerra. Kështu filloi fshehtësia e Kishit, e cila gjithnjë rritej. Këtë herë ai vrau një arushë të madhe tri vjeçare, pas asaj vrau ...

*Xbek London*



### *Bisedë rreth tekstit*

Ç’pamje të jashtme ka Kishi dhe sa vjeç është?  
Prej ç’familjeje rrjedh dhe ç’trashëgon nga i ati?  
Si i gjuan arinjte Kishi dhe pse e përbuzin bashkëvendësit?  
Cila është kjo mënyra se si Kishi i vret arushat?  
Si e kalon ai pjesën tjetër të jetës dhe kujt i ndihmon më shumë?



### *Detyrë*

Lexoni fragmente interesante nga ky roman.



Xhek London

*Xbek London* (1876 – 1916) është shkrimtar i madh amerikan. Ka shkruar tregime dhe romane. Lindi dhe u rrit në vobekësi. Ka qenë punëtor, detar, gërmues ari, gazetar dhe shkrimtar ndër më të mëdhenjtë në botë. Përshkroi në veprat e veta ata tipa njerëzish, të cilët i takoi në jetë dhe të cilët janë pjesë e jetës së tij personale. Më të njohur janë këto romane: “Ari”, “Thundra e hekurt”, “Martin Idn” etj.

# BALADË NIZAMËSH

---

Ndër dy male me dëborë  
Ra një trim vetull-hollë.  
O ju korba që më hani,  
Syt' e zez' të mos m'i ngani!  
Se kur nat' e zez' të bjerë,  
Do vrapoj un' porsì erë,  
Atdheu ku më pret,  
Tek deti buçet.

O ju korba që më grini,  
Syt' e zez' vetëm m'i lini,  
Se pa ta s'do gjej dot rrugën  
Në të errët, në të mugët,  
Ku nëna më pret,  
Tek deti buçet.

O ju korba që më sosni,  
Syt' e zez' mos m'i groposni!  
Se pa ta s'kam për të parë  
Vajzën time, malln' e parë,  
Tek deti buçet  
Dhe pret ajo, pret.

O ju korba, atë natë  
Syt' e zez' përse m'i latë?  
Drejt atdheut, n'errësirë  
Ika detit,  
Por të lidhur me zinxhirë  
Prap u gjeta.

O ju korba pse s'm'i nxorët  
Syt' e zez' mua të gjorit?  
Që dot rugën të mos gjeja,  
Rrugë shkretën,

Se kish vdekur dhe nëneja,  
Ishte tretur.  
O ju korba kur më sosët,  
Syt' e zez' pse m'i groposët?  
Se kur shkoja kallamesë,  
Ndala kalë,  
Pashë vajzën e pabesë  
Me një djalë.

*Ismail Kadare*

### *Shënim*

Në fillim, poeti përdor dy vargjet që paraqesin moton si frymëzim hyrës në brendinë që vijon, në poezinë në fjalë. Prap moto-motiv, shkas, shtytje, apo detyrim si frymëzim.



#### *Bisedë rreth vjershës*

Çka përshkruan poeti në strofën e parë?  
Ku jetojnë dy çikat me nënën e tyre?  
Në cilin dialekt ka shkruar poeti?



#### *Fjalë dhe shprehje*

nizam - ushtar në perandorinë Osmane  
mos m'i nga – mos m'i prek



#### *Bisedë rreth baladës*

Personazhi nizam pse i lut korbat që të mos ia hanë sytë?  
Kë do të shohë ai?  
Kush e pret atë?  
Pse i mallkon ai ata në strofën e pestë?  
Po në të fundit ç'kish parë ai?

### **Poezia epiko-lirike**

Poezia epiko-lirike ose liriko-epike është shumë afër poezisë epike. Ndryshon nga poezia epike sepse në të nuk kemi përshkrime të gjera të personazheve e të ngjarjeve. Edhe numri i episodeve në poezinë liriko-epike është shumë më i vogël. Gjatë rrëfimit të ngjarjes poeti i dramatizon me nota të thella lirike situatat e ndryshme. Këto janë mjaft të fuqishme dhe ia shtojnë notën emocionale poezisë

liriko-epike.

Llojet kryesore të poezisë liriko-epike janë: romani në vargje (ky lloj romani është i rrallë edhe në letërsinë botërore, ndërsa në letërsinë shqipe nuk kemi), romanca, balada, poema.

### Këndon bylbyli poshtë te zalli

Këndon bylbyli poshtë te zalli  
Edhe hana sipër ndrit  
Edhe hana sipër ndrit  
Vash'e dashtun ndaj ty malli  
Po më shtohet nat'e dit'.  
O moj han'qi mbi qiell ndrit  
Mallin ti mu po ma shton  
Mallin ti mu po ma shton  
Shum'kujtime po m'i zgjon.

*popullore*

### **Romanca**

*E afërt me baladën është edhe një lloj vjershe liriko-epike që quhet romanca. Romanca është vjershë liriko-epike ku përshkruhet ndonjë dashuri që përfundon hareshëm. Këndohet plotësisht në frymën popullore. Këtu këndohen trimëritë dhe flijimet për atdheun, dyluftimet për të mbrojtur nderin, dashurinë e lavdinë. Si e tillë romanca ka lindur në Spanjë në mesjetë.*



Ismail Kadare

**Ismail Kadare** (1936) është një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Lindi në Gjirokastrë, ku kreu mësimet e mesme, ndërsa më 1958 studimet e larta i mbaroi jashtë shtetit.

Në letërsinë shqipe Kadareja u bë i njohur me shumë vëllime poetike, tregime, romane etj.

Romanet e tij më të njohura janë: “Kështjella”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, etj.

Veprat më të mira të Kadaresë janë përkthyer në disa gjuhë të huaja në vende të ndryshme të botës.

# GAVROSHI I SHQETËSUAR

---

Në këtë kohë, Gavroshit të vogël, i cili ishte i vetmi që nuk ishte larguar nga vendi i vet i luftimit në barrikadë dhe rrinte e vëzhgonte, iu duk sikur pa ca ushtarë t'i afroheshin barrikadës pa bërë zhurmë. Befas ai thirri:

- Kini mendjen!...

Përpara se bajoneta ta prekte djalin, pushka ra nga duart e kundërshtarit; një plumb i dytë e goditi në gjoks policin tjetër që kish sulmuar Kurfeirakun dhe e shtriu pikë përdhe, ishte Mariusi që posa kishte hyrë në barrikadë...

Të dy palët po merrnin në shenjë njëri-tjetrin. Ishin kaq afër, sa po të flisnin, mund të merreshin vesh fare mirë. Kur një oficer me jakë të lartë dhe me epoleta të gjera zgjati shpatën dhe tha:

- Lëshoni armët!

- Zjarr! – u tha revolucionarëve Anzholarsi.

Nga të dy anët armët u ndezën në të njëjtën kohë dhe gjithçka u zhduk brenda në tym. Ishte një tym djegës dhe mbytës, ku të plagosurit zvarriteshin me rënkime të mekura dhe mbyturazi.

Kur u përhap tymi, u dukën nga të dy anët luftëtarët, të rralluar, po gjithnjë në të njëtat vende, që po mbushnin sërish pushkët në heshtje.

Befas u dëgjua një zë gjëmues që thirri:

- Shporruni, se e hodha në erë barrikadën!

Të gjithë u kthyen andej nga erdhi zëri.

Mariusi kish hyrë në sallën e ulët, kish marrë atje vazën me barut, pastaj, duke përfituar nga tymi e nga ajo lloj mjegulle e dendur që kish mbuluar barrikadën, ku qe vendosur pishtari. Tash të gjithë po e vështronin me habi, ashtu me këmbën mbi pllaka, me pishtarin në dorë, me fytyrën e tij krenare të ndriçuar nga vendosmëria, duke e përkulur flakën e pishtarit drejt atij togu të rrezikshëm, ku dallohej vaza e shkallmuar me barut e duke lëshuar këtë britmë që të kallte lemërinë:

- Shporruni se e hodha në erë barrikadën!

- Po të hedhësh në erë barrikadën, - tha një reshter, - do të vrasësh edhe veten tënde bashkë me ne.

Mariusi u përgjigj:

- Edhe veten time.

Dhe i afrooi pishtarin vazës me barut.

Po mbi barrikadë tani s'kishte mbetur më frymë njeriu. Policët, duke lënë aty të vrarët e të plagosurit, u tërhoqën dhe u zhdukën nëpër natë.



Barrikada qe shpëtuar...

Të gjithë e rrethuan Mariusin. Kurfeiraku iu hodh në qafë.

- Të lumtë!

- Arrite tamam me kohë!

- Po mos të ishte ti, më llufitën edhe mua! – shtoi Gavroshi.

Ndërkaq, policët nuk lëviznin nga vendi, dëgjoreshin tek po ecnin në krye të rrugës, por nuk bënë përpara, qoftë nga që pritnin urdhra, qoftë përforcime përpara sa të hidheshin sërish mbi atë barrikadë të pamposhtur...

Atëherë Mariusi mendoi se i mbetej një detyrë për të kryer; ta shpëtonte nga vdekja atë fëmijë të gjorë, Gavroshin.

Ai kishte me vete një bllok shënimesh. Këputi prej tij një fletë dhe shkroi me laps disa rreshta. Meqë s'kish zarf për ta mbyllur atë letër, e palosi më katërsh.

Si e palosi letrën, e vuri prapë bllokun në xhep, pastaj thirri Gavroshin. Djali me të dëgjuar zërin e Mariusit, rendi i gëzuar, i bindur.

- A do të më bësh një të mirë mua?

- Ç'të duash, - tha Gavroshi. – Po të mos ishte ti, unë do të kisha shkuar me të shumtë.

- E shikon këtë letër?

- Po.

- Merre. Dil menjëherë nga barrikada (Gavroshi i shqetësuar nisi të kruante kokën) dhe nesër në mëngjes t'ia japësh atij që i drejtohet.

Djaloshi heroik u përgjegj:

- Mirë, mirë, po gjatë kësaj kohe do të sulmohet barrikada dhe unë nuk do të jem këtu.

- Tani, me sa duket, barrikada do të sulmohet ndaj të gdhirë.

- Po sikur ta çoja letrën tuaj nesër në mëngjes?

- Do të jetë tepër vonë. Barrikada me siguri do të jetë bllokuar, në të gjitha rrugët do të ketë roje dhe ti s'do të mund të dalësh. Nisu që tani!

Gavroshi s'pati më se ç'të thonte, rrinte aty në mëdyshje e duke kruajtur veshin me trishtim. Befas me ato lëvizjet si të zogjve, që dinte të bënte ai, e mori letrën.

- Mirë – tha.

Dhe u nis duke rendur rrugicës Mondetur.

Gavroshit i kish lindur një mendim, që e kish bërë të pranonte, po nuk e kish shfaqur, se trembej mos i bënte ndonjë vërejtje Mariusi.

Mendimi që i kishte lindur Gavroshit ishte ky:

- Tani sapo kaloi mesi i natës, unë do të çoj letrën menjëherë dhe do të kthehem me kohë.

(Nga romani: "Të mjerët")

Viktor Hygo



### *Fjalë dhe shprehje*

**barrikadë** – pengesë që ngrihet nëpër rrugët e qytetit me fuçi, qerre dru e gurë etj., për t'u mbrojtur e për të luftuar

**bajonetë-a** – thikë që mbajnë ushtarët në brez ose e vënë në majë të pushkës

**epoletë-a** – rrip zakonisht i qëndisur, që qepet mbi sup të uniformës ushtarake dhe shërben për të treguar gradën

**mekura (të)** – të mbetura pa frymë, të fikët

**vazë-a** – buri baruti, enë ku mbahet baruti

**lemëri-a** – tmerr, frikë e madhe

**rreshter-i** – gradë më e ulët e nënoficerit



### *Bisedë rreth tekstit*

Romani “**Të mjerët**”, është një ndër veprat më të bukura të letërsisë botërore, me të cilin Viktor Hygo pasqyron jetën e vështirë ekonomike të pjesës më të madhe të qytetarëve të Francës, të cilët edhe luftojnë ta ndryshojnë këtë gjendje.

Në këtë përleshje vazhdimisht na paraqitet edhe Gavroshi i vogël, fëmijë që ishte kalitur në vuajtje dhe ishte bërë burrë para kohe, për të treguar heroizëm të rrallë. Për heroizmin e Gavroshit mësojmë edhe nga ky fragment i romanit.

Diskutoni për këtë copë leximi në klasë, duke u përqëndruar posaçërisht në fytyrën e Gavroshit, madje që në fillim e deri në fund të pjesës. Thuani, si e vlerësoni qëndrimin e Mariusit, i cili gjeti një formë të përshtatshme për ta shpëtuar Gavroshin nga vdekja e sigurt?

Po Gavroshi, si e pranoi dhe e zbatoi urdhërin e tij?

Vëreni dialogët e këtij fragmenti dhe caktoni tonin e tyre, të ashpër dhe të butë, sipas momentit!

# LAGJA E VARFUND

---

Krahët e zez të një nate pa gjum  
e varrosin lagjen pranë,  
dritë, jetë, gjallsi – askund,  
vetëm errsinë e skam.

U harrua jeta e ditës  
ndër shtresat e natës, e paqja  
u derdh nga parzmi i errsinës...  
n'andrra përkundet lagja.

Njerzit ndër shtëpia flejnë  
me gjoksa të lakurtë e të thatë  
e grave fëmij po u lejnë  
pa ushqim në gj, pa fat.

Pushojnë gjymtyrët e shkallmueme  
në punën e ditës së kalueme;  
shërohen trutë e helmueme  
në gjumin e natës s'adhurueme.

Veç zemra e njerzve të lanun  
me të rrokunat prralla rrefejnë:  
mbi barrat e jetës së namun  
që shpirt dhe kurriz thejnë.

Prralla mbi fëmij rrugaça  
barkjashtë e me hund të ndyta  
që dorë shtrijnë me vjedhë, me lypë  
e ngrihen me fjalë të ndyta...

Kështu lagj' e varfun pëshpritë  
dhe errsinës hallet tregon  
nji gjel i undshëm, me dritë  
të hanës i rrejshëm, këndon.

Hesht! Or gjel kryengritës  
i lagjes së varfun – Këtu  
nuk zbardhë për ty drita e ditës...  
i gjykuem je me ngordh n'u.

*Migjeni*


### *Shënim*

Poeti me këtë vjershë ka depërtuar thellë në mjerimin e skamjes së popullit shqiptar në kohën e regjimit feudalo-borgjez. Kjo vjershë në vete, thujse është një histori e kësaj gjendjeje të vështirë ekonomike, të cilën poeti e personifikon me errësirën e natës me krahët e zi, kur grave po u lejné fëmijë pa ushqim në gji, pse s'kanë të hanë për vete, prandaj as tambël nuk kanë, e fëmijët e tyre nuk kanë as fat e të tjera. Vjershat me përmbajtje të ngjashme trajtojnë jetën e vështirë ekonomike të shkaktuar edhe nga padrejtësitë shoqërore të kohës.



### *Bisedë rreth vjershës*

Përpiquni bashkë me arsimtarin, ta analizoni këtë vjershë thellë e thellë, sepse prej saj do t'i mësoni të gjitha pasojat e regjimit anti-popullor, peshën e rëndë të skamjes dhe revoltin gati-gati të shuar të gjelit kryengritës, të cilit, edhe poeti do t'i thotë të heshtë, sepse edhe përjeton të njejtën fatkeqësi me njerëzit.



Millosh Gjergj Nikolla  
- Migjeni

*Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni* (1911 – 1938) është poet e prozator, përfaqësuesi më i shquar i letërsisë demokratike para Çlirimit. Lindi në Shkodër dhe ka punuar si mësues në fshatrat e këtij qyteti. Libri i tij me vjersha titullohet “Vargjet e lira”, Në të njëjtën kohë ai ka shkruar me urrejtje të madhe kundër pasanikëve dhe çifligarëve të pamëshirshëm, kundër të gjithë shfrytëzuesve.

# I LUMTUR ËSHTË AI QË S'KA ZILI

Një mullixhi rronte njëherë në një katund të vogël fare dhe qe i lumtur nga të gjithë se nuk qe lakmonjës.

E kish ndërtuar mullirin pranë një lumi të vogël, që shkonte përmes fshatit të tij. Punonte gjithë ditën në mulli me gëzim duke kënduar dhe duke lojtur valle dhe kurrë nuk thyente zemrën për asgjë. Qe i lumtur në punën e vet, nuk kish zili për asnjeri, por shikonte punën, nxirte të holla për rrojtjen evet, e nuk desh më shumë gjë.

Gjithë njerëzia e kishin zili, se qe i lumtur ky njeri.

Shumë herë e pyesnin:

- Përse je i lumtur?

Ai u thoshte:

- Jam, se nuk i kam asnjëri zili.

Kështu mori ky emër të mirë në gjithë katundin.

Një mbret që mbretëronte në atë katund, qe shumë i pasur, po, me gjithë që qe mbret, kishte edhe shumë punë tjera. Lodhej nga ato punëra e desh të hiqte dorë nga ajo punë, po veç të rronte i lumtur si ai. Po nuk dinte se si. Një ditë, kur po rrinte, po mejtohej, i thotë një njeriu të tij:

- A s'ka ndonjë njeri të lumtur këtu, që të bëhem edhe unë i lumtur?

Dhe ai i tha se “në filan vend ndodhet një njeri i lumtur”. Mbreti nisete që ta shikojë. Porsa arriti atje, dëgjoi mullixhinë që po këndonte e po punonte. Si ndejti pak dhe si e dëgjoi mirë e mirë, hyri brenda dhe e pyeti:

- Ç'të bëj unë që të jem i lumtur si ti?

Mullixhiu i thotë:

- Unë s'mund të të ndihmoj për këtë gjë.

Ahere i thotë mbreti:

- Përse je kaq i lumtur?

Dhe ai i tha:

- Jam i lumtur se s'kam asnjë njeri zili, po veç shikoj punën time.

- Nuk më thua, a mund të bëjmë ndonjë punë bashkë?

- Çfarë pune? – e pyeti mullixhiu mbretin.

- Unë jam mbret dhe dua të ta jap ty mbretërinë, ti të më japësh mullirin.

- Kjo është punë që s'bëhet, - i tha mullixhiu, unë jam i lumtur, se ky lumë që rrjedh këtu nget gurin të vijë rrotull e më mban zënë kur këndoj e jam plot gas e i lumtur.

- Pra, - tha mbreti, - unë jam më i lumtur të jem si ti.

Mbreti, si pa që kish të drejtë mullixhiu, shkoi në pallat dhe zuri të rrojë i lumtur si ai.

Dhe kështu rronin që të dy të lumtur se nuk e thyenin zemrën e vet, po rronin me gas e nuk i kishin zili asnjëri.

*Tregim popullor*



### *Bisedë rreth tekstit*

Cila është tema e kësaj përralle?

Cili është heroi kryesor?

Klasifikoni dy heronjtë sipas prejardhjes sociale?

Cila është motoja jetësore e mullixhiut?


Ç'punë bën ai dhe a është i lumtur me punën e vet?

Ç'këshilla kërkon mbreti prej mullixhiut dhe a e zbaton këshillin e tij?



### *Detyrë*

Vizitoni ndonjë mulli të vjetër.



# QYTET I LASHTË

Aty, si tash, para se me ardhë fiset, ishe...  
me tambël në plasaritjen e currave  
e me themele një emër: Shkodra,  
E të thirrën qytet me kunora,  
e të hodhën përkrye gur e hekurat para.

U zgjove e përgjakun sa herë  
e u kqyre në pasqyrën tande.  
Me atë emën u lave ndër ujna  
T'lumenjve dhe qëndrove me petka të reja  
në shkamb,  
e ndritun, ballë diellit mbi fusha.

*Martin Camaj*

## *Shënim*

Në këtë vjershë autori jep lashtësinë dhe qëndresën heroike të Shkodrës dhe të atdheut të tij ndaj rrebesheve të mëdha të historisë. Vjersha ka vargje të lira (pa rimë dhe rrokje të caktuara), që me fjalë të kursyera shprehin mendime dhe ndjenja të fuqishme për dashurinë dhe krenarinë e autorit ndaj vendlindjes, ndonëse jetoi e punoi shumë vjet larg saj.



## *Fjalë dhe shprehje*

**fis-i** – grup njerëzish me gjuhë të përbashkët e zakone të njejta. Këtu autori e përdor në kuptimin, fiset sllave etj., që u dyndën shumë më vonë në Ballkan (aty nga shek.VII).

**curr-i** – shkëmb i lartë me anë të thepisura

**kqyr** – vështroj

**petk-u** – veshje, rroba

me tambël në plasaritjen e currave – këtu autori jep atë që besohej se nga shkrepat dhe muret e kalasë së Rozafatit (më e vjetra në Ballkan) pikonte qumësht gjiri të gruas që u muros për ndërtimin e kalasë. Këtu del ideja e lashtësisë së Shkodrës.



### *Bisedë rreth vjershës*

Si e kuptoni vargun: *Aty si tash, para se me ardhë fiset ishe.*

Pse e përdor shprehjen: “qytet me kunora”?

Ç’kërkon të japë përmes saj?



### *Detyrë*

Analizoni vargjet:

*u zgjove e përgjakun,*

*u këqyre në pasqyrën tande.*

(Ç’përfaqëson “pasqyra” këtu.?)

Vini re se si autori, me fjalë të kursyera, jep shumë mendime e ndjenja. I shpjegoni vargjet, tregoni idetë dhe diskutoni për ndonjë vjershë tjetër me varg të lirë.

### **Motivi**

*Motivi është njëri nga elementet kryesorë të strukturës së poezisë lirike, njësia e vogël por shumë e rëndësishme sidomos e poezisë lirike. Sipas motivit që shtjellon poezia lirike ndahet në lloje të ndryshme. Motivi, në të vërtetë, është shkaku, nxitja, ngacmimi që poetin e ka nxitur të krijojë një krijim poetik.*

*Edhe një poezi e vogël lirike mund të ketë një motiv nxitës kryesor dhe dy motive të tjera. Motive të ngjashme kemi edhe në prozë.*



Martin Camaj

*Martin Camaj* (1925 – 1992) është lirik i madh dhe gjuhëtar i shquar. Pasi kreu shkollën e mesme në Shkodër, shkoi në Kosovë, ku më 1961 dëbohet. Punoi, studioi dhe jetoi në Itali, në vendet Skandinave e në fund në Gjermani. Ka botuar shumë vepra letrare në poezi dhe në prozë si: “Kënga e vrrinit”, “Djella”, “Legjenda”, “Karpa”... Është autor veprash të njohura nga gjuhësia.

Ai u arratis nga Shqipëria, sepse ishte kundër regjimit komunist.





Leonardo da Vinci: "MONA LIZA"

# ZBULIMI I NJË FSHEHTËSIE SHEKULLORE

---

Lolua që mori si dhuratë thikën e argjendtë, m'u duk si kapedan i madh. E mbajti ca në duar. Na e dha për ta parë. Unë i provova majën. Sa e mprehtë që ishte dhe sa shkëlqente tehu i saj! Pastaj Lolua e lidhi në llërën e dorës së mëngjert.

Niko Dabua qau:

- Më vjen mirë që e trashëgove ti! Se unë nuk kam fëmijë. Gjithë djemtë e fshatit, djemtë e mi janë. Kisha menduar t'ia falja më trimit. Dhe më trimi më dukesh ti. Të njoha nga sytë, nga shtati dhe nga fjalët.

Lolua nxori thikën nga milli. E zgjati horizontalisht dhe na ftoi të betoheshim para Niko Dabos:

- Beto hem në heroizmin dhe besnikërinë e kësaj thike të shtrenjtë, se nuk do t'i kallëztoj asnjëri fshehtësinë shekullore të Shpellës së Piratëve, që do të na tregojë tani peshkatari i madh i fshatit tonë.

Ne përseritëm fjalët që thoshte Lolua. Edhe Lulja u betua.

Niko Dabua u ngrit më këmbë dhe i dha dorën Lolos duke e uruar:

- U bëfsh peshkatar i dëgjuar! - pastaj qeshi nën buzë. - Unë do t'ua kallëztoj fshehtësinë shekullore të Shpellës së Piratëve, se ju jeni guximtarë. Po... - u mendua dhe u mendua, - pa uluni pakëz! Uluni këtu! Dhe ne u ulëm. Lulja i kishte çelur më shumë sytë e saj të mëdhenj. Dhe të dy gërshetat e gjata që i binin përpara nuk i linte të qeta.

Peshkatari plak na hodhi një sy të gjithëve.

- E shikoni atë? - dhe na tregoi me dorë hyrjen e çuditshme të Shpellës së Piratëve. - Atje gjer sot nuk ka mundur të hyjë njeri. Unë jam munduar disa herë të futem, po nuk ka qenë e mundur... Jo, jo, nuk ka qenë e mundur... E shikoni aty në fund? Uji i detit hyn gjer në një vend në një ngushticë si kanal.

Nja njëzet metra më thellë, ngrihet një pllakë si pengesë për hyrjen më thellë...

Unë e arrita me not pllakën. Shpella është e lartë... Po, më e lartë se direku i karavës më të madhe... Unë s'kam parë bukuri të tillë.

Si në ëndërr më dukej... Vendosa të shkoja më tutje. U hodha në det, tej plla-

kës. Uji kishte mijëra ngjyra, e drita hynte nga shumë guva të larta dhe të dendura. Ç'të shihje, more djem! Gaforre sa një samar! Breshka sa një gomar!

Nxora thikën. Notoja lehtë më thellë... Po deti brenda në Shpellë s'paskësh të sosur. Kur arrita gjer në një vend, m'u bë sikur dëgjova një zë si bubullimë:

"E, ku shkon?"

U ktheva përsëri. Kur dola nga u nisa, duke parë diellin e bukur që perëndonte, duke parë rrugën e ndezur që më kishte shtruar dielli mbi det, m'u duk sikur vija nga një botë tjetër. U ngopa me erën e jetës dhe me shpejtësi delfini arrita ja, mu këtu ku jemi tani... Heshti. Tundi kokën.

- Siç duket, piratët hynin atje gjer te pllaka, me felluke të ngushta, të gjata e të shpejta. Pastaj felluket i ngrinin, i kalonin përmbi pllakë dhe i lëshonin në detin fantastik të Shpellës...

- Piratë! Po ç'ishin piratët? - pyeti Lulja.

- Piratët... po... piratët ishin kusarë deti: vinin nga brigjet e largëta me felluket e tyre të shpejta, rrëmbenin bagëtinë, digjnin fshatrat, plaçkitnin ç'të gjenin, bile rrëmbenin edhe djem... Po, djem. Se i donin t'i rrisnin për piratë trima. Ata... e ç'nuk bënë ata për të rrëmbyer djem...

Gjyshërit tanë luftonin me ta. I prisnin me shigjeta e me ushta, me gurë e me serë të shkrirë e të ndezur. Vinin mijëra piratë dhe ktheheshin shumë pak, të shpartalluar. Rreziku i piratëve i detyroi stërgjyshërit tanë të krijonin togje dhe legjione detarësh trima, me felluke të shpejta. Porsa shikonin që nga maja e Çikës, atje lart, piratët duke ardhur, ndiznin një zjarr si shenjë alarmi. Kapedanët e fellukeve tona, me të parë zjarrin, me shpejtësi delfini, lëshoheshin drejt perëndimit dhe ndesheshin burrërisht me piratët. Beteja në det është e tmerrshme...

Dhe atëherë kur ishte armiku shumë i madh, tanët ktheheshin dhe me marifet e shpejtësi futeshin në këtë shpellë. Aty fellukat e piratëve nuk mund të futeshin se luftëtarët tanë u rrokullisnin gurë të mëdhenj që sipër nga shkëmbi.

Piratët prisnin të dilnin nga Shpella fellukat tona, po ato nuk dilnin...

Kalonin ditë e javë e fellukat tona nuk dilnin.

Piratët kujtonin se tanët, patjetër do të kishin vdekur nga etja e nga uria, prandaj hidheshin në zall e fillonin të ngjiteshin në fshat. Mirëpo me të hedhur këmbën në shkallën e monopatit, luftëtarët tanë, që ishin futur në Shpellë me fellukat, u dilnin përpara dhe u vërsuleshin me tërbim.

- Po si ndodhte kjo? - pyeti Lolua i habitur.

- Këtu qëndron fshehtësia e Shpellës së Piratëve...

Peshkatari nuk lodhej së foluri:

- Këto që po ju tregoj unë, kisha vendosur t'i merrja me vete në fund të detit... Po më mirë që po ua lë juve, se ju jeni trima, ju jeni stërnipërit e gjyshërve

tanë kapedanë. Siç duket, nga Shpella e Piratëve do të ketë patjetër ndonjë dalje shumë të largët përtej bregoreve... Siç më tregonte, ndjesë pastë, plaku im, në

Shpellë futej qëmoti një ujk deti që quhej kapedan Gjikë Mëhill Merkur Gjonbaba... Dhe thuhej se na qënkish stërnip i të famshmit kapedan Gjonbaba...

Që thoni ju, more djema, ky trim, kapedan Gjikë Mëhill Merkur Gjonbaba, që guxonte te futej shpeshherë në Shpellë, na paskësh thënë se nga e majta e Shpellës është një shkallë e në fund të shkallës një hyrje... Atje ai na paskej ndezur një direk karave prej pisehe e si e ndezi, doli menjëherë përjashta, hipi në Majë të Karavait, atje lart dhe vuri re në çdo skutë se mos dilte gjëkund t'ym dhe, siç thotë gojëdhana, tymi doli aty ku është kisha e Shën-Premtës, nga e majta e fshatit të vjetër.

Zbriti nga Maja e Karvait, shkoi atje ku dilte tymi dhe gjeti djalin e Shpellës së Piratëve... Unë kam shkuar shpeshherë atje. Nuk mundem t'ua kallëzoi more djema, se ç'momente fantastike ka atje nën grykën e daljes.

- Po a mund të shkojmë ta shohim? - e pyeti Lolua.

- Është shumë kollaj, mund të shkoni kur të doni. Po me kujdes, mos hyni thellë, se do të rrëzoheni në një hon të errët, ku ka me miliarda e miliarda lakuriqë të natës... Thonë se kapedan Gjikë Mëhill Merkur Gjonbaba u fut për të dalë në grykë, po s'doli më dhe qysh atëherë, more djema, s'ka guxuar më kurrë asnjëri që të futet...

- Ne do të futemi dhe do të dalim!- thirri Lolua, Peshkatari.

- Jemi gati - u përgjigjëm ne.

Niko Dabua i prekur dhe i entuziazmuar nga vendimi ynë, qau.

*Petro Marko*



### *Fjalë dhe shprehje*

piratë - kusarë

guvë-a - vrimë e madhe, gropë brenda një shkëmbi ose në tokë, shpellë guri e thellë

legjion - njësi themelore ushtarake në ushtrinë romake me 6000 kalorës

felluke - njësi (po ashtu) ushtarake detare

hon-i - shpellë

mill-i - këllëf



### *Bisedë rreth tekstit*

Cilat janë personazhet e tekstit?

Cila është tema e këtij rrëfimi?


Për çfarë fshehtësie bëhet fjalë?  
Çfarë kishte në atë shpellë?  
Ç'dini ju për ngjarjen e romanit?  
Ç'personazh është Niko Dabua?



Petro Marko

*Petro Marko* (1913 – 1991) është një ndër shkrimtarët më të shquar të letërsisë bashkëkohore. Lindi në Dhërmi të Himarës. Mori pjesë në Luftën e Spanjës me grupin e vullnetarëve të Garibaldit. Ka botuar romanet: “Qyteti i fundit”, “Stina e armëve”, “Halimi”, “Ultimatum”, “Të thjeshtët”, “Nata e Ustikës”, “Hasta la vista”, “Shpella e Piratëve”, vëllimin me tregime “Uria, dhija dhe perëndia” etj.

Romani i tij i fundit, i botuar pas vdekjes, mban titullin “Dialog me vetveten”.



## AKILI MUND HEKTORIN

---

Zeusi mori peshoren dhe vuri në balancë fatin e dy heronjve. Kupa e kobshme e prijësit trojan rëndoi drejt Hadit. Atë çast dhe Apoloni hoqi dorë nga Hektori. Atëherë dhe Athinaja iu afrua Akilit dhe i pëshpëriti: “O Akil, unë jam me ty, ndaj mos ki frikë, se të dy do të dalim fitimtarë. Ndalo pak e merr frymë dhe unë do t’ia mbush mendjen Hektorit të ndalojë e të luftojë me ty. “Akili iu bind e u ul të pushonte, ndërsa Athinaja u drejtua tek Hektori e i tha: “Hektor, shumë po të mundon Akili, prandaj qëndro e lufto si burrat përkrah meje. Hektori e besoi dhe mori zemër. Qëndroi përballë Akilit e tha:

- O Akil, më s’do të ik siç të ika deri tani, kur i rashë tri herë rreth qytetit të madhërishtëm të Priamit. Përballë teje s’do të më trembet syri. Ja do të të vras, ja do të më shkulësh shpirtin. Por më parë të lidhim besën që fituesi do t’ia dorëzojë kufomën kundërshtarëve.

Akili e vështroi rëndë-rëndë e tha:

- Hektor, o armik i urryer, unë nuk pranoj të lidh besë me ty, se fort mirë e di që kurrë ujku me qengjin nuk u lidhën me besë midis tyre dhe as luani me njeriun. Mblidhi forcat dhe lufto si burrat e trego trimëri, se këtu ke për të larë gjakun e Patroklit me gjakun tënd.

Kështu tha e ushtë e lëshoi me sa fuqi që kishte, por Hektori u përkul shpejt përpara dhe ushta i kaloi sipër kokës dhe u ngul tej përdhe. Athinaja mori ushtë dhe ia dha prapë Akilit. Kur i erdhi radha përsëri Hektorit, ai fort mirë e mori shenjë dhe e lëshoi ushtë drejt Akilit. Vërtet nuk gaboi po shqyti i Akilit, ia prapsoi tej ushtë. Hektori u shtang, ngaqë nuk kishte ushtë tjetër, prandaj thirri në ndihmë Athinanë, e cila nuk dukej kurrkund. Hektori e kuptoi fort mirë dredhinë e saj dhe tha: “Çfarë fatkeqësie është për mua që hyjnitë po më shtyjnë drejt mortjes. Edhe pse për shumë kohë Zeusi dhe Apoloni më deshën, tani e shoh që më kanë braktisur e mortja e zezë po më afrohet. Një gjë kam në dorë: të luftoj si kreshnik e të mos vdes pa nder e lavdi”. Nxori shpatën dhe u turr drejt Akilit si një shqiponjë që sulet nga maja e malit drejt e në lëndinë, për të kapur ndonjë qengj. Atë rast dhe Akili u lëshua me egërsi mbi Hektorin, duke mbajtur në dorë heshtë, maja e së cilës vetëtimte si ylli i parë i mbrëmjes. Vërtetë Hektori mbante të veshura

armë të bukura, që i rrinin për shtat trupit të tij vigan, por gryka, atje ku ndodhet filli i jetës, ishte i zbuluar. Aty mori shenjë Akili dhe heshta i doli trimit pas qafe. Hektorit iu lëkundën gjymtyrët dhe u plandos përdhe. Kur po binte përdhe, Akili foli:

- Ti kujtove, Hektor, se vrave mikun tim të dashur Patroklin, e i mposhte të gjithë burrat e dheut. Nuk e dije ti, vallë, se unë do t'ia merrja hakun, duke të marrë ty jetën? Trupin tënd do ta shqyejnë qentë, ndërsa Patroklin akejt do ta përcjellin me nderime.

Hektori iu lut në agoni:

- Pashë shpirtin tënd e të prindërve të tu, mos ma lër trupin të ma shqyejnë korbat e qentë. Prano shpërblimin që do të japë babai e nëna ime, dhe jepua atyre kufomën time.

Akili ia ktheu rreptë:

- Mos zërë be për prindërit e mi, more i pafytyrë, se me urrejtjen që më ke ndezur, kam për të ta grirë mishin edhe sikur Priami të më japë dhjetëfishin e pa-surisë që ke.

Kur filli i jetës po i shuhej, Hektori prapë foli:

- Tani po të njoh tamam ashtu siç të mendoja. Fytyrën e ke mizore, por më të zi e paske shpirtin. Por dije mirë se një ditë Paridi, me ndihmën e Apolonit, ka për ta marrë hakun.

Këto qenë fjalët e fundit të Hektorit dhe hija e vdekjes ia mbylli sytë.

- Edhe mua do të më marrë vdekja, - tha Akili ndërkohë, - por vdis njëherë ti, - dhe sakaq ia shkuli hesh tën nga trupi.

Ndërkohë akejasit u afruan dhe askush nuk mbeti pa e goditur me heshtë trupin e Hektorit. Akili i zhveshi armët e kryetrimin dhe ua tregoi atdhetarëve të tij, duke thënë:

- Tani o akejas, që mposhta këtë vigan që ju solli shumë kobe, bëhuni gati të sulmojmë Ilionin, se trojanët nuk e kanë më Hektorin që t'u prijë. Por ç'flas unë kështu?! Si harrova mikun tim të dashur Patroklin, që prehet pa vaj e vrer? Le të kthehem tek anijet e ta përcjellim Patroklin siç i ka hije!

Kështu foli Akili, lidhi trupin e Hektorit pas qerres e filloi ta zvariste me kokë poshtë. Aq shpejt e ngiste qerren sa trupi i Hektorit që zvarritej ngriti një re pluhuri. Fytyra e bardhë dhe e hijshme u përbalt dhe u zhgërrye nga pluhuri. Edhe plaku Priam ta këpuste shpirtin, tek qante.

Në gjithë qytetin plasi vaji e gjëma. E gjithë turma mezi mbante Priamin, që desh të dilte jashtë ledheve.

- Më lini, o miqtë e mi, të shkoj tek anija e atij mizori e fodulli, që goditi fort zemrën e një plaku të mjerë e t'i lutem ndër gjunjë të më japë trupin e Hektorit,

- thoshte ai.

Ndërkohë Andromaka, gruaja e Hektorit, nuk dinte gjë për vrasjen. Në pallat ajo urdhëroi shërbëtorët t'i bënin gati ujin e ngrohtë Hektorit. Befas dëgjoji kujën e së vjehrrës e vrapoi drejt ledheve të qytetit, për të parë ç'kishte ngjarë. Kur mbërriti tek ledhet, e njohu trupin e Hektorit, që po zvarrisej në dhe. Një re e zezë i mbësh-tolli sytë dhe ra pa ndjenja, pa mundur të qante. Pranë iu ndodh e motra e Hek-torit, që nuk e la të plandoset përdhe. Kur u përmend, Andromaka zuri të qajë për fatin e zi të djalit të tyre, Astanjaksit.

*Homeri*

## ***Sbënim***

*Kjo pjesë është marrë nga libri “Iliada” e autorit Stavri Trako. Ky libër është një përshtatje për fëmijë e poemës “Iliada” nga Homerit. Në këtë pjesë jepet çasti kur ndodh ndeshja e famshme ndërmjet Akilit dhe Hektorit, që simbolizon luftën e egër ndërmjet grekëve dhe romakëve.*



### ***Fjalë dhe shprehje***

**kapitol-i** – kështjella e qytetit të Romës në Kodrën e Kapitolit ku ishte pushteti qendror i Romës



### ***Bisedë rreth tekstit***

Cilat perëndi morën pjesë në dyluftimin ndërmjet Akilit dhe Hektorit? Çfarë bese kërkoi të lidhte Hektori me Akilin para dyluftimit? Ritregojeni me fjalët tuaja mënyrën si u zhvillua dyluftimi. Çfarë ndodhi pas vdekjes së Hektorit? Kë ia kish vrarë Hektori Akilit? A e justifikoni zemërimin dhe egërsinë e Akilit, ndaj Hektorit? (Këtu kini parasysh se Hektori i kishte vrarë Akilit mikun e tij të ngushtë). A ka të drejtë Hektori, kur i kërkon Akilit të zbatohen rregullat e luftës? Përse?



### ***Detyrë***

Hektori lufton për të mbrojtur trojet e tij nga akejt. Akili lufton për të marrë hakun e mikut të ngushtë, Patroklit. Tregoni nga cili hero anon simpatia juaj.



# VJESHTË

Oh, lamtumirë, o këndi im i thjeshtë  
po shkunden gjethet e arta rreth e qark  
fryn'er'e ftoht' moti gjëmon larg  
e bryma endet mbi ara e mbi vreshtë!

Me koh' dhe pyll' i thinjur zu të heshtë,  
rrëke e turbullt rrëzohet përmbi zall ...  
oh, lamtumirë, o këndi im i rrallë,  
mirse na vjen në fshat e arta vjeshtë!

E bukur je, pa çka s'e ngre stuhinë  
e tufa resh në qiell'e kaltër mbledh,  
pa çka se drurët i le ti pa një gjeth,  
e kreshtave nis derdh të ftohtat thinjë!

*Dbori Qiriaz*



## *Bisedë rreth vjershës*

Ç'parafytyrim na sjell kjo poezi?  
Si është përshkruar në këtë vjershë peizazhi i vjeshtës?  
Ç'kuptoni me fjalët "gjethet e arta"?  
Si e përshkruan poeti ndryshimin e motit ?



## *Detyrë*

Bëni një hartim me temë "Vjeshta e artë"

## *Ritmi dhe elementet e ritmit*

Vjersha e mësipërme, që na sjell një peizazh të bukur vjeshte, sikurse edhe çdo krijim letrar në vargje, si keni mësuar edhe më parë, ka disa elemente të veçanta që e dallojnë nga vepra letrare e shkruar në prozë. Këtu do të bëjmë pak fjalë për disa prej tyre si: **ritmi**, **pushimi** dhe **theksi**.

**Ritmi** është një lëvizje e njëtrajtshme që lind nga vargëzimi i disa njësisve të matura që ndërtohen brenda një kobe të caktuar. Edhe në natyrë ka lëvizje dhe ato bëhen sipas një ritmi të caktuar. Kështu marrim frymë dhe ne, me ritëm na rreh zemra. Ritmi shprehet nëpërmjet elementeve të tij si: pushimi, gjatësia e rrokjeve, theksi, numri i rrokjeve, përsëritjet tingullore etj.

**Pushimi:** Në fund të çdo vargu të vjershës kemi një pushim, por ka pushim edhe brenda vargut. Kështu vargjet i ndajmë në njësi më të vogla ritmike apo premje.

**Theksi** shprehet gjatë shqiptimit të fjalëve dhe sidomos në ato fjalë që kanë dy ose më shumë rrokje. Brenda fjalës kemi rrokje që theksohen më shumë nga të tjerat, ose rrokje të theksuara.

Për këto më sipër, si dhe për shumë shprehje të ngjashme të asaj nëndege të teorisë që quhet **metrikë**, në shkollimin e ardhshëm do të mësoni më gjerësisht.

## MOS I PREK VIZATIMET E MIA!

Atë mëngjes shkencëtari plak ishte ngritur shumë herët dhe kishte dalë buzë detit. Ndjeu kënaqësi kur ajri i freskët i mbushi kraharorin. Në lindje, dielli ende nuk kishte dalë dhe në qiellin e përskuqur lundronin disa re të zeza, anët e të cilave dukeshin sikur po ndizeshin. Deti përkundte lehtë valët e tij, ku lodronin disa pulëbardha.

Plaku u ul mbi një copë shkëmb, për të kundruar më mirë mëngjesin. E kishte zakon të vjetër këtë. Gjithnjë zgjohej herët në mëngjes dhe merrej me punë. “Fuqinë më të madhe njeriu e ka në rini, - thoshte shpesh ai, - kurse mendjen e ka në mëngjes”. Dhe me të vërtetë, mëngjeseve i kishte bërë ai zbulimet e tij më të mira... Por kjo i përkiste së kaluarës. Tani ishte luftë...

Kishte afro tre vjet që qyteti i lindjes, Sirakuza, ndodhej i rrethuar nga romakët. Sirakuzianët kishin qëndruar si burrat. Qyteti nuk ishte përkulur. Meritë për këtë kishte edhe shkencëtari plak, i cili kishte udhëhequr drejtpërsëdrejti ndërtimin e fortifikatave dhe të disa makinave luftarake. Qysh në fillim të luftës shkencëtari i vuri të gjitha forcat për mbrojtjen e atdheut. Me mendjemprehtësinë e tij shpiku e ndërtoi katapultat që ishin makina-armë për hedhjen e predhave prej guri ose të predhave-trarë dhe kishte ndërtuar “korbat”, që ishin si darë të fuqishme për të kapur trarët e armët e tjera që mund të përdorte armiku rreth mureve të kështjellës.

Shkencëtari ndihej i gëzuar dhe krenar që bashkatdhetarët e tij ndërtimin e këtyre makinave-armë e pritën me atë entuziazëm që kishin pritur kohë më parë koklenë...

“Koklea... Edhe atëherë kur më lindi ideja për krijimin e saj, mëngjes ishte”, - mendoi shkencëtari mjekërbardhë dhe për një çast iu kujtua ajo kohë... Atëherë ishte në Egjipt. Ishte ngritur herët, kështu si sot, dhe po shëtiste buzë lumit Nil. Egjiptianët mbanin në krahë ujë nga lumi dhe e derdhnin sipër, në bregun e lartë, për të njomur tokat.

“Sa punë e lodhshme!” – kishte menduar shkencëtari. – A nuk mund të bëj diçka që t’ua lehtësoj punën?

Ky mendim iu ngulit në mendje. Iu desh shumë punë, por më së fundi mundi

të shpikte koklenë, një “vidë” druri, që vendosej pjerrtazi në bregun e lumit. Duke e rrotulluar atë me një dorezë, uji ngjitej lart...

Duke menduar të gjitha këto, me shkopin që kishte në duar, në mënyrë të paverëdijshme, kishte vizatuar një sferë të brendashkruar në një cilindër. Pastaj shkopi filloi të vizatojë edhe figura të tjera. Dolën ca rrrathë të çuditshëm. Ajo figurë i solli ndër mend një problem, për zgjidhjen e të cilit kohë më parë e pat vrarë shumë mendjen dhe nuk kishte arritur ta zgjidhte.

Hoqi një drejtëz. Edhe një tjetër...

“Hë, - tha, - si s’më pati shkuar më parë mendja! Shih sa lehtë, sa shpejt e sa bukur duhet të zgjidhet...”

\*\*\*

Ndërsa shkencëtari plak merrej me vizatimet e tij mbi rërë, përtej, nëpërmjet një shtegu të një kulle, romakët kishin hyrë në qytetin e rrethuar. Kaq u desh. Në të katër anët jehuan boritë dhe ushtarët romakë të gjeneral Marcelit u hodhën në sulm duke vrarë e duke prerë.

Një ushtar romak, i egër e barbar, me mburojë e me shpatë në dorë, u gjend para plakut. Shkencëtari vazhdonte i qetë punën, i zhytur në zgjidhjen e problemës. Në fytyrën e tij ishte vizatuar një ndjenjë krenarie... Ishte gëzimi i zbulimit.

Ushtari romak u afrua.

- Ç’bën këtu, more plak matuf?

Plaku nuk e dëgjoi fare.

- Magji, hë?... Për perëndi, po! – thirri i egërsuar romaku dhe u afrua më tepër, të shquante më mirë vizatimet.

Këmba i shkeli në rrethin e parë.

- Mos i prek vizatimet e mia! – u nxeh atëherë plaku dhe, i pushtuar nga zgjidhja e papritur e problemit, thirri në çast i gëzuar: - Eureka!

Eh, sa herë kishte thirrur kështu gjatë jetës së tij ai plak mendjeartë. Në këto çaste ai endej në krahët e lumturisë...

Por pushtuesi romak i rrinte mbi krye.

-E gjete, ë? – iu kërcënua me ngërdheshje. – Prite pra, o matuf, atë që kërkoi! Le të të gjejë edhe ty vdekja! – dhe shpata romake ra mbi gjoksin e rreshkur të plakut mjekërbardhë.

Plaku u rrëzua. Gjaku i tij i ngrohtë përshkoi vragat e rrrathëve dhe humbi mbi rërën e freskët...

Qielli ishte i vrenjtur. Deti ishte i shqetësuar. Oshëtima e dallgëve përzihej me klithmën e pulëbardhave.

Kështu e takoi vdekjen, asaj dite të vitit 212 para erës sonë, fizikanti dhe matematikani i madh i lashtësisë, Arkimedi.

*Astrit Bishqemi*

## *Sbënim*

Ky tregim është shkruar nga shkrimtari Astrit Bishqemi, i cili është i njohur për librat e tij fantastikë dhe shkencorë. Në këtë pjesë bëhet fjalë për shkencëtarin e antikitetit grek, Arkimedin, i cili gjeti formulat për llogaritjen e sipërfaqes dhe të vëllimit për sferën dhe cilindrin.



### *Fjalë dhe shprehje*

**fortifikat/ë-a** – vend mbrojtjeje që ndërtohet me mure të trasha në rase lufte

**shpik** – krijoj ose zbuloj diçka të re që nuk njihet më parë

**matuf-i** – plak që ka humbur shkathtësinë e mendjes dhe nuk mban mend

**shquaj** – këtu: dalloj dikë a diçka me sy; e vë re ndërmjet të tjerëve

**vrag/ë-a** – këtu: shenjat e vijave të vizatuara në rërë

**eureka** – e gjeta

**qëndruan si burrat** – qëndruan me vendosmëri dhe trimëri (siç dinë të qëndrojnë burrat trima)

**në mënyrë të pavetëdijshme** – këtu: pa u menduar



### *Bisedë rreth tekstit*

Për ç'kohë dhe për cilën figurë të shquar bën fjalë kjo pjesë?

Çfarë shpikjesh kishte bërë shkencëtari?

A u kishin shërbyer ato bashkëkohësve? Për se? Plotësoni:

Me ç'zbulim të madh kishin lidhje vizatimet që po bënte plaku në rërë?

Ritregoni me fjalët tuaja fundin tragjik të Arkimedit.

A mendoni se vepra të shquara janë pikërisht ato që iu shërbejnë njerëzve në jetë? Për se?



### *Detyrë*

Bëni një krijim të shkurtër për këtë copë leximi.

## BOBILI DHE SHOKU

---

Në skajin e fshatit jetonte plaku Bobil. Ai kishte kasollen dhe qenin e tij. Shëtiste nëpër botë, mblidhte copa buke dhe kështu siguronte ushqimin. Kurrë nuk ishte ndarë nga qeni i tij, të cilit nga mëshira i kish vënë emrin: Shok.

Kalon Bobili nëpër fshat, troket nëpër dritare, kurse shoku pranë tij – tund bishtin. Sikur të priste pjesën e tij. Kurse njerëzit i thonin Bobilit:

“Bobil, do të ishte mirë të liroheshe nga ky qen, - ti edhe vetë mezi po mbahesh me ushqim...”

Atëbotë Bobili i shikon njerëzit me sy të brengosur dhe nuk u flet fare. E thërret shokun e vet, largohet nga dritaret dhe nuk e pranon lëmshën e ofruar.

Bobili ishte i pagdhundur, rrallë bisedonte me njerëz.

Erdhi dimri, ia mësynë furtunat e furishme, frynë erërat e ftohta e të mprehta si brisku, u grumbulluan ortiqet e dëborës.

E shikon Bobili qenin dhe – sikur të ketë kuptuar mendimet e tij – i thotë me butësi dhe ngadalë:

- Vetëm, ti, o Shok, mos më lër vetëm, mua plakun.

Bredh Bobili me qenin, afrohet gjer te kasollja e vet, te kasollja e vjetër dhe e ftohtë si akulli. Vëren këndet e saj, shëtit sytë nëpër skajet e saj, por dru – asnjë krande. E shikon Bobili Shokun, por ai rri, pret fjalët e nikoqirit. Dhe thotë Bobili me zë të ëmbël:

- Do të mbroj unë ty, o Shok, me sajë do të shkojmë bashkë në pyll, do të mbledhim krande të thata, do t'i sjellim në kasolle, do të ngrohemi dhe do të pushojmë në shtroje të ngrohta.

Fërfëllaza u lodh së vajtuari. U bë më e rrallë, filluan të tingëllojnë pikat e pullazit. Shkrihet dhe zhduket bora. Bobili po sheh: dimri po shkon, kjo e bën të gëzohet dhe vazhdon bisedën me Shokun.

- Po vijnë ditë më të mira. Shok, po vjen pranvera.

Shkëlqeu dielli i praruar – dheu pranë dritares ka filluar të nxihet.

Shpërthyen gonxhet nëpër pemë, u shpërnda aroma e pranverës.

Mirëpo, Bobilin e kanë mashtruar vjetët e flladi pranveror ka nisur ta përkulë.

Nuk e mbajnë këmbët, kulli ia lodh kraharorin, ndien dhembje në bel dhe i

turbullohen sytë.

U shkri bora, u ter trolli. Nisi të lulëzojë dhe shelgu pranë dritares. Por plaku nuk mund të dalë nga kasollja. Rri i shtrirë në shtrat, nuk zbret dot.

Zbret Bobili me të vështirë, duke u kollur, dëshpërohet dhe i thotë shokut:

- Më parë, o Shok, ne të dy kemi pasur shpresë të madhe. Por, po shoh se së shpejti do të arrijë vdekja. E unë të vdes e ti të ngelësh vetëm – nuk është lehtë.

U sëmur Bobili, nuk ngrihet, nuk zbret dot nga shtrati, kurse Shoku nuk e bën një hap larg shtratit. E parandien plaku vdekjen, e ndien këtë gjë e përqafoi Shokun, e përqafoi rishtas dhe rrënkoi idhët dhe thellë...

Bie i vdekur Bobili mbi dysheme. E kupton edhe Shoku që ngeli pa të zotin. Endet nga njëri skaj në tjetrin dhe vuan. Afrohet Shoku, i merr erë të vdekurit – i merr erë dhe vingërron dhembshëm.

Njerëzit filluan të pyesin njëri-tjetrin: pse vallë Bobili nuk del nga kasollja? Vendosën dhe shkuan – shikuan, vërejtën dhe u kthyen. Bobili i vdekur rri shtrirë mbi dërrasat... Pranë tij, mbi gjunjë, qeni rri i mërëzitur.

E ngritën njerëzit të vdekurin, e morën dhe e lanë, e vunë në arkë, kurse qeni s'largohet prej tij. E çuan të vdekurin në kishë. Qeni shkoi me ata. E përzunë qenin nga kisha, e përzunë – nuk e lëshuan brenda. Lufton Shoku, bredh nëpër oborrin e kishës, vingërron, mezi qëndron në këmbë i këputur nga uria dhe vuajtja.

E dërguan të vdekurin në varr, e dërguan dhe e futën në dhe. Vdiq Bobili i panevojshëm për të gjithë dhe askush nuk derdhi pikë loti për të.

Uluron e leh Shoku mbi varr, leh e rrëmih dheun me kthetra. Dëshiron Shoku që ta nxjerrë mikun e tij të vjetër, ta nxjerrë dhe të shtrihet pranë tij. Nuk largohet qeni nga varri, nuk ha, vuan. Trupi i ligshtohet, nuk ngrihet dot, as që mund të ngrihet. E shikon Shoku varrin, e sheh, por nuk mund t'i lëvizë kthetrat. Shokut i digjet zemra... shpinën ia kaplon dridhja, e lëvar Shoku kokën, përulet, dridhet... dhe vdes pranë varrit...

*Sergej Jesenini*



### *Fjalë dhe shprehje*

gonxhe – burbuqe

rrënkoi – vuan, dergjet

lëvar kokën – e var kokën

nikoqir – zot shtëpie



## *Bisedë rreth tekstit*

Kush është Bobili e cili është Shoku i tij?  
Pse plaku Bobil përbufej nga njerëzit dhe shoqëria?  
Si shfaqet miqësia e dashuria e Bobilit ndaj Shokut të tij?  
Ç'bëri qeni i tij për të zotin?  
Ç'kuptojmë nga një përfundim i këtillë?



Sergej Jesenini

*Sergej Jesenini* (1895 – 1925) është shkrimtar i madh rus me prejardhje fshatare. Revolucionin e Tetorit e priti dhe e përjetoi me gëzim.

## ASHTI YNË

---

Gjeje vetveten në bririn e dheut  
E gjakun n'fosforin e cungut të thatë!  
Ruaju se ndoshta dikush kokën ta matë  
Gjerë e gjatë ndër shtigje të mëmëdheut!

Kanë qenë dikur do yje tanë të gjallë;  
Ata veten e kanë shkrië për të shdritë,  
Sot shpuza e tyre n'gurë na rrit çdo ditë,  
Tue na mbushur dejt tanë plot mallë.

Roje ndër shekuj emrin ta kem mbajt –  
I gatshëm gjithmonë për sulme e stuhi,  
O, kem vuajtur me gjarpërin, por s'kem qajtë!

Ti prore na dhe ngushllim, e si m'u mbajtë  
I mësove tana breznitë që t'patën lakmi.  
Ti bir i rreve q'u dogje për liri!

*Enver Gjerqeku*



## ***Shënim***

Enver Gjerqeku në vjershën “Ashti ynë”, e ka dalluar secilën gërmë të parë të çdo vargu me të zeza dhe kështu na ka dhënë emrin dhe mbiemrin: **Gjergj Kastrioti** dhe në këtë mënyrë ka krijuar një lloj vjershe të quajtur **akrostik**.

Në këtë akrostik me kuptime të rëndësishme dhe të thella, sikurse në shumë poezi të këtij poeti, kemi plot figura artistike dhe sidomos simbole.



### ***Bisedë rreth vjershës***

Kujt i është kushtuar kjo vjershë?  
Si mund ta kuptojmë se kujt i këndon poeti?  
Për cilët yje na flet ai?  
Kujt ia kemi mbajtur roje ndër shekuj emrin?  
Pse emri i tij na ka dhënë guxim nëpër shekuj?  
Cilit lloj të poezisë i takon kjo vjershë?  
Ç’do të thotë poeti me vargun:  
*O, kem vuajtur me gjarpërin, por s’kemi qajtë?*

***Simboli** është figurë poetike me kuptim të dyfishtë. Kështu p. sh. në këngët popullore të dashurisë vasha simbolizohet me thëllëzën, e djali me pëllumbin e bilbilin.*

*Simboli haset shpesh edhe në poezinë e shkruar p.sh. te Naimi, Çajupi, Mjeda, Noli, etj. Kur lexojmë, për shembull, vjershën “Himni i flamurit” të Fan Nolit me fjalën Flamur nënkuptojmë kombin shqiptar.*

### ***Ja edhe disa shenja të simbolit:***

*Flamuri simbolizon shtetin, kombin.*

*Hëna simbolizon islamizmin.*

*Kryqi simbolizon krishterimin.*

*Lepuri simbolizon frikën.*

*Dhelpra simbolizon dinakërinë, etj.*



**Enver Gjerqeku**

***Enver Gjerqeku** (1928 – 2008) lindi në Gjakovë më 1928. Filloi të shkruaj poezi qysh në ditët e para pas çlirimit. Ka shkruar vetëm poezi dhe ka botuar shumë vëllime si: “Bebzat e mallit”, “Blerimi i vonuar” etj.*

# FOTOGRAFIA

---

Ishte pranverë. Unë po kthehesha nga shkolla, kur më ndaloi tezja. Ajo s'më lëshonte pa më futur në ëmbëltoje. Ndërkohë më pyeti gjerë e gjatë si e kaloja me Verën. Nuk i ankojesha kurrë. Mirëpo dhe aq mirë nuk shkoja. As vetë s'e di pse keqkuptojesha me të për çdo gjë... I ktheja fjalë.

U vonova shumë. Në shtëpi gjeta Verën. "Trëng" ma bëri zemra. Sikur ta parandieja që do të shamatojesha me të. Hyra drejt e në dhomë, lëshova çantën në divan dhe nisa të kërkoja diçka nëpër sirtare.

- Ngadalë-ngadalë, se bëre pis, - më tha Vera, - i ke këpucët me baltë.

Unë vazhdova të vija rrotull derisa e gjeta atë që kërkoja.

- Shko të lahesh, që të hash drekë.

- Nuk kam uri, e hëngra mëngjesin vonë.

Ajo nuk më besoi, po s'tha gjë. Ama zëri iu drodh nga inati, kur më qortoi se po vija përditë pis, me vonesë e se po sillesha ashpër.

- Që të më zemërosh mua e bën ti?

- Jo. Të gjithë çunat e klasës bëhen pis, - ia ktheva unë, - se rrugës ka një kanal.

- E di kanalin unë, ai është matanë shkollës. Ç'kërkon andej ti? Pse sorollatesh nëpër shi?

Ajo më preku flokët me dorë.

- Bobo, ti qenke bërë qull! Si s'të vura re!

- Se... e kishe mendjen te balta, prandaj..., - mëmërita lirisht, ngaqë Vera në atë çast nxitoi të merrte peshqirin.

- Si the? – më pyeti ajo duke ma sjellë.

- Asgjë, asgjë, - ia ktheva unë.

U kënaqa shumë kur vura re një shenjë pasigurie në sytë e saj.

- Po ti the diçka.

- Thashë se... këtë duhej të vije re, jo baltën..., po të ishe e mirë.

Vera u trondit. E pashë kur ktheu kokën mënjane që të mos ia shihja lotët.

- Domethënë unë... nuk... nuk ditkam të hyj në zemrën tënde..., - dhe më hodhi një vështrim të shpejtë. – Vërtet... por ti mund të më ndihmosh, po të

duash. Më thuaj çfarë bënte nëna jote, si të thoshte ajo kur bëje faj? – më pyeti.

Unë heshta. Ajo doli nga dhoma për të më sjellë ndërresat. Më vuri dorën në ballë.

- E ke si të nxehtë.

- Punë e madhe.

- Pse sillesh kështu me mua? Çfarë të kam bërë?

- E di vetë...

...Ndërkohë më kishte bërë gati çaj bliri, që përhapte një aromë mjalti. U ula në divan. Ndërsa Vera vajti të lante ndërresat, unë mora në duar kornizën me fotografinë e nënës. Por ishte e pamundur të bisedoja me të si herët e tjera. Më pengonte zhurma që bënte Vera duke shpëlarë teshat, si dhe zënka që ndodhi. Jo, jo, kështu nuk shkohej.

Duke dashur të vija kornizën në vend, më shkau nga dora dhe u thye.

Vera hyri me nxitim në dhomë, më gjeti zbathur tek mblidhja copat e xhamit.

- Ngjitu, se i mbledh unë, do të ftohesh me këmbët në çimento.

- I mbledh vetë.

- Ngjitu lart, po të them! – më foli ajo rreptë.

Unë ia zgjata kornizën me një buzëqeshje të keqe në fytyrë. Befas ajo vuri re se ishte fotografia e nënës sime. Pamja e fytyrës i ndryshoi. Asaj i erdhi keq.

U kthye me të shpejtë dhe vajti në dhomë, hapi një sirtar e seç kërkoi. Kur erdhi ishte më e qetë. Vetëm buza i dridhej pak. Në duar kishte një kornizë të bukur, ku mbante një fotografi të sajën, të vetmen që kishte kujtim nga fëmijëria. Hoqi ngadalë thumbat, që mbanin xhamin, dhe zgjati dorën.

- Ma jep mua.

Unë iu binda i çuditur dhe i zgjata fotografinë. Pa thënë asnjë fjalë, Vera e vuri atë në kornizën e re dhe më pyeti:

- Ku ta vendosim?

- Atje, - mëmërita unë.

- Si të duash. Unë mendova se ke qejf ta kesh pranë shtratit.

Një copë herë ne heshtëm.

Ajo më shtriu ngadalë me një gjest fare të natyrshëm, më mbuloi me çarçaf dhe një copë herë ndenji me kokën të varur mënjanë. Pastaj befas më vështroi thellë në sy butësisht dhe tha me zë të ulët:

- Domethënë më ke shpallur luftë, kështu? Nuk më do; e ke vështirë apo jo? – psherëtiu ajo. – Edhe unë s'e kam të lehtë, Genc, - vijoi pas pak.

Unë ula sytë. Një çast luftova akoma me veten time.

Vera shoi dritën dhe la ndezur vetëm abazhurin. Unë lëviza në shtrat që t'i jepja të kuptonte se isha zgjuar.

- S'të ka zënë gjumi akoma, Genc?
- Nuk më zë...
- Po i hedh ca dru zjarrit, që të rrijë dhoma e ngrohtë sa të vijë babai...
- E presim të dy, s'kam gjumë, - i thashë. Ajo më vështroi si për të vendosur një komunikim të ri. Dhe ndërsa u mor me zjarrin, unë iu rrëfeva nga pak.
- Tani ndihesha më i qetë.
- E prisha sot, hə? – tha Vera me ngadalë e më shoi dritën.
- Natën e mirë, - thashë unë dhe s'e di përse lotët më njomën sytë. Doja të më përkëdhelte dikush. Të më lëmonte flokët.

*Shpresa Vreto*




### *Fjalë dhe shprehje*

keqkuptohem – nuk kuptohem me dikë, nuk merrem vesh  
 parandiej – e ndiej që më parë që do të më ndodhë diçka  
 më pyeti gjerë e gjatë - më pyeti me hollësi, për çdo gjë  
 nuk shkoj mirë me të – nuk kam marrëdhënie të mira me të, nuk kuptohemi  
 i kthej fjalë – i kthej përgjigje kundërshtuese dikujt, pasi më qorton  
 sorollatëm – sillem poshtë e lart duke humbur kohën kot



### *Bisedë rreth tekstit*

Kjo pjesë është marrë nga libri “Vit i paharruar” i shkrimtares Shpresa Vreto. Personazhi kryesor i librit, Genci, ka mbetur jetim, pa nënë. Ardhjen e njerks në shtëpi në fillim ai nuk e mirëpret. Por më pas ndërmjet tyre krijohet një lidhje e ngrohtë dhe miqësore.



# GJENIU I VOGËL!...

Moxarti që i vogël tregoi aftësi muzikore të rralla, ose më mirë të themi, të papara. Në historinë e muzikës ishte e pamundur të gjeje shembull të tillë që një vogëlush 3 vjeçar të ecte kaq shpejt në fushën e muzikës. Kur ishte 4 vjeç, Leopoldi (i ati) filloi t'i mësojë në piano disa pjesë të shkëputura. Moxarti i vogël i luajti ato me saktësi e bukuri të habitshme. I ati u bind se mësimi i muzikës nuk qe një zbatimje e thjeshtë, por një punë që djali i jepej me gjithë shpirt. Leopoldi e kuptoi këtë dhe nuk e la pasdore, por iu përkushtua me pasion. Koha kalonte dhe Moxarti rritej. Bashkë me të përhapej lajmi për djalin e jashtëzakonshëm të Leopoldit.

Moxarti kishte dashuri të madhe për çdo gjë: për njerëzit, kafshët, lulet. Linte çdo gjë kur duhej të ushqente kanarinën ose vadiste lulet. Çdo mbremje para gjumit përqafonte të atin, e puthte në majën e hundës dhe i premtonte se kur të plakej, ai do ta ruante në një kuti prej xhami dhe do ta mbante me kujdes të madh.

Ç'po bën im bir? – pyeste Leopoldi.

Tërë ditën pranë pianos, - përgjigjej e motra.

Moxarti ishte kërkues ndaj vetes. Asnjëherë nuk kënaqej me atë që kishte arritur. Përpiquej me ngulm të arrinte diçka të re, më lart se e para.

Lavdia e Moxartit arriti dhe në Vjenë.

Frynte një fllad i lehtë dhe vinte një erë e mirë menteje. Në këtë aromë të hollë kishte diçka që të prekte. Kopshtet dhe korijet aty-këtu kishin ndonjë dru me gjethe të verdha e të kuqërremta. Nëpër lumë lundronte ngadalë një maune që çante me përtësë ujin. Danubi, për kaltërsinë e të cilit është folur aq shumë, ishte i turbullt. Të tilla ishin dhe mendimet e të atit gjatë rrugës për në Vjenë. Ç'do t'i sillte Vjena atij dhe gjeniu të vogël? Vjena, kjo fole me njerëz të famshëm, duhej të mahnitej nga Moxarti i vogël. Dhe ashtu ndodhi. Lajmi për ardhjen e tij u përhap si rrufe në gjithë qytetin. Vjena kishte parë shumë çudira: këngëtarë të famshëm, pregjistiatorë që para syve të publikut ujin e bardhë e bënë verë të kuqe, kurse këtë e bënë flakë e tym etj. Por një mrekulli të tillë si bullaflqi i vogël, që luante në piano në mënyrë të mahnitshme, Vjena s'kishte parë ndonjëherë. Në sallonet e Vjenës tani bisedohej vetëm për Moxartin. Të gjithë nxitonin ta shikonin magjistarin e vogël. Ditën e tretë u thirr në pallatin e Kryedukës, i cili me ato sallat madhështore i la gojëhapur babain, djalin dhe pjesëtarët e tjerë. Ata u tronditën dhe u hutuan nga bukuritë e dhomave. Kjo e preku dhe Moxartin që nuk jepej aq lehtë, sa që Leopoldit iu desh të pickonte të birin pa u vënë re dhe t'i tregonte me sy një grua të gjatë, të plotë, me fustan të gjerë në krye të sallës. Ishte Kryedukësja dhe

pranë saj, i shoqi, një burë i gjatë dhe i hollë. Pickimi i babait e nxorri Moxartin nga gjendja e hutimit. Ai e kuptoi se ajo ishte gruaja që ai duhej t'i afrohej, t'i përkulej dhe t'i puthte dorën, sipas mësimëve të babait. Moxarti që nuk i duronte këto gjëra, vendosi të përshëndetej shpejt e shpejt dhe të ulej pranë pianos ku e ndjente veten të qetë si në shtëpinë e vet. Por, papritur, parketi ia punoi. Ai që pastruar gjer në shkëlqim, ngjante si një fushë akulli. Vogëlushi nga turpi dhe inati u mundua të ngrihej, por nuk mundi. Vajza e Kryedukeshës iu afrua me vrap, i zgjati dorën dhe e ndihmoi të ngrihej. Moxarti i buzëqeshi vajzës dhe tha me zë të lartë:

Të lumtë! Unë me ty do të martohem, sepse ti je zemërmirë. Kur u ul në stol pranë pianos dukej fitimtar. Koncerti i tij në pallat i mahniti të gjithë. Kryeduka iu afrua dhe i tha: - Të luash në piano duke parë tastierën, nuk është ndonjë art i madh. Nëse luan kur ajo është e mbuluar, atëherë po, tregon diçka.

Ta mbulojmë, - tha Moxarti pa hezitim dhe luajti po aq bukur si më parë.

Prapë, - vazhdoi kryeduka, - të luash me gjithë gishtrinjtë nuk është gjë e madhe... Të luash vetëm me një gisht, ja kush do të ishte art.

Ashtu?! Ja dhe me një gisht, - tha Moxarti dhe luajti po aq bukur disa pjesë. Të gjithë u habitën nga gjeniu i vogël. Fama e tij arriti kulmin. Më vonë ai do të kompozonte operat: "Dasma e Figaros", "Don Zhuani", "Flauti magjik" ejt., por ai qëndroi gjithë jetën i thjeshtë, indiferent ndaj lëvdatave dhe shkëlqimit të jashtëm të sukseseve të tij premtuese.

*H. Cvajg*

*(Përshtati: T.Harapi)*

## *Shënim*

Kjo pjesë është marrë nga libri "Moxarti" kushtuar jetës dhe krijimtarisë muzikore të kompozitorit të madh gjerman Wolfgang Amadeo Moxart (1756-1792), botuar më 1977.



## *Fjalë dhe shprehje*

**mente-ja** – bimë barishtore me erë të mirë. Gjethet e thara përdoren si erëz, esencë në liker, mente e karamelle

**korrije-a** – pyll i vogël me dushk ose drurë të tjerë jo të lartë

**pregjistiator-i** – njeri që bën lodra shpejtësie, magjistar

**kryedukë-a** – titull i lartë. Sundimtari i krahinës ose i shtetit

**operë-a** – vepër muzikore

**tastierë-a** – pllakëza prej fildishi a lënde tjetër te pianoja, firzhamonika që kur shtypen, nxjerrin tinguj

**tast-i** – një pllakëz e tastierës



## Bisedë rreth tekstit

Ç'veçori dalloi Leopoldi tek i biri dhe ç'bëri për zhvillimin e tyre?

Ç'mësim na përcjell veprimi i tij?

Si i kuptoni shprehjet: “ishte kërkues ndaj vetes”, “pickimi e nxori nga gjendja e hutimit”, “pranë pianos e ndjente veten si në shtëpinë e vet”, “parketi ia punoi”, “indiferent ndaj shkëlqimit të jashtëm”?

## Shpjegoni me fjalët tuaja!

Si e jep autori portretin moral e fizik të Moxartit?

Cilat janë mbresat kryesore që lë te ju ky gjeni i muzikës?

Gjeni krahasimet, tregoni si janë ndërtuar dhe përse shërbejnë.

Ç'farë ju pëlqen më shumë: muzika, piktura apo poezia dhe pse?

Keni në klasë nxënës(e) që ka prirje në muzikë, poezi apo pikturë?

Tregoni ç'bëhet në shkollën tuaj me talentet e reja.



## Detyrë

Nëse njihni ndonjë artist shqiptar me famë botërore, tregoni në klasë për jetën dhe veprën e tij.



# NE ISHIM, NE JEMI, NE DO TË JEMI KËTU...

---

Se kush erdhi tek ti, Kosovë,  
Kosova ime e dashur,  
Të quajti tokë të vet.  
E mua, birin tënd, që të ledhaton  
me mall dhe dashuri, dorën ta shkon,  
më quajti ardhacak, i pashtëpi,  
njeri pa tokë dhe qiell të vet mbi kokë,  
mysafir i përkohshëm dhe farë e ligë,

hije drithëritëse në ajër,  
as në tokë, as në qiell.

Por në rrugën e gjakut kafkën la kujtim,  
se ti s'je e atij shkel,  
lavrën tënde me vdekje ai mbjell  
S'je tokë e gjithkujt dhe e askujt,  
as tokë pa popull e një populli pa tokë.

Ti je dhe kreshnik i bijve besnikë,  
që të duam dhe të mbrojmë,  
me dashuri t'i mbjellim ugaret,  
me flamuj lirie ndër festa  
t'i mbulojmë varret.

Lule dhe gjyle në dorën e trimit  
je vatër e ngrohtë  
e atyre që kurrë s'të lanë vetëm,  
me ty qëndruan si shkëmb në erë,  
me ty,  
në jetë dhe vdekje,  
në liri dhe dashuri.  
Dhe në qoftë se dikush na thotë prapë:  
"Ikni që këtej, se kjo s'është toka juaj!"  
ne e dimë se ç'do t'u themi:  
"Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë,  
Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu!"

*Qerim Ujkani*





## *Fjalë dhe shprehje*

ardhacak-u – ai që ka ardhur nga një vend tjetër dhe është ngulur në një vend të ri, banor i ardhur nga diku, në krahasim me vendësit, ardhës drithëritës-e – që të fut drithmat, që të bën të dridhesh, që të drithëron, drithërues  
lavër-ra – arë e punuar dhe e mbjellë



## *Bisedë rreth tekstit*

Kjo pjesë është shkëputur nga vjersha që autori ia ka kushtuar vendlindjes së tij, Kosovës. Nëpërmjet saj thekson se Kosova ka genë, është dhe do të jetë vendi i shqiptarëve.

Ç' dini për historinë e Kosovës?

Kur mbeti ajo jashtë kufijve të shtetit shqiptar?

Në ç' shekull janë dyndur sllavët e jugut në Ballkan dhe ç' luftëra kanë bërë shqiptarët për të mbrojtur trojet e tyre amtare?

Ç' kuptoni me vargjet:

*“Se ti s’je e atij që shkel,  
lavrën tënde me vdekje ai mbjell”.*

Ç' ndjenja ju ngjall kjo vjershë? Pse?



## *Detyrë*

Shpjegoni dhe komentoni vargjet:

*“Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë,  
ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu!”*

Kujt i drejtohen këto fjalë të poetit?

## *Gradacioni*

*Në poezinë e sipërme të poetit Qerim Ujkani, krahas vlerave të tjera, kemi edhe figurën e gradacionit, e cila sajohet kur idetë, dukuritë dhe mendimet i radhitim duke pasur parasysh shkallën e fuqisë së tyre. Gradacioni i jep fuqi dhe bukuri të madhe stilit.*

*Si shembull të qartë për gradacionin po japim katër vargje të vjershës “Fyelli” të Naim Frashërit:*

*I ra qiellit e ndriti,  
i ra zemrës e nxehtu,  
i ra verës e buçiti,  
i ra shpirtit dhe e debu ...*

## BILBILI DHE SORRAT

---

Në Luginën e Errët, në një vend moçalik të mbuluar me shelgje e verrinj, nëpër të cilët kacavirren lëmyshqet dhe drita e diellit nuk arrin fare, pranë një bregu shkëmbor, ku gurët e thepisur mbajnë erë myshku, kishin foletë e tyre sorrat e zeza. Aty, në atë vend, ku dita i ngjante natës dhe ku mbretëronte qetësi e përhershme, e ngjashme me botën e gjumit, rrallëherë dëgjoheshin kroatjet e mbytura të sorrave që grindeshin duke ndarë prejën e rastit. Kjo botë e errët dhe e qetë për sorrat ishte mbretëri e qëlluar.

Dhe pikërisht në këtë Luginë të Errët, në mëngjesin e një dite të vjeshtës së vonë, u dëgjua zëri i ëmbël i një bilbili. Ishte ky një bilbil që kishte ngelur pas plimës së madhe të vëllezërve dhe motrave që kishin parandjerë afrimin e dimrit dhe kishin marrë rrugën e gjatë për në viset e ngrohta. Ishte lodhur dhe molisur nga udhëtimi i gjatë, kish humbur gjurmët e plimës së vet dhe kish rënë mbi një shelg të Luginës, në mbretërinë e sorrave. Eh, sikur ta dinte ai në ç'vënd ish ndalur sigurisht do të bënte përpjekjet e fundit, do të shkonte ca më tej dhe do të zgjidhte një vend më të përshtatshëm për të pritur plimat e vëllezërve të tjerë.

Mirëpo, meqë nuk dinte ku ndodhej, pasi pushoi ca dhe u këndell, e filloi zanatin e trashëguar, sa i mallëngjyer se mbeti vetëm, në botë të huaj e të panjohur, aq edhe për t'u dhënë shenjë shokëve që mund të kalonin fluturim sipër tij.

Edhe pse ditë vjeshte, dielli sikur derdhte argjendin e fundit mbi gjethet e praruara, të cilat era e hollë i farfuriste mbi tokë. Bukuria e ditës bilbilit i jepte guxim dhe kurajë për të derdhur akordet e mallëngjimit. Këndonte bilbili për dritën e ditës me diell të artë, për gjerësinë e qiellit të kaltër, për hapësirën ku mund të fluturonte i lirë dhe kënga e tij i ngjante lamtumirës së fundit të këtyre viseve ku kishte përjetuar çastet më të bukura dhe më të lumtura. Zëri i këngës së tij ishte si gurgullimë e kroit malor, por në të gëzimi dilte i përzier me një farë brengje dhe mallëngjimi, me një farë shprese se ditët e dimrit të ftohtë do t'i kalonte në mesin e vëllezërve dhe motrave, atje ku ftohtësia dhe dimri nuk arrijnë kurrë.

Lugina e Errët për herë të parë kishte fatin të dëgjojë këngë aq të ëmbël që qetësinë e përhershme dhe të mërzitshme e bën të gjallë dhe të gëzueshme. Kënga e bilbilit jehoi anembanë Luginës, depërtoi në çdo skutë të thellë, madje edhe në

zgafellet e bregut shkëmbor të fshehur nën hijen e ftohtë të verrinjve ku kishin foletë serrat e zeza. Serrat në fillim ngelën si të shtangura dhe të magjepsura nga ky zë i ëmbël dhe i padëgjuar, i panjohur për to deri atëherë.

- Cili do të ketë ardhur sot në Luginën tonë? – pyeti një sorrë e vogël e paditur, sorrën plakë që kishte pranë.

- Nuk jam e sigurt, por nëna ime e ndjerë më ka thënë se këngëtari më i mirë i botës së shpezëve është bilbili, - iu përgjigj sorra plakë me një farë keqardhjeje.

- Oh, përkundrazi! Ky zë më duket i keq dhe i mërzitshëm, - u hodh një sorrë kokëthinjur, plot mllef e vrer ndaj sorrës që lavdëroi këngën e bilbilit.

- Asnjëri nuk e ka thirrur atë në Luginën tonë që të na prishë qetësinë e të na e nxjerrë gjumin me atë zë shurdhues, - iu bashkua sorrës kokëthinjur një sorrë e ligë, e cila ishte ziliqare dhe jetonte në kurriz të atyreve që u mbante anën.

- Ai është i sojit tonë – tha sorra më e vjetër, e cila njihesh për kryeplakë dhe nderohej për urti dhe kuvend në botën e Luginës.

- Ai është mysafir i paftuar në vendin tonë dhe ardhja e tij është lajm i keq!

Fjala e kryeplakës shkaktoi turbullim dhe shqetësim në mesin e sorrave. Ato nuk njihnin botë tjetër përveç Luginës së Errët. Veshi i tyre nuk ishte mësuar të dëgjojë tjetër zë. Sytë e tyre nuk e duronin botën me dritë e shkëlqim. Ata i urrenin edhe gjerësitë e lira e të paskajshme të qiellit.

- Po pse këndon kështu pa pushim? – pyeti një sorrë kureshtare. – Mua më duket se ai ka ardhur të na lavdërohet se di të këndojë më bukur se ne! – tha ajo dhe provoi të këndojë, por nxorri një klithmë të egër dhe të sëmurë, sa që edhe vetë u turpërua nga zëri i paakorduar. Serrat tjera as që provuan të nxjerrin zë, sepse e dinin që kënga ishte mjeshtri e panjohur në botën e tyre.

- Bilbilat s'kanë punë tjetër. Veç këndojnë dhe fluturojnë. Janë të papunë dhe të hazdisur...- foli sorra kryeplakë duke treguar njohuritë e saja të gjera edhe për një botë tjetër, për të cilën serrat tjera s'kishin ditur gjë deri atë çast.

Dhe kështu serrat dolën nga zgafellet dhe u tubuan nën shelgun pranë përroit të ndyrë, që të vendosnin ç'të bënin me mysafirin e paftuar. Folën të gjitha me radhë, por asnjëra nuk fshehu zilinë dhe smirën, asnjëra nuk kishte guxim të thotë se kënga e mysafirit nuk prishte punë, por i jepte gjallëri asaj lugine të heshtur.

Ra vendimi që tri serrat më të fuqishme të shkonin dhe t'i urdhëronin bilbilit që menjëherë të ndërpresë këngën dhe të largohej nga maja e shelgut. U vërsulën drejt majës ku ai këndonte i dalldisur pa menduar të keqen, i qëndruan mbi kokë ashtu të zeza dhe të kërlëshura si trishtima duke krokatur me neveri. Bilbili u trondit nga rreziku i papritur dhe i ngeli kënga në sqep. Serrat filluan ta quknin me sqepa nëpër trup e kokë dhe së shpejti ai u gjet në kthetrat e ashpra të cilat i shkaktuan dhembje të padurueshme. Provoi të fluturojë drejt qiellit dhe tani iu

duk i turbullt dhe i skuqur si zjarri, por ndjeu dhembje në krahët. Kur pa se nuk do të ishte në gjendje të fluturojë lart e larg, u lëshua teposhtë nëpër degë, me shpresë se do të gjente ndonjë gropë të fshehtë në tokë.

Duke rënë poshtë, sytë ia mbuloi gjaku. Përpëlitej nëpër degët dhe çdo takim i krahëve dhe i trupit i shkaktonte plagë dhe dhembje të reja të padurueshme. Mendoi bilbili se toka në fund të shelgut do të ishte edhe fundi i jetës së tij. Me krahët e lënduar nuk mund të fluturonte e të mbante drejtimin dhe mbi tokë ra si topti i vogël leckash. Qëndroi një kohë aty si i vdekur, kur nisi të vijë në vete, provoi të çelë sytë e të shohë ku gjendej. Me mundime të mëdha çeli sytë të larë me lot e gjak, por çdo gjë iu duk e turbullt, e paqartë dhe e errët.

*(fragment tregimi)*

*Fejzi Bojku*

### ***Shënim***

Mund të kuptohet fare lehtë se ky është një tregim alegorik, për shkak se shkrimtari, përmes bilbilit dëshiron të na flasë për një kategori njerëzish dhe përmes sorrave për një kategori tjetër.

Shkrimet e tij i shquan një arsye e fortë, porosi etike e morale, shoqërore e njerëzore. Në prozën e tij çdo detaj e çdo personazh luan funksion të rëndësishëm e artistik.



### ***Bisedë rreth tekstit***

A mund ta parafytyroni Luginën e Errët?

Ç' domethënie ka kjo fjali: Sytë e tyre (të sorrave) nuk e duronin botën me dritë e shkëlqim?

Gjeni dhe rrëfeni se ç'është alegoria!

Gjeni cilët njerëz i përfaqëson bilbili e cilët sorra?

### ***Shprehje të figurshme***

Dielli sikur derdhte argjendin e fundit mbi gjethet e praruara.

Jetonte në kurriz të atyre që ua mbante anën.

I jepte gjallëri asaj lugine.

# DJALOSHI I GURTË

---

Nëpër një deriçkë të vogël hymë në një kopsht të bukur. Aty në një kënd po rrinte një njeri me kostum pune me duar të përvjelura. Ish ulur mbi një karrigë dhe shikonte një gur të gdhendur në trajtë të njeriut. Rrinte pa lëvizur dhe vetëm nganjëherë kruante kokën pas veshit me latues të hekurt.

- Mirëdita, xha Demo! – e përshëndeti shoku ynë që na çoi aty e mandej e nderuam edhe ne gati njëzërit.

Në fillim u duk sikur u tremb dhe deshi ta mbronte atë shkëmb të gdhendur. Kushedi. Ndoshta i shkoi ndërmend se mund t'ia prishnim. Por pas pak bëri sikur na njohu. U ngrit në këmbë për të na pritur.

- Urdhëroni, mirësevini... Përshëndetuni edhe me Djaloshin.

Unë kujtova se mund të ishte edhe dikush tjetër aty, por sado që e kërkova me sy, s'e pashë dot.

- Djaloshi i gurtë s'mund të flasë, xha Demo – ia bëri Besniku, i cili e kishte hetuar hutimin e plakut.

- Si s'flet, or bir? Unë po bisedoja me të kur erdhët ju.

- E ç' thoshte?

- Thoshte: më bën të bukur që të më duan fëmijët.

Besniku ma shkeli syrin. Më shkoi mendja se mund t'i bënte ndonjë sherr plakut, prandaj nxitova të flas para tij.

- Qenka djalosh i mrekullueshëm, xhaxha. Si e ka emrin?

- Djalosh. Ky është Djaloshi i Lirisë, a ju pëlqen?

- Emër i bukur. E gëzoftë!

- Do të jetë i lumtur kur ta vendosim para Pallatit të Fëmijëve. Aty do të qëndrojë gjithë jetën dhe do t'u japë fëmijëve ujë me ibrik të argjendë. A s'është kështu Djalosh? – iu drejtua në fund gurit të gdhendur. Por ai heshte.

Djaloshi i Lirisë kishte shtat të hedhur dhe qëndronte në këmbë mbi një copër shkëmbi. Kokën e mbante lart me krenari të dukshme. Shikonte ëmbël nën dy vetulla të drejta. Këmbët i kishte të forta, por duart i mungonin. Në vend të tyre ishte një copë shkëmb i pa gdhendur.

- Pse s'ia nxirrni edhe duart, xhaxha.

- Eh, duart është vështirë t'ia punoj. S'di si t'ia bëj. Njërën e kam menduar, do ta mbajë me të ibrikun e argjendë. Nga ibriku do të rrjedhë ujë i kulluar, i cili na i shëron plagët e luftës, por, ju nuk dini ç'është lufta... Në dorën tjetër s'di çfarë t'i gdhend.

- Unë mendova diçka tjetër – i thashë me drojë.

Ai ktheu përtueshëm kokën dhe më shikoi. Pastaj ma mbylli njërin sy dhe tha:

- Fol!  
 - Në dorën e djathtë ia bëni librin!  
 - Librin thua?  
 - Po, librin, xhaxha. Ai është si qiri i Naim Frashërit, që na bën dritë në jetë, thotë mësuesi ynë – i thashë.  
 Mjeshtri dëgjonte i habitur.  
 - Rrini këtu pranë mjete – tha më në fund. – Kur po ju shoh juve, po gdhend më bukur në mendje Djaloshin e Lirisë. Edhe duart më dëgjojnë më mirë.....  
 Ne ishim të lumtur që mund t'i ndihmonim një artisti.  
 - Nesër do të jetë gati Djaloshi – pëshpëriti si për vete xha Dema.  
 - Edhe pushkën thua?  
 - Jo pushkën – tha Besniku. – Ky është në liri.  
 - Por duhet ta mbrojë lirinë – tha plaku dhe drodhi kokën.  
 Të dy sytë i flakëruan prej gëzimit. Na e shtrëngoi dorën të gjithëve dhe filloi punën. Sillej rreth Djaloshit dhe herë-herë e përqafoi si i luajtur mendsh nga gëzimi. Edhe mua më kaploi një gëzim i pafund. Dhe kisha të drejtë: Djaloshi i Lirisë u zbukurua edhe nga fjalët e mia....

*Vehbi Kikaj*



### *Bisedë rreth tekstit*

Kush ishte xha Dema dhe ç'bënte aty?  
 Çfarë bisede zhvilluan të rinjtë me xha Demën?  
 Pse xha Dema ia ka vënë emrin Djaloshi i Lirisë trupit të skalitur në gur?  
 Çfarë propozimi i bëri djaloshi xha Demës? Si i pëlqeu ky mendim?  
 Ku duhej të vendosej truporja e Djaloshit të Lirisë? Çka paraqet ajo?



### *Detyrë*

Lexoni romanin “Sarajet e bardha” të shkrimtarit Vehbi Kikaj.

## IKJA

Nëndetësja fugonte me shpejtësi të madhe drejt veriut. Deri në mbrëmje kaluan dyqind mila nëpër oqeanin Atlantik. Atë natë nuk më zuri gjumi. Ajo skenë e tmerrshme më dilte gjithnjë parasysh.

Që prej asaj dite nuk munda të kujdesem më se nga po na çonte nëndetësja me këtë shpejtësi të rrezikshme. Nuk mundja të kontrolloja as kohën, sepse të gjitha orët në nëndetëse ishin ndaluar. Mendoj se ky lundrim mund të zgjaste nja pesëmbëdhjetë a njëzet ditë. Nuk e pashë më as kapitenin Nemo, e as ndokënd nga ekuipazhi. Gjithnjë fugonim nën ujë. Kur dilnim ta përtërinim ajrin, kapakët çelleshin e mbylleshin automatikisht. Nuk bënim matje, prandaj nuk dija se ku gjendeshim.

As kanadezi nuk shihej më. Këshilli nuk mund të nxirrte më asnjë fjalë prej tij dhe kishte frikë se, në ndonjë çast dëshpërimi ose malli për atdhe, mund të vriste veten. Një mëngjes, kur u zgjova, pashë Nedin mbi mua. Ai më tha me zë të ulët.

- Sonte do të ikim! Duket se nëndetësja nuk ka më kurrfarë mbikëqyrjeje. A do të jeni gati profesor?

- Po, por ku gjendemi tash?

- Afër një toke, të cilën e pashë sot nja njëzet mila larg.

- Cila është ajo tokë?

- Nuk e di, por cilado qoftë, ne do të ikim.

- Mirë, Nedi, do të ikim, edhe sikur ta di se do të mbarojmë në det.

- Deti është mjaft i shqetësuar, era mjaft e fortë, por nuk do të jetë vështirë t'i kalojmë njëzet mila në atë lundër të lehtë. Atje vura pak ushqim dhe ujë. Nëse na befasonjë, unë do të mbrohem e le të na vrasin.

- Do të vdesim bashkë, Nedi.

- Megjithatë, kam shpresë se do t'ia dalim të ikim. Në orën dhjetë hëna ende nuk do të dalë, e prandaj do ta shfrytëzojmë terrin. Eni te lundra atje, ju presim Këshilli dhe unë.

Doli. Zemra filloi të më rrahë fort. Vesha kostumin e nxehtë dhe sodita se mos dëgjohej ndonjë zhurmë në dhomën e kapitenit. Dëgjova do hapa. Më dukej se kapiteni do të hynte orë e çast në dhomën time dhe do të më pyeste pse do të iki. Fantazia ime zmadhonte gjithçka. Prapë arrita të qetësohem pak dhe u shtrira në

shtrat. Në orën nëntë e gjysmë e mbajta kryet që mos të më plasë. S'doja të mendoja më. Duhej të pritja edhe një gjysmë ore. Gjatë kësaj kohe m'u duk se do të çmendesha.

Në atë çast dëgjova tinguj të paqartë organosh, një muzikë melankolike që i përngjante dënesës së shpirtit të vuajtur. Më përshkoi mendimi se kapiteni gjendet tash në sallon, nëpër të cilin më duhet tash të kaloj për të arritur deri te lundra. Atje do ta shoh, sigurisht, për herë të fundit. Ai do të më shohë dhe ndoshta do të bisedojë me mua. Një lëvizje e tij do të mund të më zhdrukë. Një fjalë e tij do të më lidhte përgjithmonë për nëndetëse.

Erdhi çasti kur m'u desht të nisem. Çela me kujdes derën e dhomës sime. M'u duk se kërciti fort. Ecja ngadalë, si hajn, duke u ndalur orë e çast për të qetësuar të rrahurat e zemrës. Në sallon errësi e plotë. Kapiteni gjendej aty, por nuk më pa. Mendoj se nuk do të më shihte as ditën, aq tepër ishte zhytur në muzikë. Shkoja zhagas nëpër qilim, për të mos shkaktuar as zhurmën më të vogël. M'u deshtën pesë minuta derisa arrita në bibliotekë. Posa desha ta çeli, një ofshamje e kapitenit më nguli në vend. Ishte ngritur. U nis drejt meje me duar të kryqëzuara, duke ecur si ndonjë fantazmë. E dëgjova duke i pëshpëritur këto fjalë:

- Oh, mjaft më! Mjaft!

Vrapova në bibliotekë dhe nëpër shkallë arrita te lundra.

- Të ikim! Të ikim! – thashë unë.

- Menjëherë! - u përgjegj kanadezi.

Kanadezi filloi ta përgatisë lundrën, kur dëgjua një zhurmë në nëndetëse. A mos e vunë re ikjen tonë? Nedi ma shtriu një thikë. Përgjua me vëmendje, por një fjalë të cilën e dëgjonim pareshtur, na zbuloi shkakun e këtij shqetësimi në nëndetëse.

Asnjë fjalë nuk do të ishte më e tmerrshme në pozitën në të cilën ndodheshim. Gjendeshim në gjirin e tmerrshëm afër bregut suedez, prej të cilit nuk ka shpëtuar asnjë anije. Këtu tubohen valë vigane nga të gjitha anët. Këtë vend e kishin quajtur me plot të drejtë me emrin “Kërthizë e Oqeanit”, sepse uji këtu mbështillet nga pesëmbëdhjetë kilometra rreth e rrotull. “Nautiliusi” hyri këtu rastësisht ose me dashje dhe filloi të rrotullohet në rreth që bëhej gjithnjë e më i ngushtë.

Lundra, gjithnjë e lidhur me nëndetësen, rrotullohej pareshtur me shpejtësi të madhe. Gjaku na u ngri në det. Po laheshim në djersë të ftohta të mortjes. Rreth lundrës dëgjohej zhurmë shurdhuese. Valët përplaseshin rrëpirave të mprehta nën det, atje ku thehen edhe sendet më të forta. “Nautiliusi” luftonte si të ishte krijesë njerëzore. Muskujt e tij prej çeliku kërcitnin.

- Prapë duhet ta shtrëngojmë lundrën me vidha – tha Nedi. – Nëse mbetemi të gjithë në “Nautiliusin”, ndoshta do të shpëtojmë...

As nuk i pat mbaruar fjalët kur dëgjua një kërcëllimë. Lundra u shkoq dhe



si guri që hidhet me llastik, ra në midis të gjirit. Unë i rashë me krye buzës së çeliktë dhe u alivanosa.

Çka ndodhi atë natë, si mundi të shpëtojë lundra prej këtij gjiri të tmerrshëm dhe si mbetëm gjallë të tre, nuk do të dija të them. Kur erdha në vete, pashë veten të shtrirë në një kasollë të ujdhesës Lofoden. Shokët gjendeshin pranë meje.

Çka ndodhi me “Nautilusin”? A shpëtoi prej melstromit? A do të jetë gjallë kapiteni Nemo? Kurrëgjë nuk di. Megjithatë, besoj se nëndetësja do të ketë mundur të dalë nga gjiri në të cilin kishin gjetur vdekjen të gjitha anijet.

(Nga vepra: “20.000 mila nën det”)

*Zhyl Vern*



### *Fjalë dhe shprehje*

**ekuipazh-i** – tërësia e njerëzve që shërbejnë në një anije ose aeroplan fugoj – iki me vrap

**milë-a** – njësi mase për distancë prej njëmijë hapash dhe është afro një kilometër e gjysmë

**sodis** – rri e shikoj me vërejtje, vë re

**fantazmë** – hije që na përngjan në dikë

**përgjoj** – rri fshehur e dëgjoj fjalët që thonë të tjerët

**rrëpinë-a** – vend shumë i pjerët

**vidhë-a** – burmë



### *Bisedë rreth tekstit*

Bisedoni në klasë mbi këtë ndodhi të tmerrshme për marinarët e nëndetësës “Natiliusi” dhe gjeni momentet më të prekshme në të.

Thoni si e vlerësoni qëndrimin e tyre që vendosën të ikin dhe t’i lënë shokët në valët e tmerrshme të detit.



### *Detyrë*

Për të kuptuar më mirë qëndrimin e këtyre shokëve dhe fatin e mëtejme të ‘Natiliusit’, lexoni romanin e Zhyl Vernit “20.000 mila nën det”.

### *Romani fantastiko-sbkencor*

*Romani fantastik qubet ai roman që përshkruan gjëra fantastike, por që aty-këtu kanë ndonjë pikë takimi me realitetin. Temat e këtij romani merren nga zbulimet dhe shpikjet teknike.*

*Romane të tilla ka shkruar Zhyl Verni dhe shumë të tjerë*

# BAGËTI E BUJQËSIA

---

Ju bregore bukuroshe! E ju lumenjt' e kulluar!  
Çuka, kodra, brinja, gërxhe, dhe pyje të gjelbëruar!  
Do të këndonj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni;  
O vëndëthit e bukur, ju mendjenë ma dëfreni.

Kur dëgjon zëthin e s'ëmës, qysh e le qengji kopenë,  
Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë;  
Edhe në i pufshin udhën, njëzet a tridhjetë vetë,  
e ta trëmbin ajy s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë.

Mëndje! Mer fushat e malet, jashtë jashtë nga qyteti,  
nga brenga, nga thash-e-thëmet, nga rëmuja nga rëmeti.

Tek këndon thëllëza me gas edhe zogu me dëshirë,  
E qyqja duke qeshur, bilbili me ëmbëlsirë,  
tek hapet trëndafili, atje ma ënda të jem,  
bashkë më shpesh edhe unë, t'ja thëres këngës, t'ia them,  
Të shoh keçërit e shqerrat, deshtë cjepët, dhënt e dhitë,  
Qiellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me dritë.

- Vashë bukurosh' e bariut! Që vjen me llërë përveshur,  
Me zemër të dëfryer, e me buzëzë të qeshur,  
Me dy shqerëza ndër duar të bukura si dhe vetë,  
Në sythit tënd e shoh gazë që s'e kam gjetur ndë jetë.  
Dashi sysk'e me këmborë që e ke manar po të vjen pas,  
Dhe qeni me bes i larmë, të ndjek me dëshir e me gas,  
Dashç Perëndinë, pa më thua, a mos na pe bagëtinë?

- I lash' atje pas më të gdhirë... ja atje përtej tek vinë.  
O! Sa bukuri ka tufa! Sa gas bie bagëtia!  
Vinë posi blet e plotë, i bekoftë Perëndia!

Nëpër shesh e nër bregore, janë përhapur shqerrat!  
E kecërit nëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat!  
Sa me vrap e me gas bredhin edhe lozin shok me shok,  
Aty përhapen me nxit, aty mblidhen prapë tok,

Edhe prapë tufë-tufë, përhapen duke bredhur,  
Duke ikur me vrap shumë, duke lojtur duke hedhur,  
Nxitojn' e s' lodhen kurrë, edhe kur i mer uria,  
se cili futet në tufë, suletë te mëm' e tia.

Posa gjen mëmën e dashur dhe me vrap i hyn në gji,  
Rri në gjunjë dhe e zë sisën, e qumështin e ëmbël pi,  
Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë ndo dele,  
Bir' e vetëm e mer në gji, me gas e me përkëdhele...

Sa më pëlqen blegërima, zër' i ëmbël i bagëtisë,  
Qëngji dhe kec' i bukur, që rri në gjunj' e pi sisë,  
Përhapurë bagëtia nëpër shesh e nëpër brinja  
Nër lajthi e nëpër dushnja, ndër muriza ndër dëllinja;  
Bien zilet dhe këmborët, dhe fyelli dhe xhuraja,  
Dhe bleron e gjelbërojnë, fusha male brigje maja,  
Edhe gjithë gjë e gjallë, ndjen në zëmër një dëshirë,  
Një gas të ëmbël e të shumë! O! Sa bukur e sa mirë!

*Naim Frashëri*

### *Shënim*

Në veprën në vargje, “Bagëti e bujqësia” nga Naim Frashëri shihet dashuria e poetit për vendlindjen e vet dhe malli aq i madh që e diqte duke qenë larg atdheut. Gjithë mërzinë nga jeta në një qytet të madh dhe të huaj (Stamboll), gjithë mallin për vendlindje që i shkaktonte vuajtje shpirtërore, Naimi e ka shprehur përmes kësaj vjershe të gjatë – të cilën e quajmë poemë.



### *Fjalë dhe shprehje*

çuka – majë mali apo majë bregu

gërxhe – vend shkëmb, shkëmb me thepa

kopenë – tufën  
 rrëmuja – trazirë, tollovi njerëzish  
 rrëmeti – turma, njerëzia  
 ma ka ënda – kam qejf, kam dëshirë  
 dashi sysk – dashi që ka njolla të zeza në turi dhe rreth syrit  
 dashç perëndinë – pash perëndinë  
 sulet – turet, vrapon  
 dushnja – me dushk i imët  
 murriza – gjini shkuresh me gjemba  
 dëllinja – dru i vogël me gjethe si gjemba dhe kokrra të zeza  
 xhuraja – fyell i bariut



### *Pyetje dhe detyra*

Pse i këndon me aq dashuri dhe pse iu duken aq të bukura poetit viset dhe natyra e vendlindjes?

Qyshkur i ka mbetur ky parafytyrim kaq i gjallë poetit mbi jetën e barinjve shqiptarë?

Përshtetja në një ambient blektoral, ashtu si e keni parë apo dëgjuar!



Naim Frashëri

*Naim Frashëri* (1846 – 1900) lindi në fshatin Frashër, afër Korçës. Është poeti më i madh i Rilindjes sonë. Tërë jetën dhe punën e vet ia kushtoi çlirimit të atdheut të vet nga zgjedha e osmanëve. Veprat e tij letrare janë me temë patriotike, arsimdashëse dhe kanë vlerë të madhe artistike. Vdiq më 1900.

Për lexuesit më të vegjël Naim Frashëri ka shkruar: “Këndimit të çunave këndonjëtojeja”, “Të vegjëlit”, “Katër stinët”. Ka shkruar edhe shumë fabula dhe i ka adaptuar bukur fabulat e njohura të La Fontenit, etj.

## DON KISHOTI PRET ME SHPATË KOKËN E VIGANIT...

---

Sanço Panço doli me shamatë nga plevica ku flinte Don Kishoti, duke thirrur:

- Ejani shpejt or zotërinj, dhe ndihini tim zoti, i cili është përleshur në betejën më të tmerruar e më të llahtaritur që më kanë parë sytë.

Për zotin, me një të goditur të shpatës që i këputi viganit, ia preu kokën si kas-travec.

- Ç' thua mor vëlla? - tha prifti, i cili e la këndimin e novelës. Je ndër mend or Sanço? Si është e mundur një gjë e tillë, kur vigan i ndodhet shumë larg së këtejmi?

Mbi këtë e sipër dëgjua një shamatë të madhe nga oda e Don Kishotit, i cili po bërtiste:

- Mbrohu, kusar, zuzar, zagar, se tani të kam në dorë dhe jatagani s' të hyn në punë!

Me këto fjalë, Don Kishoti po godiste muret me shpatë dhe Sançoja tha:

- Mos rrini aty duke dëgjuar, po hyni brenda dhe i ndani luftuesit dhe i ndihni ustait. Po nuk besoj të jetë nevoja, se pa dyshim është vrasë, se unë ia pashë gjakun që i rridhte përdhe si rrëke dhe kokën e prerë, që iu rrukullis në një çip, e cila ishte e madhe sa një shakull i verës.

- Djall o punë! - tha hanxhiu, - Don Kishoti a Don shejtani më ka shpuar ndonjë nga shakujt me verë të kuqe që kishte pranë shtratit dhe vera që u derdh, duhet të jetë gjaku që ka parë ky budalla.

Me të thënë këto fjalë, hanxhiu hyri në odë dhe të gjithë të tjerët i ranë pas dhe e gjetën Don Kishotin me kostumin më të çuditshëm në botë. Ishte me këmishë vetëm. Këmbët i kishte të gjata, leshtore dhe jo shumë të paqme; në kokë mbante të mbështjellë çarçafin e shtratit, me dorën e djathtë mbante shpatën e zhveshur, me të cilën po godiste nga të gjithë anët, sikur luftonte vërtetë me ndonjë vigan. Dhe, bukuria ishte që s' i kishte sytë të hapur, po të mbyllur, flinte dhe ëndërronte që po luftonte me viganin. Duke pandehur se po godiste viganin, kishte hapur shakujt dhe plevica ishte mbushur e tëra me verë. Kur e pa këtë gjë hanxhiu, u zemërua aq shumë, sa iu vërtit Don Kishotit dhe nisi ta godiste me grusht aq keq, sa sikur të mos e mbanin Kardeni dhe prifti, do të kishte marrë fund beteja e vi-

ganit. Po, me gjithëkëtë, kalorësi i varfër prapë nuk u zgjua, gjersa solli berberi një kovë ujë të ftohtë nga pusi dhe ia derdhi të tërë mbi trup dhe nga kjo i doli gjumi Don Kishotit, po jo aq sa të shikonte në ç'hall po ndodhej. Dorotea, e cila vuri re veshjen e tij të shkurtër dhe të hollë, nuk deshë të hynte brenda për të shikuar be-tejën. Sançoja po shikonte për tokë kokën e viganit dhe duke mos e gjetur tha:

- E di fare mirë se në këtë shtëpi të gjitha janë të magjepsura, se ja edhe tani u zhduk ajo kokë që e pashë me sytë e mi, kur e preu ustai dhe i rridhte gjaku si krua.

- Ç'kokë dhe gjak më thua, more budalla i djallit? - tha hanxhiu. Nuk i sheh, or buf shakujt e shpuar dhe verën e kuqe të derdhur në odë? Ah, iu derdhtë shpirti në skëterrë atij që m'i shpoi.

- Nuk di gjë, - u përgjigj Sançoja, - di vetëm që po të mos e gjej unë i ziu atë kokën e prerë, atëherë më humbi e m'u tret nisja si kripë në ujë.

Kështu Sançoja i zgjuar ëndërronte më keq se i zoti i fjetur, aq shumë ia kishin turbulluar mendjen zotimet që i kishte dhënë ustai. Hanxhiu po marrorej nga përçartjet e shqyrtarit dhe nga zullumet e kalorësit, po bënte be se këtë herë nuk shpë-tonin si herën tjetër, se privilegjet e kalorësit nuk shkonin më, se duheshin paguar të gjitha dëmet për verën e derdhur dhe për shakujt e shpuar.

Prifti po e mbante për dore Don Kishotin, i cili besonte që e kishte mbaruar aventurën e viganit.

- Nuk e thashë unë? - tha Sançoja. Jo, or jo, se nuk jam as budalla as i pirë.

E fitova nisinë dhe titullin e kontit dhe më bëfshin mirë.

Kush mund të mbante të qeshurat për marrëzitë e të dyve, të ustait e të çirakut! Të gjithë qeshnin, përveç hanxhiut, i cili shfrynte dhe mallkonte. Më në fund, me një mijë mundime, berberi, Kardeni dhe prifti e shpunë në shtrat Don Kishotin, të cilin e zuri menjëherë gjumi nga lodhja e madhe. E lanë të flinte dhe dolën tek dera e hanit, për të ngushëlluar Sançon që nuk e gjeti dot kokën e viganit. Gjithashtu u përpoqën të qetësonin hanxhiun, i cili ishte i dëshpëruar për vdekjen e papritur të shakujve. Hanxhiu po ulërinte me klithma:

- E mallkuar qoftë dita dhe ora që na hyri në shtëpi ky kalorës i arratisur!

Ah, sikur të mos ma kishin parë sytë kurrë, se më ka kushtuar shumë shtrenjtë.

*Miguel Servantes*

## *Shënim*

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Don Kishoti" i shkrimtarit të njohur spanjoll Miguel Servantes. Romani, që u botua së pari më 1605, është ribotuar shumë herë. Është një nga kryeveprat e letërsisë botërore. Në të demaskohen përpjekjet për ta kthyer rrotën e historisë prapa. Ky roman lexohet edhe sot me ëndje si lexim shkollor.



### *Fjalë dhe shprehje*

plevicë-a - kasollë, ahur bagëtish, shtëpi përdhese

i, e **llahtarisur** - i tmerruar, i trembur

**zuzar-i** - njeri i poshtër, rrugaç, faqezi

**jatagan-i** - shpatë jo shumë e madhe, e përkulur në majë

**shakull-i** - kacek lëkure bagëtish të imëta, e regjur dhe e bërë si thes për të mbajtur bulmet, vaj etj

**nisi-a** - ishull

**shqytar-i** - trimi (njeriu) që shoqëronte kalorësit në mesjetë dhe u mbante armët dhe mburojën

**shqyt-i** – mburojë



### *Bisedë rreth tekstit*

Cila skenë ju bën për të qeshur dhe pse?

Cilat janë personazhet që marrin pjesë?

Si paraqitet Don Kishoti nga autori?

Pse është turbulluar Sançoja?

Pse nuk qesh hanxhiu si të tjerët?

### *Romani aventurier*

*Romani aventurier qubet ai roman që pasqyron jetën në mënyrë jo të zakonshme.*

*Për krijimet e tilla, rol të madh luan imagjinata (fantazia) e shkrimtarit.*

*Këtu mund të bëjnë pjesë edhe romanet kalorësiake, fantastike, kriminalistike, romani historik dhe shoqëror etj.*

**Miguel Servantes** (1547-1616) – shkrimtar spanjoll nga Madridi. Më 1571 mori pjesë në betejën e famshme detare kundër ushtrisë osmane.

Botoi: “Don Kishotin”, “Udhëtim në Parmas”, “Andrrallat e Persilit dhe të Sigismundës” etj.

# SE DITURIA MË E MADHE GJENDET NË MENDJEN E POPULLIT

---

Na ishte një herë një gjysh e një mbesë, bareshë, që jetonin vetëm në një malësi. Gjyshi plak me një barrë dru në shpinë, u kthye atë mbrëmje vere i lodhur në shtëpi. Shkarkoi drutë në oborr dhe duke lëshuar një “uf” të thellë, u ul mbi një gur te pragu.

Baresha, që në atë çast po rregullonte bagëtinë, e dëgjoi, mbylli portën e vathës dhe, duke iu afruar atij, e pyeti me ëmbëlsi:

- A u lodhe fort sot, o gjysh?

- Nga pak, bija ime! Epo, plak jam tash edhe lodhem. Por kur të shoh të gëzuar ty, më përtërihen forcat.

Ajo u ul pranë tij dhe ky i vuri mbi kokë dorën e rreshkur e nyje-nyje.

- Po si e kalove ditën? – pyeti përsëri vajza.

- Mirë e kalova. Bëra drutë dhe kur po kthehesha në shtëpi, takova në rrugë një njeri të çuditshëm. Ndoshta ishte i lodhur shumë, sepse nga fjalët që m’i tha, nuk m’u duk njeri me mend.

- Po pse? Çfarë të tha? – e pyeti me kureshtje baresha.

- Kur u takuam në rrugë, u gëzua shumë dhe pasi më dha një dorë duhan për llullë, më tha: “Sa mirë që të gjeta, more mik, se kështu do ta bajmë me radhë njëri-tjetrin”. Dëgjon ti. Unë mezi po ecja i lodhur nga barra e druve dhe ai më thoshte ta bajmë njëri-tjetrin!

Baresha qeshi.

- Gjysh i dashur, - i tha atëherë, - ti nuk e ke kuptuar atë, që ka dashur të thotë ai. Ato fjalë duhen kuptuar kështu: “Sa mirë që të takova, or mik, se duke qenë së bashku, do t’i heqim mërzinë njëri-tjetrit me fjalë”.

- Ashtu?! Po, mirë e ke ti. Kështu do të ketë dashur të thotë.

- Po tjetër, çfarë të tha udhtari? – pyeti mbesa.

- Kur arritëm te përroi, që zbrat nga mali, më pyeti: “Ky përroi çfarë sjell me vete, ar e argjend apo lot e helm?” Kjo më habiti më shumë dhe iu përgjegjia aty për aty: “Përroi vetëm ujë sjell me vete dhe asgjë tjetër: “Hë, si thua, ti, u përgjigja mirë?”

- Jo, gjysh! Prapë nuk e ke kuptuar çfarë ka dashur të thotë. Ajo pyetje duhet kuptuar kështu: “A e ka kanalizuar fshati këtë ujë, që të ujitë arat e mbjella dhe t’u shtojë prodhimin apo e keni lënë pas dore që, në dimër, kur të fryhet, t’ju marrë edhe kasollat?”



Gjyshi e pa përsëri mbesën.

- Shiko, shiko, sa bukur e gjete? Vërtet kështu do të ketë dashur të thotë.

- Po ndonjë gjë tjetër nuk të pyeti? – i tha prapë mbesa.

- Kur kaluam pranë varrezave, më tha edhe këtë që më ka mbetur në mendje: “A ka shumë të vdekur në këto varreza, që jetojnë apo janë shuar një herë e mirë?”

- Po ti, si u përgjigje?

- Në varreza vetëm të vdekurit qëndrojnë.

- As kësaj radhe nuk e paske kuptuar, o gjysh. Ai me ato fjalë të ka pyetur, o gjysh: “Në varrezat tuaja a keni njerëz, të cilët me veprat, zotësite e trimëritë e tyre, kanë lënë gjallë emrin e tyre, apo janë vetëm nga ata që s’kanë asnjë kujtim?”

- Ai burrë, gjysh, duket se do të ketë qenë njeri i ditur. Po ku shkoi.

Përse nuk e ftove në shtëpi?

- I thashë të vinte, po nuk desh. “Nuk dua të trazoj asnjë”, m’u përgjegj. “Më mirë po shkoj në mulli ta kaloj natën.”

Vajza u mendua pak, pastaj u ngrit dhe i tha gjyshit:

- Gjysh, ai nuk njeh njeri këtu. Ndofta s’ka as të hajë. Si të bëjmë? T’i dërgojmë diçka për të ngrënë?

Gjyshi u ngrit dhe tha:

- Ia çoj unë. Bëja gati bukën!

Vajza hyri brenda dhe pas pak doli me një bukë të rrumbullakët në dorë, mbi të cilën kishte vënë edhe gjashtë kokrra vezë.

- Ja, gjysh! Çoja, po mos harro të pyesësh: “Si ishte hëna? Gjysmë apo e plotë dhe sa yje duken në qiell?” Në qoftë se do të dijë të përgjigjet, ai njeri është me të vërtetë i mençur.

Plaku mori bukën, të gjashtë vezët, i futi në trastë dhe u nis për te mulliri.

Rrugës mendo: “Një darkë është kjo! Ai i huaji nuk besoj ta hajë të gjithë bukën sonte.” U ul në një gur, ndau bukën për gjysmë dhe e hëngri së bashku me tri kokrra vezë.

Kur arriti te mulliri e gjeti të huajin, që po qëndronte mbështetur te një shkëmb. Duke i dhënë bukën e vezët i tha:

- Mbesa më porositi të bëj një pyetje: “Si është hëna, gjysmë apo e plotë dhe sa yje duken në qiell?”

I huaji iu përgjigj:

- I thuaj mbesës se hëna është gjysmë dhe në qiell duken vetëm tre yje.

U kthye plaku dhe i tregoi përgjigjen mbesës.

Ajo e pyeti:

- Po ti, gjysh, si ia dhe bukën, gjysmë apo të plotë.

- Jo, - iu përgjigj gjyshi, - i çova gjysmën e bukës dhe tri vezë!

- Gjysh i dashur, - foli baresha, - ai njeri qenka shumë i ditur, veçse më duket se një nevojë e madhe e ka shtrënguar të marrë rrugët nëpër male. Eja të vemi ta takojmë se mbase e ndihmojmë.

Kur arritën te mulliri, e pyetën të huajin:

- Na trego, çfarë nevoje të ka sjellë deri këtu, se ndofta mund të të ndihmojmë!

Ai i vështroi me mirënjohje dhe u tregoi:

- Sundimtari i vendit një ditë më tha: “Ty të gjithë të quajnë njeri të ditur. Por unë ende nuk e kam provuar diturinë tënde. Prandaj, dua që brenda muajit të më sjellësh një dash të paqethur, që të ketë në shpinë një mbulesë të përgatitur nga leshi i tij. Në qoftë se nuk e sjell, të shkon koka”.

Baresha duke qeshur iu përgjigj:

- Nuk është edhe aq e vështirë. Ne do të japim një dash. Do ta qethim në shpinë, ndërsa barkun do t’ia lëmë pa qethur. Me leshin e qethur unë do të bëj një velenxë që t’ia hedhësh dashit në shpinë.

I huaji u mahnit nga kjo përgjigje e mprehtë dhe duke e falënderuar me gjithë zemër, i tha:

- Të falemnderit, moj bijë! Ta marrë vesh ai gjakësor s’e dituria më e madhe gjendet në mendjen e popullit.

*Kallëzim popullor*



### *Fjalë dhe shprehje*

vathë-a – vendi i thurur ku mbajmë dhentë;

kureshtje-kureshtja – interesimi, dëshira për të kuptuar ndonjë gjë të re;

velenxë-a – mbulesë e leshtë me thekë e pa thekë.



### *Bisedë rreth tekstit*

Kallëzimtari popullor këtu na ka dhënë disa mendime, që për t’u zbërthyer duan njohuri të mëdha. Gjeni ato biseda që bëri gjyshi i bareshës me të huajin dhe si i shpjegon ajo ato biseda enigmatike? Pse tregimtari ka thënë: - Ta marrë vesh ai gjakësor se dituria më e madhe gjendet në mendjen e popullit?

*Kallëzimi popullor* është rrëfim i shkurtër që tregon vetë populli përkitazi me ngjarje të ndryshme, që i kanë ndodhur atij. Ai ndryshon prej përrallës, sepse ngjarjet e tij janë realiste, aso që vërtet kanë ndodhur, kurse ngjarjet e përrallave mund të jenë, në pjesën më të madhe, të trilluara dhe me elemente fantastike. Po kështu, personazhet e kallëzimeve janë njerëz të rëndomtë, që i basim në jetën e përditshme, kurse ato të përrallave, janë njerëz të jashtëzakonshëm, që dallohen me ndonjë cilësi nga rrethi i tyre. Në anën tjetër, edhe shtazët e shpendët janë fytyra të shpeshta në përralla.

## *Anekdota*

Të shohim se çka thonë qitapet

Kur Nasradini ishte gjyqtar shkoi te ai një njeri dhe i tha:

- Zotëri gjykatës, një lopë e larme, si duket është lopa juaj, e ka vrarë lopën time.

- Nasradini ia ktheu: Po hajvan janë, o bir!

Mbas këtyre fjalëve njeriu tha:

- Më falni, zotëri gjykatës, se ju thash gabim, mbasi lopa ime e ka vrarë lopën tuaj.

Atëherë Nasradini ia priti:

E tani puna ndryshon. Ma jepni atë librin e ligjeve, të shohim.

## *Anekdota*

*Anekdotat* janë tregime shumë të shkurtra, në të cilat me një humor të këndshëm e të pasur vihen në dukje të metat e përgjithshme njerëzore; qëndrimet, sjelljet dhe dobësitë e njerëzve të privilegjuar në shoqërinë me klasa. Ato janë dëshmi e zgjuarsisë dhe e mendjempërtësisë natyrore të popullit që i tregon. Bashkë me humorin jepen ngjarje reale dhe historike. Populli ynë shqubet për mendjempërtësi dhe tregon anekdota të llojllojshme.



Nënë Tereza  
- Gonxhe Bojaxhiu, në Shkup

# GJUHA JONË

---

Secili në gjuhën e vet  
flet, këndon e ndërron mendime.  
Edhe unë kam gjuhën time,  
gjuhë të ëmbël dhe të dëlirë,  
gjuhë të lehtë dhe të mirë  
që nëna ma mësoi prej në djep  
ninulla e urata duke më falë  
me më të mirat, t'shtrenjtat fjalë,  
siç dinë nënat të urojnë  
sipër djepit kur vigjilojnë  
me këngë gjumi e prehie,  
me fjalë të ngrohta dashurie.

Si gurgullimë e përroit malor  
sikur kënga n'verë e bilbilit  
janë dhe fjalët e gjuhës sonë  
më të bukura se lulet e prillit  
tinguj që rrjedhin si simfoni,  
fjalë për këngë e melodi.

Sa e bukur gjuha jonë  
me fjalë konaku, fisnikërie  
me fjalë vatre e burrërie  
me fjalë nderi e trimërie,  
me fjalë bese e dashurie,  
me fjalë të nxehta kur të mbron,  
me fjalë të ngrohta kur të afron.  
Është gjuhë e popullit jetik  
që gjithnjë fjalën mirë peshon,  
gjuhën për të keq s'e përdorë.

Secili e do gjuhën e vet  
 mbi të gjitha gjuhët e tjera  
 ashtu si unë gjuhën time  
 qoftë për brenga dhe gëzime...  
 Por i dua dhe gjuhët tjera  
 se tërë bota është vëllazëri  
 e ai që e do gjuhën e tij  
 dhe i do dhe gjuhët tjera  
 atë dielli i vet e gëzon  
 e kënaq dimri sa edhe vera.

*Fejzi Bojku*



### *Fjalë dhe shprehje*

të dëlirë – të pastër  
 ninulla – këngë gjumi  
 simfoni – pjesë muzikore për orkestër  
 konak – bujtinë, por edhe dhomë në shtëpi për miqtë  
 fisnikëri – cilësi e atij që ka cilësi të larta morale  
 jetik – i lashtë, i moçëm



### *Bisedë rreth vjershës*

Secili e do gjuhën e vet, gjuhën e nënës. Në atë gjuhë i mëson fjalët e para, përmes asaj gjuhe bën hapat e parë në jetë, hyn në jetë.  
 Si e përshkruan, çfarë epiteti përdor poeti kur flet për gjuhën e vet?  
 Pse poeti e do aq shumë gjuhën e vet?  
 Ç'mendon ai për gjuhët e tjera?  
 Ç'mendon për ata që nuk e duan dhe nuk e mësojnë gjuhën e vet?



Fejzi Bojku

*Fejzi Bojku* lindi më 1937 në fshatin Veleshtë afër Strugës. Shkruan vjersha dhe tregime, kryesisht për fëmijë, dhe deri tani ka botuar mbi dhjetë vëllime me poezi dhe prozë si: “Lulet e para”, “Zilet shkollore”, “Shtatori i një fëmijërie”, “Fjalë dhe valë”, “Flutura të bardha”, “Sa është ora?” etj.

## NËNA ZEMËRFORTË

Kishte qenë një myderriz. Kishte pasur shokë e miq prej hoxhallarëve, prej myderrisëve dhe prej parive. Një ditë i thotë gruas:

- Dua t'i marr në drekë të gjithë shokët e mi.

- Merri me gjithë qejf, - i thotë gruaja.

Myderrizi e kishte pasur një dhi. E theri dhe e rropi dhinë e ia la gruas që ta bëjë gati dhe ky shkoi t'i marrë miqtë të cilët kishte ftuar në drekë. Myderrizi i kishte pasur dy djem, afërsisht të një moshe – gjashtë-shtatë vjeç. Kur e kishte therur dhinë njëri prej tyre nuk kishte qenë aty. Kur erdhi djali tjetër, ky po i tregon:

- Mor vëlla, babai e ka therur dhinë.

- Qysh e preu?

- Eja të tregoj.

E mori dhe e lidhi vëllain sikurse i ati që e kishte lidhur dhinë.

- Kështu e ka lidhur, - e ia vuri dorën në kokë. – Kështu ia ka mbajtur kokën, kështu e ka prerë dhe i ra brisk të vëllait në fyt e e mbyti.

Kur e mbyti të vëllain, pa se ç'bëri. Atëherë nga frika i ra edhe vetes dhe vdiq edhe ky. Kur vdiqën që të dy, nëna që ishte duke bërë gati bukën për mysafirë, i kapi dhe i çoi në dhomë e i fshehu prej mysafirëve e prej burrit që mos ta dinë dhe mos t'u prishet muhabeti. Nëna ua bëri drekën dhe ua shtroi sofrën mysafirëve. Njëri prej mysafirëve kishte qëlluar i dijsëm. I thotë babait të fëmijëve:

- Ku i ke djemtë, Xhabir?

- Këtu janë diku.

- Pa qenë djemtë këtu, unë bukë nuk ha.

Doli ai e po i thotë së shoqes:

- Ku janë djemtë?

- Djemtë kanë ngrënë dhe kanë rënë të flejnë.

U kthye në dhomë dhe i tha:

- Kishin ngrënë dhe ishin në gjumë.

- Pa qenë djemtë këtu – tha i dijsmimi – unë s'ja nisi.

Tri herë kishte shkuar t'i marrë djemtë i zoti i shtëpisë, por e shoqja nuk i tregonte vetëm e vetëm që të mos ua prishte qejfin mysafirëve dhe të shoqit. Së katërti gruaja i tregoi se djemtë ishin të vdekur dhe e kishin mbytur njëri-tjetrin. U kthye

burri në dhomë e u tha mysafirëve se djemtë i kishte të vdekur. I dijsلمي i tha:

- Unë s'ha bukë pa m'i sjellë këtu dy kufomat e tyre.

Kur i sollën kufomat, i dijsلمي lagi gishtin në gojë e i preki ato varrë të djemve me pështymë dhe djemtë u ngjallën. Pasi u ngjallën nisën mysafirët të hanë drekë me gjithë qejf.

Gruaja kishte qenë aq fisnike, saqë me dy djem të vdekur nuk ka dëshiruar t'i tregojë burrit për t'ia prishur qejfin.

*Përrallë popullore*



### *Bisedë rreth tekstit*

Cilat janë personazhet kryesore në këtë përrallë?

A mund të jetë i vërtetë shërimi i djemve pas vdekjes nga i dijsلمي?

Cila është ideja e kësaj përralle?

Ç'vlerë etike dhe estetike ka kjo?

Si e çmoni qëndrimin e nënës?



### *Detyrë*

Shkruani ndonjë përrallë që ju kanë treguar prindërit në shtëpi.

### *Nga epika popullore*

*Në epikën popullore ose letërsinë gojore vënd të rëndësishëm kanë edhe tre lloje tjera tregimesh e që janë: përrallat, legendat dhe përrallëzat.*

*Përrallat janë tregime të gjata popullore. Karakteristikë kryesore e tyre janë personazhet dhe elementet fantastike, si dhe ngjarjet e mrekullueshme që përshkruhen në to, për çka është thënë se përrallat janë tregime popullore, në të cilat kallëzohen gjithfarë mrekullish që s'kanë të ngjarë, që s'kanë bazë reale.*

*Legjenda është një lloj tregimi fantastik që bën fjalë për ndonjë person legjendar, historik, fetar ose për ndonjë objekt të njohur historik si kala, urë, mal, grykë a kështjellë. Ky krijim e ka zanafillën nga kohërat e lashta. Të njohura janë motivet e murosjes së gruas në themelet e një ure a kështjelle, i rinjobjes së burrit me gruan, vëllait me motrën etj. Të tilla janë: Rozafa, Halil Garria, Dekë e Hasanit etj.*

*Përrallëzat apo fabulat, ndërkaq, janë tregime të shkurtëra alegorike që na mësojnë e këshillojnë për diçka. Personazhet e përrallëzave shpesh janë: kafshët, bimët, shpezët që marrin virtytet dhe veset e njerëzve, si: dhelpëra, ujku, ariu, qengji, gomari, luani, buti, bleta etj. Fabulistët të njohur janë: Ezopi, La Fonteni, Naim Frashëri, Çajupi, Mjeda etj.*



# PLAGA E DHJETË E GJERGJ ELEZ ALISË

---

- Dramë në tri akte dhe shtatë tablo -

Fragment

*Tabloja e shtatë*

*(Fusha ku do të bëbej lufta. Hyjnë Balози me trupat e tij. Të gjithë janë të veshur e të ngjeshur me armë të tmerrshme. Fytyrat i kanë të lyera me ngjyra të frikshme. Vetullat e Balozit nxijnë që larg).*

BALOZI: - Këtu do t'i presim dhe do t'i shpartallojmë.

KËSHILLTARI I: - Ne mendojmë, o kryezot i ndritur, që në fillim ti të vrasësh prijësin e tyre, Gjergj Elez Alinë. Duke mbetur pa prijës, ushtria e tyre do të shpartallohet.

BALOZI: - Ha, ha, ha. Sa budalla po më dukesh, këshilltar. Ti më thua se unë duhet të vras në fillim Gjergj Elez Alinë, sikur kjo gjë të jetë në dorën time. Po ku ta gjej unë atë që ta vras? Ma sillni ju të lidhur këmbë e duar dhe do të shihni po s'e vrava.

KËSHILLTARI I: - Ai nuk lidhet kollaj, o kryezot.

BALOZI: - Po atëherë, si ta vras? Më duket se të kanë lënë mendtë, o këshilltari im i parë.

KËSHILLTARI I: - Ka një mënyrë për të vvarë, kryezoti im.

BALOZI: - Thuaje.

KËSHILLTARI I: - Përpara se të fillojë lufta, ftoje në duel vetëm për vetëm.

BALOZI: - (Klith) Jo more! Ta ftoj në duel? Po sikur ai të më vrasë mua?

KËSHILLTARI I: - Kurrën e kurrës. E para, ti e di, o kryezot, se ne kemi marrë të gjitha masat që armët e tij të jenë të prishura. Shpata e tij do të thyhet që në goditjen e parë, dhe mburoja e tij do të shpohet posa ta prekë heshta jote madhështore. E dyta, ai ka nëntë plagë në trup dhe, me siguri, mezi mbahet në këmbë. Ai vjen në luftë vetëm sa për t'u dhënë zemër njerëzve të vet. E treta dhe kryesorja, kryezoti im, është se ai as që do të pranojë fare ftesën e duelit dhe, kjo do të bëjë që gjithë ushtria e tij të ligështohet shpirtërisht, kurse ushtria jonë të tërbohet nga

ethet e luftës.

BALOZI: - Po sikur ai të pranojë duelin?

KËSHILLTARI I : - Aq më keq për të. Ai është një kufomë e gjallë dhe armët i ka të prishura, ti do ta vrasësh shumë shpejt dhe lavdia jote do të kapërcejë male e fusha.

BALOZI: - Mirë. Do ta ftoj në duel. (Larg dëgjohet boria e arbërve). Ja ku janë.

KËSHILLTARI I: - Po vijnë. Po vijnë. (Ngrenë heshtat, flamurët dhe emblemat).

BALOZI: - Po vijnë drejt fatkeqësisë së tyre.

KËSHILLTARI I: - Drejt humbjes.

KËSHILLTARI II: - Drejt tmerrit.

KËSHILLTARI III: - Mjerë ata.

KËSHILLTARI I: - Ngrysi një herë vetullat, o kryezoti ynë i tmerrshëm.

BALOZI: - Ja, po i ngrys. Si dukem?!

KËSHILLTARI I: - I madhërishëm.

KËSHILLTARI II: - I perëndishëm.

KËSHILLTARI III: - I llahtarshëm.

KËSHILLTARI IV – Ata po dridhen vetëm nga vetullat e tua, o kryezot.

(Boria e arbërve. Hyjnë në skenë Gjergj Elez Alia, Nallban Vëllami, motra e Gjergjit, mjeku, komandantë, luftëtarë).

GJERGJ ELEZ ALIA: - Për herë të fundit të drejtohem, o Baloz i huaj: hiq dorë nga trojet tona.

ARBËRIT: - (Njëzëri) Largohuni!

KËSHILLTARI I: - Ç'pafytyrësi.

KËSHILLTARI II: - Ç'marrëzi.

KËSHILLTARI III: - Ç'mungesë takti.

KËSHILLTARI I: - Tmerroi një herë, o imzot, ashtu si e di ti të tmerrosh botën.

BALOZI: - Por si më duket... Pamjen e ka shumë më krenare.

KËSHILLTARI I – Po armët i ka të prishura. Dhe veç kësaj, nën atë pelerinë të qëndisur ka nëntë plagë. Mos ki frikë, o tmerr i botës!

BALOZI: - Bëji ftesën.

KËSHILLTARI I: (Bën një hap përpara). Ty të flasim, o prijës i arbërve, Gjergj Elez Alia. Kryezoti ynë i madh, batërdia e botës dhe kamxhiku i perëndisë mbi dhe, Baloz i Janxhanxhonivan, të fton në duel në fillim të luftës. Pas përfundimit të duelit tuaj, ushtritë le të bëjnë punën e tyre, domethënë të vriten e të priten, siç e kanë zakon.

MJEKU: - Mos prano, Gjergj. Ti akoma i ke plagët të pambyllura mirë. Ata e dinë këtë dhe prandaj kërkojnë duel me ty. Mos prano. Mos bjer në kurthë.

GJERGJI: - (Pa u vënë veshin fjalëve të mjekut). E pranoj ftesën.

MJEKU: - Gjergj, ç'bëre kështu?!

BALOZI: - (Këshilltarëve). Ai e pranoi ftesën. Ç'të bëj?

KËSHILLTARI I: - Mos ki frikë, imzot. Kujto armët e tij të prishura, kujto nëntë plagët e tij. Dili përpara.

MJEKU: - (Gjergjit) Ç'bëre kështu? I harrove nëntë plagët?

GJERGJI: - Ndoshta erdhi koha për plagën e dhjetë, mjek.

BALOZI: - Ai po buzëqesh, i poshtri.

KËSHILLTARI I: - Dili përpara.

KËSHILLTARI II: - Frikësoje.

KËSHILLTARI III: - Ngrysi vetullat.

KËSHILLTARI IV: - Tmerroje.

BALOZI: - Vetullat m'u mpinë fare...

KËSHILLTARI I: - Atëherë sulju, imzot. Mbyte në vend.

KËSHILLTARI II: - Çaje më dysh.

KËSHILLTARI III: - Më tresh.

KËSHILLTARI IV: - Më katërsh.

(Balozi dhe Gjergji sulen kundër njëri-tjetrit. Dueli është i gjatë. Gjatë zhvillimit të tij, pamja e Balozit ndryshon ngadalë, nga një kalorës me armë e veshje madhështore, kthehet në një lloj karakatine. Gjergji e godet më në fund për vdekje).

BALOZI: - (Sokëllin) Oh, më vrau.

NALBAN VËLLAMI: - Balozi vdiq. Përpara. (Këshilltarët përkulen të tmerruar mbi kufomën e Balozit. Ushtritë sulen kundër njëra-tjetrës; betejë. Ndërsa bie perdja, duke mbuluar pamjen e betejës, gjithmonë e më qartë dëgjohet zëri i rap-sodit).

*Trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia.*

*Që nëntë vjet nëntë plagë në shtat m'i ka.*

*Mbi atdhe sa berë që fryn stubia*

*skuqin ato plagë të mëdha.*

*Mbi atdhe sa berë fryn erë e rreptë,*

*del ai të marrë plagën e dhjetë.*

*Ismail Kadare*

## Shënim

Në këtë fragment të dramës **Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë**, është dhënë vetëm tabloja e shtatë e saj prej të cilës mund të mësojmë për një duel të rreptë të Balozit, që paraqet të huajin në trollin tonë dhe të Gjergj Elez Alisë, që paraqet forcën tonë kombëtare. Prej kësaj tabloje, me plot elemente të fuqishme dramatike, vërejmë për përgatitjen e duelit, për këshillat që i jepen Balozit nga këshilltarët e vet për t'i dalë në duel Gjergjit, për tradhtinë që ishin përpjekur t'ia bëjnë Gjergj Elez Alisë, duke ia përgatitur shpatën e dobët e të tjera. Gjeneri këto momente dramatike në këtë dramë të bukur! Pasi drama është huazuar nga kënga jonë e bukur **Gjergj Elez Alia**, gjejini atë lexojeni dhe krahasojeni me dramën.



### *Fjalë dhe shprehje*

**mburojë-a** – armë në trajta të ndryshme e prej lënde të ndryshme që vihej në krahun e majtë për të mbrojtur trupin nga goditjet e armikut  
**heshtë-a** – armë për sulm me bisht të gjatë e me majë të hekurt shtizë, patërshanë

**emblem-a** – shenjë kombëtare, flamuri, stema shtetërore  
**i llahtarshëm** – i tmerrshëm, i frikshëm

**batërdi-a** – prishës, shkatërrues i botës, tmerrri dërmues

**karakatinë-a** – karikaturë, mbrapshtim, degjenerim

**sokëllas** – thërras me zë të madh, thërras me fuqi

### *Subjekti*

*Edhe subjekti është një element i formës letrare. Subjekti është vargu i tërë ngjarjeve që sillen rreth një konflikti të caktuar, ku janë përfshirë personazhet e veprës letrare.*

*Subjekt kanë vetëm veprat e gjinisë epike, epiko-lirike e dramatike (skica, tregimi, novela, romani, poema, komedia, drama etj.)*

*Subjekti i shërben përmbajtjes, temës dhe idesë poetike të veprës.*

*Në dramën “Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë” subjektin e përbën tërësia e ngjarjeve për heroin kryesor Gjergj Elez Alinë, marrëdhëniet e tij me motrën pas plagosjes, ngjarjet që lidhen me kujdesin e saj ndaj tij, etj.*

# RRËNKIMI

---

Tokë, qaj, Tokë, rrënko, Tokë gjëmo si egërsira –  
se mbrëmë ka vdekur një katundar i fshatit tim  
me duar të çara dhe fytyrë të vvarë nga lia  
dhe me rininë e humbur në brazdat e jetës...

Do ta çojnë mbi katër krij,  
do ta çojnë mbi katër zemra,  
do ta çojnë mbi katër dëshira,  
si ai – kur i ka çuar,  
kur vetë i ka rritur  
n'ara të bleruara.  
E, ai – mbrëmë ka vdekur...

\*

Tokë, qaj, Tokë, rrënko, Tokë gjëmo si egërsira –  
se sot në krahorin tënd do të shtrëngosh  
katundarin e ri të fshatit tim.

O, ai ty kurrë nuk t'ka ndarë prej zembrës,  
- një zemër të heshtur,  
atë – që në pranverë ka qenë i etshëm për blerimin tënd;  
atë – që në verë të ka ledhatuar plot dashuri;  
atë – prej së cilës i kanë gufuar  
urimet për ty;  
- të falem o Dhe  
- të falem o Dhe!  
E, ai – mbrëmë ka vdekur...

O, a po e dëgjon damarin e lutjes?  
O, a po e dëgjon tingullin e ofshës së lodhur?

O, a po e dëgjon vajin e dëshirave?  
që po veniten pa frymë...

*Fabredin Gunga*



### *Fjalë dhe shprehje*

brazdë-a – vija që hap plugu në arë  
ledhatoj – marr me të mirë, përkëdhel  
ofshë-a – mallkim, nemë që tregon dhembje  
venitem – tretem, vyshkem, fishkem etj.



### *Bisedë rreth vjershës*

Ku qëndron vlera e kësaj vjershe:

- Figurat me të cilat i drejtohet poeti tokës.
- Domethënien e strofës së dytë.
- Dashurinë e njeriut ndaj tokës së vendlindjes.
- Elementin lirik shumë të theksuar ndaj njeriut që ka vdekur e që do ta shtrëngojë pikërisht ajo tokë që e deshi aq shumë.
- Në fuqinë poetike të fjalës që gërsheton vdekjen e njeriut dhe dheun që e punoi për të gjallë e ku do t'i shtrëngohet kufoma për së vdekuri.
- Në dashurinë e singertë të njeriut ndaj njeriut shfaqur me anë të vargjeve të kësaj vjershe.



# HALILI DHE HAJRIJA

---

HAJRIJA: Kush m'i ka lidhë vëllaznit, Bejtash Aga?

BEJTA: Hajrie, mos u shti sikur nuk din gja në këtë punë.

HAJRIJA: Kush, unë?

BEJTA: Ti më ndihmove ta za Halilin. A nuk e lajmrove të vijë në gostë?

HAJRIJA: (E turbullueme) Halil, Mustë i motrës; unë nuk kam pre vëllaznit e mi?

HALILI: Pse erdhe këtu? Çka don?

HAJRIJA: Nuk di ma çka të kërkoj. Më qit në rrugë, vëlla i motrës, më mbyty po deshe, po mos më len kështu gjallë e për gazep.

HALILI.: Të qet në rrugë burri yt.

HAJRIJA: Me të vërtetë, Bejtash, unë kam tradhtue vëllaznit e mi?

BEJTA: Jo, Hajrie, nuk asht trahhti kur njeriu i shërben Sulltanit e pashës.

HAJRIJA: Unë i kam shërbye Sulltanit?

BEJTA: Po, Pashës i ka ardhë shumë mirë për ty dhe asht gati me të shpërblye me çka të dëshiron zemra.

SYLEJMANI: Fol, o zojë, kërko çka don prej meje. Veç kokës së Halilit jam gati me të dhanë çka të më vijë për dore.

HAJRIJA: Halil, këtu nuk asht kalaja e Shkodrës. Këtu asht shpella e dreqënve.

HALILI: E pse erdhe në këtë shpellë atëherë?

HAJRIJA: Motra e shkretë erdhi t'ju ndihmojë.

HALILI: Na ndihmove mjaft. Ndihmë tjetër nuk duem prej teje.

HAJRIJA: Edhe ti Halil u beson fjalëve të Bejtash agës?

HALILI: U besoj duerve që m'i lidhën.

HAJRIJA: Edhe ju të gjithë besoni se unë kam pre vëllaznit?

SYLEJMANI: (Qeshë) Hala, o grue, nuk e din se sa i zoti asht ky burri yt? Unë po t'ishem në kambë tande do t'i ndërrojshem vëllaznit për një burrë si Bejtash aga.

HAJRIJA: Vëllaznit e mi i ka pre Bejtash aga. Ai më ka pre edhe mue, e unë... e unë...

SYLEJMANI: Fol, çka don o grue, se nuk mund të merrem shumë kohë me ty.

HAJRIJA: Ku po i çoni, pashë?

SYLEJMANI: I çojmë t'u presim kokat se i kanë tepër.

HAJRIJA: (I bjen ndër gjunjë). Aman, pashë, fale Mustën, asht i ri. Jemi rritë jetima bashkë; fale, pashë.

SYLEJMANI: Dëgjoje, dëgjoje! Largoni kënde; t'u priten kokat këtu në për burrë. Çou, vëllai i vogël të qoftë falë. Zgjidhja duert atij të pafytyri.

MUSTA: Kush të tha me kërkue ndjesë te pasha për mue? Edhe nuk të vjen turp të përkulesh para pashës që po të mbytt vëllazën e shokë? Nuk due me më falë pasha. Unë nuk e fali pashën, por ia pres kokën dhe ia derdh nëpër lloç atë çallmë që e ka si hoxhë. Nuk due falje nga gjaksi i vëllaut dhe i shokëve të mi.

SYLEJMANI: Mirë. Po ta fal. Allahu vetë të ka dhanë një fat të madh oborr. Do të vij edhe unë t'i shikoj. Do ta shijoj gjakun e tyne; mos asht gjaku i këtij qerata millet ashtu i hidhët siç asht Halili me shokë?

KRYEROJA: Hajde; hapni rrugë!

HALILI: (Hajries) Ti na prune në Shkodër?

HAJRIJA: Aman, pash shpirtin e të parëve tu, mos më ban gjaksen tande.

HALILI: Jo, motër. Nuk do të besoj kurrë se trathitia jote ka shkue deri këtu. Tash e di ç'asht i zoti me bamë Bejtash aga. Por pa të namë nuk më durohet. Mos t'u përkundtë fëmija në djep; mos e gëzofsh burrin, dhe në shtëpi të Bejtash agës mbifitë bari mbi muret e mbetuna shkretë. Gëzoni, gëzoni mbi gjakun tonë ju të gjithë deri sa ky gjak të bahet helm në zemrat tueja. (Del Halili me shokë; pas tyne del edhe pasha). (Bejta i afrohet Hajrijes).

BEJTA: Nisu për shtëpi. Këta dy roje do të përcjellin. Dëgjoje. Tash nuk ka kohë me ta zbutë pak kokën se e ke mjaft të fortë. Ti je grueja eme. ( I ban me shej rojeve ta ruejnë dhe nget mbas pashës).

HAJRIJA: (Tue shikue vëllaznit nga jashtë), Halil, Mustë, Sokol, po shkoni. Sa hije të ka serbesllëku, Halil, kur po më kalon para xhelatit. Ti Mustë, pse e mban kokën ulë; çoje kokën të pastë motra. A dëgjon se po këndon Sokoli? Po shkoni m'u pre: po e di se motra ua bani këtë nderë kaqë të madhe. Po, Halil, fëmija ime nuk duhet të rritet në votër. Shtëpia duhet bamë kulm e themel dhe prapë zemra eme s'ka për ta gjetë rahatinë. Moje shkretë e shef çka po ndodh edhe



ke hala guxim t'i shikosh? Po, do të shikoj; do të digjem përmbrenda si furrë e gëlqeres. Due me pa xhelatin kur t'i bjerë Mustës. Bejtash, ti po qeshe? Po, pasha do të japë një peshqesh të math për kokat e vëllazënve të mi... Të pëlqen hala ky trupi im? Po Bejtash, do të vij në shtëpinë tande. Shtriga të natës më fusni fuqinë e djajve në trup! Unë due të baj atë që nuk ka bamë kush. Qeshu Bejtash, qeshu, se prej dorës seme do të vdesish ti dhe yt bir që mban vetëm gjakun tand. Halil, Mustë, Sokol, qëndroni ashtu kryenaltë! Ju merr motra gjakun ju. Motra do të hakmerret deri sa të vdesë.

(BIE PERDJA) (Fundi i aktit të tretë).

*Kolë Jakova*

### *Shënim*

Këtu kemi një fragment të dramës Halili dhe Hajrija të dramaturgut Kolë Jakova. Autori dramën e shkroi duke u mbështetur në këngën popullore "Fryni era u çel taraba". Në këtë dramë bëhet fjalë për qëndresën e malësorëve tanë kundër pushtuesve të huaj.



#### *Fjalë dhe shprehje*

xhelat-i – i pashpirt; ai që ua merr jetën njerëzve  
serbesllëk-u – krenaria, guximi  
djaj-ve – dreqërve  
çallmë-a – fesi ose kapuçi i turqve



#### *Bisedë rreth tekstit*

Cilët ishin Halili, Musta e Sokoli? Pse i ndiqnin për t'i zënë dhe si i zunë?

Pse përpiqeshin që fajin e tradhtisë t'ia linin motrës, Hajrijes?

Çka i thotë dhe si e mallkon Halili motrën? Po Hajrija si i përgjigjet?

Çka u premtonte Hajrija me fjalët e fundit?

Cilës gjini letrare i takon kjo pjesë e paraqitur në këtë formë që e shihni?

## *Drama*

*Drama është një lloj letrar (në rreshta ose në vargje) që shkrubet në formë dialogu për t'u shfaqur në teatër. Drama përbëhet nga fjalët që thonë personazhet, dhe nga të dhënat për skenën, mënyrën se si flasin dhe si sillen personazhet etj.*

*Drama ndërtohet sipas disa akteve. Në çdo akt zhvillohet një ndodhi. Vetë akti përbëhet nga disa skena. Çdo skenë ka një pjesë të ngjarjes që ndodh brenda një akti.*

*Përveç personazheve kryesorë në dramë ka edhe shumë personazhe dytësorë (që plotësojnë tërë ngjarjen).*

*Llojet kryesore të gjinisë dramatike janë: tragjedia, komedia dhe drama.*

*Personi që e shkruan veprën dramatike quhet dramaturg. Personat që luajnë rolet në skenë quhen aktorë ose artistë.*

*Dramaturgë të njohur të letërsisë sonë janë: Kolë Jakova, Spiro Çomora, Anton Pashku, Hivzi Sulejmani, Kasëm Trebeshina, Sulejman Pitarka, Ruzhdi Pulaha, Ekrem Kryeziu, Resul Shabani, etj.*

## *Filmi dhe kinematografia*

*Kinematografia është art që paraqet ngjarjet dhe jetën artistikisht nëpërmjet imazheve, figurave lëvizëse të filmit. Ky është art sintetik, d.m.th. bashkim artesh të ndryshme (letërsi dramatike, art i aktorit, art i kinoprojektorit, art i pikturës, art i muzikës etj.).*

*Filmi artistik krijohet nga bashkëpunimi i ngushtë i një grupi artistësh profilesb të ndryshme: nga SKENARISTI (ai që shkruan skenarin, veprën letrare që përmban tërë ngjarjen, dialogët, sqarimet e nevojshme që dubet të mishërohen në film), nga AKTORËT (që interpretojnë rolet e ndryshme), nga KOMPOZITORI (që krijon muzikën, këtë element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të filmit artistik, që me anë të tingujve thekson çastet kryesore të zhvillimit të konfliktit, zbulon botën e brendshme të personazheve etj.), nga SKENOGRAFI (piktori që krijon dekoret, kostumet etj.), nga OPERATORI (që përdor kamerën, mjetin me të cilin filmohen skenat e ndryshme) etj. Tërë këtë punë të ndërlikuar kolektive e planifikon, e organizon dhe e drejton KINOREGJISORI. Ky ka gjithashtu një rol të veçantë në krijimin e filmit.*

*Këto arte të ndryshme që i përmendëm në kinematografi nuk ekzistojnë të shkëputura e të ndara, si të themi të pavarura. Ato shkruben në një tërësi të vetme në film dhe kështu formojnë së bashku një art krejt të ri sintetik-kinematografinë, që ka tipare origjinale në krahasim me artet e tjera.*

*Kinematografia ka shumë afërsi me artin teatral, por ka edhe ndryshime me të.*

# PARATHËNIE TË ARBËRESHËVET

Gjyshërit tanë, që kur ikën nga Arbëria dhe e themeluan katundin e Fallac-Adrianit në vitin 1482, ruajtën gjithnjë të ndezur në zemër kujtimin dhe mallin e atdheut të humbur.

Ati birit, dhe biri nipit i rrëfenin punët e shkëlqyera dhe luftat e ndershme, që u bënë në kohë të Skënderbeut, se vetëm atëherë për të parë dhe, mjerisht, për të fundit herë bujarët, gjithë trimat e Arbërisë, burra e gra, pleq e të rinj, patën një zemër, duke dashur nderin dhe lirinë e vendit, dhe atë që deshte njëri, e deshën të gjithë.

Andaj nga ai bashkim i shenjtë lindi fuqia, që për njëzet e pesë vjet theu forcën e turqvet dhe përpiu njërën pas tjetrës ushtritë e zotit të madh, ndërsa Evropa e përmbysur i tmerrohej, sa i dëgjonte emrin.

Pastaj, si u shua nga viti në vit në varrin, që e mblodhi, zulma e madhe e të lartit Kastriot, u ftohën edhe shokët e tij; u mungoi besa, iu zgjidh nyja e zemravet; kush shkoi këtej, kush andej; filluan të ziheshin midis tyre, katund me katund, fis me fis, çetë me çetë. E më në fund, armiku i keq iu fut në mes e, pasi ata ishin të ndarë e të përçarë, i vuri nën një zgjedhë hekuri e pastaj i zvarrisi të tërë, të gjithë fushat e lindjes që të derdhnin për të huajin gjakun e kursyer vendit të vet.

Që atëherë emri i Arbërisë u harrua ndër shekujt e ai vend e ai gjak, që kishin habitur botën me gjestet e trimërisë, mbetën në të errët, gjer më tashti. E dashtë Perëndia që të shuhet nëma e moçme, që copëton gjindjen tonë të lindur për të zotëruar, po të shtrëngohen prapë në bashkimin e parë të krishterë e muslimanë, katolikë dhe ortodoksë, çfarëdo që të jenë, duke mendua se janë vetëm arbëreshë!

*Gavril Dara (I riu)*

## *Shprehje të figurshme*

Ruajtën gjithnjë të ndezur në zemër kujtimin e mallin e atdheut të humbur.

Atë që deshte njëri, e deshën të gjithë.



## *Bisedë rreth tekstit*

- Kur dhe pse u shpërngulën nga vendi i vet këta shqiptarë të Italisë?
- Si e kanë ruajtur ata kujtimin e dashurisë për vendlindjen e vet?
- Si e përshkruan shkrimtari gjendjen e shqiptarëve në kohën e Skënderbeut dhe si qe ajo pas vdekjes së tij?
- Si dëshiron t'i shohë shkrimtari shqiptarët e popujt fqinjë – maqedonasit e grekët?

*“Gavril Dara i Ri* (1826-1885) lindi në një fshat të kolonive arbëreshe në Itali. Në Palermo kreu studimet dhe u bë avokat. Gavriili e kish ndjekur me shumë interes lëvizjen kombëtare të shqiptarëve me dëshirë që t'i vijë në ndihmë. Më 1878 atë e shohim të marrë anën e Lidhjes së Prizrenit.

Gavril Dara ka shkruar shumë vepra. Kryevepra e tij në vargje është “Kënga e sprasme e Balës”.



# MIGJENI FLET

Nuk është sëmundja që ma bren mushkërinë;  
as brengë e dashurisë. As dhe fati.  
Jo, mos ma shkulni heshtën që në brinjë  
ma nguli koha me sa fuqi që pati.  
Ndodh që poetit zemra t'i përgjaket  
nga një trishtim i vogël, nga një fjalë;  
po mua sot tullumbat e vocërrakve  
kanë hapur gojën dhe po më hanë të gjallë.  
Një plumb i verdhë tejpertej më mori:  
ah, s'ishte plumb! Ishte një kokërr misri;  
nga thesi i grisur i ra një malësori  
dhe era s'di në ç'barqe e gremisi.  
Nga ky mjerim dhe gurët do të qanin,  
s'mund të mos çahet zemra si me plor,  
këndoni për mustaqet e sovranit,  
poetë të oborrit mbretëror.  
Kur gishti nis t'i hakërron zotit  
më lind një shpresë... Dridhuni, tiranë!  
Ma shkulni, shokë, atë shigjetë prej gjoksit  
me të u bini atyre që më ranë!

*Xhevahir Spabiu*

## *Sbënim*

Poeti ia kushton këtë poezi autorit të “Vargjeve të lira” dhe me të njëjtin stil përdor fjalët me kuptim metaforik “Tullumbat e Lulit”, “Plumbi i verdhë”(misri) - si frymëzim nga “Legjenda e misrit” dhe grushti sipas “Recitalit të malësorit”.



## *Bisedë rreth vjershës*

Cila është ideja e autorit në këtë poezi?  
Ç'dimë për personin që i kushtohet kjo poezi?  
Çka ju përkujtojnë vargjet e strofës së dytë?  
Për cilin tregim e ka fjalën poeti në vargjet e strofës së tretë?  
Ç'paraqet shigjeta sipas jush?



## *Detyrë*

Analizoni dhe komentoni vjershën me arsimtarin.

# SHTIGJET E LIRISË

(Fragment ditari)

7 janar 1944

Doja me shkruar një roman mbi jetën e shokëve e të shoqeve. Por s'kam as letër, as laps, as edhe kurgja. Lapsin e vogël që më ka mbetur, e përdor me kursim.

14 janar 1944

Sot, në mëngjes, u mallëngjeva shumë kur pashë se mbi tokën e mbulueme me borë që ka nisur me shkri, shtrohej e përhapej një qiell i kthjellët dhe i panjollë, qiell pranveror, si sytë e vashës së pamëkatueme. E ambël dhe e kandshme m'u duk jeta.

17 janar 1944

I Zoti i shtëpisë, pardje shkoi në Tërnovë për punë vetjake. Iu luta të më blinte një sasi letra, zarfa dhe lapsa. M'i kishte prue. Kishin kushtue tepër shtrenjtë. I kishte ble tek një tregtar. Ndërsa populli lufton e sakrifikon për liri, tregtarët mashtrojnë dhe grumbullojnë pasuni.

Fillova me e shkruar romanin, për të cilin pata folë disa ditë më parë. Ky ka me qenë libri i shokëve dhe i shoqeve në luftë, libri i vëejtjeve të popullit tonë të ngratë, libri i heroizmave të një brezi që u zhvillue e u reformue nga urrejtja kundër fashizmit. Kur të zhदारiten retë e zeza të fashizmit e të zhduket kjo stuhi e tmerrshme, sigurisht, ky roman ka me u këndue me sytë e zemrave të dëshirueme, prej atyne që kanë me mbetur gjallë si trashëgimtarët e lirisë së fitueme me sakrificat mbinjerëzore.

18 janar 1944

Dje mbramë fryni një erë aq e fortë, sa dukej sikur po rroposet bota dhe po i shkatërrohen rrathët. Era, tue shungullue me një melodi të vrazhdët, vajtonte e katrronte dhe mue me përqetëj shtati nga ky trazim i natyrës së egërsueme. Sot, në kundërshtim me natën, zotnon qetësia dhe koha paraqitet si një zonjë e buzëqeshun.

19 janar 1944

Fillova me i dhanë mësim djalit të vogël. S'mund ta la të verbët këtë djalë, që ka nevojë për dritë. Prindërit e tij nuk besojnë se mund të mësojë. U duket e pamundur që një malësor i pagdhendun të mbërrijë me e mposhtë injorancën. Unë kam vendosë me e mësue me çdo kusht, me gjithë që s'kam as abetare, as dërrasë të zezë, as edhe mjete të tjera. Pra kam besim se, me vullnet, do t'ia mbërrij qëllimit.

*Haki Stërmilli*



## Fjalë dhe shprehje

vashë e pamëkatueme – vajzë e pamartuar  
 zhdavariten – zhduken, hiqen, largohen, përmbysen  
 rroposet – përmbysen  
 tue shungullue – duke fryrë ashpër, me një forcë të madhe  
 katrronte – ushtonte  
 përqethej – rrënoqethej  
 i pagdhendun – i pashkolluar, këtu i pasprovuar, i papërvojë



## Bisedë rreth ditarit

Në këtë fragment ditari janë dhënë ditë pas ditësh përshtypjet e shkrimtarit për dukuri të ndryshme, me të cilat ai takohet përditë.  
 Ç'ju ka bërë përshtypje më tepër?  
 Si ndërtohet rrëfimi në këtë pjesë të leximit?  
 Ç'përshkruhet në secilën pjesë të këtij ditari?  
 Me çka e krahason ardhjen e pranverës?  
 Si e shpjegoni këmbënguljen e shkrimtarit për ta mësuar djalin e vogël të familjes ku rrinte. Do të ketë sukses, apo jo?

## Ditari

*Ditari është hartim letrar-shkencor, në të cilin shënohen ditë për ditë ngjarjet e jetës së një personi.*

*Në të shënohen edhe ditët edhe vjetët kur përshkruhen përjetimet. Ditari i Ana Frankut është një kryevepër letrare dhe historike e Luftës së Dytë Botërore. Ditare kanë shkruar: Haki Stërmilli, Nasbo Jorgaqi, Spiro Dede etj.*



Haki Stërmilli

*Haki Stërmilli* (1895 -1953) është shkrimtar i dalluar shqiptar që shkroi ndërmjet dy luftërave botërore. Veprat më të njohura janë: dramati Dashuri e besnikëri, Agimi i lumnueshëm, romani Sikur t'isha djalë, ditari Shtigjet e lirisë e tjera. Në veprat e veta përdori elemente të folklorit të vendlindjes së tij.

# BARKA E XHA NURIUT

Kthente kokën dhe shikonte se ku i mbeti barka, e ajo valvitej larg në liqen. Tashmë ishte errur krejtësisht e ai nuk e shihte.

- E harrova barkën në ujë, të mallkuarën!

- E çdo të bësh?

- Çdo të bëj? Do të shkoj e ta marr prapë.

- Sonte? Në gjithë këtë terr, në këtë natë pa hënë?

- Jo, nesër, nuk bën, - thanë edhe disa të tjerë, - Humbet barka. Zoti e di ku e përplasin dallgët për gjith natën. Po edhe sonte zor se e gjej. Se nuk dukej gishti në këtë errësirë, o xha Nuri.

- Do ta gjej, do ta gjej, - thoshte xha Nuriu, por kush të më japë barkën e tij.

- Merre timen, - u hodh xha Zenuni, peshkatar i vjetër.

- Dhe, në daç, vij edhe unë me ty që të mos mërzitesh, o Nuri se jo për tjetër.

- Vetëm ma jep ti barkën, e rri këtu dhe numroi yjtë, se unë vij menjëherë, - tha xha Nuriu.

- S'e ke me gjith mend, xha Nuri, ia priti një peshkatar tjetër prej më të rinjëve, se natën nuk lundrohet vetëm.

- Bile edhe po veson nga pak, - shtoi dikush.

- Do të ma jepni, apo jo barkën? – pyeti plaku me tërbim.

- Po si ore, s'ta dhënkemi.

- U hodhën katër, a pesë menjëherë. Merre cilën të duash, te gardhi i ke të gjitha të lidhura. Po dije që s'e ke mirë këtë punë, të nisesh vetëm.

Xha Nuriu nuk përgjigjej asgjë, por u nis, drejt gardhit, te barkat, e pasi e zgjidhi atë më të afërmen humbi në terrin e natës verore.

U shpërndanë.

Kah mezi i natës shiu binte me shtambë. Xha Zenuni s'vuri dot gjumë në sy. – A do të jetë kthyer vallë Nuriu, pyeste ai vetveten. Cigaret i ndizte njëren pas tjetrës. Nuk duroi shumë, me ngadalë zbriti shkallët e drunjtja e nëpër livadhin e Kamberit u drejtua kah shtëpia e Nuriut. Nga larg pa dritën e verdhë në dritaren e tij. “S'qenka kthyer”, tha, se “drita s'do të ishte”. “E pritkan të shtëpisë të kthehet ... Po sikur të afrohem një çikë më afër” dhe vazhdoi t'i shpejtojë hapat.

Trokiti në derë. Plaka e xha Nuriut ia çeli derën, me gjasë e befasuar kur ndeshi në xha Zenunin. “A u kthye”, pyeti ai, edhe pse nga pritja e plakës dukej se s'ishte kthyer. “Jo”, i tha ajo “Po e presim edhe ne”. – Dhe në sytë e saj u pikturua një nur ngjyra, që shprehte ngjyra, që shprehte droe.



Doli fushës. Bari i lagët ia qulli këpucët e llastikta, kurse ai nxitonte drejt liqenit: gjumë nuk kishte më në sy, shqetësimi i qe futur në kraharor, thellë, aty diku ku vlonte, vlonte ...

- Oooooo Nuri, - Ooooo, - qe zëri që çante errësirën atë natë. Gjithë buzë liqenit.

Por thirrjeve të tij nuk u përgjigjet as frymë, as zot. Buzë liqenit shavarët, zogjtë trembeshin nga këlthitja e tij, kokoronin patat e egra, po edhe vetë liqeni gjëmonte me përgjërim.

Iu bë sikur u zu në kryqëzat. I lodhur u ul mbi një gur, ndezi një cigare. Vendosi ta priste agimin aty. Me një fije shkrepse mundohej ta ndriste orën e xhepit, ta shikonte akrepin se ku kishte arritur.

- Oooooo Nuri, - Ooooo, - u dëgjua atë natë tërë natën.

Agu kishte filluar të nxjerrë kokën andej kah lindja e diellit dhe ndonëse kishte kohë të lindte dielli, nuri i dritës kaploi majat e bjeshkëve dhe hop, duke luftuar me terrin, erdhi dhe u bë pasqyrë syprina e liqenit. Xha Zenuni hypi maje një shkëmbi të lartë, aty afër bregut, vuri dorën në ballë, e soditi të katër anët e ujit, në mos e shihte dikah plakun, xha Nuriun. Por syri nuk i kapi asnjeri, as zog e as send mbi sipërfaqe të ujit. Po zgjohej çdo gjë, kurse trupi i tij po fikej nga lodhja e përgjërimit. Liqeni dukej si një trup femre pehri, trupin e së cilës nuk mund ta prekësh, ose as që ke nevojë për një gjë të këtillë.

S'ishte fëmijëria as e xha Zenunit as e atij që ky e kërkonte nëpër atë natë, jo. Po agonte, por ngrysej trupi i plakut, trupi i tjetrit, qetë në pamundësinë e duarve të lëshuara nga takati, mund të flinte qetë aty poshtë, nën valët e liqenit dhe me lymin.

Xha Zenunit iu kujtuan motet e shkuara, ditët e netët e gjata, rrjeta e xha Nuriut, barka të shpejta si ngjالات, iu kujtua syri i saj, ëndërrimet dhe të gjitha ato që prinin me vite.

Ku vajti, me djallin? – pyeti veten dhe kërkonte më kot me sy nëpër syprinën e liqenit barkën e xha Nuriut.

Agonte dielli i madh dhe i zjarrtë si saç i skuqur, ato valëza të bukura liqeni, e tani, fëmijët e shkollës, vallë të vijnë e ta nxjerrin trupin? Nuk bën, jo! Përimtonte kështu me mendje xha Zenuni, kur, sa çel e mbyll syt iu dha, aty, pak më larg bregut, në shavar, barka e tij që rrëshqiste mbi ujë, e në të xha Nuriu.

Xha Zenuni nxitoi bregut me sa fuqi kishte, e kur iu afrua i thiri:

- Oooo Nuri!

- Oooo, - iu përgjigj tjetri.

- (.....)

Xha Nuriu duke rrëmuar me rrëmbim, erdhi dhe e ndali barkën në zall aty në breg, dhe doli prej saj, e preku në sup xha Zenunin dhe i kërkoi një cigare.

U ulën në zallin e plazhit.

*Resul Shabani*



## Bisedë rreth tekstit

Cili është personazhi kryesor i këtij teksti?

Si përshkruhet miqësia e afërt e dy shokëve të rinisë, e tani pleq?

Si përshkruhet në këtë prozë – tema e saj?

Si ndihmohen personazhet?

Ç' e mundon xha Zenunin kur shkon në shtëpi dhe për ku niset pas mesit të natës? Pse xha Nuriu e kërkon barkën e tij me këmbëngulje, ç'i jep ajo dhe a mund të jetojë pa të?



## Detyrë

Këto elemente tëthurjes së veprës letrare epike zbatoni edhe në prozat e tjera të librit.

### Kompozicioni

*Secila vepër letrare thurret sipas një sistemi, sipas një mënyre, prandaj mënyrën se si shkrubet një vepër letrare e quajmë kompozicion.*

*Kompozicionin e veprës letrare, (kryesisht llojet e poezis epike) pra, ndërtimin e saj, e ndajmë në disa faza:*


*fabula* – është sistemi, mënyra e rrëfimit të ngjarjes në vepër;

*pjesa hyrëse* e fabulës deri te fillimi i ndodhisë quhet *ekspozicion*;

*ngjarja me të cilën fillon ndodhia quhet intrigë (gërshtim, thurje);*

*kurse ngjarja (shkakun me të cilin mbaron ndodhia) quhet shthurje-zgjidhje. Zhvillimi (zbdërvjellimi) i veprimit është prej intrigës e deri në shthurje, kurse pika më kulminante e zhvillimit quhet kulminacion.*

*Kështu, në prozën e librit, kur xha Zenuni bindet se s'mund ta gjejë xha Nuriun dhe mendohet si ta gjejë, është pika më e lartë e zhvillimit – është kulminacioni. Shthurja është gjetja e xha Nuriut.*



Resul Shabani

**Resul Shabani** (1944) lindi në Kalisht të Strugës. Kryesisht e tërheq Liqeni i Ohrit, buzë të cilit ndodhet edhe fshati i tij i lindjes. Jeton në Shkup. Botoi shumë vepra si për të rritur ashtu edhe për fëmijë, në prozë, poezi dhe dramaturgji. Ndër to janë “Liqeni”, “Shën”, “Qerpik i lagur”, “Kashta e Kumtrit”, “Hamleti me plis të zi”, etj.

# KËNGË E SERAFINËS DHE E SHOQEVE

---

Kallëzohet lashtit, na u nda një herë  
Prej vashës trimi dhe shkoi detit gjerë.  
Vasha na priti sa e re më s’dukej,  
Por anije s’sheh e shpresa po i kputej.

Një mëngjes te zalli me shpirt helmrrëmbyer,  
Në mingëll të hollë, vasha na është kthyer!

As plakej, as rritej. Edhe një të hënë  
Trimin shqotash rrahur pranë ia kanë shpënë.

Aq të bukur vasha kurrë s’e kish parë:  
Me lule të bardha, pa zili, mbulohet  
Për t’i thënë trimit: “Zemra më gëzohet!”

*Jeronim de Rada*



## *Fjalë dhe shprehje*

mingëll-a – lloj rrobë femrash arbëreshë  
shqotë-a – borë e përzier me shi




## *Bisedë rreth vjershës*

Analizoni këtë vjershë të bukur dhe thuani çfarë ndjenjash shfaq poeti në të?

A ka në të elemente përrallore?

Nëse ka, në cilën strofë i vëreni këto?

Çfarë përfundimi i ka dhënë poeti vjershës dhe si duket kjo nga mesi?



Jeronim de Rada

*Jeronim de Rada*, (1814 – 1903) lindi në një fshat të arbëreshëve në Itali. Ka filluar të shkruajë qysh në rininë e tij të hershme, duke e përkrahur lëvizjen kombëtare shqiptare. Me kohë u bë njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe. Kryevepra e tij “Milosao” mbahet si një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe, vepër kjo të cilën e botoi kur i kishte 22 vjet. Në të jepet dashuria mes dy të rinjve – Milosaos dhe Rinës mbi të cilën ngadhjnjën dashuria ndaj atdheut. De Rada është njëri ndër shkrimtarët kryesorë romantikë, i cili pos trajtimit të temave nga e kaluara historike e popullit shqipëtar, trajton edhe tema të dashurisë.

## MIKU IM - MITU

---

Ishim duke luajtur në oborr. Fshiheshim në mesin e luleve të erëkëndshme. Dhe kërkonim njëri-tjetrin. Rendin e kisha unë. Valdeti duhej t’i mbyllte sytë. Ai ishte i padurueshëm. Gjithmonë thërriste të ngutem, të fshihem sa më shpejt.

Në çastin kur unë isha fshehur bukur mirë dhe mendoja se s’ka për të më gjetur lehtë, Valdeti më thirri:

“Besnik, dil – dil! Dikush thërret. Gjuhën s’ia kuptoj. Kërkon diçka”.

Unë e ndieja, por heshtja. Mendoja se shoku i im do të më gënjejë e pastaj do të tallet me mua. Ai është dinak. Ja ka anda të tallet.

Unë sërish heshtja. Po ai gjithnjë vazhdonte të më thërrasë. E, unë s’i besova. E detyrova të betohet e të thotë:

“ U bëfsha mi nëse të gënjej. Ai pret...”

Kësaj here i besova.

Një burrë i panjohur mbante për dore një vocrrak, i cili na shikonte dhe buzëqeshte ëmbël.

U afrova duke i nderuar shqip. E ata ma kthyen në gjuhën e tyre.

Së paku u kuptuam me lëvizjet e kokës dhe me buzëqeshje të ëmbël.

Burri i panjohur m’i përkëdheli flokët dhe nxori një adresë. Bëri me shenjë ta lexojë. Kuptova se kërkon gjyshin tim. Sahora u gjeta në dhomën e gjyshit. Së bashku me të dolëm te porta hyrëse. Kur e pa gjyshi, klithi:

“Ky është Gjorgjiu. Gjorgjiu nga Boroneshti. I biri i mikut tim. Është nga Rumania”.

E nderoi të huajin dhe e përqafoi gjer në dhembje. Këtë e përsëriti edhe ai. Pas pak kohe u gjetëm të gjithë në dhomë.

Ndërsa gjyshi bisedonte me ankth me të huajin, Gjorgjiun, unë rrija pranë vocërrakut të tij, i cili më shtriu dorën e më tha:

“Mitu”.

Unë ia ktheva:

“Besniku”.

Që të dy u njohtuam dhe u përqafoam, sipas shembullit të gjyshit tim dhe të jatit të tij.

Shikoheshim dhe buzëqeshnim.

Ah, si s’e dinim gjuhën e njëri-tjetrit. Do ta bëja të mos mërzitet. Do të luanim bashkë. Kështu mendoja një çast, por kisha gabuar. Gjuha nuk qe pengesë të mos luajmë. Në kopsht vazhduam lojën që e patëm ndërprerë me shokun tim, Valdetin. Fshiheshim ne – na gjente ai, fshihej ai – e gjenim ne. Dhe kështu shpërthente gazi.

Ditët kalonin e lojërat tona ndërroheshin.

Në mëngjesin e parë ai më nderoi në gjuhën e tij:

“Bonadimineaca!”

E unë ia prita në gjuhën time:

“Mirëmëngjesi!”

Në mëngjesin e ardhshëm unë e nderova në gjuhën e tij ai mua në gjuhën time.

Qeshnim.

U shoqëruam aqë, saqë kur u ndamë kemi qarë me lot. Mezi na shkëputën nga njëri-tjetri.

Gjyshi u premtoi t’u shkruajë letra.

Edhe ata u shprehën kështu.

Letrat e Mitos m’i përktente gjyshi im. Mitua është mirënjohtës për kohën që e kaluan tek ne. Më shkruan që edhe unë, me gjyshin, t’ua kthejmë vizitën.

Tash edhe unë kam mësuar ca fjalë nga gjuha rumune. Mitu më ka dërguar një ABECEDAR, që në gjuhën rumune do të thotë **abetare**.

Edhe Mitua dëshiron të mësojë të flasë në gjuhën shqipe. Porse ai nuk ka mundësi. I jati i tij nuk e di gjuhën tonë. Kurse gjyshi im gjuhën rumune e njeh njësoj si gjuhën shqipe. Atje ai ka jetuar si kurbetçi. Shumë vite me radhë ka punuar. Ka qenë mik i ngushtë i babait të Gjorgjiut. Atëherë Gjorgjiu ka qenë i vogël, si Mitua sot ndaj babait tim. Edhe unë tanimë jam miku i Mitos. Sot ia shkrova një letër në gjuhën e tij.

*I dashur Mitu,*

Kjo letër e shkruar nga dora ime, mos të të habitë. Të jam mirënjohtës për abetaren, që ma dërgove. Me ndihmën e gjyshit tim të shtrenjtë, i kam mësuar të gjitha shkronjat. Madje edhe të gjitha fjalët tanimë të shkruara i njoh.

Edhe pse njihemi qysh më heret, tani po fillon miqësia jonë e sinqertë.

Letrat Tua i lexoj para shokëve të mi. Ua përkthej fjalë për fjalë. Besomë, të gjithëve na kaplon një mall. Na shpërthejnë riga të nxehta loti.

Të përqafohem me mall të zhuritur –

*miku yt-  
Besniku.*

Në zarf ia futa fotografinë time dhe të shokëve të mi. Këto i patëm përgatitur në shkollë me ndihmën e arsimitarit përgjegjës të Klubit të fotografëve të rinj.

Edhe Mitua më ka dërguar disa fotografi. Ato i kam ngjitur në fletoren e shënimeve të kujtimeve të mija. Ma shtojnë dashurinë ndaj mikut tim, Mituas, i cili gjindet pas shumë e shumë maleve të larta, pas shumë e shumë ultësirave e grykave. Por ai qëndron shumë, shumë afër zemrës sime.

Gjyshi shpeshherë më kërkon fletoren e shënimeve të mia. Përmalohet me to. Dhe nis e më tregon për kohën e tij, i cili qysh si fëmijë, i ka shijuar përshtypjet e jetës mërgimtare. Në ato ditë gjyshi i Mituas i është bërë mik. Ka marrë pjesë në dhembjet e tij. I ka bërë shoqëri, sadopak, për t'ia larguar mallin për prindërit dhe për vendlindjen e shtrenjtë.

*Abdylazis Islami*



### *Bisedë rreth tekstit*

Cila është tema e kësaj proze?

Cili është personazhi kryesor dhe kush është rrëfimtari i saj?

Si përshkruhet njohja e Besniku që nuk i përgjigjet thirrjes së Valdetit?

Ç'përpyetje bëjnë Besniku e Mitua për ta vazhduar miqësinë e gjyshërve?



### *Detyrë*

Duke e lexuar këtë prozë, sigurisht ju është kujtuar ndonjë ngjarje nga e kaluara juaj ose që e keni dëgjuar prej dikujt, e cila ju ka lënë përshtypje të thellë. Përpiquni në fletoret tuaja të bëni një përshkrim të ngjashëm.

### **Letra**

*Letra i takon zhanrit letrar didaktik. Është e thjeshtë, sepse i dërgohet një dashamiri, siç është dhënë në shembullin tonë. Dikur letrat shkruhen në vargje dhe me to shfaqeshin mendime rreth artit e letërsisë.*

*Letra është, po ashtu, një lloj njoftimi me shkrim që shkruhet i bën marrësit. Dërguesi e marrësi krijojnë lidhje të ndryshme me njëri-tjetrin. Letrat mund të jenë: private, tregtare, zyrtare, etj.*

## SHPELL' E DRAGOBISË

---

Kur tufani e shthuri fenë,  
kur tirani e k'rrusi atdhenë,  
mbi një breg të Dragobisë,  
prirët Flamur' i lirisë.

Atje nisi, atje mbaroi,  
atje krisi, atje pushoi,  
rrufe-shkab e Malësisë,  
në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ai mbeti,  
se s' tronditej nga tërmeti,  
dif-dragoi i Dragobisë,  
trim-tribun i vegjëlisë.

Thon' u shtri e thon' u vra,  
por ti s' vdiqe or Baba,  
as te shkëmb' i Dragobisë,  
as te zemr' e Djalërisë.

As je vrar' e as po vritesh,  
legjendar Ante po rritesh,  
ditiramb i Dragobisë,  
tmerr, panik i mizorisë.

Me zjarr t' shenjt' u ndrit kjo shpellë,  
gjer në qiell u ngrit kështjellë  
për lirim të Shqipërisë  
katakomb' i Dragobisë.

*Fan S. Noli*

## *Shënim*

Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit të 1924-ës Bajram Curri, si një nga pjesëtarët kryesorë të opozitës në Shqipëri, nuk u largua jashtë atdheut, por mori malet me armë në dorë. Plaku i maleve, bashkë me pjesëmarrësit e tjerë të çetës, luftoi, heroikisht te shpella e Dragobisë.



### *Fjalë dbe shprehje*

**tufan-i** – kjo fjalë përdoret në mënyrë të figurshme, për të dhënë forcat reaksionare, të cilat mposhtën Revolucionin Demokratik të Qershorit  
**priret** – anohet

**div-i** – këtu: njeri me trup të madh e të fuqishëm

**dragua-oi** – këtu: trim i madh, trim që nuk e ka shokun

**tribun-i** – këtu: veprimtari i shquar për mbrojtjen e të drejtave të popullit

**bajrak-u** – flamur



Fan S. Noli

*Fan S. Noli* (1882 – 1965) lindi në Qytezë, një nga fshatrat shqiptare në Turqi. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në mërgim, në Amerikë. Ka përkthyer në gjuhën shqipe disa nga kryeveprat e letërsisë botërore, siç janë tragjeditë e Shekspirit, Ibzenit etj.

Noli ka shkruar vjersha të bukura e të fuqishme me përmbajtje politiko-shoqërore si dhe veprën e tij më të madhe origjinale “Historia e Skënderbeut”.

Veprat e Nolit, origjinale ose përkthime, kanë luajtur një rol të dorës së parë në zhvillimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe.



## FSHATI I PESË KODRAVE

---

Fundi i të pesë kodrave lëshohej pjerrtas dhe humbet në fushën e vogël me formë trekëndëshi, e cila tërë verën e ruante blerimin, edhe atëherë kur dielli piqte gjithçka. Pesë përrrenjtë që i ndanin ato kodra të vjetra, të cilat kushedi sa lisa kishin rritur dhe ushqyer dhe, më në fund i kishin kalbur e tretur, sajonin një lumë të vogël, i cili ia shtonte bukurinë edhe më tepër asaj lugine që dukej si një qilim i madh. Lumi dredharak e përshkonte nëpër qendër, e ndante katundin në dy pjesë dhe gjatë tërë verës rridhte, ashtu i qetë, me atë pak ujë të kthjellët e të vakët. Vetëm në vjeshhtë, e herë-herë në dimër e pranverë, uji i tërbuar, i palonte buzët e gërryera të shtratit të vet, mbyste ara e livadhe dhe linte pas vetes lym. Njerëzit me fuqinë e krahut të tyre e mbanin këtë lym dhe përsëri e hidhnin në lumë, thuajse ashtu vepronin për inat të fuqisë së tij që për atë vit ua kishte shkatërruar frutat e punës së tyre. Por në verë uji ishte më i çmueshëm se çdo gjë që kishte katundi dhe banorët e tij. Ai ua mbante kopshtet, arat me misër dhe kafshët. U ndihmonte katundarëve saherë që qiellit nuk i vinte keq për tërë atë nxehtësi që derdhte mbi ta. Ishte ushqim i çmueshëm për tokën e tyre, për trembëdhjetë familjet e atij katundi të vogël malor.

Trembëdhjetë oborret, të thurura me gur ose thupra, ishin strukur nën hijen e kodrave, duke u munduar të zënë sa më pak vend në arat pjellore, sepse në atë mënyrë ruhej më mirë kafshata edhe ashtu e vogël e katundit, që rritej përvjet ngadalë dhe disi pa u rënë në sy njerëzve. Lumi gjapëronte duke u ngjeshur me rrënjët e shelgjeve përreth dhe thuase gurgullimën e vet të qetë ua kushtonte atyre trembëdhjetë shtëpive, me oxhaqe të larta e të vjetëruara, me pullaze të mbuluara me kashtë ose me dërrasa, që vjetët ua kishin falur ngjyrën e plumbit.

Dita në atë katund malor, ku gati kurrë nuk shkelte këmbë e huaj, përpos ndonjë miku, që rrallë herë shihej atypari, ishte shumë e qetë. Njerëzit shpërndaheshin në punë sëbashku me agimin e çdo dite.

Kur dielli depërtonte me rrezet e veta nëpër kurorat e mëdha të lisave përballë katundit, një njeri i ndodhur rastësisht në lindje mund të vërente katundin me të gjitha karakteristikat e tij: aty këtu ndonjë fëmijë duke lozur në oborr ose në rrugë, përroskat e vogla të ujit, që hynin e dilnin nga oborri në oborr dhe më në fund drejtoheshin si gjarpërinj dredha-dredha e të gjerë pa fund kah arat e gjelbëruara nga misri, që nuk dinte për nxehtësinë e madhe edhe kur dielli digjte

gjithçka nëpër ato kodra, sepse gjithmonë ujin e kishte pranë. Ditëve të verës mund të dëgjohej prej së largu, vetëm herë pas here, ndonjë zile kafshe ose blegërimë e ndonjë deleje e ndarë nga tufa, e që herë-herë përzihej me zërin e barinjve, me jehonat që kumbonin thekshëm përrua pas përroit, duke e përcjellë zërin derisa humbte në lartësi.

Kah mesdita, kur dielli i afrohej kupës së përhimtë të qiellit, katundi bëhej edhe më i qetë. Ngjante me një vend të shkretë, pa kund njeri të gjallë në të. Edhe nga pamja e jashtme ai nuk jepte shumë shenja gjallërie. Vetëm gjelat, tërë ditën, pa marrë parasysh vapën apo të ftohtit, nuk menin këngën dhe, po të dinin njerëzit më tepër për këngën e tyre, do ta quanin: katund i gjelave. Edhe çdokush nga banorët e tij dëshironte që shtëpia e tij të kishte sa më shumë gjela. Shpeshherë shtyheshin ndërmjet tyre se gjeli i kujt këndonte më mirë, e zgjaste zërin më tepër dhe kush kishte më shumë gjela në shtëpi. Mëngjeset ishin të mbushur plot me këngën e tyre, e cila përcillej përrua pas përroi e këthehej si jehonë, duke u përzjerë me zërin e kësaj orkestre të çuditshme por, kur dielli lëshohej kah kodrat e perëndimit, që ishin vetëm pak më të ulët se ato të lindjes dhe qielli dukej më i gjerë, e hijet e shtëpive e mbulonin me pjesë të oborreve, katundi ngjallej përsëri. Njeriu që kalonte për herë të parë andej habitej sa shpejt ndryshonte çdogjë. Mbrëmja ishte edhe më e gjallë. Njerëzit këtheheshin nga puna, ndaheshin në mes të katundit dhe bisedonin deri vonë. Tufat e mëdha të deleve që shiheshin në fillim në rrëzat e kodrave, zvogëloheshin ngadalë, sepse çdonjëra dinte të ndalej para dyerve të veta. Tingëllimat e zileve të tyre pushonin dhe çdo gjë binte në heshtje.

(...)

Në oborrin e mbuluar gati krejt me bar, përpos një shoke kah ecnin zakonisht njerëzit, ku bari nuk mbinte kurrë, gjendej një shtëpi e lyer me baltë, qysh para disa vjetësh dhe e mbuluar me dërrasa, që shiu dhe dëborë u kishin dhënë ngjyrën e plumbit. Përkundraill, mu afër dyerve të oborrit ishte një shtëpi tjetër, gjithashtu e mbuluar me dërrasa, por me mjeshtëri e me dy dritare të vogla, kthyer kah lindja, thuase ato ishin bërë që më lehtë të shihej e tërë fusha, e cila shtrihej në atë anë deri te rrëzat e kodrave të pyllëzuara. Nëpër muret e saj grethat kishin hapur vrimat e veta dhe posa agonte, fillonin zukamën e mërzitshme e montonte, e cila zgjaste deri kah mesdita, kur vapa i detyronte të struken diku nën hije.

Dielli atë ditë vere ishte ngritur bukur lartë mbi kurorat e rrumbullakta të lisave kah lindja. Një mjegull e hollë, vetëm sa shihej, si vel nuseje e tejdukshme, kishte marrë ngjyrë ari nga rrezet e diellit. Tërë lugina dukej si e praruar nga ajo mjegull e çuditshme.

Në atë katund, atë ditë ndodhte diçka e pazakonshme. Asgjë thuase nuk i ngjante jetës së rëndomtë të atij katundi. Qetësia e përditshme ishte zëvendësuar me endjen e njerëzve dhe me një zhurmë që vinte nga çdo anë.

Oxhaku i asaj shtëpie, që shtrihej në të majtë të krahut të rrugës, e cila shkonte

kah jugu, villte tym të zi e të dendur tërë atë mëngjes. Tymi nganjëherë turrej shllunga – shllunga edhe nëpër derë e dritare, sepse gryka e nxirë e oxhakut, e cila kishte vjellë aqë shumë tym, tash sa vjet nuk e zinte.

Një grua, që, nga pamja, nuk dukej aq e moçme, megjithëse mund të vërehej lehtë se gjatë jetës kishte mbledhur mbi kurrizin e vet një barrë të rëndë vuajtjesh, me dimi të arrnuara në disa vende, një mbështjellësi të zi e me dy tre arna të bardha, që e bënë edhe më të shëmtuar, doli e hyri disa herë atë ditë prej mëngjesit. Aty- pari silleshin herë pas here edhe gratë e tjera me shami lidhur nën fytyrë dhe pa shikuar as djathtas as majtas, por duke u ngutur që të mos takoheshin me kënd rrugës.

*Nazmi Rrahmani*



### *Bisedë rreth tekstit*

Kjo pjesë e prozës është nxjerrë nga romani “Malësorja” dhe atë nga pjesa e parë e romanit. Që të futet më lehtë në përshkrimin e ndodhisë, shkrimtari përdor mjete shprehëse dhe mënyrën përshkrimore artistike që vepra e tij të jetë sa më e ndieshme dhe artistikisht më e realizueshme. Në këtë tekst bëhet përshkrimi i një fshati.

Si është përshkruar pamja e fshatit, për cilën stinë të vitit bëhet fjalë dhe për ç’kohë?

A ka ndonjë dallim rrënjësor ndërmjet këtyre dy pjesëve përshkrimore të tekstit?

Në bazë të emrave: kodra, lumi, përroska, gjela, shtëpi, dele, (të pjesës së parë) dhe rrugicë, oxhak, katund, grua, shtëpi, (të pjesës së dytë) përpikuni t’i vëreni dallimet përshkrimore të këtyre dy pjesëve!



### *Detyrë*

Shpjegoni shprehjet figurative: fundi i të pesë kodrave lëshohet pjerrtas / edhe atëherë kur dielli piqte gjithçka. /Lumi dredharak.../ u ndihmonte katundarëve sa herë që qiellit nuk i vinte keq për atë nxhtësi që derdhte mbi ta. /tymi turrej nganjëherë./!



Nazmi Rrahmani

**Nazmi Rrahmani** (1941) lindi në një fshat të Podujevës së Kosovës. Njihet si romancier. Ka shkruar romanet: “Malësorja”, “Tymi i votrës së fikun”, “Toka e përgjakun”, “Pas vdekjes”, “Rruga e shtëpisë sime” etj.



Picasso

# TRINA

---

Molla t'kputuna një deget,  
Dy qershija lidhë n' një rrfanë,  
Ku fillojnë kufijt e Geget,  
Rrijnë dy çika me një nanë.

Kreskë e bre përzie me lisa  
Rriten rrotull, me çetinë,  
Plepa t'but' e qeparisa  
Mblojnë e veshin at ledinë.

S'ushton mali prej bagtjet,  
S'fryn murlani me duhi;  
Paq i kthjelltë prej Perëndijet,  
Paq prej njerit e qeti.

Gurra e lugut veç ushtonte  
Si lahutë me kangë kreshnike;  
E nder pem' bylbyli këndonte  
Valle darsmet e fisnike.

Ngreh, bylbyl, n'at hije valle,  
Ushto, gurrë trimneshë, n'shkambije;  
Bulk i natës, kungallë, qi talle  
Nëpër gamba e n'për lamije,

Këndoni, këndoni, veç prej stanit,  
T'ardhmen Trina mbramje n'shpi,  
Tue blegrue një kij mbas zanit  
T'deles nan' kenë me ndi.

Veç prej plehit gjel kokoti,  
Me njat za që s'ndrron kurr-herë,  
Ka m'u gjegjë sa a tui ndërrue moti,  
Se a tui çue një tjetër erë.

*Ndre Mjeda*



### *Bisedë rreth vjershës*

Çka përshkruan poeti në strofën e parë?  
Ku jetojnë dy çikat me nënën e tyre?  
Përshkrimin e atij ambienti poeti e plotëson në strofën e dytë. Në strofën e katërt është një krahasim shumë i bukur.  
Çfarë figure kemi në strofën e pestë?  
Lexoni me kujdes strofën e gjashtë. Si janë rreshtuar fjalët në fjalitë e asaj strofe? A është rreshtim i natyrshëm. A i rreshtojmë ne fjalët në atë mënyrë kur flasim? Pse ka vepruar poeti në atë mënyrë?  
Çka paralajmëron gjel kokoti me këngën e tij?



### *Detyrë*

Përshkruani ambientin e pikturuar në këtë vjershë.



Ndre Mjeda

*Ndre Mjeda* (1886 – 1937), megjithëse ishte i veshur me petkun fetar, është një ndër shkrimtarët më përparimtarë të kohës së vet. Si shumica e shkrimtarëve shqiptarë të Rilindjes, edhe Mjeda kaloi një pjesë të mirë të jetës larg vendlindjes.

Ka shkruar më tepër vjersha lirike, që u botuan në përmbledhjen “Juvenilia”. Ka shkruar edhe poemat: “Skodra”, “Lisus” dhe “Liria”. Ka edhe mjaft vjersha për fëmijë, përmbledhur në veprën “Guxo”.

## VDEKJA E ALI PASHË TEPELENËS

Ali Pasha u ngrit dhe u përkund mbi këmbë.

- Qëndroni aty! Çfarë më sillni, - tha ai, me zërin e tij kërcënues.

- Vullnetin e mëkëmbësit të profetit Muhamed, - thiri Hasan Pasha. Ai nxori nga gjoksi një ferman dhe e shpalosi. – A i njeh këto shenja? – tha ai.

Hasani kishte qëndruar pesë-dhjetë hapa më tej dhe rreth tij rrinin grumbulluar oficerët me armë në duar. Ishin të zbehtë.

I njoh dhe i nderoj, - tha Aliu. Ai kishte vënë të dy duart në mes.

- Atëherë përulu. Merr avdes dhe drejtoja zemrën allahut. Koka jote kërkohet nga sulltani. – Hasan Pasha mbështolli fermanin, e futi prapë në gjoks dhe bëri përpara. Ai ishte fare i sigurt se e mbaroi punën e tij të vështirë. Një muslimani të urtë, mjaftonte t'i thoshje se koka e tij i duhej sulltanit, që ai të quhej i lumtur dhe të zgjaste qafën për të marrë shiritin.

- Koka ime! Tradhëtar! Kjo kokë nuk merret kollaj. – Aliu dëgjoi zërin e tij që buçiste si qëmoti. Ai nxori të dy koburet dhe i shprazi pa marrë shenjë.

Kaftan Agai ra në vend i vdekur dhe Hasan Pasha u palos më dysh dhe u praps i plagosur. Menjëherë oficerët i zbrazën pushkët, po asnjë plumb nuk e mori Aliun. Të katër trimat u dhanë përpara dhe e mbuluan me trup. Trimat ranë në këmbët e Aliut dhe grupi prej pesëdhjetë vetësh, që ndodhej në shesh, u vu për mbrojtje nën muret e shtëpisë. Nga dritaret e asaj shtëpie po shtinin trimat e tjerë.

Aliu u kthye të hynte brenda, ku kishte armët, po një plumb e mori në sisën e djathtë. Shtinin nga të trija anët, mbi atë qoshkë të vjetër prej dërrase.

- Zjarr! – thirri Aliu. – Qëndroni për jetë! – Ai vuri dorën në gjoks që të ndalonte gjakun. Një plumb tjetër e mori në ijë. Ai nxori jataganin me vështirësi, u drejtua nga shkallët. Të dy plumbat ja kishin bërë gjakun valë. I shkrepri në sy një dritë e madhe gëzimi, si në ditët e fitoreve të shkuara, po tri herë më e fortë. Ai e kishte gjetur vdekjen prapë. Do të vdiste si ushtar, me armët në duar duke e zënë armikun për grykë.

Po nuk arriti te shkallët. Plumbi i tretë erdhi nga poshtë dyshemesë, i përshkoi tërë kofshën dhe i doli në boshtin e kurrizit. Dërrasat e dyshemesë nxirrnin tym dhe e tërë bota që kthyer në buçitje e krisma. Ai u pre në mes, u rrotullua mbi

vete, ra në gjunjë dhe u mbështet me të dy bërrylat në parmakun e qoshkut. Ai desht t'i buzëqeshte vdekjes, po nuk pati kohë. Kur i doli gulçima e fundit, u kthye në shpinë, me jataganin në dorë, me sytë të shqyer, me nofullat e shtrënguara si darë.

Nuk dëgjohej më asnjë krismë dhe oficerët kishin dalë nga bodrumi e nga prapa pemëve. Ali Pasha shtrihej mbi qoshkun para tyre, i larë i tëri në gjak, po askush nuk besonte se kishte vdekur. Më në fund një njeri kërcëu i pari mbi të, e kapi nga mjekra dhe e tërhoqi poshtë shkallëve. Aty u sullën të tjerë. Në shkallaren e fundit, e goditën me jataganë, që t'i merrnin kokën. Zverku i tij i dobët, gjithë lëkurë e damarë, ishte më i fortë se një trung i thatë.

*Sabri Godo*

### *Sbënim*

“Vdekja e Ali Pashë Tepelenës” është shkëputur nga romani biografik “Ali Pashë Tepelena” i Sabri Godos. Ky është romani i parë i këtij lloji në letërsinë shqipe.





# JUL QESARI

*Tragjedi në pesë akte*

*Fragment nga Akti III, skena II*

*Hyjnë BRUTI dhe KASI dhe një grup qytetarësh.*

QYTETARËT: Duam shpjegim; nemnani shpjegime

BRUTI: Pra, ejani, o miq, dhe më dëgjoni.

Ti, Kas të lutem, çap në rrugën tjetër

Ta ndajmë popullin në mest.

Kush do të më dëgjojë mua, le të mbetet

Të tjerët le të shkojnë pas Kaj Kasit;

Dhe do t'ju a çkoqitim arsyet

Q'e desh e mir'e Romës vdekjen e Qesarit.

I PARI QYTETAR: Unë do të dëgjoj fjalën e Brutit.

I DYTË QYTETAR: Unë dëgjoj Kaj Kasin, dhe pastaj përjasim arsyet e të dyve.

I TRETË QYTETAR: Bujari Brut po flet, pushoni!

BRUTI: Duroni gjer sa të mbaronj.

Romanë! Qytetarë! Miq! Dëgjomëni që t'ju tregonj punën, dhe heshtni që të muntni të dëgjoni. Në më quani të nderçim, besomëni mjaft të nderçim sa të më besoni. Gjykomëni me mënt, dhe zgjojeni mëndjen që të munt të gjykoni më mirë. Në pastë këtu në këtë mbledhje nonjë mik me zemër të Qesarit, atij i thom që Bruti e desh Qesarin jo më pak se ay. Dhe në më pyet ay mik përse Bruti u ngrit kundër Qesarit, përgjegjja ime është kjo: Jo se e desha Qesarin më pak, po se e desha Romën më tepër. A do të deshit më mirë të rronte Qesari e ju të vdisni robër që të gjithë, se sa të vdiste Qesari dhe ju të rronit të gjithë të lirë?

Qanj për Qesarin se më deshte, gëzohem se qe dorë mbarë, e nderonj se qe trim, po e vrava se qe ambicioz. I dhash lot për dashurin e tij, gas për mbarësinë e tij, nderë për trimërinë dhe vdekje për ambicien e tij. Kush është këtu aq i poshtër

sa të dojë të jet rob? Në pastë nonjë le të flasë, për atë kam bërë faj. Kush është këtu aq i humbur sa të mos dojë të jetë Roman? Në pastë nonjë, le të flasë, për atë kam bërë faj. Kush është këtu aq i lik sa të mos dojë vendin e tij? Në pastë nonjë, le të flasë, për atë kam bërë faj. Qëndroj dhe pres përgjigje.

QYTETARËT: S'ka asnjë Brut, s'ka asnjë.

BRUTI: Atëherë s'i kam faj asnjërit. S'i kam bërë Qesarit më tepër se ç'mund t'i bëni ju Brutit. Çështja e vdekjes të tij do të bisedohet në Kapitol, lavdia e tij nuk do të pakësohet për ato që ish i zoti, as faji i tij për të cilin u vra, nuk do të madhohet. (Antoni dhe disa të tjerë hyjnë me kufomën e Qesarit). Ja ku e sjell për të varrosur trupin e tij Mark Antoni, i cili, ndonëse s'pati gisht në vrasjen, po do të përfiton nga vdekja e tij dhe do të marrë një vënt në Republikë. Cili prej jush nuk do të përfitonjë? Dhe tani shkonj me këtë fjalë, - që ashtu si e vrava mikun më të mirë për të mirën e Romës, me atë kamë do t'i bie edhe vetes, kur do herë që ta quanj vdekjen time të nevojshme për vendin tim.

QYTETARËT:

I PARI QYTETAR:

I DYTI QYTETAR:

I TRETË QYTETAR:

I KATËRTI QYTETAR:

I PARI QYTETAR:

BRUTI:

I DYTI QYTETAR:

I PARI QYTETAR:

BRUTI:

Rroftë Brut! Rroftë, rroftë!

Shpjereni në shtëpi me triumf.

Ngrejeni statujën pranë stërgjyshërve të tij.

Le të bëhet Qesar.

Kurorëzoni te Brut vryrtet më të mira të Qesarit.

Do ta shpiem në shtëpi me gas e brohori.

O qytetarë, -

Pushoni! Heshtni! Brut flet.

Pushoni, eh!

Të dashur qytetarë, lërmëni

Të shkonj i vetëm dhe, për hatrin tim,

Këtu qëndroni bashkë me Antonin.

Ju lutem të nderoni trupin e Jul Qesarit

Dhe të nderoni fjalët për lavditë e tij

Që Mark Antoni mban me lejen tonë.

Ju lutem të mos shkonj asnjëri,

Veç meje gjer sa të mbaroj Antoni.

*Uiliam Shkëspiri*



### *Fjalë dhe shprehje*

Capitol-i – kështjella e qytetit të Romës në Kodrën e Kapitolit, ku ishte pushteti qendror i Romës.

## Shënim

Ky fragment u mor nga tragjedia “Jul Qesari”. Shekspiri këtë tragjedi e thuri në bazë të shkrimeve të historianit grek Plutarkut, përkritazi me ndodhitë nga historia e Romës së kohës së Qesarit. Kur Jul Qesari u bë diktator absolut në Romë, e vranë në vitin 44 para epokës sonë patricët, duke menduar se kështu do ta mbrojnë republikën. Atëherë bëhet një luftë qytetare në mes të Marko Brutit me ushtrinë e tij dhe Mark Antonit me një ushtri tjetër. Luftën e fitoi Mark Antoni.

Në këtë fragment kemi dhënë vetëm Brutin dhe fjalimet e tij para qytetarëve të revoltuar për vrasjen e Qesarit. Vëreni se me sa fuqi oratorike, Bruti ia del ta kthejë masën nga vetja. Edhe Mark Antoni është, po kështu, orator dhe e përvetëson masën dhe nis luftën kundër Brutit, i cili edhe është kryeprogonist i tragjedisë, pavarësisht se ajo është titulluar me emrin e Jul Qesarit.



### Detyrë

Mësoni përmendsh disa shprehje të fuqishme të Brutit, se përnjëmend janë të bukura dhe u duhen në jetë!



Uiliam Shekspiri

*Uiliam Shekspiri* (1564 – 1616) është njëri nga shkrimtarët dhe dramaturgët më të mëdhenj vepra e të cilit luftoi padrejtësitë shoqërore të kohës. Në veprat e tij hasim një numër të madh karakteresh njerëzore, një botë të tërë heronjsh, që nga mbretërit deri te lypësit. Veprat më të dëgjura janë: Hamleti, Jul Qesari, Otello, Makbeti, Romeo dhe Zhulieta, etj.

## PENOLOPA NJEH TË SHOQIN

Evriklia hyri duke dihatur në dhomën e zonjës dhe e gjeti atë shumë të shqetësuar dhe gati për të zbritur poshtë. Ajo deshti të merrte vesh se ç'kishte ndodhur në dhomën e bukës, sepse ca më parë kishte dëgjuar së andejmi britma e zhurmë. Andaj, kur pa Evriklinë te dera e dhomës, e pyeti me padurim:

- A, më në fund erdhe! Po ç'u bëre, moj nënke? Nga humbe gjer tani?

Përse nuk duken shërbëtoret e tjera? Ku janë? Desha të marr vesh se ç'po ndodh poshtë në dhomën e bukës dhe s'kisha kë të pyes. Mos u zu gjëkafshë Telemahu me ndonjërin prej tyre? Dëgjova një pështjellim e një poterë të madhe poshtë dhe nuk di ç'u bë.

- Qetësohu, moj zonjë, e mos u mërzit. Mendja s'duhet të të shkojë më te e keqja – u përgjegj Evriklia dhe vijoi:

- Vajtën hallet tona, zonjë, morën fund. Tashmë ke shpëtuar edhe ti, edhe yt bir, edhe ne të tjerët nga ankthi i madh që na e ka shtypur shpirtin gjer tani. Erdhi Odhisea, që e prisnim prej kaq vjetësh! Erdhi zotëria dhe i shfarosi të gjithë mtonjësit! Zbrit tani poshtë të shohësh e të ngazëllohesh. S'mund të të them më shumë, më dridhet trupi, dhe zemra më rreh fort nga mallëngjimi. Më duket sikur do të më dalë shpirti nga ky ngazëllim i madh.

- Penelopa u hutua kur dëgjoi këto fjalë dhe nuk ishte e sigurt nëse i kishte dëgjuar me të vërtetë apo jo. I hodhi një vështrim Evriklisë, që nga koka gjer te këmbët dhe i tha me ashpërsi:

- Ç'janë këto që më thua, moj plakë? Ose nuk je në vete, ose më merr mua për ndonjë foshnjë, gjersa kërkon që t'u besoj këtyre përrallave.

- Jo, moj bijë, paç uratën! Jo, moj zonjë, unë nuk të gënjej – u përgjigj aty për aty Evriklia. – Të betohem për sytë e birit tonë, se të them të vërtetën. Zotëria erdhi, është ai lypësi që e ke parë dhe fole mbrëmë në darkë. Nëse s'më beson hidh një sy nga dritarja poshtë në oborr.

Penelopa shkoi shpejt e shpejt te dritarja dhe shikoi poshtë. Kur pa stivën e kufomave, aty thirri me të madhe:

- O Zeus i madh. Shpëtua! Por paskan marrë dënim të rëndë. U vranë në moshë fare të re! Mjerë njerëzit e tyre, kur ta marrin vesh!

Pastaj u kthye përsëri nga ana e Evriklisë dhe e pyeti me lot në sy:

- Me të vërtetë u kthye Odhisea? Ta besoj, vallë? Po si mund t'i shfarosë filli

vetëm gjithë ata mtonjës?

Evriklija u përgjigj:

- Se si ndodhi kjo mrekulli, moj bijë, as unë s'e di, se nuk e pashë me sy. Dëgjova vetëm britmat e rënkimet e atyre që vdisnin. Telemahu na kishte mbyllur të gjitha shërbëtoret në një dhomë të katit të parë dhe, së andejmi ne dëgjuam gjëmën që u bë. Pak më vonë, kur më thirri vetë Odhisea, në dhomën e bukës, pashë se të gjithë mtonjësit ishin vlarë e mbytur në gjak; kurse vetë zotëria qëndronte në mes si luan. Në atë çast më porositi të të bëj zë që të zbresësh poshtë, të takohesh e të çmалlesh me të. Eja, pra moj bijë, shpejt! Të gjitha u bënë ashtu siç na e dëshironte zemra.

Penelopa përsëri nuk besonte. Ajo pandehte se ndonjë forcë e mbinatyrshme do t'i kishte vlarë mtonjësit, që të dënonte sjelljen e tyre të keqe. Por, megjithatë u nis që të dilte nga dhoma.

Ndërkohë Odhisea kishte vajtur të lahej e vishej me rrobat e bukura që ia kishte falur mbretëresha Areta. Dhe pasi kishte mbathur edhe sandalet e mira, ishte kthyer përsëri pranë të birit, i ndryshuar fund e krye.

Fytyra i shkëlqente prej gëzimit. Nga vështrimi krenar e nga pamja madhështore që kishte marrë tash, dukej shumë më i ri se më parë.

Në atë çast në dhomën e bukës hyri Penelopa. Zemra i rrihte fort dhe gjunjët i dridheshin. "Të jetë me të vërtetë ai?" – thoshte me vete.

Dhe ja. Pas pak ajo pa të birin dhe pranë tij një burrë të huaj, të veshur me rroba të reja. "Vërtet, sa i ngjan ky burrë Odhisesë tim! Po sikur të më gënjejnë sytë? Po sikur të jetë ndonjë njeri i huaj, që i ngjan tim shoqi. Pa ta provoj njëherë" – tha me vete. Dhe, pa humbur kohë, u shkoi pranë, përshëndeti burrin e huaj dhe i tha Telemahut:

- Të më falësh, mor bir, nëse do të them tash ndonjë fjalë pa vend. Më duket se nuk jam në vete. Nuk e di nëse po shoh ëndërr, apo jam zgjuar. Është e vërtetë kjo që po shoh, apo më gënjejnë sytë? Evriklija më tha se ky burrë qenka yt atë. Është e vërtetë kjo, mor bir? Sepse mendja ime nuk mund të besojë.

- Është e vërtetë, nënë. Unë çuditëmi sesi mbas një ndarjeje kaq të gjatë ti qëndron e ftohë në këtë çast kaq të lumtur – u përgjigj Telemahu, i habitur për ngurrimin e s'ëmës.

- Lëre, biri im, t'i mbushet mendja një herë – tha Odhisea – dhe mos u habit që ajo ngurron të besojë. Edhe unë vetë herë-herë dyshoj e më duket sikur jam në ëndërr.

Penelopa u përgjigj:

- Ato që më panë sytë në oborr nga dritarja e dhomës, mendja e njeriut mund t'i kuptojë e t'i besojë me vështirësi. Prandaj edhe unë, megjithëse, nga shtati e nga zëri, e kuptoj fare mirë se ky është Odhisea im i dashur, prapëseprapë nuk guxoj ta besoj.

- Penelopa ime e dashur! – thirri i mallëngjyer Odhisea. – Unë jam yt shoq,

Odhisea. Ja edhe shenja e plagës. Do tani që të them se si është dhoma jonë e gjumit?

Penelopa nuk u mbajt më tepër. Gjunjët i dridheshin dhe lotët i rridhnin rrëke nga sytë. Mbështeti kokën e saj të bukur te kraharoni i të shoqit, e përqafoi me mall dhe i tha me gjysmë zëri:

- Tash të besoj! Ti je Odhisea im i dashur, ati i birit tim!

Në atë çast u bë një me ta edhe Telemahu. Ai përqafoi me të dy duart kryet e tyre dhe nisi t'i puthte që të dy, duke qarë me lot.

Për një kohë të gjatë qëndruan kështu të përqaftuar që të tre: Odhisea, Penelopa dhe i biri. Edhe kur u ndanë dhe ndenjën nëpër frone, vazhdonin të shikonin njëri-tjetrin, të gëzuar e të derdhnin lotët pa pushim.

Pastaj secili tregoi shkurtimisht ato që kishte hequr gjatë kësaj kohe. Ata folën e folën gjersa u lodhën dhe vajtën për të fjetur.

(Nga vepra Odisea – adaptuar në prozë për fëmijë e të rinj).

*Homeri*



### *Fjalë dhe shprehje*

**ankth-i** - frika që na zë nganjëherë në gjumë, kur shohim një ëndërr të trembshme, na duket sikur po na zihet fryma;

**stivë-a** – grumbull, turra, turra e druve;

**mtonjës-i** – pretendues, kërkues.



### *Bisedë rreth tekstit*

“Penelopa njeh të shoqin”, është njëra nga momentet më të bukura të epopesë së Homerit grek “Odisea”, e cila edhe u kthye e u përshtat shumë bukur në prozë, që ju ta kuptoni më lehtë përmbajtjen e saj.

Edhe pse këtu nuk është thënë, paramendoni ardhjen e Odisesë në shtëpi të vet, mosnjohjen e tij nga gruaja Penelopa as nga kurrkush tjetër, pos qenit dhe Telemahut që e dinte këtë lojë, sepse ishin takuar më parë dhe e kishin bërë këtë plan së bashku. Po kështu, parafytyroni përleshjen e Odisesë me mtonjësit, të cilët kishin ardhur se kush do ta merrte Penelopën për grua dhe vrasjen e tyre të tmerrshme në sallën e bukës!

Si ju duken këto përshkrime dhe a është i bindshëm qëndrimi i Penelopës edhe pasi takohet me Odisenë, për të cilin dyshon deri vonë se a është burri i saj, apo mos është edhe kjo një tradhti e kurdisur mirë.

Sipas mendimit tuaj, çfarë femre personifikon Penelopa, e cila e pret burrin e vet më se njëzet vjet edhe pse kishte oferta shumë të mira për martesë?

Cili është qëllimi edukativ dhe mësimor i kësaj cope, vërtet, artistike?

# ENDËSIT E SHLEZISË

---

Në sytë e zgurdulluar s'kanë lot  
Po dhëmbët i kërcasin me furi:  
Qefinin tënd ne endim këtu sot,  
Me tri mallkime thurur, Gjermani,  
Trike-trak, trike-trak.

Mallkuar qoftë Zoti! Ne ju falmë  
Në zi e në thellime pa pushuar;  
Shpresuam edhe pritmë e prapë psallmë,  
Po tallje e qesëndi na ka dhuruar.  
Trike-trak, trike-trak.

Mallkuar qoftë mbreti! Shpirtmizori,  
Mbret kusarësh, bejlerësh, mbret barbar,  
Na piu gjakun, lëkurën na nxori  
Dhe sot na vë në plumb e në litar.  
Trike-trak, trike-trak.

Mallkuar qoftë atdheu, ku sundon  
Luksi pa fre dhe varfëria pranë,  
Ku asnjë shpirt i bukur s' lulëzon,  
Ku skllavëria shtrihet anembanë.  
Trike-trak, trike-trak.

Hidhet përpjetë boshti me furi;  
Ne dit' e natë endim pa pushuar;  
Qefinin tënd po endim, Gjermani,  
Me tri mallkime rreth e qark punuar.  
Trike-trak, trike-trak.

*Hajnrib Hajne*

## *Shënim*

Kjo poezi është përkthyer bukur në gjuhën shqipe.

Krahas luftës për çlirimin kombëtar, popujt kanë luftuar edhe për çlirimin e tyre shoqëror. Edhe krijimtaria artistike e ka ndihmuar këtë luftë.

Vjersha “Endësit e Shlezisë” bën pjesë në margaritarët e poezisë sociale botërore.



### *Bisedë rreth vjershës*

Ç’është temë e kësaj vjershe?

Si i kuptoni vargjet “ “Qefinin tënd ne e endim këtu sot / Me tri mallkime thurur, Gjermani”.

Pse e mallkon punëtori atdheun e vet? Kë tjetër e mallkon ai?

Cilat nga figurat stilistike ka përdorur poeti më shumë në këtë vjershë?

Me çfarë elementesh akustike i ka begatuar figurat poetike të vjershës?

**Hajnrih Hajne** (1797 – 1856) është liriku më i madh i romantizmit gjerman. Ishte ithtar i ideve socialiste. Këto ide vërehen edhe në veprimtarinë e tij letrare.





## DETI S'KA MËSHIRË

---

Nëna do ta bëjë një dasmë të madhe, me falca që s'i ka marrë hala asnjë nuse, me aheng që hala s'është dëgjuar në Ulqin – i thonte e ëma të birit, shend e verë, kur bisedonte për martesë.

- Këto mallra nëpër dugajë të Ulqinit s'po më pëlqejnë, - i tha e ëma një ditë sa hyri në dyqanin e të birit, e lodhur prej kërkimit në treg. – A kishe shkuar ti vetë në Stamboll të blesh mallra? Të kallëzon ty nëna se çka... - e pyeti ajo.

- Mirë, nënë, - pa pritesë e pa menduar fort. Sepse dëshirës për të bërë dasmë të madhe, iu bashkua edhe dëshira për të shëtitur. S'e kishte parë Tivarin e lëre më Stambollin.

Dhe, një ditë Maistrali e shtyri barkën tredyrekëshe në drejtim të jugut.

Atë ditë në breg të rërës, duke përcjellë djalin, diçka të rëndë ndjeu nëna plakë në shpirt. Një dorë e padukshme ia shtrëngoi zemrën, kur anija me vela të fryra rrëshqiti si mjellmë dhe u zhduk pas Kepit të Sukës. Me hapa të molisur u kthye në shtëpi.

Ashtu ndjeu edhe Ylfetja në majë të bedeneve të Kalasë. Ajo mbet e shtangur në atë pikë të bardhë që zvogëlohej; mbeti si dru deri sa s'u pa më. Atëherë ia tërhoqën vërejtjen valët që kacafyteshin me shkëmbinj në rrënzë të bedenave. U frikësua e s'dinte as vetë pse dhe vrapoi duke rrapëlluar me nallone rrugicave të Kalasë, në shtëpi.

Në Stamboll Skënderi s'lodhej t'i kërkonte dyqanet; të zgjedhë dhe t'i blejë basmat e kadifetë më të bukura e më të shtrenjta.

Ylfetja tinëzisht përgatiste dhurata më të bukura për të dashurin e saj. I qëndiste me lule të arta. Qëndiste dhe thuajse zemrën e shpirtin e shkrinte në to.

Ditët shtynin njëra-tjetrën me dembeli.

Ëshë koha e kthimit.

Shend e verë, me barkën me një vel, Skënderi e lëshoi Stambollin e shkëlqyer nga dielli mëngjesor.

Ditët në rrugë dukeshin muaj nga dëshira e flaktë për t'u kthyer në shtëpi, për

ta bërë dasmën, për ta parë Ylfeten, nënën...

Një ndjenjë trishtuese zuri t'ia mjegullojë mendjen...

Nata ishte qorre. Nisi të fryjë një erë – ndjellakeqe. Vinte duke u rritur. U bë furtunë. E hatashme. Ndihej një melodi trishtuese; fishkëllimë e erës, luhatjet dhe thyerjet e degëve të ullinjve, bajameve dhe fiqve. Dora e erës gjuante në tokë dhe thente tjegulla nga pullazet e shtëpive.

Nënzeza s'mund të flinte. Disa mendime trishtuese ia copëtonin shpirtin. Dora e padukshme prapë ia ndrydhi zemrën. Ajo mbylli sytë. Dukej se po flinte.

Gjumi s'e zuri as Ylfeten. Ajo u çua prej dysheku dhe shkoi në kuzhinë. U ul pranë vatrës, e shpupurishi hirin mendueshëm...

- Çka bën në këtë kohë këtu, bijë? – e pyeti e ëma mbas shpine, sa çeli derën dhe ia ndërpreu mendimet.

- S'po mund të fle prej zhurmës së tallazeve e furtunës, - u "arsyetua" ajo.

E ëma e kuptoi se e mashtrou. E mori për krahu dhe së bashku shkuan të flejnë.

Të nesërmen Ylfetja qiti një bohçe në krye, mori ibrikët dhe u nis në krua.

Të bërri i rrugës së kroit dëgjoi bisedën e trishtueshme të grave që mbushnin ujë.

- Ishte mbytur barka me tre dyrekë "Tre vëllezërit", kur ka dalë prej

Durrësit atë natë kur fryri ajo Fortunë e madhe. Ishte mbytur edhe Skënderi i Nafijes. E kanë gjetur të mbytur në ranishtë afër Shën Gjinit dhe atje e kanë shti në dhe...

Ylfetes iu prenë këmbët. I ranë ibrikët prej duarsh dhe u rrokullisën kall-drëmit. I rrëshqiti edhe bohçja prej kreje. Flokët iu hodhën në erë. Rendte pa shikuar ku vinte këmbët. Si fantazmë u zhdruk në terrin e portës së kalasë.

Në shtëpinë e të fejuarit as që i vërejti gratë e mbledhura. Fluturim u ngjit shkallëve të shtëpisë. Hyri në dhomë dhe, duke i shpërndarë me duar gratë, për t'i çelur rrugë vetes, shkoi dhe u gjunjëzua pranë hankos së pashkruar, të shtrirë në dyshek, me sy të mbyllur...

Kur plaka fatzezë dëgjoi për kobin e saj, si druri i prerë, u përplas në tokë, për të mos u ngritur kurrë më.

Ylfetja nguli shikimin në fytyrën e verdhë, të pangjyrë, të së ndjerës dhe, pa prituri e pa kujtuar:

- Pse e ke nisur në det? – duke u shtjerrë i bërtiti së ndjerës.

- Ka dalë mendësh!

- Largonie! – u dëgjuan zëra prej grumbullit të grave të shqetësuara e të frikësuar nga kjo hata e papritur...

- Deti s'ka mëshirë!

- Deti është i pamëshirshëm, e ka zemrën e fortë.

- Ai kurrë s'ngopet me një viktimë! – vërejtën do detarë të moçëm, kur biseduan në Pazar për këtë fatkeqësi.

*Hajro Ulqinaku*



### *Fjalë dhe shprehje*

**mjellmë-mjellma** – shpend i madh me qafë të gjatë me sqep të gjerë dhe me krah të gjerë; shpend i bardhë si bora;

**kep-i** – shkëmb i mbrehtë; thep; hundë mali që hyn në det;

**beden-i** – pjesët e sipërme të mureve të trasha të kalasë që janë dhëmbë-dhëmbë e frangji e përdoren për mbrojtje;

**hanko-ja** – titull që u jepej zonjave myslimane.



### *Bisedë rreth tekstit*

Përpiquni të hyni në zemrën e nënës me një djalë dëshiri!

Çfarë ëndrrash mund të thurë ajo për ardhmërinë e tij?

Për çfarë dasme bëhet fjalë këtu dhe a u realizua ajo?

Ç'ndodhi me Skënderin që shkoi në Shtamboll për të blerë sende për nusen dhe për martesë?

Po Ylfetja, kush është kjo?

Si përfundon kjo ngjarje, të cilën shkrimtari e huazoi nga jeta e njëmendët?

A ia ka dalë autori të hyjë në shpirtin e njerëzve që i ka pasqyruar këtu?

# STRUGA

---

Aty ku lulet zgjojnë ofshamjet  
dhe uji i lumit gurgullon amshueshëm,  
atje është Struga.

Aty ku njerëzit duart zgjasin  
njihen miqtë dhe vëllezërit  
atje është Struga.

Aty ku ditën e natën  
i dëgjoj të gjitha gjuhët  
dhe të gjitha këngët  
atje është Struga.

Ku mund të takosh fytyra të ndryshme  
(të botës)

bukuri, dashuri dhe dhembje  
atje është Struga.

Ku drunjtë me qiellin bëjnë bisedë  
njerëzit me ujin  
opale t'Ohrit,  
atje është Struga.

Ku valojnë të gjithë flamujt  
dhe shpresat e buzëqeshjet lulëzojnë  
atje është Struga.

Ku dashuria bën vija të thella,  
si plori i fshatarit të vjetër,  
atje është Struga.

“Mizëria e zërave  
të pritur për ardhmërinë  
ditët të duken se janë të amshuara  
si dashuri e vërtetë.

Ditët që lënë gjurmë,  
të latuar në kujtesë

si statua të lashta  
në kujtime të paharrueshme.  
Kjo është Maqedonia  
dëshirë e amshuar njomësi, këngë,  
Unë nuk të them lamtumirë.  
Të përshëndes plot me kujtime  
dhe këngë,  
E përshëndes agimin tënd të ndritshëm  
jetën, gurgullimën e ujit  
natën e mrekullueshme  
dhe dritën magjike.

*Rolando Çerta*



### *Bisedë rreth tekstit*

Si e realizon autori porosinë poetike në këtë poezi?  
Sipas mënyrës përshkrimore poezia ndahet në dy pjesë: ç'përshkruhet  
në gjashtë vargjet e parë, e çka në tetë vargjet vijuese?  
Si fillon dhe si mbaron përshkrimi poetik i Strugës?

Ç'kuptim kanë vargjet:

*Ku drunjte me qiellin bëjnë bisedë*

*njerëzit me ujin*

*opale të Obrit*

*atje është Struga*

Ç'kujtime i ngjall poetit Struga?



### *Detyrë*

Nga përshtypjet që keni fituar gjatë një ekskursioni, përshkruani  
vendin më tërheqës dhe më të bukur, që më tepër në psikën tuaj ka  
lënë mbresa. Përqëndrohuni në: pamjen e vendit, bukuritë natyrore,  
shtrirjen gjeografike, pritjet e njerëzve, jeta kulturore në atë vend e  
tjera.

# KUJTIME

---

Në hyrjen juglindore të Vlorës, në kryqëzimin e shumë rrugëve që duke zënë fill nga rruga e Skelës të çonin në qendër të qytetit, në mes të një parku të madh rrethuar me mure të larta tetëmetërshe dhe me dy porta në të ishte konaku i Vlorajve, përfshi këtu edhe haremin dhe selamllëkun. Kurse populli këtë kompleks e quante thjesht “sarajet e beut”. Këtu, më 1 dhjetor 1885 lindi unë, si bir i Syrja bej Vlorës dhe i Mihri hanëm Toptanit. Dhe, siç më tregon nëna, “linda me këmishë”, d.m.th. me fat. Kjo bestytни popullore vërtetë më ka sjellë fat në jetë, por unë kurrë nuk kam qenë i lumtur. Gjatë gjithë jetës mua më ka shoqëruar një frikë e pashpjegueshme, një brengë e brendshme, thujse një makth. Kryeneç dhe i mbyllur në të gjitha situatat e vështira të jetës jam futur në kafkullën time dhe çdo goditje të fatit e kam përballuar jo vetëm pa u trembur, por sidomos edhe pa u emocionuar.

Mbresat e para jetësore që më kujtohen janë mundimet që kam hequr në djep. Këto tortura më thotë mendja kanë vazhduar tri vjetët e para të jetës sime, se ndryshe nuk ka se si më kujtohen me aq qartësi. Kështu u rrita unë – një fëmijë krejt i zakonshëm, po aq i fortë dhe i bukur, po aq i zgjuar dhe budalla, sa edhe shumica e fëmijëve tjerë.

Kur i mbusha katër vjeç, ndodhi një ndryshim i rëndësishëm: nuk do të lahesha më në govatë, por dy herë në javë do të shkoja në hamamin tonë. Aty pasi më zhvishnin në divanin e paradhomës, më ulnin mbi një stol të vogël mermeri. Do të duhet të kem qenë tmerrësisht i ndotur, sepse me të filluar, më hidhnin përsipër ujë të nxehtë – o tmerr, pastaj më sapunisin një dy, tre, katër, pesë herë dhe më shpërlanin. Edhe koka do ta kalonte torturën pesëherëshe. Unë protestoja, bërtisja, por gjithmonë do të dëgjoja të njëjtën gjë: “një herë lahen fukarenjtë, dy herë të vdekurit, tri herë lahet hoxha para namazit, katër herë dhëndri para natës së martesës dhe pesë herë zotërinjtë e mëdhenj”. Tani unë mund të zgjidhja vetë cili doja të isha.

Kur mbusha pesë vjeç, më vunë për të fjetur në një krevat të veçantë. Një ditë babai më mori për dore dhe më çoi në selamllëk ku unë u njoha me dy burra. Njëri ishte një djalosh italian, inxhinier Luigji Bekali nga Mesina, tjetri një shqiptar, Mehmet efendi Lusi, hoxhë i Kaninës. I pari do të ishte mësuesi im i përhershëm, i dyti mësuesi im i fesë. Luigji më pëlqeu menjëherë. Ai ishte dhe mbeti gjithmonë për mua një mik

i dashur dhe një këshilltar i mirë, ndërsa Mehmet efendiu mua dhe kushëririn tim, Servetin, na çonte për namazin e drekës në Xhaminë e Madhe edhe pse unë atëbotë nuk kuptoja gjë prej gjëje nga ky ritual. Vetëm më vonë me myderrizin e mrekullueshëm Jusuf Riza efendiu, arrita ta kuptoj vlerën dhe rëndësinë e fesë.

(fragment nga “Kujtime”)

## ***Shënim***

Fragmenti i dhënë është marrë nga vepra “Kujtime” e Eqrem bej Vlorës. Siç shihet në fragment, autori jep të dhëna për jetën e tij. Veprat e këtilla bëjnë pjesë në llojet letrare shkencore, autobiografike.

Autobiografia – është hartim letrar, ku shkrimtari jep shënime për vetveten.



### ***Fjalor***

hamam - banjo publike

harem - dhomë e grave

sleamllëk - dhomë e burrave

myderriz - profesor i fesë



### ***Bisedë rreth fragmentit***

Pasi ta keni lexuar tekstin, do të keni kuptuar se kemi të bëjmë me shënime autobiografike.

- Kush i jep ato shënime?

- Cilët janë personazhet e fragmentit?



### ***Detyrë***

Hartoni edhe ju një tekst autobiografik.

***Autobiografia** është një lloj tregimi i jetës së një njeriu, shkruar prej atij vetë. Shpesh, ky lloj letrar, ngatërrohet me kujtimet, ditarët, letrat, prandaj është e nevojshme të bëbet dallimi ndërmjet këtyre formave.*

*Ditarët dhe letrat, ndryshe nga kujtimet dhe autobiografitë, nuk janë tregime të zgjeruara e të organizuara, të përgatitura për t’iu paraqitur syve të publikut. Nga ana e tyre, kujtimet lidhen më tepër me ngjarje e personazhe të tjera, sesa me jetën e autorit, kurse autobiografia përqëndrohet në jetën e vet shkrimtarit.*



Edouard Manet - *Flautista*



## VDEKJA E NJË MBRETËRESHE

---

*“Dëgjohet zëri i brirtë, më i buçitshëm, që paralajmëron sulmin e menjëhershëm në këshqjellën e mbretëreshës. Kthehet e çmeritur, e vendos kamxhikun e artë, parzmoren e çunit, thikën dhe gotën e helmit në dollap. I afrohet dritares, vendos duart në skajet e saj dhe u drejtohet pushtuesve, që nuk shihen, me zë të vendosur dhe të lartë”.*

Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbinjt që të pushtoni tokat e mia. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia juaj do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të të pushtuarit. Jo. Nuk na njihni mirë. Ju keni marrë guxim prej fatkeqësisë sime dhe prej urrejtjes suaj. Guximi juaj do të jetë edhe fatkeqësia juaj. Ju do t’i shihni kufijtë e vetes kur t’i kaloni kufijtë. Nuk e dini se prej luleve këtu bëhen shpesh ujqit, prej kaprojve lindin shpesh arinjtë; prej dafinave farkohen shpesh shigjetat, kurse prej medosit bëhet shpesh helmi. Ju nuk e njihni këtë popull. Nuk e duron ai shpatën e të vetit e aq më pak e duron shpatën e të huajit. Ky popull e vë krenarinë mbi lumturinë. Përmbi malet tona fluturojnë shqiponjat dhe prej tyre jemi mësuar të çmojmë mbi çdo gjë tjetër lirinë. Edhe buka na duket e ëmbël, edhe gruri na duket i butë; edhe malet na duken fusha; edhe dimri na duket pranverë vetëm kur jemi të lirë. Ne i kemi këputur gjithmonë prangat dhe do t’i këpusim aq më shpejt prangat tuaja. Si nuk keni mësuar prej ushtarëve të mi? A ka ngjarë ndonjë herë të zini ndonjë rob dhe ta bëni skllav? Jo. Tani mendoni se do ta shtini në duart bazileshën e tyre! Jo. Nuk do ta shtini në duar as të gjallë, as të vdekur. Kufomën e saj do ta lëshojë dheu dhe s’do ta shihni kurrë me sytë tuaj. Do të bindeni se edhe pushtimi juaj do të dëshmojë namin tim. Namin e bazileshës, që s’ju ka lënë kurrë të qetë.

*(I largohet fronit dhe i afrohet bustit të perëndisë Medaurus para të cilit gjunjëzohet dhe fillon të lutet).*

Perëndi? Pse hesht? Fol, së paku sot, mos të shkoj pa ta njohur zërin. Kurrë nuk ta kam dëgjuar fjalën edhe pse kurrë vullnetin tim s’e kam vënë mbi vullnetin tënd. Ti me heshtje e ke drejtuar fatin tim dhe fatin e popullit tim: të keqen dhe të mirën t’i kemi pranuar njësoj. Kurrë s’të kam lutur si sot, sepse kurrë s’kam dashur ta shqetësoj heshtjen tënde. E, sot? Jam pajtuar me vdekjen time, por mos u pajto Ti me pushtimin e popullit tim. Perëndi! Bëj që nami i tij të mos shuhet!

Bëj që nami im të ruhet! Unë do të vdes ashtu si më ka hije: pa më prekur dora e armikut dhe e tradhtarit. Kujdesu që të mos ketë uri dhe etje, që të lulëzojnë pemët dhe të shtohen të korrat, të pjellin bagëtia dhe të shumëzohen bletët, të kenë gjinj nënat dhe të rriten foshnjat. Perëndi! Vetëm Ty të bie në gjunj dhe vetëm Ty të lutem: mallkoj armikun, dënoje tradhëtarin. Dhe mos e harro Laidin tim të vogël, të humbur. Perëndi! Më jep ndjesë herën e fundit, se unë të jap veten.

*(Ia ndërpret lutjen zëri i bririt, që bie shtatë herë, duke paralajmëruar dorëzimin e përgjithshëm edhe të rojtarëve të kështjellës. Mbas zërit të bririt shikon dritare më dritare. Heshtje e plotë. Kur kthehet sheh se valltaret dalin njëra pas tjetrës. Pastaj fillon marsbi triumfues.)*

Të gjithë janë dorëzuar. Tani edhe ato më lanë. Edhe Fari është bërë me ta. Kam mbetur vetëm. Mes luleve më kanë çelur gjarpërinjtë. Kam parë dashurinë edhe atje ku ka qenë urrejtja – si gjithnjë; besnikërinë edhe atje ku ka qenë tradhtia – si gjithnjë. Kam zgjatur dorën që të më nxirret krahu – si gjithnjë; më është dhuruar buzëqeshja e është shikuar froni – si gjithnjë. Unë e vdekur, derisa të tjerët do të jetojnë. Vetëm...

*Rexhep Qosja*

## *Shënim*

Kjo pjesë është marrë nga monodrama me të njëjtin titull, botuar më 1978. Vepra merret me çastet e fundit të mbretëreshës ilire Teuta. Është koha kur e ka humbur luftën me romakët dhe do të humbë edhe fronin. Ajo tani shpalolet shpirtërisht edhe si mbretëreshë edhe si grua.

## *Monodrama*

Monodrama është një vepër dramatike që shfaqet si drama e një personazhi. Në këto vepra dramatike zakonisht nuk ka shumë veprime, por teksti shfaqet si monolog i shpalimit shpirtëror të protagonistit. Kjo lloj drame është e përhapur sot në botë, si element i teatrit modern.



Rexhep Qosja

Rexhep Qosja lindi më 1936 në Vuthaj. Fakultetin Filozofik, degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, i kreu në Prishtinë. Passtudimet i bëri në Beograd e u doktorua në letërsi në Prishtinë. Pak kohë punoi në Radio Prishtinë, pastaj në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Fakultetin Filozofik ishte kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re” etj. Veprat e tij më të rëndësishme janë

: tregimet “Vdekja më vjen prej syve të tillë“ (1974), dramat “Mite të zhveshura”(1978), studimet “Dialogje me shkrimtarë“(1968), “Asdreni – jeta dhe vepra” (1972), “Shkrimtarë dhe periudha” (1975), “Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, II, III” (1984-1986), “Nocione të reja albanologjike”(1983), “Kritika letrare” (1969), “Porosia e madhe” (1986), “Panteoni i rralluar” (1973), “Kontinuitete” (1972), “Çështja shqiptare” (1994) etj. Shkruan prozë, drama, kritikë letrare, ese, artikuj publicistikë etj.

## LIBRI, RADIOJA DHE TELEVIZORI

Luli, e hodhi librin pranë televizorit dhe doli të luante. Radioja që ishte aty pranë zuri ta ngacmonte.

Habitem ç’të duan edhe më njerëzit ty?! – i tha ajo. - ti tashmë je vjetëruar. Pse të lodhen njerëzit mbi shkronjat e tua të imta, kur mund të shtrihen çlirë-çlirë dhe ta dëgjojnë zërin tim?

Edhe ty të shkoi koha, - ndërhyri televizori. – Unë jam fjala e fundit e teknikës. Në mua çdo gjë është e gjallë: edhe shihet edhe dëgjohet. Mrekullia vetë! Ëndërr mijëvjeçare e njerëzimit. Krejt botën i sjell në shtëpi çdo njeriut.

Mos u krekosni kaq shumë, - u tha libri i qetë. – Së pari, kini një çikë nderim për më të vjetrit. Pastaj kujtojeni nga keni dalë. Pa dijen që kam bartur unë ndër shekuj, ju nuk do të zbuloheshit kurë. Dhe, fundja, mua më duan ende njerëzit, sepse jam i pazavendësueshëm...

# INTRENETI

---

Në kabinetin e informatikës mund të gjeni internetin.

Ç'është interneti?

Interneti është një lloj si një bibliotekë e madhe kombëtare, ku ka me mijëra e mijëra libra dhe kur hyn njeriu në të hutohet e nuk di ç` të zgjedhë më parë. Por, për të hyrë në internet duhet të dish e ta kesh të qartë se ç` kërkon. Për këtë mund t`ju ndihmojë arsimtari i informatikës ose ndonjë tjetër që di ta përdorë internetin.

Si mund të kërkosh në internet?

Pasi ke hyrë në internet, ke dy nundësi:

a) Ta kesh të qartë se ç` kërkon. Për këtë gjë të këshillon mësuesja ose arsimtari i gjuhës ose ndonjë shok që ka lexuar një libër interesant e që ke dëshirë edhe ti ta lexosh, p. sh.: Libri për artin (në internet).

b) Nuk njih asnjë website në lidhje me temën që ty të intereson.

Në rastin e parë, kur ti e di adresën, kërkon në `//http.www.artonline.it` dhe këtë duhet ta shkruash te vendi bosh ku shkruhet adresa. Pasi t`i kesh dhënë komandën(enter) nga tastiera, ty do të të shfaqet në ekran (home page) e Website-it, të cilin ti e ke zgjedhur.

- Në rastin e dytë, kurn ti nuk di asnjë adresë, atëherë mund t`u drejtoresh websit-eve. Aty mund të shkruash me pak fjalë ç` kërkon dhe do të të shfaqen në ekran shumë Website, (ueb-sajt), ndërmjet të cilëve ti duhet të zgjedhesh atë që të intereson.

Disa nga këto Websit-e, janë: [www.yahoo.com](http://www.yahoo.com), [www.google.com](http://www.google.com)

Mësoni:            `www` = world – wide – web  
                          bota - e gjerë - rrjeti



NJOHIM  
GJUHËN TONË



# ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET

---

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe ndani fjalët në pjesë më të vogla.

Nëpër një deriçkë të vogël hymë në një kopsht të bukur. Aty më një kënd po rrinte një njeri me kostum pune me duar të përvjela. Ishte ulur mbi një karrige dhe shikonte një gur të gdhendur në trajtë të njeriut. Rrinte pa lëvizur dhe vetëm nganjëherë kruante kokën pas veshit me latues të hekurt.

Prej se përbëhen fjalët?

Si shënohen ato në gjuhën e shkruar?

Teksti është formuar nga bashkimi i disa fjalive, sipas rregullave të gjuhës, ndërsa fjalitë janë formuar nga bashkimi i fjalëve në mes tyre për të shprehur një mendim të caktuar e të përfunduar.

Fjalët janë formuar nga bashkimi i tingujve (fonemave) që janë shënuar me shkronja.

P. sh., fjalët e fjalisë së parë janë formuar nga këto fonema:

**n-ë-p-ë-r, nj-ë, d-e-r-i-ç-k-ë, t-ë, v-o-g-ë-l, h-y-m-ë, n-ë, nj-ë, k-o-p-sh-t, t-ë, b-u-k-u-r.**

Fonemat e shënuara janë **zanore** dhe **bashkëtingëllore**.

Gjuha letrare shqipe ka 36 fonema, që shënohen me 36 shkronja.

Shkronjat radhiten sipas një rendi të caktuar dhe formojnë alfabetin e një gjuhe.

Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?

Shkruajini fonemat e fjalisë së dytë të tekstit të mësipërm dhe i ndani në zanore dhe në bashkëtingëllore.

Zanore janë: \_\_\_\_\_

Bashkëtingëllore janë \_\_\_\_\_

Bashkëtingëlloret ndahen: a) **në të zëshme**: b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh.

b) **të pazëshme**: p, t, th, k, q, f, c, ç, s, sh.

Në gjuhën shqipe përdoret vetëm një bashkëtingëllore e dyfishtë **rr** që është formuar nga një **r** dyfishe. Dallimi i këtyre dy fonemave (**r-rr**) në disa raste shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve.

P.sh.: **arë – arrë, rimë – rrimë** (ne) etj.

A mund të gjeni edhe fjalë të tjera si këto?

Transkriptimi i gjuhës shqipe në gjuhë të tjera bëhet me anë të Alfabetit fonetik ndërkombëtar.

## DISA RREGULLA PËR DREJTSHKRIMIN DHE DREJTSHQIPTIMIN E ZANOREVE DHE TË BASHKËTINGËLLOREVE

### Zanoret

Zanorja e e theksuar

Fjalët që kanë e të theksuar para bashkëtingëlloreve **m, n, nj**, shqiptohen dhe shkruhen me e (e jo me ë) p.sh.: **vend, i shtrembër, qendër, i vendosur, i përqendruar, brenda, gjendje, kuvend, mend, e enjte** etj.

Zanorja ë e theksuar

Shkruhen me ë dhe jo me e fjalët që në gegërishten e veriut kanë â hundore në vend të ë – së, p.sh.: **bëj, dëm, dhëmb, këngë, këngëtar, i (e) ëmbël, lëmë, zë, thëllëzë** etj.

Me u shkruhen në të gjitha rasat emrat dhe mbiemrat që mbarojnë me – **ull, ur**, p.sh.: **akull, kukull-kukulla, kungull, flutur, fluturim, shembull, shembullor, i bukur, hekur** etj.

Po kështu shkruhen edhe fjalët: **tingëlloj, tingëllim, bashkëtingëllore**, si dhe **shëmbëllej**.

Shkruhen dhe shqiptohen me y dhe jo me u fjalët: **frytdhënës, i frytshëm, trysni, virtyt, mysafir, mysliman, lyp, zymbyl** etj.

Shkruhen me i dhe jo me y fjalët: **ai, krimb, krip, kripë, qilim, bilbil, hip, hipje** (jo hypje) etj.

Grupet e zanoreve: **ua, ye, ue**, shkruhen të plota, p.sh.: **muaj, duar, buall; lyej, ngjyey pyes, pyetje; qiell, diell, miell; mësues, dëgjues, ndërtesues** etj.

Bashkëtingëlloret e zëshme **b, d, dh, g, gj, v, z, zh, x, xh**, në trup të fjalës ose në fund të saj shqiptohen si të tilla, p. sh.: **djeg, gaz, hedh** (jo hudh, djek, gas) etj.



Fjalët që fillojnë me **sh, zh, ç** shkruhen: **shfaq, shpall, shtur, shtrydh, zhbllokoj, zhvesh, çorganizoj, çlodhem, çregjistroj, çregulloj, çmallem, çnjerëzor** etj.

### Kujdes!

Kur takohet **g** –ja me **j** –në, shkruhen me **i**, p.sh.: **djegie, shmangie, parathënie, rënie, marrëdhënie** etj.

Kur takohen dy bashkëtingëllore të njëjta, ato ruhen dhe shqiptohen të dyja: **në të pyettë, e gjettë, kënddrejtë** etj.

Kur takohen **r** –ja me **rr** –në dhe **l** –ja me **ll** –në shkruhet vetëm **rr**-ja ose **ll**-ja, p.sh.: **përreth, dembellëk** etj.

Grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj** shkruhen të plota si në fillim, ashtu edhe në trup të fjalës, p.sh.: **thembër, femër, gjemb, kumbull, humb, mbjell; përmendsh, ndërmarrje, asgjekund, kuvend** etj.; **ngjaj, ngjyej, i ngjashëm, tungjatjeta, thëngjill, ungjill** etj.

### MBANI MEND

Gjuha letrare (standarde) shqipe ka 36 fonema (tinguj), që shënohen me 36 shkronja.

Normat e drejtshqiptimit janë po aq të rëndësishme për trajtën e folur të gjuhës letrare sa edhe normat e drejtshkrimit për trajtën e shkruar të saj.

### Ushtrime

Lexoni si duhet fjalët:

dhembje, femër, më dhemb, shembullor, zemër, mendoj, qendror, qengj, vend, vendës, i shtrenjtë.

Shkruani në trajtën e shquar emrat e mëposhtëm:

kala	_____	ide	_____
kafe	_____	hare	_____
shtëpi	_____	qershi	_____
çati	_____	shoqëri	_____
Maqedoni	_____	Shqipëri	_____

Shqiptoni drejt fjalët e mëposhtme dhe shkruani në fletore. (Arsimtari i dikton fjalët, ndërsa nxënësit i shkruajnë në fletore).

çark, qark; çaj, qaj; qep, qepë;

fajësoj, shfajësoj; fryj, shfryj; prish, shprish;

i madh, hedh, hell, mbjell, hënë, hyr, krehër, kthehu, ngrohtë; radhë, rregull, rrëzoj.

Shqiptoni drejt fjalët e mëposhtme:

shtathedhur, meshollë, Mithat, në të pyettë; biologia, lagie, thënie.

**Kujdes!**

Kur takohen dy bashkëtingëllore të njëjta, ato ruhen dhe shqiptohen të dyja.

Kur takohet **s** dhe **t** me shkronjën **h** ruhet shqiptimi i veçuar i tingujve, p.sh.: **meshollë** – lexohet (mes –hollë), **brezhumbur** (brez –humbur).

Kur takohen shkronjat **g** ose **n** me **j**, ruhet shqiptimi i veçuar i tingujve.

Për të mënjeluar shqiptimin e tyre si një tingull në vend të **j** shkruhet **i**, p.sh.: **biologe** – biologia, **pedagoge** – pedagogia: **dibrane** – dibrania; **ngrënie** etj.

## RROKJA, THEKSI, INTONACIONI

Si merremi vesh me njëri – tjetrin?

Ç` përdorim kur flasim?

Po kur shkruajmë?

Lexoni vargjete mëposhtëm dhe vëreni si janë bashkuar fjalët në fjali.

Ndani fjalët në pjesë më të vogla.

“Edhe shtaza po gazmohet,

edhe bari mungullon;

N` shend natyra gjith po çohet,

Veç ti i mjeri, po gjimon”...

Po e analizojmë vetëm vargun e parë të poezisë:

Edhe shtaza po gazmohet.

1. e –dhe shta –za po gaz –mo –het

2. e –dh – e sh –t –a –z – a p –o g –a – z –m – o –h – e –t

Fjala ndahet në pjesë më të vogla: në rrokje: **e –dhe** dhe në fonema: **e – dh –e**, por që të dyja nuk kanë kuptim.

Kur flasim nuk përdorim fonema (tinguj) të veçuara, por të lidhura njëra me tjetrën dhe kështu formohen rrokje, e rrokjet bashkohen ndërmjet tyre dhe formojnë fjalë dhe fjalët fjali.

Shqiptimi i fjalive karakterizohet edhe nga dukuritë e **theksit**, **intonacionit**, **pauzës** (pushimit).

## RROKJA

Rrokja është një grup fonemash të përqendruara rreth një zanoreje. Edhe një zanore e vetme mund të formojë një rrokje, p.sh., fjalët: **ura**, **era** janë fjalë dyrrokëshe: **u –ra** , **e –ra** etj.

Dallojmë dy lloje rrokjesh :

a) Rrokje të **hapura**, kur (fjala) mbaron me zanore: **shtaza** (shta – za), **bari** (ba –ri ), **u –ra** etj. dhe

b) rrokje të **mbyllura**, kur fjala mbaron me bashkëtingëllore: **gazmohet** (gaz –mo –het), **mungullon** (mun –gu –llon).

## THEKSI

Rikujtohuni!

Ç` është theksi dhe sa lloje theksash dallojmë?

Shqiptimi me zë më të fortë ose me ton më të ngritur i një rrokjeje a i një zanoreje në fjalë ose i një fjale a i një pjese të fjalisë për ta dalluar nga të tjerat quhet **theks**.

Dallojmë tri lloje theksash: theksin e fjalës, theksin e fjalisë dhe theksin e insistimit.

**Theksi i fjalës** bie në një rrokje të fjalës:

**në të fundit:** puno, këtu, ajo, liri etj.;

**të parafundit:** shkolla, rrugë, popull etj. dhe

**të tejfundit:** shkollave, rrugëve, populli etj.

Si rregull, **emrat** gjatë lakimit dhe **foljet** gjatë zgjedhimit e **ruajnë theksin mbi të njëjtën rrokje**.

**Theksi i fjalisë** përdoret kur duam të shqiptojmë një gjymtyrë të fjalisë me ton më të lartë për ta vënë në dukje. P.sh.: Të gjithë ishin **mirë** ose **Të gjithë** ishin mirë.

Në fjalitë me fjalë pyetëse theksi bie në fjali pyetëse: Sa erdhën? Ku do të shkosh?

**Theksi i insistimit** përdoret në disa raste kur duam të vlerësojmë një fjalë që shpreh emocion ose bëhet objekt i intonacionit, d.m.th., përdoret një theks i dytë, i cili mund të bjerë në një rrokje tjetër të fjalës, p. sh.:

E pabesueshme është kjo! – foli një njeri.

## INTONACIONI

Ndryshimi i tonit formon intonacionin e fjalisë. Këto ndryshime janë në përputhje me shprehjen e emocioneve dhe të ndjenjave të ndryshme (të gëzimit, zemërimit, shpresës, dyshimit etj.).

Siapas intonacionit mund t`i dallojmë edhe fjalitë.

Shqiptoni me zë të lartë fjalitë e mëposhtme dhe vëreni dallimin e tyre.



Kur do të shkojmë në ekskursion? (intonacion ngjites).



Nesër do të shkojmë në ekskursion.



Shko andej! (intonacion zbritës).

### MBANI MEND

Rrokja është një grup fonemash të përqendruara rreth një zanoreje.

Ajo mund të ndryshojë nga të folurit në të shkruar.

Ka tri lloje theksash:

Theksi i fjalës (çdo fjalë ka theksin e vet),

Theksi i fjalisë (me anë të tonit më të lartë një gjymtyrë vihet në dukje)

Theksi i insistimit (një theks i dytë në fjalë, që shpreh emocion).

### Ushtime

1. Shkruani fjalët dhe vini theksin mbi zanoret e theksuara: bie, shpie, e diel, pyes, i huaj.

2. Shkruani nga një fjali për të shprehur ndjenjat e mëposhtme: gëzim, zemërim, dyshim, admirim.

# SHENJAT E PIKËSIMIT

---

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Çfarë shenjash janë përdorur brenda dhe në fund të fjalive?

Përse, o bir, me gjithë mirësinë time, ti mua më le kështu? Më mirë të kisha vdekur unë përpara dhe ti të mbyllje sytë e mi.

Unë më e moçme e ti në më të mirin motin tënd. Përse deshe kështu i ri të vdesësh, përse nuk më more me vete? Mbasi unë të linda nuk u ndava kurrë prej teje.

Në këtë fragment janë përdorur: **presja, pikëpyetja dhe pika.**

Kur flasim, shpeshherë e ngremë ose e ulim zërin, u japim fjalëve intonacion pyetës ose thirrmos, shprehim kënaqësi, frikë ose inat etj. Të gjitha këto shprehën në të shkruar me anë të shenjave të pikësimit.

Me to sigurohet lexueshmëria dhe qartësia e një teksti.

Shenjat kryesorë të pikësimit janë: **pika, presja, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, dy pikat, tri pikat, viza, thonjëzat, kllapat.**

Ato mund të ndahen në tri grupe:

1. Shenjat e pikësimit që përdoren **në fund të fjalisë**: pika, pikëpyetja, pikëçuditja, tri pikat.

2. Shenjat e pikësimit **brenda fjalisë**: presja, pikëpresja, dy pikat, dhe kllapat.

3. Shenjat e pikësimit që përdoren **në fillim të fjalisë**: viza dhe thonjëzat.

**Pika** shënon intonacion zbritës në një fjali dëftore. Psh.: Unë jam nxënës në klasën e shtatë fillore.

**Pikëçuditja** tregon se fjalia shpreh habi, dhimbje, porosi ose urdhër. Ajo përdoret në fund të fjalive **thirrmore**. Psh.: Rrofsh sa malet! Mos e ndiz dritën!

Përdoret edhe në fjalitë **pyetëse thirrmore** bashkë me **pikëpyetjen** për të shprehur habi ose mosbesim: Ende s'është kthyer vajza?!

**Pikëpyetja** shënon intonacion ngjitës në një **fjali pyetëse të drejtë**. P.sh.: Ç` më thirre? A erdhi dikush?

**Tri pikat** tregojnë që fjalia përmban edhe diçka që nuk është shprehur dhe mendimi mbetet i pambaruar: Tani jam këtu dhe kam një emër tjetër...

## 2. Shenjat që përdoren brenda fjalisë:

**Presja** shënon një pushim të shkurtër brenda fjalisë . Ajo përdoret në fjalitë e thjeshta dhe në fjalitë e përbëra për të ndarë a veçuar gjymtyrë homogjene (kryefjalë, kundrinorë, rrethorë, përcaktorë, në fjalinë e thjeshtë): **Arbeni, Drita** dhe **Arta** ishin në Ohër. Asaj i pëlqente të fliste **për detin, për pyllin, për qiellin** dhe për gjithçka që kishte lidhje me natyrën.

Në fjalinë e përbërë përdoret për të ndarë: pjesët e fjalisë me lidhëza kundërshtore: Ai mësoi shumë, **por** s` pati sukses.

- Pjesët e fjalisë që bashkohen me lidhëza dyshe: **Jo vetëm** që u vonua, **por** nuk kërkoi as falje.

**Pikëpresja** shënon një pushim pak më të gjatë se presja. Ajo zakonisht ndan pjesë të ndryshme të pavarura të një fjalie të përbërë: Ata që na donin, erdhën në dasmë; ata që nuk na donin, nuk erdhën.

**Dy pikat** shënojnë një pushim që zgjat pothuajse sa presja, por ndryshojnë nga ajo, sepse paralajmërojnë një shpjegim. P.sh.: Tani m`u kujtua: borxhin ta ktheva kur erdha nga Amerika.

**Thonjëzat** përdoren për të shënuar titujt e veprave, gazetave, revistave, shkollave, rrugëve, institucioneve etj. P. sh.: Mësoj në gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup.

**Viza** përdoret për të ndarë fjalët e një ose më shumë bashkëbiseduesve në ligjëratën e drejtë. Ajo përdoret edhe për të ndarë fjalët në rrokje në fund të rreshtit.

## Ushtrime

1. Plotësoni fjalitë dhe vini aty ku duhet thonjëzat.

Unë jetoj në rrugën \_\_\_\_\_

Vëllai im mëson në shkollën \_\_\_\_\_

Në televizor pashë filmin \_\_\_\_\_

2. Kopjoni fjalitë dhe vini shenjat e pikësimit.

Kaluan ditët e nxehta Dita e parë e shkollës filloi  
Sa brohoritje e madhe dëgjohet Paskan ardhur disa nxënës të rinj Sa qenke  
rritur Ardit

Cili është atje A kanë ardhur të gjithë  
Zemra i dridhej kur kujtonte vendlindje  
A mos e kishte marrë malli për tingëllimën e zileve  
Shkruani nga tri fjali që të mbarojnë me pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditje.

## EMRI

---

### Emri si njësi morfosintaksore në fjali

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza .

E kujtoj **mësuesin** tim të parë. E kujtoj dhe mallëngjehem. Ne e donim dhe e respektonim shumë .

Ai ishte një **burrë** me **trup** mesatar, i hequr në **fytyrë**. Nuk ish **plak**, po **flokët** i qenë zbardhur.

Fjalët e shkruara me të zeza janë emra. Të gjithë janë emra të përgjithshëm dhe të gjinisë mashkullore, me përjashtim të emrit fytyrë, që është i gjinisë femërore.

## KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

**Emri i përgjithshëm** tregon një frymor a një send të përgjithshëm dhe ka karakteristika të gjinisë dhe të numrit, mund të jetë:

- i gjinisë mashkullore: mësues, burrë, trup, flok etj.,
- i gjinisë femërore: fytyrë, vajzë, mësuese etj.,
- në numrin njëjës: burrë, grua, djalë, vajzë etj.,
- në numrin shumës: burra, gra, djem, vajza etj..

Përdoret vetëm dhe i shoqëruar me fjalë përcaktuese:

- mbiemër apo përemër: djalë **i mirë**, vajzë **e sjellshme**, mësuesi **im** etj.
- Është **bërthamë** e grupit emëror: **burrë** i fortë, **grua** trime, **mësuesi** ynë.

**Emri i përveçëm** tregon një frymor a një send të individualizuar mirë (emra njerëzish, emra vendesh etj.) Emrat e përveçëm shkruhen gjithnjë me shkronjë të madhe: Sami Frashëri, Pelisteri, Baloja etj.

Emrat e përgjithshëm ndahen në:

**Emra konkretë** që tregojnë frymorë njerëz ose kafshë: nënë, baba, dele, drenushë etj. dhe emra jofrymorë që tregojnë objekte ose dukuri: zjarr, stilograf, shkollë etj. dhe

**Emra abstraktë** – emra jofrymorësh, që tregojnë veprime a ide të përgjithshme të gjërave: frikë, gëzim, fjalë etj.

## GJINIA DHE NUMRI I EMRAVE DHE I MBIEMRAVE

### Gjinia dhe numri i emrit

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe nënvizoni emrat.

Ku ta di unë se kush i kishte treguar se në librari gjendej ai libër, në të cilin bëhej fjalë për një princ të lumtur. I kishin thënë se një shkrimtar i vjetër e kishte shkruar atë përrallë për një princ, që në fëmijërinë e tij kishte qenë shumë i varfër.

Vetëm kaq dinte për atë përrallë të atij libri dhe asgjë më tepër. I kishin thënë se, po të kishte dëshirë të mësonte më shumë për jetën e tij, duhej ta blinte librin.

Mirëpo vogëlushi për të cilin po e shkruaj këtë tregim, nuk kishte para. Ishte shumë i varfër, ndoshta edhe më i varfër sesa princi në fëmijërinë e tij. I qe lutur s'ëmës t'i jepte diçka nga shtëpia për të shitur dhe me ato para ta blinte librin, por ajo i ishte përgjigjur se edhe ato plaçka ishin tepër të pakta.

### Gjinia e emrit

Çdo emër ka një gjini të caktuar: **mashkullore, femërore dhe asnjëse**.

Dallimi i gjinisë bëhet duke u mbështetur në **mbaresat** e emrave.

Janë të **gjinisë mashkullore** të gjithë ata emra që në rasën emërore të shquar të numrit njëjës marrin mbaresën **-i** ose **-u**: **djalë-i, zog-u, burrë-i, mal-i, peshk-u, krah,-u** etj.

Janë të **gjinisë femërore** të gjithë ata emra që në rasën emërore të shquar, të numrit njëjës marrin mbaresën **-a**: **vajzë-vajza, lule-lulja, derë-dera, shkollë – shkolla** etj.



Janë të **gjinisë asnjanëse** ata emra që në rasën emërore të shquar njëjës marrin mbaresën –t ose -të: **kryet, të zitë, të kuqtë, të ecurit.**

Emrat e **gjinisë asnjanëse** në shqipen e sotme janë shumë të kufizuar. Këtu hyjnë disa emra të prejardhur nga mbiemrat si: **të kuq-të, të bardhë-t, të zitë,** si dhe emrat foljorë të tipit: **të folurit, të menduarit, të shkruarit.**

Dallimi i gjinisë së emrave bëhet duke u mbështetur në kuptimin e fjalës si dhe në gjininë e mbiemrave dhe të fjalëve të tjera përcaktuese.

### **Kini kujdes!**

1) Disa emra njerëzish a kafshësh si: **daja , axha, Leka, Deda, Kola, Koçoja** lakohen si emrat e gjinisë femërore dhe kur përdoren në fjali në bashkëvjajtje me mbiemra, mbiemrat i marrin format e gjinisë mashkullore. Psh.:

**Leka i Madh** sundoi në shekujt e parë të erës së re.

**Kola** është punëtor i mirë.

Emrat e këtij tipi do të merren si emra të gjinisë mashkullore.

Nga ana tjetër, kemi emra të tillë si: **Fitnet-i, Irin,-i, Antigon,-i,** megjithëse marrin mbaresën -i dhe lakohen si emrat e gjinisë mashkullore, do të merren si emra të gjinisë femërore. Ata shoqërohen me mbiemra të gjinisë femërore: **Fitneti** ishte e **urtë** dhe e **zgjuar.** **Nedreti** është punëtore e **zellshme.**

2) Gjinia e një emri mund të dallohet edhe duke u bazuar në gjininë e fjalëve përcaktuese që i përshtaten emrit: **ky** nxënës, klasë e madhe, motra ime.

- Në ç'gjinë janë grupet emërore të mësipërme?

### **Numri i emrave**

Emri ka dy numra: **numrin njëjës** dhe **numrin shumës.** Kur një emër emërton një objekt, një njeri, një dukuri etj., ai është në numrin njëjës: **mal-mali, zog-zogu, mendim-mendimi.** Kur emërton më shumë se një njeri, objekt, një dukuri, është në numrin shumës: **male-malet, zog-zogitë, mendime-mendimet.**

## **FORMIMI I SHUMËSIT TË EMRAVE**

Emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore e formojnë **numrin shumës** në disa mënyra:

- Duke i shtuar formës së numrit njëjës **mbaresa** të ndryshme nga të cilat më

të përdorshme janë -ë, -a dhe -e. P.sh. një punëtor - **dy punëtorë**, një gur - **dy gurë**, një shok - **dy shokë**, një qytetar - **dy qytetarë**, një drejtor - **dy drejtorë**, një trim - **dy trima**, një shkollë - **dy shkolla**, një vajzë - **dy vajza**, një viç - **dy viça**, një qytet - **dy qytete**, një fis - **dy fise** etj.

Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën -e, dhe -ra, si: **mal-male, vend-vende, fis-fise, ujë -ujëra, djathë-djathëra, fshat-fshatra** kur shoqërohen me mbiemra në numrin shumësi e **ndërrojnë gjininë**, kalojnë nga **gjinia mashkullore në atë femërore**: **mal i lartë- male të larta, vend i bukur-vende të bukura, fshat i ri- fshatra të reja, ujë (uji) i pastër- ujëra të pastra, vaj i mirë- vajra të mira** etj.

- Duke ndërruar tinguj në temën e emrave. Ndërrimet më kryesore janë:

a-e p.sh.: **dash-desh, plak, pleq** etj;

k-q: **bujk- bujq, mik-miq, fik-fiq** etj;

ll-j: **akull-akuj, tingull-tinguj, popull-popuj** etj,

r-j: **lepur-lepuj, bir-bij** etj.

- Duke ndërruar tinguj dhe duke marrë mbareta njëkohësisht. P.sh.; **brëgj- brigje, shteg-shtigje, lak-leqe, rrezik-rreziqe** etj.

- Duke e ruajtur formën e njëjësit: një nxënës- **dy nxënës**, një mësues-dy **mësues**, një mësuese-dy **mësuese**, një kafshë-dy **kafshë** etj.

Disa emra e formojnë shumësin me mbaresën **en** dhe **inj** : **lumë -lumenj, lëmë-lëmenj, por gjarpër-gjarpërinj, shkëmb-shkëmbinj** etj.

## GJINIA DHE NUMRI I MBIEMRAVE

### Gjinia e mbiemrit

Rikujtohuni!

Cila janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?

A ka mbiemri kategori të mëvetësishme apo ato varen nga ato të emrit?

Si e formojnë numrin shumësi mbiemrat?

Analizoni shembujt e mëposhtëm dhe vëreni në se ndryshojnë mbiemrat.

djalë i mirë	vajzë e mirë	djem të mirë	vajza të mira
libër i ri	fletore e re	libra të rinj	fletore të reja
një burrë zemërbardhë	një grua zemërbardhë.		
kënga e fundit	këngës së fundit		

Mbiemri ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin dhe rasën, por të tria këto kategori varen nga gjinia, numri dhe rasia e emrit.

Përshtatja në gjini.

Gjinia femërore e mbiemrave formohet:

- me ndryshimin e nyjës **i** në **e**:

princ i lumtur	princeshë e lumtur
pallat i bukur	shtëpi e bukur

- me mbaresën **-e**

nxënës shembullor	nxënëse shembullore
djalë trim	vajzë trime

me ndryshimin e nyjës **i** në **e** dhe me mbaresën **-e** njëkohësisht

burrë i sjellshëm	grua e sjellshme
-------------------	------------------

### Numri i mbiemrave

Mbiemrat e nyjshëm e formojnë numrin shumë:

- me ndryshimin e nyjës **i** në **të**: stilolaps i kaltër - stilolapsa të kaltër, djalë i qetë - djem të qetë, lumë i rrëmbyer - lumenj të rrëmbyer;

- me **temë të njëjtë** si tema e njëjësit: djalë kokëfortë - djem kokëfortë;

- me ndryshimin e nyjës **i** në **të** dhe me **mbaresën**:

vajzë e pastër - vajza të pastra, fushë e gjerë - fusha të gjera, mal i lartë - male të larta.

Mbiemrat e nyjshëm përshtaten në rasë me emrin duke ndryshuar nyjën.

Në tabelën e mëposhtme po lakojmë emrin djalë dhe vajzë bashkë me mbiemrin i bukur (e bukur). Vëreni ndryshimin e nyjës:

<b>E.</b>	djalë	i	bukur	vajzë	e	bukur
<b>Gj.</b>	i ... djalit	të	bukur	i... vajzës	së	bukur
<b>Dh.</b>	djalit	të	bukur	vajzës	së	bukur
<b>K.</b>	djalin	e	bukur	vajzën	e	bukur
<b>Rr.</b>	prej djalit	të	bukur	prej vajzës	së	bukur

Gjatë lakimit të një mbiemri të nyjshëm mbiemri përshtatet me emrin dhe në rasia të ndryshme ndryshon vetëm nyjën: **i, e të, së**.

## Ushtrime

1. Emrat e mëposhtëm e formojnë shumësin me - ë. Shkruajini ne numrin shumës në trajtën e pashquar.

satelit, magnet, planet, pirun, aeroplan, kamion, filxhan, byrek, dyshek, çiklist, turist.

2. Lidhni emrat me mbiemrat duke pasur parasysh përshtatjen në gjini, numër e rasë.

shokut	të shtruara
lajmi	të asfaltuara
shoqes	i fundit
rrugë	të sjellshme
fshatra	të ngushtë

3. I vini në numrin shumës grupet emërore të mëposhtme.

**Kini kujdes!** Këta emra e formojnë shumësin me mbaresën - e.

Qytet i ri, mal i lartë, aparat matës, vullkan aktiv, vendim i vjetër.

4. Zëvendësoni emrin e gjinisë mashkullore në grupet e mëposhtme me një emër të gjinisë femërore. Shkruani grupin e ri emëror.

plak zemërbardhë	.....
gjysh i thinjur	.....
mësues i guximshëm	.....
gazetar i zoti	.....
burrë i thyer	.....

### MBANI MEND

Emrat kanë tri gjini: gjininë mashkullore, femërore dhe asnjane.

Emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresat shquese -i, -u (djalë,-i, zog,-u etj.);

Emrat e gjinisë femërore marrin mbaresat shquese -a (nënë-nëna etj.);

Emrat e gjinisë asnjane marrin mbaresën -t dhe -të (kryet, të kuqtë etj.).

Shumica e emrave tregojnë frymorë dhe sende që mund të numërohen, prandaj mund të përdoren në të dy numrat: në njëjës dhe në shumës.

Numri shumës i emrave formohet:

- me anë të mbaresave të ndryshme,
- me anë të ndërrimit të tingujve të temës,
- me anë të mbaresave dhe të ndërrimit të tingujve njëkohësisht dhe
- duke ruajtur formën e njëjësit.

### Kujdes !

Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën -e dhe -ra kur shoqërohen prej mbiemrave kalojnë në gjininë femërore (**male të larta, ujëra të pastra**).

## Ushtrime

1. Më poshtë është dhënë një listë emrash të gjinisë femërore. Tregoni cilët emra janë futur gabimisht:

Kalë, nënë, grua, motër, plakë, dajë, bankë, pulë, kuti, shtëpi, hoxhë, Kolë, Nermin.

2. Gjinia e emrit caktohet sipas mbaresës që merr emri në rasën emërore, në trajtën e shquar, në numrin njëjës.

3. Ktheni në numrin shumës emrat e mëposhtëm në trajtën e pashquar:

Ushtar, shofer, fotograf, rosak, kapiten, mikrofon, plep, çelës, gjarpër, shkëmb, fshat, litër, shekull, plak; natë, kërmill, lepur, akull, fik, krushk, peshk, zog, kalë, dash.

Emri vit ka dy shumësa: vjet kur shoqërohet me **numërorë** ose fjalë që tregojnë sasi (pesë vjet, shumë vjet); vite (këto vite, vitet e para).

# PËREMRAT PRONORË DHE TË PACAKTUAR

---

## PËREMRAT PRONORË

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbinjtë që të pushtoni tokat e **mia**. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia **juaj** do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të pushuarit. Jo. Nuk na njihni mirë. Ju keni marrë guxim prej fatkeqësisë **sime** dhe prej urrejtjes **suaj**. Guximi **juaj** do të jetë edhe fatkeqësia **juaj**. Ju do t'i shihni kufijtë e vetes kur t'i kaloni kufijtë.

Fjalët: e **mia**, **juaj**, **sime**, **suaj** janë përemra pronorë.

Përemrat pronorë zëvendësojnë ose përfaqësojnë një emër të përmendur më parë dhe tregojnë se kujt i përket diçka. Përemrat pronorë u përshtaten emrave në gjini, numër dhe vetë, si të tillë i marrin format nëpër rasi.

Përemrat pronorë kanë dy lakime të veçanta:

a) kur përdoren si përcaktues të emrave: Libri **im**, i e librit **tim** etj. dhe

b) kur përdoren më vete: **imi**, i e **timit**, **timit**, **timin** prej **timit**; **imja**, i e **simes**, **simes**, **timen**, prej **simes**.

Përemrat pronorë në gjininë mashkullore kur përdoren më vete në numrin njëjës kanë mbaresën – **i**: **imi**, **yni**, **yti**, **i tiji**, **i saji**, **i tyri**; ndërsa në gjininë femërore marrin mbaresën –**a**: **imja**, **jona**; **jotja**, **juaja**; e **tija**, e **tyrja**, e **saja**.

Në numrin shumës të gjithë përemrat pronorë kanë mbaresën – **t(ë)** dhe disa prej tyre nyjën e përpjare të: të mitë, të miat, tanët . tonat, të tutë, të tuat, tuaja, tuajat, të tjtë, të sajte, të tijat, të sajat, të tyret.

Në vetën e tretë përdoren edhe përemrat pronorë vetvetorë: **i vet**, e **vet**; e **vet**, e **veta**: djali **i vet**- djemtë e **vet**; vajza e **vet**- vajzat e **veta**.

Përemrat pronorë kanë dy lakime të veçanta:

a) kur përdoren si përcaktues të emrave: libri **im**, i e librit **tim**; vajza ime; i e vajzës sime dhe

b) kur përdoren më vete: **imi**, i, e, **timit**, **timin**, prej **timit** ; **imja**, i e **simes**, **simes**, **timen**, (prej) **simes**.

Përemrat pronorë në gjininë mashkullore kur përdoren më vete në numrin njëjës kanë mbaresën –**i**: **imi**, **yni**, **yti**, **i tiji**, **i saji**, **i tyri** etj. Ndërsa në gjininë femërore – **a**: **imja**, **jona**; **jotja**, **juaja**, e **tija**; e **tyrja**, e **saja** etj.

### **Kujdes!**

Duhet pasur kujdes në përdorimin e drejtë të përemrave pronorë.

Kështu shpesh herë

**mund të përdoren gabimisht:**

**time** (Ju përgjigj pyetjes time.)

**tonë** (...nxënësit e klasës tonë.)

**tënde** (...libri i motrës tënde.)

**tuaj** (...nxënësit e klasës tuaj.)

**tonë** (Klasa tonë....)

**tënde** (Shtëpia tënde.)

**Në vend të**

**sime** (Ju përgjigj pyetjes sime.)

**sonë** (...nxënësit e klasës sonë.)

**sate** (...libri i motrës sate.)

**suaj** (...nxënësit e klasës suaj.)

**jonë** (Klasa jonë....)

**jote** (Shtëpia jote.) etj.

### **MBANI MEND**

Përemrat pronorë zëvendësojnë ose përfaqësojnë një emër duke treguar njëkohësisht edhe se kujt i përket objekti i emërtuar nga emri.

Përemrat pronorë përdoren edhe si përcaktorë të një emri, edhe më vete.

Duhet pasur kujdes për të shmangur disa përdorime të gabuara të përemrave pronorë.

## Ushtrime

1. Këto grupe emërore për afër përdorni si grupe emërore për larg: Ky nxënës, kjo nxënëse, këta burra, këto gra.

2. Plotësoni pasqyrën e lakimit të përemrit dëftor i këtillë në numrin njëjës dhe shumës:

<b>E.</b>	një djalë i këtillë	ca djem të këtillë...
<b>Gj.</b>	i, e një djali.....	ca djemve....
<b>Dh.</b>	një djali.....	ca djemve...
<b>K.</b>	një djalë.....	ca djem...
<b>Rr.</b>	(prej) një djali.....	(prej) ca djemve...

3. Plotësoni lakimin e përemrave pronorë.

<b>E.</b>	stilolapsi yt	yti	stilolapsi i saj	i saji
<b>Gj.</b>	i, e stilolapsit tënd	i,e tëndit	i, e stilolapsit të saj	i,e të sajit
<b>Dh.</b>	stilolapsit ....	.....	stilolapsit ....	.....
<b>K.</b>	stilolapsin...	.....	stilolapsin ...	.....
<b>Rr.</b>	(prej) stilolapsit	(prej) ....	(prej) stilolapsit...	(prej)...

4. Me grupet emërore djali im, shoqja ime, nxënësit tanë, atletet tona, formoni fjali sipas shembullit të mëposhtëm:

Motra ime studion në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

5. Plotësoni fjalitë me formën e duhur të përemrave pronorë.

Jepja këto para vëllait ..... Jepja këtë letër motrës.....

Të them të drejtën, më preku thellë fjala .....

Ai menjëherë erdhi përpara shtëpisë .....

Klasa ..... zuri vendin e parë në futboll.

Nëna shkoi me vajzën ..... në Prishtinë.

# PËREMRA TË PACAKTUAR

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç` tregojnë dhe përse përdoren?

Bari mbeti i shtangur me letër dhe florinj në dorë. Nuk dinte se ç`të bënte tani. Ushtari me fytyrë të qeshur i tha fjalët më të rënda që kanë dëgjuar ndonjëherë veshët e mi: Kjo gjë ishte sekrete dhe po të dëgjonte **ndokush**, që të dy mund të mbesin pa kokë!...

- Si t'ia bëj tani? - mendoi edhe pak dhe letrën e futi në kraharor, kurse florinjtë i futi shpejt e shpejt në një gropë në rrënjë të plepit të gjatë qindvjeçar.

Në mbrëmje, kur u kthye grigja në fshat, nisi të pyesë tërthorazi të zotin e shtëpisë, ku bunte atë natë, se cili nga fshatarët ishte më i shkolluari.

- Më i shkolluari?! – u step fshatari. – Çfarë të shkolluarësh! Ne as që kemi parë me sy si duket shkolla.

- Domethënë **askush** nuk di të lexojë në fshat?! – pyeste djaloshi, thujse nuk i besonte.

**Askush..**

As kryeplaku?

As ai.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë përemra të pacaktuar.

**Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyrë të pacaktuar:**

Përemrat të pacaktuar janë: një, njëri, njëra, disa, ca, fare, dikush, ndokush, askush, kurrkush, ndonjë, ndonjëri, ndonjëra etj.

Disa përemra të pacaktuar ndryshojnë sipas gjinisë, si p.sh: njëri – njëra, ndonjëri-ndonjëra, secili-secila, cilido-cilado, të gjithë-të gjitha, tjetri-tjetra etj.

Zakonisht përemrat e pacaktuar që ndryshojnë sipas **gjinisë** edhe **lakohen**. Më poshtë po japim tabelën e lakimit të disa përemrave të pacaktuar.

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
<b>E.</b>	njëri-ndonjëri-secili	njëra-ndonjëra-secila
<b>Gj.</b>	i, e njërit-ndonjërit-secilit	i,e njëres-ndonjëres-secilës
<b>Dh.</b>	njërit-ndonjërit-secilit	njëres-ndonjëres-secilës
<b>K.</b>	njërin-ndonjërin-secilin	njëren – ndonjëren-secilën
<b>Rr.</b>	(prej) njërit-ndonjërit-secilit	(prej) njëres-ndonjëres-secilës



Po ashtu lakohen edhe përemrat e pacaktuar **dikush, kushdo, disa, askush, kurrkush** etj., por pa pësuar ndonjë ndryshim në gjini.

Rasa	dikush	ndokush	disa	askush
E.	dikush	ndokush	disa	askush
Gj.	i, e dikujt	i,e ndokujt	i,e disave	i,e askujt
Dh.	dikujt	ndokujt	disave	askujt
K.	dikë	ndokënd	disa	askënd
Rr.	(prej) dikujt	(prej) ndokujt	(prej) disave	(prej) askujt

Nuk lakohen këta përemra të pacaktuar : **një, ndonjë, shumë, tërë.**

Përemrat e pacaktuar, në përgjithësi **nuk ndryshojnë sipas numrit.**

Disa përemra të pacaktuar kanë **kuptim mohor**, si p.sh.: **askush, kurrkush, asnjë, asnjëri** etj.

## FUNKSIONI I PËREMRAVE TË PACAKTUAR

Disa përemra të pacaktuar përdoren edhe **veç**, edhe **të shoqëruar me emra.**

Kur janë të pashoqëruar me emra, kryejnë funksionin e kryefjalës a të kundrinorit në fjali, si p.sh: **Garat olimpike i ndoqën të gjithë.** (kryefjalë)

Do ta përkrahim **secilin** që punon për të mirë e popullit. (kundrinor i drejtë)

Kur janë të shoqëruar me emra, përdoren si përcaktorë të grupit emëror:

Garat olimpike i ndoqën **të gjithë** nxënësit e shkollës sonë.

### MBANI MEND

Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyrë të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar nuk ndryshojnë sipas numrit.

Përemrat e pacaktuar gjithë dhe kurrë, kur përdoren si pjesë e parë e fjalëve të përbëra, ë-ja në fund të kësaj pjese nuk shkruhet. Pra jo gjithëçka, kurrëgjë, por: gjithçka, gjithsecili, gjithfarë, kurrëgjë, kurrkush.

Ndërkaq përemrat e pacaktuar njëri-tjetri dhe shoqi –shoqin shkruhen me vizë në mes.

## Ushtrime

1. Secilën fjali pyetëse bashkoheni me vijë me përgjigjen e saj.

Kush foli në mbledhjen e prindërve?	Ai kishte qenë nxënës i at Gjergj Fishtës.
Kë rrethuan fëmijët?	Ata i dhuruan lule mësueses.
Kujt i dhuruan lule ata?	Fëmijët rrethuan shkrimtarin.
Nxënës i kujt kishte qenë ai?	Në mbledhjen e prindërve foli kujdestari i klasës.

2. Në cilat raste janë përdorur gabim përemrat pyetës? Pse janë përdorime të gabuara?

Kush erdhën dje?

Cilët nxënës erdhën dje?

Kush nxënës erdhi me vonesë?

Kush erdhi me vonesë?

Kujt nxënëse i humbi stilolapsi?

Kush djalë u kthye?

Kush u kthye?

Cili i kthye?

3. Formoni nga një fjali me përemrat e pacaktuar të mëposhtëm:

njëri, ndonjëra, secila, dikush, asnjë, të gjithë.

4. Nënvizojini përemrat e pacaktuar dhe thoni ç`funktion kryejnë në fjali.

Dikush mori guximin, foli me dikë dhe po zbriste poshtë shkallëve. Babai më zgjati dorën dhe ra në karrige si i shtyrë prej dikujt. Lëre që nuk shohim fare, po s`kemi as nga të dalim, sikur të na ndodhë ndonjë e papritur. Do të të tregoj diçka, që s`ia kam treguar askujt deri më sot, - foli me zë të ulët plaku. Tani atë e njihte gjithë vendi dhe ishte e natyrshme që gjithë qytetit të tij i përkiste më tepër se kujtdo të krenohej me të.

# NUMËRORI

---

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç` tregojnë ato ?

Sulltan Murati me **40 mijë** këmbës e me **60 mijë** kalorës, ra përpara Krujës më 1448 dhe bëri qark qytetin. Nga ana tjetër, Skënderbeu me **80 mijë** njerëz, vetëm derdhej për së jashti me ushtrinë armike...

Fjalët e shkruara me të zeza janë numërorë.

Numërori tregon sasi të caktuar frymorësh a sendesh ose pjesë të sendeve .

Kur është i shoqëruar me emër, tregon sasi të caktuar frymorësh ose sendesh.

Psh.: **dy** djem - **dy** vajza, **pesë** libra - **pesë** fletore etj.

Kur nuk shoqërohet me ndonjë emër, sidomos në veprimet aritmetike, atëherë tregon numra:

$$60: 3 = 20 ; 22 + 88 = 110 ; 87 - 26 = 61 \text{ etj.}$$

Numërori përdoret edhe për të treguar datën ose orën :

Ka lindur më 25 maj 1977.

Do të takohemi në orën 10.30.

Kur tregon sasi për të cilën është folur më parë, atëherë para numërorit vihet **njja të**, p.sh.: **Të dy** astronautët u kthyen shëndoshë e mirë.

Numërori nuk ka kategori të gjinisë.

Vetëm numërori **tre** del edhe me trajtën e gjinisë femërore **tri**: tre djem – tri vajza.

**Numërorët** janë:

- të thjeshtë : një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë...dhjetë;

- të përngjitur : njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë e deri në njëzet, si dhe tridhjetë, dyzet...njëqind etj., të cilët shkruhen bashkë dhe

- shprehje : njëzet e njëqind e pesëdhjetë e nëntë, një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre etj., të cilët shkruhen ndaras .

Ka edhe numërorë që nuk tregojnë njësi të plota , por pjesë të njësisë. Këto janë thyesat :

Një e treta (  $1/3$  ), pesë të dhjetat (  $5/10$  ) dy të katërtat (  $2/4$  ) etj.

Thyesat dalin gjithmonë në gjininë femërore dhe lakohen në trajtën e shquar.

Psh.:  $2/6$

E. dy të gjashtat

Gj. i, e dy të gjashtave

Dh . dy të gjashtave  $\frac{2}{6}$

K. dy të gjashtat

Rr. ( prej ) dy të gjashtave



# FOLJA

---

## KLASIFIKIMI I FOLJEVE NË ZGJEDHIME

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'emërtojnë ato?

Unë nuk e **di** i cilës ushtrie **je** ti, sepse asnjëherë nuk i **kam njohur** rrobat e ushtrisë dhe tani **jam** shumë plakë për t'i mësuar, por ti **je** i huaj dhe i një prej atyre ushtrive që na **kanë vrarë**. Ti **ke** zanatin e mallkuar të luftës dhe **je** një prej atyre që më **kanë bërë** mua gjysmënjeriu, një copë plakë të shushatur, që **vjen** në këtë dasmë të huaj dhe **rri** në qoshe dhe **lëviz** buzët, duke biseduar me ty. Asnjëri nuk **di** ç'them unë, sepse të gjithë **janë** shumë të gëzuar dhe unë nuk **dua** t'ua **prish** gëzimin të tjerëve.

Me siguri vërejtët se fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë folje.

Fjalët që emërtojnë një veprim, një punë a ndodhi ose një të qenë të kryefjalës quhen folje.

Foljet janë pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që ndryshojnë në **kohë, mënyrë, vetë e diatezë**. Folja përbën bërthamën kryesore të fjalisë. Çdo folje në gjuhën shqipe ka një **trajtë përfaqësuese** e cila jepet edhe në fjalorë.

Si trajtë përfaqësuese e foljes merret veta e parë njëjës e kohës së tashme të mënyrës dëftore në formën veprare. P.sh.: trajta përfaqësuese e foljes **kam njohur** është **njoh**. Ndërsa trajta përfaqësuese e foljes **kam shkruar** është **shkruaj**. Kjo formohet nga **tema shkrua + mbaresa j**.

Sipas temës dhe mbaresave që marrin në trajtën përfaqësuese foljet ndahen në tri zgjedhime:

Zgjedhimi i **parë** përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në **zanore** dhe marrin mbaresën **j**. P.sh: **lexo-j, la-j, gje-j, pëlqe-j, shkrua-j, lye-j** etj.

Zgjedhimi i **dytë** përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në

bashkëtingëllore dhe nuk marrin asnjë mbaresë në të tria vetat e njëjësit. P.sh.: **Hap, kap, mbyll, mbush, qesh, lodh, rrit** etj.

Zgjedhimi i **tretë** përfshin një numër të kufizuar foljesh që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në zanore dhe nuk marrin asnjë mbaresë. P.sh.: **Pi, fle, di, lë, vë, zë, shpie** etj.

Më poshtë po japim një pasqyrë për tri zgjedhimet e foljeve.

Koha e tashme e mënyrës dëftore (forma veprore)

Nr.	Veta	Zgjedhimi I	Zgjedhimi II	Zgjedhimi i III
<b>Njëjës</b>	unë	mësoj -j	mbyll -	lë -
	ti	mëson -n	mbyll -	lë -
	ai, ajo	mëson -n	mbyll -	lë -
<b>Shumës</b>	ne	mësojmë -jmë	mbyllim -im	lëmë -më
	ju	mësoni -ni	mbyllni -ni	lini -ni
	ata, ato	mësojnë -në	mbyllin -in	lënë në

## FOLJET E PARREGULLTA

Në gjuhën tonë, përveç foljeve të rregullta që klasifikohen në zgjedhime, ka edhe disa folje që quhen **të parregullta**. Disa nga këto folje temën e së kryerës së thjeshtë dhe të pjesores e kanë krejt ndryshe nga tema e trajtës përfaqësuese. Të tilla janë, p.sh. foljet e mëposhtme:

**Tema e trajtës  
përfaqësuese**

shoh  
jap  
bie  
ha  
jam  
kam  
rri  
vij  
bie

**Tema e së kryerës  
së thjeshtë**

pashë  
dhashë  
rashë  
hëngra  
qeshë  
pata  
ndenja  
erdha  
prura

**Tema  
e pjesores**

parë  
dhënë  
rënë  
ngrënë  
qenë  
pasur  
ndenjur  
ardhur  
prurë

Përveç këtyre foljeve ka edhe disa folje **të tjera të parregullta** të cilat pësojnë ndryshime aq të mëdha në tinguj, saqë nuk mund të bëjnë pjesë në asnjë nga këto tri zgjedhime. Psh.:

dua, do, do	desha	dashur
them, thua, thotë	thashë	thënë etj.

Më poshtë po japim një pasqyrë të zgjedhimit të disa foljeve të parregullta në kohën e tashme të mënyrës dëftore, në formën veprare.

### F o l j e t

Nr.	Veta	shoh	jap	bie	rri	ha	jam	kam
<b>Njëjës</b>	unë	shoh	jap	bie	rri	ha	jam	kam
	ti	sheh	jep	bie	rri	ha	je	ke
	ai, ajo	sheh	jep	bie	rri	ha	është	ka
<b>Shumës</b>	ne	shohim	japim	biem	rrimë	hamë	jemi	kemi
	ju	shihni	jepni	bini	rrini	hani	jeni	keni
	ata, ato	shohin	japin	bien	rrinë	hanë	janë	kanë

#### MBANI MEND

Foljet emërtojnë (tregojnë) një **veprim** a **një gjendje** të **një njeriu**, të **një kafshe** a të **një gjëje**. Foljet gjatë përdorimit të tyre marrin një varg formash.

Pjesa e pandryshueshme e foljes quhet **temë**, ndërsa pjesët shtesë, sipas vetës numrit dhe kohës, quhen **mbaresa**.

Për të përcaktuar në cilin zgjedhim përfshihet një folje do të nisemi nga **trajta e saj përfaqësuese** (forma veprare, mënyra dëftore, koha e tashme, veta e parë, numri njëjës). Foljet ndahen në **tri zgjedhime**:

**Zgjedhimit të parë** i takojnë të gjitha foljet që në **trajtën përfaqësuese** dalin me **temë në zanore** dhe marrin **mbarësën j**.

**Zgjedhimit të dytë** i takojnë të gjitha foljet që në **trajtën përfaqësuese** dalin me **temë në bashkëtingëllore** dhe nuk marrin asnjë **mbarësë** në të tria vetat e numrit njëjës.

**Zgjedhimit të tretë** i takojnë foljet që në **trajtën përfaqësuese** dalin me **temë në zanore** dhe në të tria vetat e njëjësit nuk marrin asnjë **mbarësë**.

**Foljet e parregullta** nuk mund të përfshihen në asnjë nga tri zgjedhimet, sepse **temën e së kryerës së thjeshtë** dhe **të pjesores** e kanë krejt të ndryshme nga tema e trajtës përfaqësuese dhe pësojnë ndryshime të mëdha gjatë zgjedhimit.

## Ushtrime

Lexoni tekstin “Dasma” dhe nxirrni nga dy folje të secilit zgjedhim. Zgjedhijini ato në kohën e tashme.

Ndani në zgjedhime foljet e mëposhtme; zë, hip, ngarkoj, qesh, hyj, dërgoj, kërkoj, nxjerr, mbush, përmbush dhe tregoni arsyen.

## FOLJET KALIMTARE DHE JOKALIMTARE

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe gjeni foljet . Vëreni me kujdes funksionin e tyre. Vallë veprimi i tyre mbetet tek ai që e kryen ( kryefjala ) apo kalon e bie mbi një person a send tjetër?

Afërdita, pasi mbaroi letrën , hodhi vështrimin jashtë nga dritarja dhe sytë i ranë mbi kodrën ku ngrihej shkolla e re. Bënte sikur shihte shkollën, po në të vërtetë mendonte problemin e madh të krijimit të familjes...

Foljet mbaroi, hodhi , bënte , shihte , mendonte janë kalimtare, sepse veprimi që e kryen kryefjala ( Afërdita ) kalon mbi një send tjetër ( letrën , vështrimin , shkollën , problemin \_ , d.m.th. mbi kundrinorin e drejtë.

Foljet që pranojnë një kundrinor të drejtë janë folje kalimtare të drejta . P.sh.: Ajo e lexoi hartimin para nxënësve të klasës . Kopshtari i ujit pemët .

Foljet që mund të marrin kundrinor të zhdrejtë janë folje kalimtare të zhdrejta. P.sh.: Korrieri u përkul me nderim dhe i hipi kalit .

Foljet jokalmtare janë ato që nuk pranojnë kundrinor, d.m.th. veprimi mbetet tek ai që e kryen. Të tilla janë :fle, rri,dal,eci,hyj,shkoj etj. P.sh.: Ata nuk flinin tërë natën e nuk bisedonin fare.

Beni shkoi në Tetovë.

Po ka edhe disa folje që përdoren herë si kalimtare,herë si jokalmtare. Për t`i dalluar se cilit grup i përkasin duhet parë se në ç` kuptim janë përdorur .

Kalmtare                      Jokalmtare

Genta filloi transmetimin e emisionit . Mësimi fillon në orën 8.

Motra e shkoi perin në gjilpërë.                      Agimi shkon në shkollë herët.

## FORMAT VEPRORE DHE JOVEPRORE TË FOLJEVE

Lexoni me vëmendje fjalitë e mëposhtme, analizoni domethënien dhe formën e foljeve të shkruara me shkronja të zeza.



Alba e uli kokën dhe filloi të shkruante letrën. Në letër ajo pasqyroj të gjithë ngjarjen. Pasi e mbaroi mësuasi i tha që ta lexonte letrën. Letra ishte shkruar bukur dhe u pëlqye shumë nga të gjithë. Edhe kësaj herë Alba u lavdërua nga mësuasi.

Foljet uli, filloi të shkruante, pasqyroj, lexonte janë në formën veprorë, sepse tregojnë veprime që i kryejnë kryefjalët Alba dhe mësuasi e që bien mbi kundrinorët e drejtë

(kokën, ngjarjen, letrën) të cilët mund t'i gjejmë me pyetjet: kë?, cilën?, çfarë? Që ja bëjmë foljes- kallëzues. P.sh.: Alba e uli kokën. Kë e uli Alba?-Kokën.

Ndërsa foljet ishte shkruar, u pëlqye, u lavdërua, janë të formës joveprorë, sepse tregojnë veprime që kryhen prej dikujt tjetër dhe që e pëson kryefjala (Alba).

Pra, foljet në përgjithësi veprimin e shprehin në dy forma: në formën veprorë dhe formën joveprorë.

Këto dy forma dallohen njëra nga tjetra:

1. nga mbaresat e ndryshme që marrin foljet në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer të mënyrës dëftore.

2. nga përdorimi ose jo i pjesëzës u para foljes në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore dhe

nga foljet ndihmëse kam për formën veprorë e jam për formën joveprorë që përdoren për të formuar kohët e përbëra p.sh. kohën e kryer, më se të kryer etj.

### Pasqyra e zgjedhimit të foljes mësoj në mënyrën dëftore

		Koha e tashme		Koha e kryer e thjeshtë	
Numri	Veta	Forma veprorë	Forma joveprorë	Forma veprorë	Forma joveprorë
Njëjës	unë	mësoj	mësohem	mësova	u mësova
	ti	mëson	mësohesh	mësove	u mësove
	ai, ajo	mëson	mësohet	mësoi	u mësoi
Shumës	ne	mësojmë	mësohemi	mësuam	u mësuam
	ju	mësoni	mësoheni	mësuar	u mësuar
	ata, ato	mësojnë	mësohen	mësuan	u mësuan

		Koha e kryer		Koha më se e kryer	
Numri	Veta	Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	kam mësuar	jam mësuar	kisha mësuar	isha mësuar
	ti	ke mësuar	je mësuar	kishe mësuar	ishe mësuar
	ai, ajo	ka mësuar	është mësuar	kishte mësuar	ishte mësuar
Shumës	ne	kemi mësuar	jemi mësuar	kishim mësuar	ishim mësuar
	ju	keni mësuar	jeni mësuar	kishit mësuar	ishit mësuar
	ata, ato	kanë mësuar	janë mësuar	kishin mësuar	ishin mësuar

### MBANI MEND

Foljet veprimin e tyre e shprehin në **dy forma**: në **formën veprore** dhe **joveprore**.

Këto dy forma dallohen ndërmjet tyre nga: **mbaresat foljore**, nga pjesëza **u** në të kryerën të thjeshtë dhe nga **folja ndihmëse** që përdoret në **kohët e përbëra**: **kam** për **formën veprore** dhe **jam** për **formën joveprore**.

### Ushtrime

1. Foljet e mëposhtme të formës veprore i ktheni në formën joveprore, si p.sh.:  
laj, pyes, gëzoj, mendoj.

2. Shkruani fjali të tilla që fjalët me shkronja të zeza të përdoren si kryefjalë.  
Si ndryshon forma e foljeve?

Nxënësit e klasës sonë e vizituan **ekspozitën e librave**.

Dita e mësuesit “7 Marsi” do të festohet nga të gjithë **nxënësit**.

Ardiani ndërtoi **një shtëpi të madhe**.

3. Dalloni foljet në fjalitë e mëposhtme. Thoni në ç'mënyrë e në ç'kohë janë ato?

Mjegulla u shkri.

Bënte vapë.

Deti shkëlqente nga rrezet e fundit të diellit flakë.

Në vjeshtë gjëmon.

Tërë ditën veson.

# MËNYRA LIDHORE DHE KOHËT E SAJ

---

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza.  
Ç` janë ato? Krahasojini me ato të shkruara me shkronja të pjerrëta.

Sokol,

Letrën ta *vonova*, se **të prisnim**, por ti s` paske mundësi që **të na vish**. Kjo na *dëshpëroi* jo vetëm mua me nënën e me gjyshin, por edhe me shokët. Ne **të prisnim** me padurim, Tani *dashke* të **të tregoj** ndonjë gjë për fshatin. Po **të shkruaj**, por me zemër të thyer, pse s` na *erdhe*.

Fjalët e shkruara me të zeza dhe ato me shkronja të pjerrëta janë folje në mënyra të ndryshme dhe tregojnë një veprim që kryhet në të tashmen ose në të kaluarën.

Foljet e shkruara me të zeza janë në mënyrën lidhore.

Me anë të mënyrës lidhore folësi e tregon veprimin e shprehur nga folja si të mundshëm, të dëshirueshëm ose të detyrueshëm.

Mënyra lidhore ka dy kohë të thjeshta: të tashmen dhe të pakryerën dhe dy kohë të përbëra: të kryerën dhe më se të kryerën.

Më poshtë po japim pasqyrën e zgjedhimit të foljeve kam, jam dhe të disa foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë dhe të tretë.

	kam	jam	laj	kap	di
	1. të kem	të jem	të laj	të kap	të di
	2. të kesh	të jesh	të lash	të kapësh	të dish
	3. të ketë	të jetë	të lajë	të kapë	të dijë
E tashme	1. të kemi	të jemi	të lajmë	të kapim	të dimë
	2. të keni	të jeni	të lani	të kapni	të dini
	3. të kenë	të jenë	të lajnë	të kapin	të dinë

E pakryera	1.	të kisha	të isha	të laja	të kapja	të dija
	2.	të kishë	të ishe	të laje	të kapje	të dije
	3.	të kishte	të ishte	të lante	të kapte	të dinte
	1.	të kishim	të ishim	të lanim	të kapnim	të dinim
	2.	të kishit	të ishit	të lanit	të kapnit	të dinit
	3.	të kishin	të ishin	të lanin	të kapnin	të dinin

E kryer	1.	të kem pasur	të kem qenë	të kem larë	të kem kapur	të kem ditur
	2.	të kesh pasur	të kesh qenë	të kesh larë	të kesh kapur	të kesh ditur
	3.	të ketë pasur	të ketë qenë	të ketë larë	të ketë kapur	të ketë ditur

Më se e kryer	1.	të kisha pasur	të kisha qenë	të kisha larë	të kisha kapur	të kisha ditur
	2.	të kishë pasur	të kishë qenë	të kishë larë	të kishë kapur	të kishë ditur
	3.	të kishte pasur	të kishte qenë	të kishte larë	të kishte kapur	të kishte ditur
	1.	të kishim pasur	të kishim qenë	të kishim larë	të kishim kapur	të kishim ditur
	2.	të kishit pasur	të kishit qenë	të kishit larë	të kishit kapur	të kishit ditur
	3.	të kishin pasur	të kishin qenë	të kishin larë	të kishin kapur	të kishin ditur

### MBANI MEND

Në vetën e tretë njëjës të së tashmes së lidhores të gjitha foljet, pa përjashtim, kanë ë fundore (ai, ajo të mësojë, të lajë, të hapë et.).

- Veta e dytë njëjës e foljeve të zgjedhimit të dytë formohet me mbaresën - ësh: ti, ti të mbjellësh, ti të hapësh, ti të mbyllësh etj.

- Foljet: lë, përzë, vë, zë, nxë, kanë këtë formë në vetën e tretë njëjës të së tashmes së lidhores: të lërë, të përzërë, të vërë, të nxërë. Ndërsa foljet fle dhe ngre, kanë formën: të flejë, të ngrejë.

# PËRDORIMI I MËNYRËS LIDHORE

Me anë të mënyrës lidhore, folësi e praqet veprimin e shprehur nga folja si të mundshëm, të dëshirueshëm, ose të detyrueshëm. Foljet në këtë mënyrë shoqërohen shpesh nga foljet **mund** e **duhet**.

## a) Përdorimi i mënyrës lidhore në fjalinë e thjeshtë.

Folja në mënyrën lidhore përdoret për të shprehur mundësi:

- në fjali pyetëse të drejta - Kush të jetë kaq vonë?
- në fjali thirrmore: - Ta ketë bërë këtë gjë Genci?!
- për të shprehur mundësi a detyrim: me vlerën e mënyrës urdhërore: Të rrih këtu! Të më presësh mua gjer sa të vij! Të rrimë shtrembët e të flasim drejt.
- Këtë punë ta mbarosh sa më parë!
  - me vlerën e mënyrës dëshirore:
  - Të rrosh e t' i gëzosh rrobat e reja!
  - Të rrojë sa malet!

## b) Përdorimi i mënyrës lidhore në pjesën e nënrenditur të fjalisë së përbërë.

Në pjesën e nënrenditur përdoret shpesh për të shprehur rrethana dhe na del në funksion të një rrethanori :

- të kohës: Pastaj, si ta mbarojmë punën, do të shkojmë në stadium..
- të vendit: Ngado që të shkoje, shihje mjerim.
- të mënyrës: Ata silleshin si të ishin fëmijë.
- të qëllimit: Filluan të shpejtojnë që të arrijnë në kohë në shkollë.

Po ashtu përdoret për të shprehur edhe raporte të tjera si:

- kushtore: Po të dëgjosh mësuesin, punën do ta kesh mirë .
- lejore: Edhe vëlla ta kishe, nuk do ta donte aq shumë.
- kundrinore: Edhe ne kemi qejf të shkojmë në shëtitje.

Me përjashtim të pjesës së nënrenditur qëllimore, ku është i detyrueshëm përdorimi i mënyrës lidhore të foljes, te pjesët e tjera të nënrenditura mund të përdoret edhe mënyra dëftore, varësisht nga ajo se ç` dëshiron të shprehë folësi një fakt real që është kryer ose kryhet me siguri, apo një fakt të mundshëm, të dëshirueshëm.

Në mënyrën lidhore përdoren foljet ndihmëse kam dhe jam për të sajuar format e përbëra të foljes: **kohën e kryer**: të kem pasur, të kem qenë, të kem larë, të kem ditur etj. dhe **më se të kryerën**: të kisha pasur, të kisha qenë, të kisha larë- të isha larë, të kisha ditur etj.

Në mënyrën lidhore përdoren edhe foljet gjysmëndihmëse : mund, duhet, do, për të paraqitur një veprim të shprehur nga folja themelore si të mundshëm, të lejueshëm, të detyrueshëm. P. sh.: Shoqet e tua mund të presin edhe pak.

Detyrat duhet bërë me kujdes. Po ashtu përdoren edhe folje të tjera gjysmë ndihmëse, si: filloj, nis, zë, vazhdoj, mbaroj, pushoj, që përdoren për të shprehur fillimin, vazhdimin ose mbarimin e veprimit të emërtuar nga folja që vjen pas dhe që është themelorja: Atë ditë nisi të binte shi pa pushuar. Ata filluan të punojnë me seriozitet të madh dhe e vazhduan punën gjer në fund.

### Ushtrime

1. Shkruani nga një fjali të thjeshtë me folje në mënyrën lidhore, që të shprehin: urdhër, mallkim, hidhërim.

a) Dalloni foljet në mënyrën lidhore dhe tregoni se në ç` funksion është përdorur pjesa e nënrenditur.

Prindërit e kanë për detyrë të kujdesen për shëndetin e fëmijëve të vet. Ngado që t`i hidhje sytë shikoje vetëm gjelbërim. Po ta njihje mirë, do të flisje ndryshe për të. Po të ishe nisur me kohë, do të shkonim bashkë.

b) Dalloni foljet ndihmëse dhe foljet gjysmëndihmëse.

Nga qielli i përhirtë nisi të derdhej dëborë e parë. S`kishim bërë as njëqind metra duke ecur mbi dëborën që kishte rënë atë ditë, kur atje tej ia behu një lepur. Dasma duhet të kishte arritur kulmin e saj. Orkestra vazhonte të luante pa pushim.

2. Zgjedhoni foljet e mëposhtme në të tashmen dhe në të pakryerën e mënyrës dëftore dhe lidhore: blej, shes.

E tashmja e dëftores blej , shes .....	E tashmja e lidhores të blej , të shes .....	E pakryera e dëftores blija, shitja .....	E pakr. E lidhores të blija , të shitja .....
--	--	---	---

3. Zgjedhoni këto folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore, sipas shembullit:

Unë ngre, ti ngre, ai ngre; ne ngremë, ju ngrini, ata ngrenë.  
fle, pi, rri.

# KRYEFJALA DHE KALLËZUESI

---

## KRYEFJALA

### Grupi i kryefjalës

#### Rikujtohuni !

Cilat janë gjymtyrët kryesore të fjalisë? Po gjymtyrët e dyta (plotësuese)?

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Gjeni fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra.

Vapë e madhe. Pushimet po mbarojnë. Drita është sa e lumtur, aq edhe e pikëlluar. Ajo bëri shëtitjen e fundit nëpër fshat. Me shumë mbresa e kujtime largohen nga fshati. Kudo mbretëronte qetësi e madhe. Lart në qiell lundronin dy tri re si floku i dëborës. Një herë e lehtë i lëvizte ato, ashtu siç e lëvizin anijen valët e detit. U err. Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë. Do bjerrë shi.

Ky tekst përbëhet nga fjali të thjeshta dhe të përbëra. Dy fjalitë e para dhe dy të fundit janë fjali të thjeshta, por me strukturë (ndërtim) të ndryshme.

Fjalia e parë **Vapë e madhe** ka vetëm një gjymtyrë kryesore që shprehet me një grup emëror (togfjalësh emëror).

Fjalia **U err** po ashtu shprehet vetëm me një gjymtyrë kryesore, me folje-kallëzuesin.

Ndërkaq fjalia **Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë** përbëhet nga kryefjala + kallëzuesi + rrethanori. Fjalia **Një errë e lehtë i lëvizte ato, ashtu siç e lëviznin anijen valët e detit** është fjali e përbërë dhe përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa I —————Pjesa II

Sipas ndërtimit fjalitë ndahen në të thjeshta dhe në fjali të përbëra.

Tipi më i zakonshëm i fjalisë së thjeshtë është fjalia dykryegjymtyrëshe e cila përbëhet nga kryefjala dhe kallëzuesi. **P.sh.:** *Pushimet po mbarojnë.* (Pushimet



–kryefjalë, po mbarojnë –kallëzues), që janë gjymtyrë kryesore-bërthama të fjalisë.

Fjalja e thjeshtë mund të zgjerohet edhe me gjymtyrë të dyta. **P.sh.:** *Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë.* Në këtë fjali kemi kryefjalën (Një mjegull) + përcaktorin (e bardhë) + kallëzuesin (lundron) + rrethanorin (mbi luginë).

Pra kjo fjali përbëhet nga dy grupe fjalësh, nga grupi emëror (GE) dhe nga grupi foljor (GF).

Skematikisht struktura e fjalisë së thjeshtë mund të paraqitet kështu:

GE 1: Një mjegull e bardhë                      GF: lundron mbi luginë



Nga shembujt e mësipërm shihet se fjalët e shkruara me të zeza janë kryefjalë në fjali.

### Roli i kryefjalës në fjali

Ç` rol luan kryefjala në fjali?

Kryefjala luan rolin kryesor në fjali. Ajo është pjesë e domosdoshme që duhet të njihet, sepse prej saj fillojnë lidhjet e fjalëve të tjera, e sidomos ajo e foljes (kallëzuesit), e cila duhet t`i përshtatet kryefjalës. P. sh.: *Nxënësi mëson. Nxënësit mësojnë.*



Kryefjala gjendet me anë të pyetjeve që ia parashtrojmë kallëzuesit: Kush? (për njerëz në numrin njëjës: Kush mëson?- Nxënësi), Cili? , Cila?, Cilët?, Cilat ? (për frymorë e sende: Cilët mësojnë? -Nxënësit) dhe Ç`?, Çfarë? (për sende).

b ) Kryefjala përbën **temën e njoftimit** që jepet nëpërmjet të fjalisë, pra **tregon atë për të cilën bëhet fjalë në fjali**.

Folja përfaqëson kallëzuesin (remën), pra atë që thuhet për kryefjalën (temën).

c) Kryefjala e një foljeje në formën veprorë tregon vepruesin (atë që kryen veprimin), P. sh.: Plaku zemërbardhë (tema: ajo për të cilin bëhet fjalë) i donte fëmijët (rema-kallëzuesi: ajo që thuhet për temën).

## Veçoritë e kryefjalës

a) **Vendi i kryefjalës në fjali**.

Ajo ndodhet shpesh para foljes:

**Rrezet** e diellit pranveror *u derdhën* mbi majat e thepësura të maleve.

Por, kur duam ta theksojmë, ta vëmë në dukje më shumë, kryefjala del në fund, pas foljes: Mbi majat e thepësura të maleve u derdhën **rrezet** e diellit pranveror.

Ajo vihet në fillim të fjalive pyetëse të drejta:

Kush fluturoi i pari në hënë?

Cilët shkuan në ekskursion?

b) **Përshtatja e kryefjalës me foljen** (kallëzuesin). Kryefjala i përcakton foljes vetën dhe numrin (njëjës ose shumës ). Pra, folja përshtatet në vetë dhe në numër me kryefjalën:

**Nxënësi** përparon në mësim.

**Ai** mëson shumë

**Nxënësit** përparojnë në mësim.

**Ata** mësojnë shumë

Mund të zëvendësohet me një përemër vetor (të përemërzohet): **Besniku** punon në kopsht. **Ai** punon shumë.

## Shprehja gramatikore e kryefjalës

Kryefjala shprehet:

a) me një emër: Arta shkruan bukur. Dita sapo kishte nisur të zbardhte.

b) me një përemër: Ai ishte gazmor.

c) me një grup emëror: **Fytyra e tij e skuqur** tregonte shqetësimin shpirtëror.

d) me një pjesë të nënrenditur në fjalinë e përbërë:

U pa qartë se **kjo punë s` mund të bëhet**.

Në një fjali mund të ketë disa kryefjalë homogjene, që i përkasin të njëjtës foljeje, si p.sh.: Genci, Agimi dhe Petriti janë shokë të ngushtë.

# KALLËZUESI


Lexoni tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza dhe tregoni se çfarë shprehin ato.

Dafina **kishte hipur** në malin e Apolonisë që **të përgjonte** nga lart lëvizjet mbi fushën e përmytur. Sytë iu **vagëlluan** nga lotët dhe të mugëtit e mbrëmjes. **Brodhi** tatëpjetë kodrës dhe e **mbajti** frymën në buzë të kënetës. Që atje mund **të shihet** më mirë, në të ngrysurit e natës, që **tkurr** horizontin, ardhjen e lundrës me të shoqin dhe të birin...

Fjalët e shkruara me të zeza janë kallëzues (folje).

Tregoni në ç`kohë e mënyrë janë foljet. Ç`përfaqësojnë ato në fjali?

Folja në fjali përfaqëson **kallëzuesin**, atë që **thuhet për kryefjalën**.

Dallojmë dy lloje kallëzuesish 

Kallëzuesit e fjalive të mësipërme janë kallëzues foljorë dhe janë shprehur me folje veprorë dhe joveprorë.

Si kallëzues mund të jetë edhe një folje vetvetore: u lava, u veshja etj.; një folje pavetore: vetëtin, gjëmon, veso etj.; si dhe një shprehje foljore: kam frikë, mbaj mend, vë vesh etj.

## MBANI MEND

Kallëzuesi është foljor, kur shprehet me anë të një foljeje, përveç foljes jam (kur ajo nuk ka kuptim të foljeve: gjendem dhe ndodhem).

Kallëzuesi emëror shprehet me një **emër**, **mbiemër**, **përemër** apo me ndonjë **ndajfolje** të shoqëruar me **foljen këpujë jam**. P. sh.: Unë jam nxënëse e klasës së shtatë. Kjo fletore është imja.

Fjalitë që janë ndërtuar me foljet: bëhem, dukem, quhem etj., si dhe me foljen jam, përveç kryefjalës kanë edhe **kallëzuesor** (përcaktor kallëzuesor) të kryefjalës. P. sh.: Ai u bë i njohur. Agroni u zgjodh deputet.

## Ushtrime

1. Dalloni gjymtyrët kryesore në fjalitë e mëposhtme. Aeroplani ra në det. Nata po afrohet. Drita e ditës tretet dalëngadalë dhe mbi tjegullat e shtëpive, mbi fletët e pemëve, një ngjyrë manushaqeje shtrihet dhe i mbështjell. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza.

2. Formoni fjali me fjalët dhe grupet e fjalëve:

a)	anëtar	b)	jam
	shkencëtar		u larguan
	të gjithë		fluturoj
	pilot		nis të flas
	fëmijë		punoj
	shkrimtar		stina e vjeshtës

3. Ndërroni numrin e emrit ose të përemrit kryefjalë dhe bëni përshtatjen e foljes.

Kjo është e vetmja ndërtesë në lagjen tonë . Ai gjuan me zagarin e tij. Langoi po e ndiqte këmba – këmbës kaprollin. Mësuesi im është i sjellshëm. Ai foli bukur në miting. Uji i liqenit duket i pastër.

## KUNDRINORI


---

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza . Cilën gjymtyrë kryesore e plotësojnë ato?

“Ju , s` e keni parë **Zaverin** tonë se ç` vend i mrekullueshëm është! Unë shkoja kurdoherë kur isha i vogël. Harroja **shqerrat** dhe **më** rrëmbente bukuria e natyrës; liqeni, brigjet me atë gjelbërim të përhershëm të dëllinjave... Një ditë babagyshi **më** gjeti mu në majë të thepave të Zaverit . Ishte trembur shumë se mos rrëzohesha, prandaj **më** hoqi **veshët** keq e **më** këshilloi të mos rrija në vendet e rrezikshme.

Unë i kërkova **të falur** dhe i putha **dorën** .Atij **iu** bë qejfi shumë dhe **më** tregoi pastaj **këtë legjendë** të liqenit të Prespës”.

Fjalët e shkruara me të zeza janë kundrinorë. Këto fjalë janë përdorur në rasën kallëzore pa parafjalë, ndërsa fjala atij në rasën dhanore, po ashtu pa parafjalë. Këto fjalë kryejnë funksionin e kundrinorëve në fjali dhe janë gjymtyrë plotësuese të kallëzuesit.

Dallojmë dy lloje kundrinorësh 

## KUNDRINORI I DREJTË

Si e dallojmë?

Kundrinorin e drejtë e dallojmë për nga ndërtimi i tij. Ai është një emër, grup emëror ose përemër në rasën kallëzore pa parafjalë dhe gjendet me pyetjet: Kë?, Cilin?, Cilën?, Cilët?, Cilat?, që ia drejtojmë kallëzuesit.

P. sh., në fjalinë e parë: Kë?, ose Cilin s` e keni parë? – Zaverin.

Vazhdoni me pyetjet dhe gjeni edhe kundrinorët e tjerë në tekst.

Kundrinori i drejtë mund të shoqërohet edhe nga një trajtë e shkurtër e përemrit vetor në rasën kallëzore:

Ju e fituat edhe këtë ndeshje të rëndësishme.

E fituat me angazhimin tuaj.

Në përgjithësi, në të dyja këto raste theksi i fjalisë bie mbi veprimin që kryhet mbi foljen. Kur kundrinori i drejtë nuk shoqërohet nga një trajtë e shkurtër, atëherë theksi i fjalisë zakonisht bie mbi vetë kundrinorin e drejtë:

Puna sjell **përparim** e lumturi.

Kundrinori i drejtë është gjymtyrë e domosdoshme në fjali. Ai as mund të hiqet, as mund të zhvendoset lehtë pa e prishur kuptimin e fjalisë. P. sh.:

Skënderbeu u hodhi **një vështrim** ushtarëve të tij. Le ta heqim kundrinorin e drejtë e të shohim se a ka kuptim fjalia:

Skënderbeu u hodhi ushtarëve të tij.

**Kundrinor i drejtë mund të jetë:**

a) **emër në rasën kallëzore** në trajtën e shquar dhe të pashquar: Gjuha bashkon **kombin**.

b) **një grup emëror**: Ai mori **uratat e prindërve**.


c) **një përemër a trajtë e shkurtër e përemrit vetor** në rasën kallëzore: Unë po e marr **këtë**, e ti merre **atë**.

d) një pjesë e nënrenditur ffilluese e një fjalie të përbërë: E dimë se është i pasjellshëm.

### MBANI MEND

Kundrinori i drejtë është gjymtyrë plotësuese e kallëzuesit foljor dhe tregon sendin ose frymorin mbi të cilin bie veprimi i shprehur nga folja në formën veprore.

## KUNDRINORI I ZHDREJTË

Dallojmë dy lloje kundrinorësh të zhdrejtë 

### Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Në ç` rasë janë ato?.

Mësuesi u tha **nxënësve**: “Nesër të vini më herët në shkollë”.

Populli i dha ndihmë **kësaj shkolle**.

**Më të mirëve** u dhanë **shpërblime** dhe **fletëlavdërime**.

**Atij** i erdhi keq për **mësuesin**.

Fjalët e shkruara me të zeza janë kundrinorë të zhdrejtë pa parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë është gjymtyrë e dytë e **domosdoshme** në fjali. Ai shoqërohet gjithnjë nga një trajtë e shkurtër e përemrit vector në rasën dhanore. Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet edhe vetëm me trajtë të shkurtër. Ai është plotës kryesor në fjali.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë është **më i lirë për të lëvizur brenda fjalisë**, sesa kundrinori i drejtë. Ai qëndron zakonisht pas foljes, por mund të dalë edhe para saj: Dritës ia trego të gjithë gjërat. Asaj ia trego gjërat fill e për pe.

### Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë është: një emër, një grup emëror ose një përemër në rasën emërore, kallëzore ose rrjedhore, i paraprirë gjithmonë nga një parafjalë. Ai u përgjigjet pyetjeve: Nga kush?, Nga se?: Me kë?, Për kë? etj.

Besa kujdeset shumë për **nënë**n e saj.

Gjyshi u shqetësua shumë nga **sjellja** e nipit.

Njeriu me vullnetin e tij bën çudira.

Këto ngjarje mbështeten mbi ndodhitë e vërteta.

Foljet që mund të marrin një kundrinor të drejtë janë kalimtare: Lexoj një roman. Ndërsa foljet që shprehin veprime që mbeten tek ai që i kryen e që s`mund të kalojnë, të bien mbi një send ose frymor janë folje jokalimtare. Këto folje nuk mund të lidhen me një kundrinor të drejtë.

### MBANI MEND

Fjalët a grupet e fjalëve mbi të cilin drejtohet veprimi i shprehur nga folja quhen kundrinorë të zhdrejtë.

### Ushtrime

1. Gjeni kundrinorët në paragrafin e dytë të tekstit dhe nënvizojini kundrinorët e drejtë me një vijë, ndërsa të zhdrejtit me dy vija.

2. Plotësoni fjalitë me gjymtyrët gjegjëse.

Arsimtari \_\_\_\_\_ kontrolloi \_\_\_\_\_ e shtëpisë.

Kopshtari mbjell \_\_\_\_\_ në kopsht. Ata \_\_\_\_\_ lavdëruan \_\_\_\_\_ më të zellshëm. \_\_\_\_\_ u dhanë \_\_\_\_\_ me tregime interesante.

3. Zvogëloni fjalitë. Provoni të hiqni kundrinorët, a mund të qëndrojnë fjalja?

Ato lajme u niseshin me shpejtësi princave shqiptarë në krahina të tjera Këta punëtorë u jepnin jetë makinave. Infermieren e pavijonit të gjithë pacientët e thërrisnin “ Trimëreshë”.

4. Dalloni llojet e kundrinorëve.

Në qiell hëna dukej sikur ndiqte hapin tim.

U nisa, u nis edhe ajo me çapin tim.

Ngjarjet e mëdha popullore e ushqejnë shpirtin e artistit.

Për gjuhën tonë letrare kanë punuar breza të tërë patriotësh, shkrimtarësh, studiuesish.

5. Shndërroni fjalitë në mënyrë që kundrinori i drejtë të bëhet kryefjalë.

Kryetari e lavdëroi këshilltaren e tij.

Rrezet e diellit përflakën qiellin e kaltër.

Albana përshëndet shoqet e klasës.

Era e ftohtë dhe e furishme e dimrit theu degët e pemëve.

# RRETHANORI

---

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Ç'funksion kryejnë ato në fjali?

Në **pranverë** fusha e gjerë ishte veshur me ngjyra dhe me blerim të freskët.

Pikat e shiut rrokulliseshin **në faqet e pjerrëta** të çatisë, duke shpejtuar të binin **sa më parë në tokë** e pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin **prapë atje lart, në qiellin e kaltër**. Porsa pushoi shiu, bujqit shkuan **në fushë**. Ata ia filluan punës menjëherë.

Fjalët e shkruara me të zeza tregojnë rrethanat në të cilat kryhet një veprim, prandaj quhen rrethanorë.

Shprehja e rrethanave në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet rrethanorëve:

- **me anë të ndajfoljeve dhe të shprehjeve të ndryshme ndajfoljore: Dje ra shumë shi.**

- **me emra me ose pa parafjalë: Në vjeshtë vilen pemët.**

- **me forma të pashtjelluara të foljes (me paskajore, përcjellore dhe pjesore): Ecte duke kënduar.**

Me një grup emëror : **Të dalim jashtë qytetit e të shkojmë buzë ndonjë lumi për t`u freskuar pak.**

një pjese të nënrenditur rrethanore në fjalinë e përbërë: **Ai ktheu kokën andej nga dëgjoheshin zërat.**

Sipas rrethanës që tregojnë rrethanorët marrin edhe emra:

rrethanor vendi: **Bujqit shkuan në fushë.**

rrethanor kohe: **Kam lindur në muajin shtator.**

rrethanor mënyre: **Fliste bukur.**

rrethanor shkaku: **Fytyra iu çel nga gëzimi.**

rrethanor qëllimi: **Kemi ardhur në shkollë për mësim.**

rrethanor sasië: **Flisnin shumë.**

# KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË RRETHANORËVE

Rrethanorët dallohen nga kundrinorët (pa parafjalë) për këto veçori:

a) Nuk janë gjymtyrë (plotës) kryesore të fjalisë: ata mund të hiqen dhe fjalia të mbetet e pranueshme. P. sh.:

Ai e bën **mirë** detyrën.

Ai e bën detyrën.

b) Janë gjymtyrë të lëvizshme: në të shumtën e rasteve mund të zhvendosen brenda fjalisë pa ndryshuar dukshëm kuptimin e saj:

Në oborrin e shkollës ishin mbledhur **shumë prindër**.

**Shumë prindër** ishin mbledhur në oborrin e shkollës.

c) Nuk pësojnë asnjë ndryshim, kur fjalia kthehet nga veprorë në pësorë. P.sh.:

Siana i pëlqeu shumë **vallet popullore**.

**Vallet popullore** u pëlqyen shumë nga Siana.

Heqja e kundrinorit si plotës kryesor, ndonjëherë, e ndryshon kuptimin e fjalisë. P.sh.: Shkumbini hoqi **xhaketën**, përveshi **llërët** dhe i shkumëzoi **duart** me sapun.

Po t`i heqim nga kjo fjali kundrinorët e drejtë **llërët**, **xhaketën**, **duart** vështirësohet kuptimi i saj. P.sh.: Shkumbini hoqi, përveshi dhe (i) shkumëzoi me sapun.

## MBANI MEND

Rrethanori tregon një rrethanë të kryerjes së veprimit (vend, kohë, mënyrë, shkak etj.)

Mund të hiqet me lehtësi nga fjalia pa e prishur kuptimin e saj.

Mund të zhvendoset brenda fjalisë shumë më shpesh e më lehtë.

Nuk pëson asnjë ndryshim gjatë shndërrimit pësor të një fjalie veprorë.

Mund të plotësojë si foljet kalimtare, ashtu edhe foljet jokalimtare.



## Ushtrime

1 . Gjeni rrethanorët në tekstin e mëposhtëm dhe thoni me se janë shprehur dhe nga ç` gjymtyrë varen.

Në oborrit e shtëpisë së vjetër, pranë dritares gjelbëronin dhe fëshfërinin degët dhe gjethet me erë të një lisi të madh shekullor.

De Rada rrinte tani në shtratin e fortë. Ai jetonte në shtëpinë e thjeshtë të një bariu arbëresh.

U dëgjua një trokitje në dritare.

Ja,, po çohem tani !

2. Thoni ç` rol luajnë në fjali fjalët a grupet e fjalëve me shkronja të zeza. Provoni t`i hiqni ato. A është e pranueshme fjalia? Diskutoni dhe argumentoni mendimin tuaj.

Era lëvizte degët e një plepi të lartë.

Genti i pëlqente shumë këngët popullore.

Që prej asaj dite e takuam më rrallë Mirlindën.

Në fund tub oborrit, nën drurin e qershisë, pashë një grua plakë.

3. Fjalitë e mëposhtme shndërrojini nga veprorë në pësorë dhe shkruajini në fletore. Vëreni se ç` ndodh me kundrinorin e drejtë, me kryefjalën dhe me rrethanorin.

Dje Kryesia e LASH-it shpërbleu mësuesit më të mirë.

Rrezet e diellit e çanë në dy tri vende vellon e hollë të reve.

Javën e kaluar skuadra juaj e mundi skuadrën kundërshtarë.

Mjeku e kontrolloi pacientin.

Shembull: Mësuesit më të mirë dje u shpërblyen nga Kryesia e LASH-it.

# PËRCAKTORI

---

- Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'pjesë të ligjëratës janë fjalët që shoqërojnë emrat në grupet emërore?

Ishte pak a shumë siç e kisha parafytyruar. Një **pallat i vjetër**, **ngrehinë hijerëndë** që të kujtonte një **kështjellë mesjetare**... Kapërcejmë **pragun e portës** dhe futemi në oborr. **Ndërtesa trekatëshe** është e rrethuar nga **oborri i madh** ku lëshojnë hije **drurë me kurora** të gjera. Diku përpara vjen **çezma**, një **çezmë** e lartë, ndërtuar me **pllaka guri** të skalitur. Ky ishte një nga **ato vendet** e pëlqyera të Milloshit. Afrohemi dhe pimë ujë te **çezma prej metali**, e nxirë nga koha e gjatë, ku ka shuar etjen sa e sa herë Milloshi.

Në tekstin e mësipërm ka disa grupe emërore: **pallat i vjetër**, **oborr i madh**, **ngrehinë hijerëndë**, **kështjellë mesjetare**, **pragun e portës**, **drurë me kurora**, **çezma prej mali**, **ato vendet**.

Fjalët që e shoqërojnë emrin në grupet emërore quhen **përcaktorë**. Përcaktorët shprehen me **emra**, **mbiemra**, **numërorë**, **përemra** dhe me **një pjesë të nënrenditur përcaktore**.

## EMRI SI NJË PËRCAKTOR I NJË EMRI BËRTHAMË

- Në tekstin e mësipërm gjeni emrat dhe tregoni në ç'rasë janë. Çfarë roli luajnë ata ndaj emrit bërthamë?

Emri në rolin e një përcaktori mund të jetë në rasën:

a) **gjinore**, **rrjedhore e kallëzore pa parafjalë** e në këtë rast ai tregon:

- **përkatësi**: Shtëpitë e fshatrave janë të vogla.

- **cilësi**: Ajo ishte e gojës e s'linte njeri t'i dilte përpara.

- **vend a origjinë**: Këto janë mollët e përmendura të Prespës.

Kam blerë ullinj Berati.

- **lëndë**: Kishte blerë vathë argjendi

- **përmbajtje**: Bleu një thes miell.

b) emërore, kallëzore e rrjedhore me parafjalë e në këtë rast ai tregon:

- **karakteristikë a cilësi:** Ajo në Amerikë do të punojë në një fabrikë tekstili.

Kjo është fjalë me vend.

- **lëndë:** Do të jap një sheqerkë me mjaltë. Shtëpia prej guri është e fortë..

- **përmbajtje:** Gjyshja i vinte gjithmonë përpara një pjatë me fiq.

- **synim:** Në zemër i vlonte dëshira për punë.

- **vend:** U bë fjalë për një shkollë në malësi.

Nga shembujt e mësipërm shihet se emri përcaktor vë në marrëdhënie sendin ose frymorin.

## MBIEMRI SI PËRCAKTOR

Vëreni edhe një herë shembujt e tekstit të mësipërm. Ç'emërtojnë fjalët i vjetër, hijerëndë, i madh?

Mbiemri, si përcaktor i emrit, emërton (tregon) një cilësi, një karakteristikë (formë, ngjyrë, madhësi) të një frymori, sendi a dukurie të emërtuar nga emri.

Mbiemri i vendosur para ose pas emrit, i cili është i lidhur ngushtë me emrin, quhet edhe **epitet** i emrit.

Përcaktori i shprehur me mbiemër mund të jetë:

- **i paveçuar**, kur lidhet drejtpërdrejt me emrin nga i cili varet dhe shqiptohet pa pauzë. P.sh.: Drita e fortë na i verboi sytë. Puna e mirë lavdërohet nga të gjithë.

- **i veçuar**, kur nuk lidhet me emrin që përcakton. P.sh. **I kënaqur** shumë, trajneri fluturonte nga gëzimi. Dini, **i dëshpëruar**, përplasi shkopin pas raftit.

Mbiemri kur është i veçuar prej emrit shqiptohet me pauzë, ndërsa në gjuhën e shkruar ndahet me presje.

Përcaktori i shprehur me mbiemër të nyjshëm përshtatet me emrin në **gjini**, numër dhe në **rasë**: djalë i mirë, vajzë e mirë, djalit të mirë, vajzës së mirë, djem të mirë, vajza të mira; por kur shprehet me një mbiemër të panyjshëm përshtatet me emrin vetëm në gjini dhe në numër: djalë besnik, vajzë besnike, djem besnikë, vajza besnike.

## NDAJSHTIMI

Vëreni fjalët e shkruara me të zeza në fjalitë e mëposhtme. Në ç'rasë janë ato? Ai ka lindur në muajin maj.

**Nënë** Tereza u shqua për bamirësi.

**Usta** Dinia u nis për në mal.

E lexova dy herë romanin “**Gjenerali i ushtrisë së vdekur**”.

Migjeni, poeti i mjerimit, vdiq i ri.

Fjalët e shkruara me të zeza janë emra. Ata u janë ndajshtuar emrave-bërthamë, dhe i përcaktojnë ata. Pra, janë ndajshtime.

Ndajshtimi është një lloj **përcaktori** që shënon të njëjtin send a dukuri që shënon edhe emri a grupi emëror që ai përcakton. Kështu emrat **maj, nënë, usta** përcaktojnë emrat **muajin, Tereza, Dinia** dhe janë gjithmonë në rasën emërore, në trajtën e pashquar.

### Llojet e ndajshtimit

Ndajshtimi mund të jetë i **veçuar**, ose i **paveçuar** nga emri - bërthamë.

Kur është i veçuar ndahet me presje dhe vjen pas emrit që përcakton :

Psh. Liria, **motra më e madhe e Lirimit**, është profesoreshë.

Migjeni, poeti i mjerimit ,vdiq i ri .

Ndajshtimi i **paveçuar** qëndron para dhe **pas emrit** që përcakton dhe zakonisht shprehet me një emër të përgjithshëm që tregon **profesion, titull, gradë**: **Profesor Çabeji** është gjuhëtar i dalluar. Ndërsa kur ndodhet **prapa** shprehet me **një emër të përveçëm** që tregon emrin e një vepre, rruge shkolle etj. Psh. : Këshilli i komunës **Saraj** bëri mbledhjen e parë. Lexova romanin „Afërdita përsëri në fshat”.

Kujdes!

Ndajshtimi i paveçuar që tregon emrin e përveçëm të një vepre ose të një shkolle, rruge, gazete etj. Vihet gjithmonë midis thonjzash dhe fillon me shkronjë të madhe.

## PËREMRI SI PËRCAKTOR

Funksionin e përcaktorit e kryejnë përemrat:

- a) pronorë,
- b) dëftorë,
- c) pyetës dhe
- ç) të pacaktuar.

a) Mbarë populli ynë, të gjithë intelektualët tanë krenohen me rilindësit e tyre.

Me një brengë të madhe në zemër u nda nga njerëzit e vet.

b) Të të thotë miku një fjalë të tillë është një gjë e madhe.

c) Në cilën shkollë e ke djalin? Për cilat vajza po flet ti?

ç) Vita bluante të tjera mendime në tru e të tjera ndjenja në zemër.


Ashtu si edhe mbiemrat e nyjshëm, edhe përcaktori i shprehur me përemër përshtatet në numër, gjini dhe në rasë me emrin e përcaktuar. P. sh.:

Në librin e tij mund të lexosh poezi shumë të bukura.

Librat e tyre janë mjaft tërheqës.

**Kujdes!**

Kur emri i gjinisë mashkullore ndërron gjininë në shumës, përcaktorët e tij mbiemra kalojnë në gjininë femërore. P. sh.:

Vend i bukur  vende të bukura  
këto vende  
këto vende të bukura

## NUMËRORI SI PËRCAKTOR

**Rikujtohuni !** Ç` shpreh numërori?

Numërori përcaktor shpreh sasinë e sendeve, dukurive ose frymorëve të treguar nga emri që përcakton. P. sh.:

Tre njerëz duken te maja e bregut. Erdhën tri shoqe të reja në klasën tonë.

Skuadra jonë ka 22 lojtarë. Njëzet e tri nxënës të shkollës sonë marrin pjesë në garat republikane.

Nga numërorët vetëm tre/ tri përshtaten sipas gjinisë së emrit që përcaktojnë: Erdhën tre djem dhe tri vajza.

### **MBANI MEND**

Përcaktori i shprehur me mbiemër shpreh një cilësi të sendit ose frymorit të treguar nga emri që përcakton.

Ai mund të jetë i veçuar dhe i paveçuar.

Në të shkruar, përcaktori i veçuar ndahet gjithmonë me presje.

Përcaktori i shprehur me mbiemër, përemër, numëror, përshtatet me emrin:

- kur është mbiemër i nyjshëm dhe përemër, në gjini, numër dhe rasë;

- kur është mbiemër i panyjshëm, në gjini dhe në numër. Kur është numërori tre/ tri, në gjini.

# PËRCAKTORI I SHPREHUR ME FORMË TË PASHTJELLUAR

## Përcaktori i shprehur me pjesore

Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç` funksion kryejnë ato në fjali?

U afrua me të shpejtë një djalë i ri, **veshur** si qytetar. Burri kishte një kostum të zi, **qepur** si që moti . Nga brezi i pishave, **ngarkuar** me dëborë, frynte një thëllim i lehtë që të shponte fytyrën si me gjilpërë.

Fjalët e shkruara me të zeza janë pjesore. Ato kryejnë funksionin e një përcaktori që është i ngjashëm më pjesën e nënrenditur të fjalisë së nënrenditur përcaktore. Kështu pjesorja **ngarkuar** mund të kthehet në: **që ishte ngarkuar** me dëborë -

Pjesë e nënrenditur e fjalisë kryesore – Frynte një thëllim i lehtë

## Përcaktori i shprehur me paskajore

Përcaktori shprehet edhe me një paskajore, p.sh.:

S` bëri punë **për të qënë**.

Dyshimi është rruga **për të gjetur** të vërtetën .

## Ushtime

1. Dalloni përcaktorët dhe thoni me çfarë janë shprehur.

...Kushedi sa kohë të shkuara, ndofta njëmijë vjet më parë, gojë pas goje tregojnë se ky liqen ka qenë i tëri fushë, një fushë pjellore, që e kishin zili të gjithë. Në të bëhej dardha naa, sa një shtambë uji, e molla naa, sa një plloskë verë... Çdo fshat kishte nga një krua me dhjetë sylynjarë me ujë të pastër qelibar e të ftohtë akull. Në këto kroje mbrëmjeve e ditëve të festave mblihdeshin çupat e fshatit, mbushnin ujë, kuvendonin sa kuvendonin e ia merrnin këngës, hidhnin valle!

*Sipas S. Spasses*

2. Shkruani në fletore shumësin e grupeve të fjalëve dhe formoni fjali me to.

ujë i pastër	vend i mrekullueshëm
metal i çmuar	mall i shtrenjtë
film interesant	shesh i gjerë
aparaturë elektronik	gëzim i madh

3. Zgjidhni katër nga emrat e mëposhtëm dhe formoni fjali duke i shtuar një ndajshtim.

shkolla	rruga	lagja
poema	tregimi	romani
filmi	teatri	revista

# FJALIA E PËRBËRË

## FJALIA E THJESHTË DHE FJALIA E PËRBËRË

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni nga sa folje kanë ato. Vëreni fjalitë nën a) dhe nën b).

a) Po e **dua** detin.

Deti është si një **nënë** zemërgjerë.

Mallkimi i nënës **të zë**.


b) Mua deti kurrë s'më **ka mallkuar**, se unë nuk **jam zemëruar** me të...

Mora një levrek të madh nga ata që **kisha nxjerrë**, i çava barkun dhe i **futa brenda** një dinamit të tërë.

Tri fjalitë e mësipërme, nën a) janë fjali të thjeshta, sepse kanë vetëm nga një folje (kallëzues) në një nga mënyrat vetore. Ndërkaq, fjalitë nën b) janë të përbëra, sepse secila fjali ka më shumë se një folje në një nga mënyrat vetore.

Fjalja e thjeshtë apo pjesë e fjalisë së përbërë quhet ajo që ka vetëm një folje në një nga gjashtë mënyrat vetore: dëftore, lidhore, dëshirore, kushtore, habitore dhe urdhërore, ndërkaq format e pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores e mohores nuk mund të jenë bërthama fjalie dhe si të tilla nuk formojnë as fjali, as pjesë të fjalisë së përbërë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.

Karakteristikat e veçantat dhe të përbashkëta ndërmjet fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë



Të dy llojet e fjalive kanë të përbashkëta:

- a) kumtojnë një përmbajtje të plotë,
- b) gjenden ndërmjet dy pushimeve të gjata,
- c) kanë intonacion të përfunduar.

### MBANI MEND

Fjalja e thjeshtë është ajo pjesë e fjalisë që ka vetëm **një folje** në një nga 6 mënyrat vetore. E këto janë: **mënyra dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore** dhe **urdhërore**. Ndërkaq format e **pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores** e **mohores nuk mund të jenë bërthama fjalie** dhe si të tilla nuk formojnë as fjali as pjesë të fjalisë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.

Fjalja e përbërë quhet ajo fjali e cila përbëhet të paktën nga dy ose më shumë pjesë fjalish (ka dy e më shumë folje) në një nga mënyrat vetore.

Fjalitë e përbëra janë dy llojesh: a) fjali të përbëra me bashkërenditje dhe b) fjali të përbëra me nënrenditje.

## FJALIA E PËRBËRË ME BASHKËRENDITJE DHE ME NËNRENDITJE

T'i analizojmë fjalitë e përbëra.

1. Mora frymë thellë dhe me shpejtësinë dhe forcën e predhës **u krodha** në thellësi.
2. Mua deti kurrë s'më **ka mallkuar**, se unë nuk **jam zemëruar** me të...

Që të dyja fjalitë janë fjali të përbëra, sepse kanë nga dy folje në mënyrën dëftore dhe që të dyja kanë intonacion të përfunduar. Po ku shihet ndryshimi ndërmjet tyre?

Në fjalinë e parë, që të dyja pjesët janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe mund të përdoren edhe më vete, si fjali të thjeshta: Mora frymë thellë. Me shpejtësinë dhe forcën e predhës u krodha në thellësi.

Të përdorura si pjesë të një fjalie të përbërë, ato lidhen me lidhëzën bashkërenditëse **dhe** kjo quhet fjali e përbërë me bashkërenditje.

Kjo fjali e përbërë përbëhet nga **dy pjesë të pavarura**.

Në fjalinë e dytë, pjesët nuk janë të pavarura nga njëra - tjetra dhe nuk mund të përdoret secila si fjali e thjeshtë, prandaj kjo fjali quhet **fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur**. Pjesa e parë e fjalisë që mund të qëndrojë më vete është **pjesë kryesore**, kurse pjesa e dytë është pjesë e varur ose pjesë e nënrenditur.

Në këtë fjali pjesa kryesore është **Mua deti s'më ka mallkuar**, kurse pjesa e



nënrenditur se unë nuk jam zemëruar me të.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dallohen nga ato me nënrenditje edhe në pikëpamje të përdorimit të lidhëzave. Fjalitë me bashkërenditje nuk mund të fillojnë me lidhëz, ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje mund të fillojnë edhe me një lidhëz nënrenditëse. P.sh.: Dhe me shpejtësinë dhe forcën e predhës u krodha në thellësi... mora frymë thellë, nuk mund të fillojë kështu.

Pjesët e bashkërenditura kanë vend të caktuar në fjalinë e përbërë dhe ato nuk mund të futen në mes të pjesës tjetër, kurse pjesët e nënrenditura mund të futen para dhe pas pjesës kryesore.

**Para se të bëjë mjaltin, bleta bën dyllin.**

**Bleta, para se të bëjë mjaltin, bën dyllin.**

## LLOJET E FJALIVE TË PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE

Një budalla hedh një gur në lumë dhe njëqind të mençur s'mund ta nxjerrin. Ose nisemi tani, ose nuk shkojmë fare. Fjala e keqe të verbon, kurse fjala e mirë të shëron.

Mësoj shumë, prandaj kaloj mirë.

Të gjitha fjalitë e mësipërme janë fjali të përbëra me bashkërenditje, të cilat dallohen si për nga kuptimi, ashtu edhe për nga mjetet e lidhjes.

Kështu, sipas marrëdhënieve që vendosen në mes të pjesëve në fjalitë e përbëra me bashkërenditje dallojmë këto lloje fjalish:

**Fjali me bashkërenditje shtuese,**

**Fjali me bashkërenditje veçuese,**

**Fjali me bashkërenditje kundërshtore dhe**

**Fjali me bashkërenditje përmbyllëse.**

### Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese

Fjali e përbërë me bashkërenditje shtuese quhet ajo fjali që përbëhet prej dy a më shumë pjesësh të cilat bashkohen me lidhëzat **shtuese e, edhe, dhe, edhe – edhe, as – as, jo vetëm... por edhe**. P.sh.: **As nuk erdhi në dasmë, as nuk na lajmëroi.**

**Jo vetëm që nuk shkoi në punë, por as nuk u paraqit fare.**

**Blerina edhe mëson rregullisht, edhe merret me sport.**

Para pjesës së dytë të lidhëzave të përsëritura dhe para pjesës së dytë të lidhëzave të dyfishta gjithmonë vihet presje.

## Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese shprehin veprime nga të cilët mund të realizohet vetëm njëri prej tyre. Ato bashkohen me lidhëzat bashkërenditëse: **ose, o, apo, a, ose...ose, ja**. Psh.: **O** mëso si duhet, **o** lëri studimet. **Ja** të punojmë siç duhet, **ja** të pushojmë. Do rrish, **apo** do të shkosh?

Pjesët e fjalive që bashkohen me lidhëzat e përsëritura ndahen me presje.

## Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore janë fjali që shprehin veprime që kundërshtojnë njëri-tjetrin. Pjesët e tyre bashkohen me lidhëzat bashkërenditëse: **po, por, mirëpo, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, ndërsa etj.**

Unë e lëshoj, por s'më lëshon ai. Romanin e lexova një herë, po s'e kuptova mirë.

E ëma e kishte dërguar të birin te një usta për të mësuar zanatin, mirëpo ustai nuk ia kishte mësuar as gjysmën e zanatit.

Pjesët e fjalisë të përbërë me bashkërenditje kundërshtore ndahen me presje.

## Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse

Fjali me bashkërenditje përmbyllëse quhet fjalia e përbërë, ku pjesa e dytë e së cilës shpreh përfundimin e asaj që është thënë në pjesën e parë. Pjesët bashkohen me lidhëzat bashkërenditëse përmbyllëse: **andaj, prandaj, ndaj, pra**.

Ai mësoi tepër, prandaj u lodh shumë. Unë do ta hap një shtëpi të re, pra dua të blej ca mobilie.

### MBANI MEND

Fjalitë mund të jenë të thjeshta dhe të përbëra.

Fjalitë **e thjeshta** kanë **vetëm një folje** në njërën nga mënyrat vetore, ndërsa fjalitë e përbëra kanë **dy ose më shumë folje** në njërën nga mënyrat vetore.

Fjalitë **e përbëra** me bashkërenditje përbëhen nga **dy pjesë të pavarura**, ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje përbëhen nga **një pjesë kryesore** dhe nga **një pjesë e nënrenditur**.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje janë :

Fjalitë **shtuese** të cilat bashkohen me lidhëzat **e, dhe, edhe, edhe..edhe, as, jo** **vetëm... por edhe.;**

Fjalitë **veçuese** bashkohen me lidhëzat **ose, o, apo, a, ose...ose;**

Fjalitë **kundërshtore** bashkohen me lidhëzat: **po, por, mirëpo, kurse etj., dhe**

Fjalitë **përmbyllëse** që bashkohen me lidhëza përmbyllëse: **prandaj, andaj, ndaj, pra.**

## Ushtrime

1. Dalloni fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra dhe tregoni cilat janë me bashkërenditje e cilat me nënrenditje.

Punëtorët kishin ngrënë darkë dhe po pushonin.

Meqë ishte ftohtë ata ndiznin edhe zjarr.

Afroheshin rreth zjarrit dhe bisedonin.

Një djalë i vogël u ndal para një librarie dhe atje takoi një shoqe të klasës.

Kur arrita në vendlindje, të gjithë më pritën me gëzim.

Dheu mëmë ka qenë i shtrenjtë për jetë për shqiptarët, ndaj Jani Vretoja krijoi fjalën e bukur “mëmëdhe...”.

2. Nga fjalitë e thjeshta krijoni fjali të përbëra me bashkërenditje shtuese dhe kundërshtore. Shkruani fjalitë e formuara.

Drini i Zi kishte veshur një cipë akulli. Nën cipën e akullit rridhnin ujërat.

Erdhën ditët e ngrohta. Kumbullat çelën lule.

Mos prit të të kërkojë shoku. Kërkoje ti atë.

kishte kaluar mesnata. Mua nuk më flihej.

3. Shkruani nga dy fjali të përbëra me bashkërenditje veçuese dhe përmyllëse.

# TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

## DISKUTIMI

Kujdestari i klasës nuk është i kënaqur me suksesin e arritur nga nxënësit e klasës së tij në gjysëmvetorin e parë. Për këtë çështje vendosi të bisedojë me nxënësit në orën e kujdestarisë. Para nxënësve parashtrroi këto pyetje për diskutim:

Ku qëndron shkakun i këtij mospasësi, te prindërit a te arsimtarët?

Sa jeni angazhuar për mësim?

A i keni kryer detyrat e shtëpisë rregullisht?

A janë përgaditur sa duhet arsimtarët gjatë procesit të mësimdhënies?

A ju kanë ndihmuar sa duhet prindërit?

Të diskutojmë rreth këtyre çështjeve dhe të sjellim një përfundim për të diskutuar më tej me prindërit tuaj në një mbledhje prindërore.

Për të diskutuar si duhet ekzistojnë disa rregulla.

### Rregullat e diskutimit

Çdo njeri duhet të përpiqet të marrë pjesë në diskutim.

Mendimi duhet shprehur shkurt e pa përsëritje.

Nuk duhet t'i ndërpresim të tjerët, kur flasin.

Të flasim kur na jepet fjala nga drejtuesi i diskutimit.

Duhet t'i dëgjojmë me vëmendje të tjerët, kur flasin.

Ndërsa të tjerët janë duke folur, mund të mbajmë shënime për disa çështje të parashtruara.

### Ç'është diskutimi?

Diskutimi është tërësia e mendimeve dhe e pikëpamjeve që paraqit dikush ose që paraqitin një grup njerëzish, për një çështje që shqyrtohet.

### Detyrë

Diskutoni rreth temës: Ç'është bërë për të përmirësuar suksesin e klasës sonë.

### Diskutimi dhe të shprehurit

Diskutimi është një lloj komunikimi që kryhet ndërmjet dy a më shumë personash për të shkëmbyer ide, informacione dhe opinione për një fakt a ngjarje të caktuar.

*Çdo të thotë të bindësh dikë në një diskutim?* Do të thotë të japësh informacion, t'i kujtosh bashkëfolësit faktet e argumentet, t'i japësh atij fakte të reja, të panjohura duke dhënë edhe opinion vetjak për to.

Çdo diskutim mbështetet mbi tri elemente bazë, të cilat janë:  
faktet, argumentet dhe opinionet.

Një diskutim që mbështetet mbi faktet dhe argumentet, për të përballuar opinionet e pjesëmarrësve është i domosdoshëm dhe i frytshëm. Secili diskutant ka mundësi të pasurojë mendimin e vet me fakte të panjohura, të sjella nga pjesëmarrësit.

### **Tregim-i**

Një nga llojet e letërsisë epike narrative, formë e saj e vogël, vepër e vogël letrare që i kushtohet zakonisht një ngjarjeje të veçantë në jetën e njeriut, pa treguar në mënyrë të detajuar se ç'ka ndodhur me të para dhe pas kësaj ngjarjeje.

Tregimi dallohet nga novela, në të cilën zakonisht përshkruajmë jo një, por disa ngjarje, që tregojnë një periudhë të tërë në jetën e njeriut dhe në këtë ngjarje marrin pjesë jo një, por disa personazhe të përshkruar pak a shumë në mënyrë të detajuar. Arti i shkrimtarit në tregim konsiston në faktin se ai, në një episod të shkurtër nga jeta e njeriut, zbulon tiparet esenciale, tipike të jetës.

Tregime kanë shkruar: A. Çehovi, V. Kokona, Migjeni etj. Të faqja 108 të librit tuaj është "Barka e Xha Nuriut". Aty do ta gjeni kompozicionin e veprës letrare me të gjitha etapat.

### **Ritregimi**

Të ritreguarit do të thotë të përsëritet diçka me gojë ose me shkrim, një pjesë e lexuar ose e dëgjuar. E ritregojmë ngjarjen e tregimit ose të romanit.

Me anë të tregimit, kryesisht flitet për veprat letrare, njëkohësisht në to mund të bëhet edhe ritregimi, duke përshkruar personazhet e njerëzve. Shkrimtari përpiqet që këta njerëz, ose si i themi në letërsi, këto personazhe, t'i ritregojë sa më qartë. Në këtë mënyrë ne kemi mundësi të ritregojmë për personazhet si punojnë, si bisedojnë, si veprojnë etj.

Në shumë tregime, gjatë ritregimit ne mund të nxjerrim një përfundim se personazhet janë njerëz që punojnë dhe veprojnë. Kjo mund të shihet në f. 108 "Barka e Xha Nuriut" dhe në shumë vepra të tjera.

### **Procesverbali**

Procesverbali është një fletë a fletore ku shënohen ato që thuhet a vendosen në një mbledhje. P.sh. në klasën tuaj zgjidhni kryesinë e klasës, shumë nxënës bisedojnë dhe propozojnë kurse njëri mban procesverbalin. Procesverbal mbahet në parlament, komunë, këshillin e shkollës etj.



## PËRMBAJTJA:

7	Fjala .....	Abdylazis Islami
8	Mësuesi im i parë .....	Petraç Zoto
11	Malli i atdheut .....	Faik Konica
13	Arbneshës Zarë.....	Murat Isaku
15	Fshati im .....	Sterjo Spasse
17	Tanushën vetë e kam pa .....	Këngë kreshnike
20	Kënga ime më e bukur.....	Hivzi Sylejmani
23	Kopshti i dashurisë .....	Andon Z. Çajupi
25	Përtej valëve të kohës .....	Mitrush Kuteli
27	Të dua – Kosovë! .....	Din Mehmeti
29	Duhanmbledhësit.....	Koço Racin
31	Gjeniu i anijes .....	Lazgush Poradeci
33	I biri i gjahtarit plak .....	Xhek London
35	Baladë nizamësh .....	Ismail Kadare
38	Gavroshi i shqetësuar .....	Viktor Ygo
41	Lagja e varfun .....	Migjeni
43	I lumtur është ai që s'ka zili .....	tregim popullor
45	Qyteti i lashtë .....	Martin Camaj
48	Zbulimi i një fshehtësie shekullore .....	Petro Marko
52	Akili mund Hektorin .....	Homeri
55	Vjeshtë .....	Dhori Qiriaz
57	Mos i prek vizatimet e mia! .....	Astrit Bishqemi
60	Bobili dhe shoku .....	Sergej Jesenin
62	Ashti ynë .....	Enver Gjerqeku
64	Fotografia .....	Shpresa Vreto
67	Gjeniu i vogël!.....	H. Cvajg
70	Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu .....	Qerim Ujkani
72	Bilbili dhe sorrat .....	Fejzi Bojku
75	Djaloshi i gurtë .....	Vehbi Kikaj
77	Ikja .....	Zhyl Vern
80	Bagëti e bujqësia .....	Naim Frashëri
83	Don Kishoti pret me shpatë kokën e viganit.....	Miguel Servantes
86	Se dituria më e madhe gjendet në mendjen e popullit.....	popullore
91	Gjuha jonë .....	Fejzi Bojku
93	Nëna zemërfortë .....	përrallë

95	Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë.....	Ismail Kadare
99	Rrënkimi .....	Fahredin Gunga
101	Halili dhe Hajria .....	Kolë Jakova
105	Parathënie të Arbreshëvet .....	Gavril Dara (I riu)
107	Migjeni flet .....	Xhevahir Spahiu
108	Shtigjet e lirisë .....	Haki Stërmilli
110	Barka e xha Nuriut .....	Resul Shabani
113	Kënga e Serafinës dhe e shoqeve .....	Jeronim De Rada
114	Miku im Mitu .....	Abdylaziz Islami
117	Shpellë e Dragobisë .....	Fan S. Noli
119	Fshati i pesë kodrave .....	Nazmi Rrahmani
123	Trina .....	Ndre Mjeda
125	Vdekja e Ali Pashë Tepelenës .....	Sabri Godo
127	Jul Qesari .....	Viliam Shekspir
130	Penelopa njeh të shoqin .....	Homeri
133	Endësit e Shlezisë .....	Hajnrih Hajne
135	Deti s'ka mëshirë .....	Hajro Ulqinaku
138	Struga .....	Rolando Çerta
140	Aforizma .....	Sami Frashëri
143	Vështroj tokën .....	Jurij Gagarin
<hr/>		
149	Zanoret dhe bashkëtingëlloret	
152	Rrokja, theksi, intonacioni	
155	Shenjat e pikësimit	
157	Emri	
163	Përemrat pronorë dhe të pacaktuar	
169	Numërori	
171	Folja	
177	Mënyra lidhore dhe kohët e saj	
181	Kryefjala dhe kallëzuesi	
185	Kundrinori	
189	Rrethanori	
192	Përcaktori	
197	Fjalja e përbërë	
202	Të shprehurit dhe krijimtaria	